




ABC



Gjuha Shqipe 6



GJUHA SHQIPE 6

AUTORË

JORGJI DOKSANI

LOREDAN BUBANI

REDAKTORE LETRARE

Hajrije Hoxha

REDAKTORE PËRGJEGJËSE

Teuta Mati

Piktorë:

Llazar Taçi, Ikbal Beli, Heldi Pema

Art grafik e digjital:

Gert Alibali

Kopertina:

Besa Mati

Botim 2026

ISBN 9789994325139

SHBLSH E RE

Rruga Mine Peza, 1/1

Tiranë

www.shblsh.com

info@shblsh.com

SHBLSH e RE



ABC



PËRMBAJTJA

1. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

1. Dëgjojmë, flasim. Ushtrohuni	5
2. Dëgjojmë, flasim	8
3. Dëgjojmë, flasim. Mësojmë	10
4. Dëgjojmë, flasim. Teknologjia	12
5. Në ekskursion. Ushtrohuni	15
6. Peisazhi i pyllit të zgjuar - Dritëro Agolli	17
7. Dëgjojmë, flasim	20
8. Dëgjojmë, flasim. Ushtrohuni	24
9. Dëgjojmë, flasim. Ushtrohuni	28
10. 11. Tekstet ndryshojnë nga njëri - tjetri	30
12. Dëgjojmë, flasim. Ushtrohuni	34
13. Dëgjojmë, flasim. Ushtrohuni	36
14. Dëgjojmë, flasim	38
15. Interneti dhe shpërndarja e informacionit	39
	41

2. TË LEXUARIT E TEKSTEVE LETRARE DHE JOLETRARE

1-2. Naim Frashëri. Atdheu. Kthimi i Skënderbeut në Krujë	42
3. Asdreni. Pamje	45
4. Gavril Dara . Qiparizi dhe molla e bardhë	47
5-6. Ndre Mjeda. Zoga	49
7. Andon Zako Çajupi. Fshati im	51
8-9. Jeronim de Rada. Këngë për vdekjen e Skënderbeut	52
10. Pashko Vasa. Jetesa e shqiptarit	54
11. Mihal Grameno. Lufta e Mashkullorës	56
12-13. N. Frashëri, La Fonten, Krillov - Fabula	58
14. Fan. S. Noli. Dita e flamurit	62
15. Fishta. Gjuha Shqipe	64
16. Migjeni. Zoti të dhashtë	65
17-18. Lazgush Poradeci. Kroi i fshatit tonë. Dremi liqeri	67
19 -20. Mitrush Kuteli. Fuqia e Mujit	70
21. Populli. Kënga e Dhoqinës	73
22. Xhonatan Suift. Në qytetin e liliputëve	75
23 - 24. Daniel Defo. Robinsoni në ishull dhe "peshorja " e tij	78
25. Zhyl Vern. Në balonë	81
26 - 27. Xhek London. Kushtrimi i të parëve	84
28 - 29. Mark Tuen. Tomi dhe Haku marrin një ftesë	87
30 - 31. Edmond de Amiçis. Mirënjohja	90
32 - 33. Antuan De Sent Ekzyperi. Princi dhe Lulja	94
34 - 35. Odhise Grillo. Serafina	97
36 - 37. Ferenc Molnar. Djemtë e rrugës Pal	100
38. Naum Prifti. Bulina	102
39 - 40. Ismail Kadare. Kështjella. Magjia	104
41. Ana Frank. Pjesë nga ditari i Ana Frank	108

42 - 43. Ernest Heminguej. Krenaria e toreadorit	110
44 - 46. Xhani Rodari. Shtëpia fluturuese	111
47. Shtëpia fluturuese. Kuptojmë dhe analizojmë	112
48 - 49. Homeri. Akili mund Hektorin	116
50 - 51. Uilliam Shekspir. Jul Çezari	119
52 -54. Frederik Shiler. Vilhelm Tel	121
55-56. Kristo Floqi. Vëllazëri e interes	125
57 - 58. Aleksandër Mojsiu. Debutimi im në Burgteatër	127
59 -60. Spiro Çomora. Karnavalet e Korçës	130

3.TË KRIJUARIT ...

1-2 Krijimë në prozë apo në poezi	131
3-4. Si të përshkruajmë Ismail Kadare. Rugova	133
5. Teknika krijimi	134
6 -7. Intervista si krijim	136
8-9. Shkrimi paraqitës. Referati	138
10. Teksti shkencor	139
11. Teknika e përmbledhjes së një teksti. Nonda Bulka	141
12. Petro Marko. Përmbledhja e një teksti	142
13-14. Krijimi me fakte Historike. Moikom Zeqo	143
15. Përdorimi i fjalëve të huaja	144

4. PËRDORIMI I DREJTË I GJUHËS

1 - 2 Përdorimi i drejtë fjalëve në gjuhë të huaj (drejtshkrim)	145
3 - 4. Klasat e fjalëve	148
5. Emri	149
6. Emri. Trajta dhe gjinia.	150
7 - 8. Ushtrime	151
8 - 9 Numri i emrit	152
10 - 11. Rasat dhe lakimi i emrit	154
12. Përemri dhe llojet e tij	158
13 -14 Përemri lidhor dhe pronor	159
15 -16 Përemri pyetës	161
17-18. Përsëritje. Ushtrime	
19 -20 Folja dhe kohët e saj	164
21 - 22. Zgjedhimi i foljeve. Foljet ndihmëse	167
23 - 24. Mënyra dëftore, lidhore	171
25. Format e pashtjelluara. Skeda	174
26 -27. Përsëritje. Ushtrime	
28 -30. Ndajfolja dhe Drejtëshkrimi i saj	176
31 -32. Lidhëzat dhe Drejtëshkrimi i tyre	179
33 -34. Parafjala dhe Drejtëshkrimi i saj	180
36. Fjala dhe përbërësit e saj	181
37-38. Fjalë të parme dhe jo të parme. Rrënja e fjalës	183
39-40. Fjalët e thjeshta dhe të përbëra	184
41-42 Fjalja. Fjalja dhe përbërësit e saj. Llojet e fjalisë	185
43-45. Llojet e fjalisë sipas kumtimit. Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë	189
46 - 47. Kryefjala	192
48 -51 Kallëzuesi. Skedë	199
52-57 Përcaktori. Kundrinori. Rrethanori	208
58 - 59 Drejtëshkrim. Përdorimi i shkronjës së madhe. Drejtëshkrimi i zanoreve	210
60. Fusha leksikore e fjalës	212

- Flasin, dëgjojmë, kuptojmë dhe shkruajmë.
- Flasin, dëgjojmë dhe përgjigjemi.
- Përgjigjemi më mirë dhe me edukatë, kur e kuptojmë folësin.
- Të dëgjuarit, të folurit ndërmjet nesh, realizohet me teknika të ndryshme që përparojnë çdo ditë.

1

– Era, shkruaj më bukur dhe më pastër!




– Po, mësuese, do të mundohem më shumë.

2

Sot është ditë e gëzuar.
Mijëra fëmijë fillojnë vitin e ri shkollor.



Sot është ditë e gëzuar.
Mijëra fëmijë fillojnë vitin e ri shkollor.



3

– Era, u ktheve nga shkolla? A ke filluar t'i bësh detyrat me shkrim?



4

– Mos ki merak, babi. Detyrat bëra të parat. Tani do të vazhdoj me mësimet.



DËGJOJMË, FLASIM




LEXONI



A

- Alo!
- Stadiumi "Air Albania" ?
- Po. Urdhëroni.
- Ju lutem, jam një tifoz i futbollit. A mund të më thoni, nëse ka bileta për ndeshjen e kombëtares sonë me kombëtaren e Italisë, për kampionatin botëror?
- Ka bileta, por vetëm në tribunën anësore.
- Po për tribunën përballë saj?
- Jo, më vjen keq.
- Faleminderit, zonjë, mirupafshim!



B

- Alo, Dritan ?
- Po, Gimi.
- Dëgjo, Dritan! Jemi vonë. Ka rrezik të humbasim fillimin e ndeshjes.
- Po ç'po thua, o Gimi... Ndeshja do edhe një gjysmë ore që të fillojë.
- Sigurisht, po rrugët janë plot dhe është e pamundur që të arrijmë në kohë. Po që se do të vonohesh më shumë, unë do të nisem.
- Më prit edhe një minutë, Besnik, se erdha.
- Mirë, po vetëm një minutë, përndryshe ika.



6



PYETJE

1. Lexoni me kujdes dy bisedat telefonike dhe thoni për secilin rast:

- a. Kush flet?
- b. Me kë flet?
- c. Për çfarë flet?

2. A vini re dallime në mënyrën e të folurit në këto dy biseda telefonike?

3. Nga ndryshon mënyra e të folurit në këto dy biseda?

4. Bisedat janë zyrtare apo jozyrtare? Nga e kuptoni?

5. Kur bie telefoni cili thotë i pari: "alo", "urdhëroni", "po", "ju lutem"... ?

6. Ai që kërkon dikë në telefon, si vepron?

DËGJOJMË DHE FLASIM

• **Biseda telefonike mund të jetë:**

- zyrtare ose pune;
- jozyrtare ose private.

• **Mënyra e të folurit në telefon varet nga situata dhe personi të cilit i drejtoheni.**

• **Kur bie telefoni, ai të cilin e thërrasin, thotë i pari: "alo", "urdhëroni", "po", "ju lutem"... ;**

• **Ai që telefonon, mund të prezantohet dhe të thotë mbiemrin e familjes që kërkon. Mund të pyesë në fillim për mbiemrin e familjes që kërkon dhe pastaj të prezantohet.**



USHTROHUNI

1. Lexo bisedën telefonike.

- Mirëdita!
- Mirëdita!
- Ju jeni sekretarja e drejtorit të shkollës së mesme "Naim Frashëri"?
- Po. Urdhëroni.
- A mund të bisedojmë me drejtorin, zotin Pjetër Gjergji? E kërkon Zana Mirashi, sekretarja e Ministrisë së Arsimit.
- Drejtori tani ndodhet te fusha e sportit. A mund t'ju ndihmoj unë?
- Zonjë, në shkollën tuaj do të vijë një grup kontrolli dhe këmbim përvoje. Ju lutemi, që të njoftoni të gjithë mësuesit, në mënyrë që ditën e premtë, në datën 18 tetor, të jenë të

2. Biseda e mësipërme është:

a) zyrtare apo b) jozyrtare?

3. Në këtë përfundim keni arritur në bazë të:

- a) të folurit të bashkëbiseduesit.
- b) përmendjes së emërtimeve të institucioneve.
- c) përmendjes së emrit të bashkëfolësit.

- gjithë të pranishëm në sallën e mësuesve.
- Mësuesit do të njoftohen të gjithë në kohë. Faleminderit!
- Faleminderit ju për bashkëpunimin.
- Mirupafshim, zonja Zana!
- Mirupafshim!

Përgjigjuni pyetjeve:

- Cilët janë bashkëbiseduesit?
- Për çfarë bisedojnë?
- Cili është raporti midis dy bashkëbiseduesve?
- Si prezantohet në telefon sekretarja e ministrisë?
- Si i përgjigjet sekretarja e drejtorit të shkollës?
- Shpjego kulturën e të folurit të bashkëbiseduesve.

4. Zonja Zana Mirashi flet në emër të institucionit që përfaqëson.

Si e kuptoni?

- a) Nga mënyra e prezantimit.
- b) Nga mënyra se si i drejtohet bashkëbiseduesit dhe përdorimi i përemrit **Ju**.
- c) Flet në numrin shumëz dhe jo në njëzës.

Nënvizo përgjigjet e sakta

DËGJOJMË, FLASIM


Disa të dhëna:

Telefoni është shpikur më 1876 nga **Aleksandër Graham Bell**.

Përpjekjet e tij dhe të ndihmësit Thomas Uatson janë kurorëzuar me sukses në 10 mars 1876, kur është transmetuar fjalia e parë e plotë: "Uatson, eja këtu, kam nevojë për ty".

Sot ka më shumë se 800 milionë telefona në botë. Në telefon dridhjet e zërit tuaj kthehen në sinjale elektrike nëpërmjet mikrofonit. Telat i përcjellin sinjalet në largësi të mëdha, kështu që mund t'u telefononi njerëzve nga larg. Njeriu që thërrisni, e dëgjon zërin tuaj, sepse një altoparlant në telefonin e tij kthen sinjalet elektrike përsëri në tinguj. Sot për të dërguar thirrjet telefonike përdoren satelitët. Në orbitë ka rreth 8000 satelitë telekomunikimi. Biseda e parë telefonike me celular është bërë në prill të vitit 1973.

Aparati i parë peshonte afërsisht 1 kg. Dhjetë vjet më vonë u prodhua një aparat 2 herë më i lehtë dhe u instalua rrjeti i parë celular. Në atë kohë, telefoni celular ka qenë luks i vërtetë, kurse përdorimi masiv filloi disa vite më vonë.





DËGJOJMË

Vera dhe Mira janë shoqe.

Një ditë ato diskutojnë me njëra-tjetrën:

Vera: - Mariza Ikonomi është këngëtarja më e mirë.

Mira: - Për mua, jo. Jonida nga Tirana më duket se është më e ëmbël si këngëtare. Ajo e ndien këngën dhe është shumë e këndshme në skenë.

Apo jo, Vera?

Vera: - S'është e vërtetë, po flet kot. Mos u mërzit, por ti nuk merr vesh shumë nga muzika e lehtë.

Mira: - Më fal, Vera, po jo të gjithë duhet të pëlqejmë të njëjtën këngëtare.

Vera: - Mirë, mirë, po s'është ashtu për këtë rast.

Mira: -Ti mund të kesh të drejtë, po nuk është e thënë që të mendojmë të gjithë njëjloj. Po, megjithatë, s'kemi pse grindemi për këngëtarët.



PYETJE

1. Çfarë kërkon të marrë Mira nga shoqja e saj, Vera?
2. A e thotë ajo mendimin e saj drejtpërsëdrejti?
3. Çfarë thotë ajo në fillim?
4. Mira e mbyll bisedën miqësisht. Përse e bën këtë?

DËGJOJMË DHE FLASIM

1. Me shokët dhe shoqet duhet të jemi të sjellshëm.
2. Kur i kërkojmë një shoku ose një shoqeje diçka, duhet të dimë ta bindim dhe jo ta detyrojmë. Duhet ta lëmë të lirë që të vendosë vetë.
3. Nuk duhet të harrojmë të përdorim shprehjet: më falni, të lutem, a ka mundësi, faleminderit etj.



KUJDES

Për të shmangur konfliktet duhet:

1. Të përdorim një fjalor të zgjedhur.
2. Të tregohemi tolerantë, pra të sjellshëm, të butë.
3. Po qe nevoja, më mirë ta ndërpresim bisedën, për ta vazhduar kur të jemi të qetë.



1. Kërkoni në internet me tri fjalët kyçe: "fjalor shqip online". Sa rezultate u gjetën nga shfletuesi?
2. Zgjidhni faqen që ju përshtatet më shumë (p.sh.: www.fjalorthi.com) dhe kërkoni fjalët: "drejtpërsëdrejti", "tolerancë", "sjellshëm", "miqësisht", "zyrtare". Shkruani në fletore përkufizimet e tyre, duke u përpjekur që të kujtoni saktë kuptimin që lexuat.

Ftojme me shkrim

I dashur Jon,

Të dielën, më 3 shkurt, kam ditëlindjen. Mbush 13 vjeç. Kam ftuar për të festuar ditëlindjen edhe shokët e shoqet e klasës. Kam shumë dëshirë që të jesh edhe ti. Që tani kemi filluar nga përgatitjet. Babai ka gjetur muzikë të bukur. Blerta me shoqet e saj po zbukurojë mjedisin. Mamaja ka filluar përgatitjen e ëmbëlsirave. Do të jemi së bashku të lirë. Besoj se do të kënaqesh. Të presim të dielën, në 3 shkurt, në orën 8 °, në shtëpinë tonë.

Përqafime, Andi



PYETJE

1. Lexoni tri tekstet dhe thoni çfarë synojnë: të ftojnë, të falënderojnë apo të urojnë?
2. Çfarë duhet të përmbajë një ftesë që të jetë e sinqertë dhe e qartë?
Ju kanë ardhur mesazhe zanore për urim? I keni dëgjuar?
3. Jepni mendimin tuaj për të trija shkrimet, si ju duken? Merrni emocione nga mesazhet zanore?

VËSHTRIMË



Falenderojme me shkrim

I dashur Andi,

Të falënderoj për ftesën që më dërgove. Për mua është kënaqësi e veçantë që të marr pjesë në ditëlindjen tënde. Do të vij patjetër. Po pate ndonjë kërkesë, më thuaj se do të ta plotësoj. Të fala prindërve dhe Blertën përshëndete nga unë.

Të përqafoj, Joni

Mesazh zanor

I dashur Jon, jam Endri...

Po të uroj ditëlindjen me këtë mesazh zanor!
U bëfsh njëqind vjeç dhe suksese në mësim!
Të uroj nga zemra!

MËSOJMË

- Kur ftojme dikë, duhet të shkruajme qartë se përse e ftojme, ku dhe kur do të organizohet festa, veprimtaria përkatëse etj.
- Brendia e ftesës duhet të përcjellë respekt dhe dashuri për njeriun të cilit i drejtoheni.
- Ftesa mund të përmbajë shprehje si këto: Për ne (mua) do të ishte kënaqësi e veçantë (kënaqësi e madhe) ...; Do të gëzoheshim shumë ...; Do të isha i lumtur ...
- Përgjigjja e një ftese mund të jetë pozitive ose negative. Në të dyja rastet ajo duhet të jetë e shkruar me kulturë dhe të përcjellë respekt për atë që ju ka ftuar.
- Përgjigjja pozitive mund të përmbajë shprehje si këto : Ju falënderoj ...; Jam i gëzuar...
- Përgjigjja negative mund të përmbajë shprehje si këto: Më vjen shumë keq, por...
- **Kujdes!** Teknologjia sot ka mundësuar mesazhet zanore. Ato përdoren shumë për urime të natyrave të ndryshme, sepse dëgjon zërin e atij që flet: Gëzuar ditëlindjen!



USHTROHUNI

1. Shkruani një ftesë me rastin e ditëlindjes së motrës suaj.
2. Keni marrë një ftesë për të vizituar një ekspozitë që sapo është hapur. Përgatitni përgjigjen; ajo mund të jetë pozitive ose negative.
3. Ju do të shkoni në festën e pranverës në Elbasan. Si do të uroni gjyshërit me këtë rast? Mund t'i uroni edhe me mesazh zanor... nëse nuk keni mundësi për të shkruar.
Mesazhi zanor përcjell ngrohtësi!



DËGJOJMË

Në pushimin e shfaqjes,
Genta dhe **Andi** bisedojnë.

Genta: - Mua më pëlqen më shumë programi "Muzikë për ju". Ai na jep mundësi të shijojmë më shumë këngë. Në programin me muzikë sipas kërkesave të dëgjuesve, prezantuesja e programit e zgjat shumë me paraqitjen e kërkesave të dëgjuesve, kështu që mbetet pak kohë për këngët.

Andi: Mua më pëlqen shumë programi me muzikë, hartuar sipas kërkesave të dëgjuesve. Njerëzit mund të përshëndesin nëpërmjet tij të afërmit dhe shokët, sidomos ata që janë larg vendit.



Genta dhe Andi

10

Një ditë tjetër

Genta: - E pe mbrëmë shfaqjen?

Andi: - Çfarë shfaqjeje, unë isha në shtëpi.

Genta: - Po flas për shfaqjen që dha televizioni i Tiranës.

Andi: - Në cilin kanal ishte shfaqja?

Genta: - Në kanalin shtetëror, pra RTSH.

Andi: - Mbrëmë unë po shikoja një kanal privat, që jepte ndeshje futbolli. Zhvillohej ndeshja miqësore ndërmjet kombëtares së Shqipërisë dhe kombëtares së Luksemburgut. Ishte me të vërtetë një ndeshje shumë e fortë dhe e bukur.

Genta: - Më vjen keq, po ke humbur një rast të mirë për të parë një program të realizuar me nivel të lartë, nga një regjisor i njohur shqiptar. Në shfaqje merrnin pjesë edhe artistë të huaj, të ardhur nga Europa dhe Amerika. Ne të gjithëve na pëlqeu shumë. Më duket se përsëritet dhe nesër.

Andi: - Atëherë, sa mirë që më the, do ta shikoj patjetër bashkë me motrën.



PYETJE

1. Lexoni tekstin e parë dhe shpjegoni kuptimin e fjalëve me të cilat i drejtohen njëri-tjetrit.
2. Lexoni tekstin e dytë dhe shpjegoni kuptimin e bisedës.
3. A vihen re ndryshime në terminologjinë e përdorur në radio dhe në atë të përdorur në televizion?

DËGJOJMË DHE FLASIM

- Kur flasim për emisionet që dëgjojmë në radio ose televizion, duhet të kemi kujdes me termat që do të përdorni, sepse kanë terma të veçantë.
- Disa terma janë të përbashkët për të dyja fushat: program, emision, folës i radios dhe i televizionit, pajisje, paraqitës, transmetim, lajme të brendshme, lajme të jashtme etj.
- Për radion janë të veçanta terma të tillë si:
radio, stacion, valë, dëgjues, kërkesa të dëgjuesve etj.
- Për televizionin janë të veçanta terma të tillë si:
televizion, televizion, televizor, televizor me ngjyra, shikues, kanal, ekran, figurë, kontrast, qendër televizive, film televiziv, rubrikë televizive, kamerë, kamerë e lëvizshme, kameraman etj.



USHTROHUNI

1. Përmendni disa nga emisionet kryesore të radios që dëgjoni më shpesh: lajme, muzikë e lehtë, përshkrime me natyrë enciklopedike apo muzikë klasike*.
**(Radio Tirana ka një stacion të veçantë që jep 24 orë muzikë klasike, çdo ditë).*
2. Shpjegoni kuptimin e termave: program, emision, kamerë, kameraman, muzikë e lehtë, muzikë klasike.
3. Bëni vlerësimin e emisioneve televizive që shihni, sipas kërkesave të tabelës. Shkruani ashtu siç mendoni, pa u ndikuar. *(me laps)*



Skenë nga opera: "Traviata", e Xhuzep Verdit, vënë në skenë nga Teatri i Operas dhe Baletit

11

Vlerësimi

Emri i emisionit	Vendi I	Vendi II	Vendi III
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

I. TË DËGJUARIT, TË FOLURIT DHE TEKNOLOGJIA

Në një bisedë që zhvillohet në një mjedis çfarëdo, ka gjithmonë një folës dhe një dëgjues. Folësi flet dhe dëgjuesi dëgjon. Dëgjuesi i mirë i kupton menjëherë fjalët e folësit. Dëgjuesi mund t'i bëjë edhe pyetje folësit, për të sqaruar diçka që nuk ka kuptuar që në fillim.

Gjuha shqipe ka shumë rregulla. Ju kujtojmë që emrat kanë dy gjini: mashkullore dhe femërore. Për shembull, "libri" është emër i gjinisë mashkullore dhe "lulja" është emër i gjinisë femërore. Që të flisni bukur dhe me pasion gjuhën shqipe, duhet të njihni mirë gjininë e emrave. Rëndësi të madhe ka përdorimi i foljeve, për shembull: folja dëgjoj, kuptoj, flas, mësoj.

Kur dëgjoni, perceptoni botën jashtë jush nëpërmjet veshit, që është organi i dëgjimit. Për shembull, dëgjoni zhurmën e erës dhe shiut, dëgjoni muzikë dhe fjalë nga dhoma që ndodhet pranë.

Që të kuptoni, duhet me ndërgjegje të dëgjoni me vëmendje bisedën që po bëhet pranë jush, apo të dëgjoni me kujdes muzikën e radios dhe fjalët e këngës; vetëm kështu do merrni vesh se për çfarë po bisedohet, apo çfarë kuptimi kanë fjalët e këngës. Mbase dëgjoni dhe kuptoni, flisni, pra vjen natyrshëm procesi i të folurit.

Të dëgjuarit dhe të folurit ndihmohen sot, kryhen edhe me procese e aparate, teknika të ndryshme si: mikrofoni, telefoni, aparat dëgjimi etj., që realizojnë komunikimin tuaj me të tjerët edhe në distancë.

Në fjalitë më poshtë ka rëndësi zgjedhja e një prej foljeve, sepse nga zgjedhja e tyre do të varet, ajo që doni të shprehni.

Plotëso me foljet dëgjoj, kuptoj, flas fjalitë më poshtë

1. Mund të flisni më fortë ju lutem? Nuk ju mirë.
2. Më thuaj! Unë po të shumë mirë.
3. Ne mësimin që në klasë, sepse mësuesi shpjegon qartë.
4. Po një zhurmë nga kuzhina, është e ndezur soba?
5. Shko të hapësh derën! Nuk e zilen që po bie?
6. Dje një këngë në radio, por nuk fjalët.

Të kuptuarit zanor, pra nga të folurit, ka rëndësi shumë të madhe për gjuhën shqipe.

Në dallim nga të lexuarit, ku mund të kthehesh e ta rilexosh faqen e librit për të kuptuar tregimin, të dëgjuarit dhe të folurit është veprim i menjëhershëm. Ai bashkon tingujt zanorë, fjalët që dëgjoni, me të kuptuarit e përmbajtjes së asaj që dëgjuat.

Më pas vjen përgjigjja dhe rrjedh biseda, e cila detyrimisht duhet të bëhet në gjuhë standarde.

KUJDES!

Teknologjia moderne sot ka përparuar dhe me objektet që ofron, ndihmon në rritjen e cilësisë së dëgjimit, me kufje, për mos të shqetësuar të tjerët dhe të të folurit ose të kënduarit me mikrofoni, që e përforcon zërin.



kufje



mikrofon

1. Shikoni tekstin në faqen 10 dhe përgjigju pyetjeve:

- Kush është folësi në figurë? Po dëgjuesi?
- Çfarë i thotë Genta, Andit?
- Ku ndodhen personat që komunikojnë ndërmjet tyre?

2. Keni një folës në radio dhe një dëgjues:

- Lajmi kalon nga folësi te dëgjuesi. Mendoni dhe tregoni si arrin informacioni (lajmi) nga folësi te dëgjuesi?
- Si mund të ndihmohet dëgjimi?
- Me njohuritë që keni marrë në lëndën e informatikës, shkruani në fletore si ndodh ky proces.



Këngëtarja e famshme Dua Lipa duke komentuar e interpretuar në radion BBC 1.



Radiot kishin përdorim të madh pa u shpikur ende aparatet televizivë. Ato kanë sukses të madh edhe sot!



1. **Kërkoni në internet me fjalët kyçe: “adresë zyrtare radio televizioni shqiptar”.** Për çfarë bëhet fjalë?
2. **Cilat faqe do të përdornit për të shkruar një historik të shkurtër të RTSH?**
3. **Shkruani në fletore një shkrim të shkurtër mbi zhvillimin e RTSH, ku të përmendni tri personalitete që ju tërheqin vëmendjen. A kanë ata faqe zyrtare?**

AI QË FLET

jep (emeton) mesazhin. → dhënës (emetues)

AI QË DËGJON

merr (kap) mesazhin. → marrës (receptor)

Mesazhi është informacioni ose njoftimi, që jepet me fjalë nëpërmjet të folurit. Ai kalon nga dhënësi (emetuesi) te marrësi (receptor).

Të folurit
(Komunikimi
me gojë)

i drejtpërdrejtë

(personat janë përballë njëri-tjetrit)

i ndërmjetëm

(me telefon, radio, TV)

Një komunikim
i mirë
me gojë
nënkupton

një marrës
(dëgjues) i mirë:

- që dëgjon me vëmendje mesazhin,
- që e kupton mesazhin,
- që kërkon sqarime, kur nuk kupton,
- që tregon interes dhe respekt ndaj folësit,
- që është tolerant ndaj mendimeve të kundërta.

një dhënës
(folës) i mirë:

- shqipton qartë tingujt dhe fjalët,
- jep njoftime të qarta dhe të sakta,
- siguron interesin e dëgjuesit,
- përdor intonacionin, vëllimin e zërit dhe një fjalor në përshtatje me mesazhin,
- tregon respekt dhe tolerancë ndaj dëgjuesit.

Vështroni dhe plotësoni



1. Kush e dërgon dhe kush e merr mesazhin e shkruar në letër në figurën 1?

Si merret mesazhi në këtë rast nga dhënësi te marrësi?

2. Ku shfaqen mesazhet e shkruara në situatat e komunikimit 2,3,4?

Në këto situata, cilët janë dhënësit? Po marrësit? Si merren mesazhet e shkruara në gazeta, në libra dhe afishe të ndryshme? Ka mënyra të tjera komunikimi?

Njerëzit e kanë të domosdoshme që të flasin dhe dëgjojnë (komunikojnë) me njëri me tjetrin për të marrë e për të dhënë informacion. Mjeti kryesor që na vë në marrëdhënie komunikuese me njerëzit e tjerë, që na ndihmon të merremi vesh, është GJUHA, e folur dhe e shkruar.

Në praktikën e komunikimit ka hyrë edhe përdorimi i shenjave dhe i sinjaleve, që ndihmojnë njerëzit të japin e të marrin informacion në situata të caktuara, duke zëvendësuar kështu komunikimin me gojë a me shkrim, kur nuk është praktik ose është i pamundur. Kështu, për shembull, është drita e kuqe e semaforit, që të ndalon të kalosh në një drejtim të caktuar; lëvizja e duarve të një polici trafiku; fërshëllima e gjyqtarit në një ndeshje; ngritja e supeve të dikujt kur e pyesim për diçka; lëvizja e kokës nga lart-poshtë ose majtas-djathtas e një personi gjatë kohës që i flasim; një tabelë me shenjë ndaluese ose vijat e bardha që vizatohen në rrugë për kalimtarët.

- Diskutoni në klasë për kuptimin e këtyre shenjave dhe sinjaleve.
- Zhvilloni një bisedë ndërmjet jush. Ndonjë shok ose shoqe mund të përmendi shenja e sinjale të tjera, duke shpjeguar edhe mesazhet që jepen me to.
- Mësoni prej tyre!

NË EKSKURSION

Diskutojmë së bashku dhe vendosim për propozimin më të mirë

Nxënësit e klasës së gjashtë, javën që vjen kanë në program, të bëjnë një ekskursion në një vend të bukur, që shumica e tyre nuk e ka parë. Fëmijët, flasin me njëri - tjetrin, bisedojnë dhe tregojnë dëshirat e tyre të veçanta. Në fund të bisedës, ata merren vesh mirë së bashku për vendet se ku do të shkojnë.



Andi: - Shkojmë te pishinat pranë liqenit?



Beni: - E pse te pishina? Atje kemi qenë gjithmonë.



Andi: - Eh, mua më pëlqen gjithnjë të notoj...



Anila: - Te pishina ishim herën e kaluar. Shkojmë më mirë në malin e Dajtit.



Beni: - Në Dajt? Po gjithë këto ditë ka rënë shi, vendi do jetë shumë i lagur?



Iliri: - Ty asgjë nuk të pëlqen, sikur i ke parë gjithë vendet.



Beni: - Jo, nuk i kam parë gjithë vendet, por dëshiroj të shikoj diçka të bukur.



Tani: - Më dëgjoni mua. Unë them të shkojmë në Berat me autobus.



Anila: - Oh, sa mirë! Më kanë thënë të gjithë që është qytet i vjetër dhe i veçantë.



Tani: - Atje do shohim edhe Kalanë e Beratit. Pamja lart është e mrekullueshme!



Të gjithë: - Kështu do të bëjmë, pra, e vendosëm. Në Berat do të shkojmë!



PYETJE

Plotësoni me përgjigje pyetjet. (*me laps*)

1. A e tregon Andi mirë me fjalë mendimin e tij? _____
2. Si flasin Beni, Anila dhe Iliri me njëri - tjetrin? _____
3. Po shoku i tyre, Tani, si i bind që të aprovojnë mendimin e tij? _____

MËSOJMË

- **Kur flisni bukur** me argumente bindëse, është mënyrë e mirë të shprehuri, që përdoret kur duam të mbrojmë ose të kundërshtojmë një mendim të caktuar.
- Një shpjegim i saktë, një fakt konkret, një dëshmi ose gjë e veçantë mund të shërbejnë si argument për të bindur të tjerët. Jepni shembuj? Bindini shokët për diçka.
- Të folurit me fjali të sakta dhe me argumente e shembujt konkretë, për një problem të caktuar, duhet të renditen në mënyrë logjike. Kështu çdo bisedë shkon mirë.



KUJDES

Kur flisni për të shfaqur një mendim, shpreheni qartë atë dhe argumentojeni. Sillni fakte, dëshmi, shembuj të ndryshëm për të plotësuar mendimin tuaj. Mos e fyeni bashkëfolësin, nëse ai ka një mendim të ndryshëm nga ju. Dëgjojeni në fillim atë me vëmendje. Më pas i tregoni me kujdes, se përse ju mendoni ndryshe.



USHTROHUNI

- Flisni për pyetjet më poshtë.
- A ju pëlqejnë revistat për fëmijë?
Përse mendoni kështu?
- Nga programi i televizionit, zgjidhni një emision që doni t'i rekomandoni një shokut tuaj. Përse e keni zgjedhur pikërisht atë emision? Çfarë informacionesh jep ai mbi ndryshimet në natyrë? Keni vënë re edhe ju ndryshime të tilla në vendin ku banoni?
- Ju jeni ftuar për një vizitë nga shoku juaj, po nuk keni mundësi të shkoni. Përse nuk mund të shkoni? Argumentojeni pse nuk mund të shkoni tek ai.



PEIZAZHI I PYLLIT TË ZGJUAR

U zgjuan të gjitha ç'ka e ç'mban pylli,
U zgjuan qukapikët dhe nisën të bëjnë me sqepa
injeksione në pemët,
U zgjuan bletët dhe dolën nga shtëpitë e tyre prej
dylli,
U zgjuan milingonat dhe ngritën antenat përpjetë
Dhe lajmet e para të agimit i dhanë në bar e në
fletë.


U zgjuan zhizhat e majit me kurrizin e kaltër,
U zgjuan fluturat dhe nisën shpejt të shkëmbejnë
Letrat e shkruara që i mbajnë në krahë,
Letrat me shkronja të çuditshme që shkëlqejnë
Dhe që vetëm ato kuptimin dinë t'ua gjejnë.

U zgjuan hardhucat dhe shtrinë në gur bishtërinjtë,
U zgjuan grifshat me zërat e tyre të çjerrë,
U zgjuan kërmintë, duke marrë me vete në shpinë
shtëpitë,
U zgjuan luledredhëzat si parashuta në erë,
Të gjitha u zgjuan, çdo mizë e çdo grerë...

U zgjuan, u zgjuan e ç'qenë për t'u zgjuar,
u zgjuan!
U zgjuan bilbilët pas përroit mbi lëndinë
Dhe këngët e mahnitshme të parët filluan...
Ah, ky zog i vogël i tëri violinë,
Sikur ka lindur kastile veç për njerinë!

Zgjimim e pyllit ky zog e ngre në kulmin e lartë
Dhe mua më merr e në zgjimim e madh më përzien,
Te bota e gjelbër tërë shëndet lahet mes dritës
së artë

Dhe ngrihet në këmbë, vërtitet e zien
Dhe më thotë në vesh: a ndien se ç'bëhet, a
ndien?...



Dritëro Agolli

Kjo pjesë poezie e Dritero Agollit, është marrë nga një prej vëllimeve poetike të shkrimtarit të madh. Dritëro Agolli (1931 - 2017) ishte poet, prozator, publicist dhe politikan shqiptar. Që nga viti 1973, ai ishte kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Agolli u shfaq në letërsi si autor me kërkesa të larta për poezinë. Ai krijoi model të ri vjershërimi, ku gërshetoi natyrshëm vlerat tradicionale me mënyra të reja të shprehjes poetike. Fraza e pasur popullore dhe filozofia e tij për jetën e bëjnë veprën letrare të Dritero Agollit ndër më të lexuarën.



- 1. Merrni pranë një orë ose pajisje digjitale dhe matni kohën që ju duhet për të kopjuar në fletore gjysmën e poezisë.**
- 2. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.**



1. Babai, që e adhuron futbollin, gjatë pushimeve, do t'ju regjistrojë në rrethin e futbollit. Flisni me babanë, me prindërit qetë, i tregoni se pëlqeni më shumë notin në pishinë. Ata patjetër do t'ju kuptojnë, por kërkesën duhet ta bisedoni me kujdes, pa i mërzitur.

2. Ju keni dëshirë të shkoni për pushime me një shokun tuaj në fshat te gjyshja. Prindërit tuaj nuk janë dakord, se jeni ende të vegjël. Bindini ata, argumentoni duke biseduar, se në fshat do keni shumë përvoja të mira, do shikoni natyrën e bukur dhe premtani se do të silleni shumë mirë.



TË FOLURIT BINDSHËM

- Për shumë çështje është e vështirë të jepet një mendim i prerë dhe përfundimtar.
- Është mirë të pranosh që bashkëfolësi ka të drejtë në disa pika: pra të bësh një lëshim sado të vogël. Pastaj mund të japësh mendimin tënd personal: pra të bësh një vërejtje, të shtosh diçka...
- Për të bërë një lëshim mund të përdorim shprehje si këto:
 - Po, është e vërtetë, - Sigurisht që po. - Sigurisht. - Është e vërtetë, - Është e arsyeshme.
 - Është e padiskutueshme. - Pa dyshim. - Në të vërtetë. - Ndoshta. - Në këtë pikë jam dakord.
 - Jam krejtësisht dakord me ju. - Jam plotësisht dakord me ju.

Foljet që përdoren më shumë:

- E di. - E pranoj. - E njoh. - Dyshoj. - Nuk dyshoj. - Jam i sigurt që... - Më pëlqen. - Pranohet. - E mendoj ndryshe. - Nuk e mohoj. - Ju keni të drejtë. - Mendoj se keni të drejtë.
- Për bërë një vërejtje mund të përdorim shprehje si këto:
 - Po por... - Por, megjithatë... - Ndërkaq... - Gjithësesi... - Të paktën... - Kjo nuk më pengon...
 - Megjithatë, kjo nuk më pengon... - Kjo do të thotë... - Mirëpo... - Sido që të jetë... - Më vjen keq...
 - Nuk jam i bindur... - Dyshoj. - Fatkeqësisht... - Jo tamam ashtu. - Jo gjithmonë. - Është e kritikueshme.
 - Është e dyshimtë. - Në parim...



KUJDES

Të bësh lëshime, do të thotë që të pranosh që në disa pika që **bashkëfolësi** juaj **ka të drejtë**. Lëshimi **lejon që pastaj të paraqiten më mirë vërejtjet**. Por jo gjithmonë duhet të bëhen lëshime. Ka rëndësi të kuptohet se për çfarë flitet.



VËSHTRIMË DHE FLASIM ME NJËRI - TJETRIN



- Sapo është hapur një qendër e re sportive në Tiranë. Aty ka shumë vegla moderne që ndihmojnë në zhvillimin e muskujve. Për mendimin tim, qendra e re **është shumë e bukur.**

- Ashtu mund të jetë. Por, për mua, nuk mund të jetë më e mirë se qendra sportive që ka sot Korça. Ajo është shumë e pasur në vegla sportive dhe ka hapësirë.



- Nuk e kam parë qendrën sportive të Korçës. Në verë pashë qendrën sportive të Vlorës. Ajo qendër kishte ndriçim të shkëlqyer edhe natën dhe hapësira të habitshme!



- Qendra e re e Tiranës, do ta shikoni vetë, i ka të gjitha: veglat e ushtrimeve, ndriçimin fantastik dhe hapësirat pa fund!



PYETJE

1. Cilat fjali japin informacion për qendrat sportive?
2. Si i shprehin mendimet e tyre personale fëmijët?
3. Cila fjali shpreh parapëlqimin?
4. Cili nga fëmijët i ka dëgjuar me vëmendje shumë të madhe shokët, i përmbledh kërkesat e tyre në vlerësimin e tij? Mendoni se e folura e tij është më bindëse? Flisni qartë, jepni edhe ju mendimin tuaj për këtë bisedë.

TË FLASIM BUKUR!

1. Një fjali mund:

- të japë një informacion: *Sapo është hapur një qendër e re sportive.*
- të shprehë një pikëpamje personale: *Për mendimin tim, ajo është shumë e bukur.*
- të modifikojë një pikëpamje: *Mirë, ashtu mund të jetë.*
- të bëjë një vlerësim duke krahasuar dy elemente: *Po, për mua, nuk mund të jetë më e mirë se qendra sportive, që ka sot Vlora.*
- të shprehë miratim të një pikëpamjeje: *Kështu mendoj edhe unë.*

2. Për të shprehur një pikëpamje mund të përdorim shprehje si këto:

- *Unë mendoj...* - *Sipas mendimit tim...* - *Për mendimin tim...* - *Unë besoj...* - *Jam i mendimit që...*
- *Jam i bindur që...* - *Sipas meje...* - *Për mua...* - *Për mua e rëndësishme...* - *Unë personalisht...*
- *Nga ana ime...* - *Sipas pikëpamjes sime...*

3. Për të shprehur një kundërshtim mund të përdorim shprehje si këto:

- *Po, po megjithatë...* - *Përkundrazi...* - *Po nuk duhet harruar që...* - *Ju mund të keni të drejtë, po...*
- *Unë nuk e kuptoj se përse...* - *Mos duhej...* - *Mos do të ishte më mirë...*

4. Për të ndryshuar një pikëpamje mund të përdorim shprehje si këto:

- *Më duket se...* - *A nuk të duket se...* - *Unë kam përshtypjen se...* - *Është e mundshme...*
- *Në parim...* - *Si të doni...*

5. Për të kërkuar informacione shtesë:

- *Nuk e di nëse ju kam kuptuar mirë, po...* - *Çfarë doni të thoni me këtë?* - *Çdo të thotë kjo?*
- *Çfarë do të thuash me këtë?* - *A mund të ma shpjegosh?*

6. Për të shprehur miratimin tonë:

- *Jam i një mendjeje...* - *Jam dakord...* - *Jam plotësisht dakord...* - *Jam i bindur që...*
- *Ju keni të drejtë...* - *S'ka dyshim.* - *Është plotësisht ashtu si thoni ju.* - *Sigurisht.*
- *Pa asnjë dyshim.* - *Unë ta kisha thënë.*

7. Për të shprehur mosaprovimin tonë:

- *Unë nuk jam absolutisht dakord...* - *S'jam aspak dakord...* - *Nuk jam shumë dakord.* - *Në asnjë mënyrë!* - *E ke gabim.* - *Ajo që thoni ju, nuk ndodh.* - *Në këtë pikë nuk jam dakord me ju.*



USHTROHUNI TË LEXONI DHE FLISNI BUKUR

Shprehni mendimin tuaj duke pasur parasysh situatën dhe bashkëfolësin.

- Prindërit tuaj vendosin që ju të mos shikoni televizorin pas orës 10⁰⁰, të darkës. Duhet të flini.
- Motra juaj ka blerë një fustan të ri dhe kërkon mendimin tuaj.
- Keni blerë një lojë -video të re. Jepini mendimin tuaj një shoku, duke i treguar se përse i vlerësoni ato. *Dëgjoni edhe mendimin e tij për video-lojërat.*

Kujdes!

Të japësh mendimin tënd, do të thotë të vlerësosh pozitivisht ose negativisht, drejtpërsëdrejt ose me nuanca (ndryshim i hollë) një problem, një situatë ose objekt të caktuar.



PYESIM

22

1. Në shprehjet më lart, çfarë ndjenjash shfaqin personazhet e tyre (figurat 1, 2, 3)?
2. Si e shprehin kënaqësinë e tyre? Po pakënaqësinë e tyre, si e shprehin, me cilat fjalë?



1. Merrni pranë një orë ose pajisje digjitale dhe matni kohën që ju duhet për të shkruar në fletore një shkrim të shkurtër (rreth 10 -15 fjali) mbi një qendër sportive ose artistike që keni vizituar. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.
2. Shkruani me kompjuter krijimin tuaj duke përdorur programin Word. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.
3. A mund ta përktheni krijimin tuaj në gjuhë të huaj? Në cilën gjuhë? Si do të vepronit?

MËSOJMË

1. Ja disa shprehje që përdoren zakonisht për të shprehur kënaqësinë:

- Të lumtë! - Bukur! - Shkëlqyer! - I jashtëzakonshëm!
- I mrekullueshëm! - Më le pa fjalë!
- Jam i kënaqur. - Jam i lumtur. - Jam i gëzuar. - Është i jashtëzakonshëm. - Është fantastik.
- Është i përsosur. - Është i përkryer.

2. Ja disa shprehje që përdoren zakonisht për të shprehur pakënaqësinë:

- Jam i mërzitur. - Jam i nevrikosur. - Jam i shqetësuar. - Jam i zemëruar. - Jam bërë nervoz.
- S'jam aspak i kënaqur. - S'mund ta shoh. - Kjo më shqetëson. - Kjo më nervozon.

3. Nuk përdoren të njëjtat shprehje kur tregojmë duke folur qëndrimin tonë për një libër të bukur ose një shfaqje që kemi parë ose kur flasim për një objekt ose një njeri.

4. Për të thënë që më pëlqen:

një libër, një film, një shfaqje, ju mund të shprehni mendimet, ndjenjat tuaja duke folur në mënyra të ndryshme, si në shembujt më poshtë.

Një libër, një film, një shfaqje

*Më pëlqen (shumë).
Është i mrekullueshëm.
Është i bukur.*

Një objekt

*Më pëlqen.
Është i jashtëzakonshëm.
Është i bukur.*

Një person

*Më pëlqen shumë (ai/ajo).
Çmendem pas...
Është i lezetshëm.
E adhuroj.*

5. Për të thënë që nuk më pëlqen:

një libër, një film, një shfaqje, ju mund të shprehni mendimet, ndjenjat tuaja duke folur në mënyra të ndryshme, si në shembujt më poshtë.

Një libër, një film, një shfaqje

*Nuk më pëlqen (shumë).
Nuk është i mirë.
Më frikëson.*

Një objekt

*Nuk më pëlqen.
Nuk ka funksion.
Më lodh nga ngjyrat.*

Një person

*Nuk më pëlqen shumë (ai/ajo).
Nuk është i bukur.
Nuk është simpatik.*



USHTROHUNI

1. Ju kanë sjellë për ditëlindje si dhuratë një helikopter me telekomandë. Si do ta thoshit fjalinë e mëposhtme nëse do të ishit i lumtur.

Ky është helikopteri im!

Si do ta thoshit po këtë fjali nëse nuk e pëlqenit. (Plotësoni gjithnjë me laps ose në fletoren tuaj.)

2. Tregoni çfarë ju pëlqen dhe çfarë nuk ju pëlqen lidhur me ushqimin.

Po - një shoku, një mikut në moshën tuaj?

Po - nënës ose babait të shokut, mësuesit tuaj.

3. Ju keni parë një film, një emision televiziv, një koncert ose keni blerë një disk të këngëtarit tuaj të preferuar. Tregoni çfarë ju ka pëlqyer dhe çfarë nuk ju ka pëlqyer.

- një shoku, një të afërmi në moshën tuaj.

Flasim dhe dëgjojmë të rriturit dhe moshatarët. Analizoni këto dy situata.



24



PYESIM

1. Analizoni këto dy situata: Të folurit, "mësues - nxënës"; të folurit, "shoqe me shoqe". Pyetjet për ju në çdo rast janë:

Cili është folësi? _____

Ku dhe kur flet? _____

Për ç'qëllim flet? _____

Kush është bashkëbiseduesi? _____

2. Thoni për secilën pyetje ku përqendrohet folësi te pyetja që bën? Pret ai / ajo përgjigje? Pyetja kërkon një përgjigje me po ose jo apo thjesht një sqarim?

3. Thoni për secilën pyetje nëse pret ose jo të marrë përgjigje folësi. _____

MËSOJMË, KUPTOJMË, PLOTËSOJMË

Pyetje tërësore

Pyetja është tërësore kur folësi që pyet, pret një përgjigje pozitive (me fjalën po) ose negative (me fjalën jo). Pyetja tërësore përqendrohet te folja. Plotësoni më poshtë.

- A i ke çelsat?

Po _____ Jo _____

- A i ke përgatitur mësimet?

Po _____ Jo _____

Pyetje e pjesshme

Pyetja është e pjesshme kur folësi që pyet, kërkon sqarim të veçantë: kush, çfarë, ku, si, pse?

Pyetja e pjesshme përqendrohet te një përbërës tjetër i fjalisë

(kryefjalë, kundrinor, rrethanor etj.).

- **Si të quajnë?** Drini.

- **Sa lekë e bleve fustanin?** Mos pyet fare më mirë. Shumë shtrenjtë.

Pyetje retorike ose pyetje pa përgjigje

Pyetja është retorike ose pa përgjigje kur folësi që pyet, nuk pret të marrë përgjigje.

Pyetje orientuese

Pyetja është orientuese kur folësi që pyet, kërkon të marrë përgjigjen që dëshiron.

- **A është e drejtë që vetëm disa të punojnë?**

- **Ti do të vish në ndeshje, besoj?**

Përmbledhje

1. Pyesim:

- për të kërkuar një miratim ose një refuzim,
- për të kërkuar një informacion,
- për t'ju imponuar dikujt,
- për të bërë një anketë.

2. Pyetjet mund të jenë:

- tërësore ose të pjesshme,
- të vërteta ose retorike,
- të vërteta ose orientuese.

Kur pyesim, mund të përdorim shprehje si këto më poshtë. Plotësoni me fjali.

A mund të më ...; _____

Ju lutem më ...; _____

Më falni më duhet të ...; _____

Kur pyesni, kini parasysh se kujt i drejtoheni.



USHTROHUNI DHE PLOTËSONI ME FJALI

1. Ju keni dëshirë të njiheni më mirë me një shokun tuaj. Pyeteni atë, a dëshiron edhe ai?

2. Ju keni qenë i sëmurë dhe nuk keni shkuar në shkollë. Si do ta pyesnit shokun tuaj që t'ju tregojë ç'detyra keni për nesër.

3. Një shoqe ka humbur çantën e saj. I bëni pyetje që ta përshkruajë çantën e saj.

4. Arbri ka shkuar në verë për disa ditë në Amerikë. Ju doni të dini për udhëtimin dhe qëndrimin e tij në Amerikë. I bëni pyetje atij.

5. Ka ndodhur një aksident në rrugë. Ju do të shkruani një artikull në gazetë. Për këtë ju duhet të pyesni dëshmitarët. Provojeni.

Shprehim dëshirat tona edhe me fjalë.

Është fundjavë. Miri, Indriti me Olin, Vera, mami dhe Genta. Shhkruani dëshirat e tyre.



Miri

Sa shumë më pëlqen futboli!
Është loja ime e preferuar!



Indriti me Olin



Vera



Mami



Genta



PYESIM

1. Çfarë dëshirash kanë: Indriti, Vera, Albana dhe Genta?
2. Proveni edhe ju të shfaqni dëshirat tuaja, si te plotësimi më lart.
3. Çfarë duhet të keni parasysh kur shfaqni dëshirat tuaja?

MËSOJMË

- Kur shfaqim një dëshirë me zë apo duke shkruar, duhet ta formulojmë *qartë* dhe ta arsyetojmë përse e kemi atë dëshirë.
- Paraqitja e dëshirave duhet të bëhet me një gjuhë të kujdesshme e të zgjedhur dhe të përcjellë *respekt* për njeriun të cilit i drejtoheni.
- Paraqitja e dëshirave mund të fillojë me shprehje si këto:
 - Mua më pëlqen...; Mua do të më pëlqente...; Unë do të doja...; Do të ishte kënaqësi e veçantë (kënaqësi e madhe) për mua; Do të gëzohesha shumë...; Do të isha i/e lumtur...
- Dëshirat mund të jenë të natyrave të ndryshme. Kur shfaqni dëshirat tuaja, kini parasysh se me kë flitni: me shokët, apo mësuesit, prindërit...

PËRMBLEDHIM

1. Dëshirat duhet të shprehen me gjuhë të qartë.
2. Duhet t'i arsyetoni dëshirat tuaja. I renditni arsyet sipas radhës.
3. Kur paraqitni dëshirat tuaja, kini parasysh se me kë flitni.



USHTROHUNI

1. Çfarë do t'ju pëlqente më shumë të bënit në një ditë feste? Tregoni me shkrim përse.

2. A ju pëlqen të udhëtoni? Në ç'vende do të dëshironit të shkonit? Pse?

Shkruajeni përgjigjen tuaj (me laps).

Do të më pëlqente të shkoja.....që _____

Do të doja të shkoja.....që _____

Më pëlqen të udhëtoj,sepse _____

3. Miri dëshiron të ketë një lojë elektronike. Ai u thotë prindërve:

A do të më blini një lojë elektronike? Të gjithë shokët e mi kanë. Unë kënaqem shumë, kur shkoj tek ata. Ju lutem, ma blini! Do ta mbaj me kujdes. Do ta përdor me orar.

Prindërit e Mirit nuk pranojnë, tregojnë arsyet e tyre. Si do të vepronit ju për t'ua mbushur mendjen? _____

4. Dikush kërkon të takohet me ju. Ju keni dëshirë, po nuk keni kohë. Si do t'i përgjigjeshit bashkëbiseduesit tuaj për ta shtyrë takimin më vonë? Ai mund të jetë:

- një shok

- një i afërmi juaj më i rritur, mësuesi juaj.



1. Regjistroni në fletore disa të dhëna nga shokët dhe shoqet e klasës tuaj (rreth 8 persona), për t'i patur kujtim në të ardhmen (p.sh., vendlindjen, hobin, parapëlqimet mbi artistët, shtetet, kafshët, profesionet, natyrën etj.).
2. Formoni me kompjuter një tabelë duke përdorur programin Excel ku të regjistroni të dhënat që mblodhët. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.

Fjala ka forcë të madhe bindëse!



Ky film është shumë i bukur. Mendoj ta ndjekim të gjithë deri në fund. Si mendoni?

Ku doni t'i kaloni pushimet tuaja? Bregdeti i Jugut është më i bukur. Zgjidhni atë!

Nuk e di...
Jam ende e pavendosur...



PYESIM

1. Çfarë po bëjnë fëmijët në figurën e parë? Çfarë thotë Alba? A i bind ajo të tjerët?

2. A është e vendosur mami i Jonës, se ku duhet t'i kalojë pushimet? A e bind punonjësja e agjencisë turistike? Çfarë i propozon ajo? Po ju si mendoni?

MËSOJMË

- Që të arrijmë t'i marrim dikujt diçka, mund ose ta urdhërojmë ose ta bindim. Kur është e mundur, është gjithmonë më mirë ta bindim sesa ta urdhërojmë. Kur kërkojmë ta bindim, tregojmë *respekt* për bashkëfolësin dhe i japim mundësi ta ndryshojë ose jo mendimin.
- Për të arritur të bindim dikë duhet së pari që të mos harrojmë qëllimin që kemi. Për të arritur qëllimin duhet të kemi arsye të mjaftueshme për ta bindur bashkëfolësin.
- Nuk është e rëndësishme që të ketë shumë arsye ose argumente. E rëndësishme është të dish t'i zgjedhësh ato arsye, në mënyrë që t'i përshtaten bashkëbiseduesit.

1. Për të sugjeruar diçka mund të përdorim shprehje si këto:

- Sikur të bëje... - Unë të propozoj... - A nuk do të mundje të... - Përse ti nuk... - A mund ta provojmë...

2. Për t'u lutur për diçka mund të përdorim shprehje si këto:

- Të lutem... - Në qoftë se ke mundësi... - Po të kesh mundësi... - A ka mundësi... - A mundesh...

3. Për të këmbëngulur për diçka mund të përdorim shprehje si këto:

- Të siguroj që... - Të betohem që... - S'ka rrugë tjetër veçse... - E ke kot që... - **Është** budallallëk të...

4. Për të ruajtur dikë mund të përdorim shprehje si këto:

- Po të isha në vendin tënd unë... - Nuk duhet ta... - Kujdes, po të paralajmëroj që... - Mos harro që... - Dua të të kujtoj që... - Vëre veten në vendin tim... - Do të ishte më mirë që ti... - Në vendin tënd unë...



USHTROHUNI

1. Ju doni t'i bindni prindërit tuaj t'u lejojnë të dielën të shkoni të laheni në lumë. Si do të vepronit?
2. Ju doni të blini një disk me muzikë shqiptare. Si do t'u thoni prindërve?

3. Ju keni nevojë t'i blini diçka një shoku tuaj, për ditëlindje. Si do të vepronit për të kërkuar para te prindërit për dhuratën? Si do t'i zgjidhnit fjalët?

4. Në shtëpinë tuaj ju ka ardhur një shok për të luajtur. Nuk keni mundësi të luani, sepse keni diçka tjetër për të bërë. Si do ta bindni shokun tuaj në këtë rast, pa e mërzhitur atë.



KUJDES

Të bindësh dikë, do të thotë ta bësh të ndërrojë mendim, të bëjë atë që doni ju, të mendojë atë që mendoni ju. Për t'i bindur të tjerët duhet t'u drejtohem atyre me fjalë të zgjedhura, që edhe ata të fillojnë të ndiejnë si ju.



LEXOJMË DHE KUPTOJMË

A. Klithma

Terri u derdh, e një rrigë e praruar e rrezeve të hënës e lau kreshtën e malit, luginën dhe u ngrit poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Çdo gjë është lidhur e shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohet. Çdo gjë është strukur në vetvete, është mbyllur e kyçur në therrën e gjumit.

E lart, atje lart nëpër hapësirën e kupës së qiellit, një yll noton duke lënë mbas vetes një hark të gjatë vezullues.



Një klithmë u dëgjua!

Korbi krokati.

E penjtë e qetësisë u prenë si me shpatë.

Anton Pashku

B. Bulina

Atë ditë më mirë të mos e kishim marrë Bulinën me vete. Po ta dinim se ç'do të ngjiste, do t'i flisnim që të kthehej, dhe ajo, sigurisht, do të ishte kthyer, sepse i kuptonte të gjitha urdhrat që i jepnim. Veç... ne s'na bënte zemra të ndaheshim prej saj e ta linim në shtëpi, kur shkonim në fushë.

A mund ta përzinin Bulinën që e donim aq shumë, sa s'dinim ç'të bënim për të? Ne mernim qëllimisht bukë në magje për t'ia dhënë Bulinës.

Gëzimi ynë s'kishte kufi kur Bulina hidhej si një portier i shkathët dhe i priste në erë koret e bukës. Pastaj, në shenjë falënderimi luante bishtin dhe ndiqte me sy lëvizjet e duarve tona, nëse kishim edhe një gjë tjetër për t'i falur.

Kur ne shkonim të luanim me top, Bulina

rrinte afër vendit ku linim xhaketat, këpucët e çorapet. Shrinte këmbët e para, vinte mbi to kokën e madhe me veshë të vegjël dhe bënte sikur flinte.

Edhe atë mëngjes, kur u nisëm për në arat e Bairit, Gurorja e mori me vete. Ishim nja pesë a gjashtë fëmijë me një tufë lopësh, viçash, manarësh dhe mushkash dhe Bulina ecte herë pas nesh e herë përpara.

Aty pranë shkonte xhadeja e bardhë, si një fjongo mes fushës. Mbi të shumë rrallë kalonin makina. Kamionët së largu dukeshin si të ndarë në dy pjesë dhe ne i ndiqnim derisa na humbitnin nga sytë.

Papritur, aty nga dreka, dikush vuri re një tym të bardhë që ngrihej sipër xhadesë. - Po vijnë makina, y... sa shumë që janë!

Naum Prifti

C. Naim Frashëri (fragment)

Në figurën e Skënderbeut, Naimi përmbloodhi katër virtytet kryesore shqiptare: trimërinë, nderin mirësinë dhe urtësinë. Këto virtyte e kishin ndihmuar atë të mbronte Shqipërinë. Po ndërkohë, si poet romantik, Naimi i veshi Skënderbeut edhe cilësitë e humanizmit evropian. Ai ishte njeriu i përsosur nga ana morale dhe intelektuale.

Letërsia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare

D. Kënga e sprasme e Balës

Ndikimi i poezisë popullore në këtë vepër është shumë i madh.

Dara merr nga poezia popullore heronjtë kryesorë, Nik Petën dhe Pal Golemin, mjaft veçori të figurës së Skënderbeut dhe asaj të Ballabanit, ndërthur në veprën e tij shumë motive nga poezia popullore arbëreshe, si:

- ndarja e dy të dashurve, që të kujton legjendën e Kostandinit;
- rrëmbimi i vajzës nga: "qeni turk";
- shkëmbimi i unazës midis bashkëshortëve kur burri i saj niset për luftë;
- amaneti i trimit kur vdes në luftë, që e shoqja të martohet;
- vdekja e përnjëhershme e dy njerëzve shumë të afërt dhe mbirja e një peme mbi varrin e tyre.



Gjergj Zheji



PYESIM

1. Për se flitet në secilin nga këto dy tekste?
2. Çfarë bën autori në tekstin e parë përshkruan, tregon, shpjegon apo argumenton diçka?
3. Po në të dytin, në të tretin dhe të katërtin?

MËSOJMË

- **Tekstet ndryshojnë në vartësi të synimit që kanë:** të përshkruajnë, të tregojnë, të shpjegojnë ose të argumentojnë diçka.
- **Pra, tekstet mund të jenë përshkruese, treguese, shpjeguese, argumentuese.**

TEKSTET PËRSHKRUERE

Të përshkruash, do të thotë të japësh karakteristikat dalluese të njerëzve, të vendeve ose të objekteve.

Kosova është veçanërisht e bukur në këto ditë nëntori me diell. Peizazhet e saj shpalohen butësisht në sytë tanë, tokë pjellore, mullarë vjeshte që duken si të përhënur, kodrina, skërka e ujëvara aty-këtu dhe midis xhadeve, dasmat e famshme me flamur që për herë të parë i kisha parë në studion e Buzës.

TEKSTET TREGUESE

Të tregosh, do të thotë të paraqesësh disa veprime në mënyrë logjike dhe të renditura në kohë. Ato mund të kryhen nga njerëz ose kafshë që veprojnë si njerëz.

Terri u derdh, e një rigë e praruar e rrezeve të hënës e lau kreshtën e malit, luginën dhe u ngrit poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Çdo gjë është lidhur e shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohet.

TEKSTET SHPJEGUESE

Të shpjegosh, do të thotë të japësh një informacion ose të sqarosh një problem ose një pyetje duke vendosur lidhje shkaku dhe pasoje ndërmjet fakteve dhe ngjarjeve, po edhe duke dhënë shembuj.

Në figurën e Skënderbeut Naimi përmbledhi katër virtytet kryesore shqiptare: trimërinë, nderin mirësinë dhe urtësinë. Këto virtyte e kishin ndihmuar atë të mbronte Shqipërinë. Po ndërkohë, si poet romantik, Naimi i veshi Skënderbeut edhe cilësitë e humanizmit europian. Ai ishte njeriu i përsosur nga ana morale dhe intelektuale.

Teksti shpjegues ka më shumë informacion.

TEKSTET ARGUMENTUESE

Të argumentosh, do të thotë t'i bindësh të tjerët me fakte, arsye, që t'i bësh të ndryshojnë mendimin ose qëndrimin e tyre.

Ndikimi i poezisë popullore në këtë vepër (Kënga e sprasme e Balës), është shumë i madh. Dara merr nga poezia popullore heronjtë kryesorë, Nik Petën dhe Pal Golemin, mjaft veçori të figurës së Skënderbeut dhe asaj të Ballabanit, ndërthur në veprën e tij shumë motive nga poezia popullore arbëreshe.

Një tekst mund të përmbajë disa tipa tekstesh.

PËRMBLEDHIM

1. Tekstet ndryshojnë në varësi të synimit që kanë: të përshkruajnë, të tregojnë, të shpjegojnë ose të argumentojnë diçka.
2. Tekstet mund të jenë: përshkruese, treguese, shpjeguese, argumentuese.

32



USHTROHUNI

1. Lexoni tekstin dhe thoni llojin e tij (tregues, përshkrues, shpjegues apo argumentues).

Sa shumë e ndryshuan Hajrien ato tetëmbëdhjetë vjet, habitej edhe ajo vetë.

Nëpër fytyrën dikur të njomë e të bukur, të shëndoshë e të plotë, si lulja në mëngjesin e pranverës plot rreze të këndshme dielli ishin kryqëzuar tash do rrudha, që ia kishin bërë koha dhe vuajtjet, thua se në atë mënyrë i kishte shënuar çdo vuajtje kujtimet e veta me nga një rrudhë në fytyrën e saj... Edhe trupi i saj, dikur i hollë e i gjatë si selvia në mes të malit, ishte kërrusur pak, tash dukej më i vogël. Sytë i ishin zgjeruar e flokët, dikur aq të zezë e të gjata, sa të gjitha shoqet ia lakmonin, ishin thinjur e rralluar. Megjithatë, Hajria, mu tash, në këto vite pleqërie, e ndjente veten më krenare se kurrë ndonjëherë më parë.



Nazmi Rrahmani



1. Krijoni skica të thjeshta në fletoren e vizatimit mbi katër fragmentet që lexuat dhe kuptuat (A, B, C, D).
2. Vizatoni me kompjuter krijimet tuaja duke përdorur programin Paint. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.
3. Me ndihmën e mësuesit/es, printoni një poster artistik me krijimet digjitale.

Për të parë se çfarë qyteti ka qenë Shkodra, mjafton të themi se kur një ushtri e madhe barbarësh sulmoi tokat e saj, atëherë rreth pesë mijë kalorës, thujse e gjithë rinia shkodrane, u turrën të radhitur jashtë qytetit (sikurse thonë) mbas shenjës që jepte kambana.

U përlëshën me armikun pranë lumit të Drinit, që sot gjendet larg qytetit tetë milje, edhe bënë kërde të madhe në të.

Mirëpo, meqenëse ushtria shkodrane ishte shumë e vogël në numër, aty nga fundi, për arsye se luftimi zgjati shumë, u lodh edhe u thye keqas. Ata që mbetën pa u vranë u tërhoqën bashkë me familjet e tyre brenda kështjellës edhe atëherë armiku me një sulm të fortë, u hodh në qytet e mbasi s'gjete njeri brenda, e dogji dhe e shkrumoi plot tërbim në të katër anët edhe e rrafshoi përdhe.

Marin Barleti

2. Pjesët më poshtë përmbajnë secila nga dy tipe tekstesh. Çfarë tekstesh janë ato?

Argumentojeni mendimin tuaj.

Ndiqte klasën e katërt të shkollës fillore. Ishte një vogëlush i lezetshëm nga Firenze, nja dymbëdhjetë vjeç, leshzi e i bardhë në fytyrë, djali i madh i një nëpunësi të hekurudhës, i cili e hiqte jetën hollë, se peshën e familjes e kishte të madhe e rrogën të vogël. I ati e donte shumë dhe sillej mire me të, po, kur vinte puna për të mësuar, nuk i dhimbej: kërkonte shumë prej tij dhe tregohej i egër se i biri duhej të mendohej që si e si të zinte sa me shpejt punë dhe t'i jepte dorë familjes. Babai ishte në moshë të thyer, po e kishte plakur para kohe edhe puna e tepërt. Megjithatë, që t'u bënte ballë nevojave të familjes, përveç barrës së madhe që kishte si nëpunës, merrte poshtë e lart edhe punë të tjera si kopist, kështu që një pjesë të mirë të natës e kalonte pa gjumë.

Edmond de Amiçis

Një ditë, kur po merrja gështejat e zakonshme, vërejta diçka që më çuditi: gështejëpjekësi kishte mbulue gjoksin e vet leshtak me një rrobë të vjetrueme. Ishte të ftohtë, të ftohtë kërcëllues nandori. Ishte mëngjes, mëngjes i rrebët. Binte borë e bardhë virgjinore, që flokë-flokë lëshonte mjerimin mbi kalibet e unjëta dhe gëzim mbi pallatet e ndritëshme... Kur më dha gështenjat, burri u kollit. Fytyra i mori një ngjyrë të zjarrtë. Për një çast vrulli u ul dhe përnjiherë burri u zverdh... shikoi dy fëmijët, që po androshin qetësisht mbi dërrasat e vjetrueme të arkave të prishuna. Dhe psherëtiu... Unë kuptova.



Qemal Stafa

3. Ja disa situata komunikimi. Ju do të tregoni nëse duhet të shkruani një tekst përshkrues, shpjegues apo argumentues ose kombinime të tyre.

- Ju i shkruani një shoku tuaj për t'i treguar se si i zutë peshqit.
- Ju shkruani një njoftim për të dhënë me qira apartamentin tuaj.
- Ju i tregoni një miku tuaj se cilën rrugë duhet të marrë për të ardhur tek ju.
- Ju i shkruani dikujt që nuk ju njeh dhe ju pret në stacionin të trenit.
- Ju i jepni dikujt recetën e: "Tavë Elbasani".
- Ju i kërkoni nënës tuaj leje për të shkuar në ditëlindjen e një shoqeje.
- Ju tregoni për paraqitjen e veshjes së një burri nga Veriu i Shqipërisë.

Të rrëshqasësh me ski në dëborë, sigurisht që është shumë i bukur. Kurse boksi, unë mendoj se nuk është sport, kur godasin, kur gjakosen... Jo, për mua nuk duhet të quhej sport!

ARBI

Këto thua gjithmonë, po ama vetëm ti mendon se boksi nuk është sport, se boksierët nuk janë sportistë. Ti nuk ia ke idenë, se nuk shikon qoftë edhe një herë boks në televizor. Ti nuk di ç'është ringu, prandaj, meqë s'di gjë, më mirë mos fol fare!

OLSA

Unë pashë një herë me babanë një ndeshje boksi, në televizion, por nuk më tërhoqi. Ndashja ishte shumë e gjatë, të gjithë spektatorët bërtisnin e ngriheshin në këmbë. Megjithëse njëri boksier e mundi keq tjetrin, u kënaqa kur i dhanë dorën njëri - tjetrit...

ERI



PYESIM

1. Si quhen bashkëbiseduesit?
2. Për çfarë bisedojnë?
3. Arbi shpreh mendimin e tij për boksin. A ka të drejtë ai?
4. Olsa nuk mendon si Arbi, por nuk është shprehur si duhet. Argumentojeni.
5. Po në ligjëratën e Erit, çfarë vini re? Çfarë ka parë me kureshtje ai në fund të ndeshjes?
6. Çfarë diskutimi bëjnë mësuesit në këshillin e tyre, për frekuentimin dhe përparimin e nxënësve të tyre në mësim?
7. Çfarë diskutimi është ai, që bëjnë të ftuarit në televizion për një problem shoqëror?
8. Çfarë dallimi kanë këto diskutime nga diskutimi i mësipërm për sportin e boksit?

MËSOJMË

Diskutimi është një shkëmbim i lirë mendimesh mes dy ose më shumë personave për një çështje të caktuar. Diskutimet mund të jenë zyrtare dhe jozyrtare. Secili prej tyre ka veçoritë e veta, rregullat e veta, por disa rregulla janë të përgjithshme për të gjitha llojet e diskutimeve.

Rregullat e pjesëmarrjes në diskutim

- Çdo njeri duhet të marrë pjesë në diskutim.
- Propozoni temën dhe pyetni nëse edhe të tjerët dëshirojnë të flasin për të.
- Mos u kërkoni të tjerëve të diskutojnë për tema që ju interesojnë vetëm ju.
- Përqendrohuni tek tema, mos e vini veten në plan të parë, mos flisni keq për të tjerët.
- Ndiqni me kujdes çfarë thonë të tjerët. Kundërshtoni ose mbështetni mendimet e të tjerëve me fakte dhe argumente.
- Mendimi duhet shprehur shkurt.
- Dëgjojmë me vëmendje të tjerët, kur flasin.
- Mendimin tuaj argumentojeni me të dhëna.
- Mos nënvleftësoni askënd dhe mos i ndërpritni të tjerët gjatë të folurit.
- Kur ju ofendojnë, mos u përgjigjini po ashtu, sepse kështu do të fitoni respektin e të tjerëve si njeri i zgjuar dhe i edukuar.



USHTROHUNI

1. Zhvilloni një diskutim për temën: “Duhani dëmton shëndetin”.

Tregoni kujdes të respektoni rregullat e pjesëmarrjes në diskutim.

2. Bisedoni në grupe dhe më pas me gjithë klasën rreth temës:

“A ka nevojë një dymbëdhjetëvjeçar të ketë një shumë parash?”

a. Do t’u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

- Përse mund t’i nevojitet një sasi lekësh një dymbëdhjetëvjeçari?
- A duhet t’u japin prindërit lekë fëmijëve rregullisht apo vetëm si shpërblim për një notë dhe sjellje të mirë?
- A ka mundësi që duke pasur vazhdimisht një sasi të caktuar lekësh, të bëhesh më i kujdesshëm në përdorimin e tyre?

b. Jepni mendimin tuaj për zhvillimin e diskutimit.

Cilat ishin anët më të mira dhe pikat e dobëta të diskutimit?

3. Diskutoni rreth temës: “Propozime për bashkëjetesën dhe mirëkuptimin në klasë”.

a. Shkruani propozimet tuaja për një shoqëri të mirë në klasë, duke plotësuar me laps listën.

1. Çdo nxënës duhet të mundohet që të jetë gjithnjë miqësor.

2. Duhet të jeni të gatshëm të ndihmoni njëri-tjetrin.

3. _____

4. _____

b. Hartoni në fletoren tuaj sipas këtij modeli një rregullore për bashkëjetesën në klasë.



- Mirëdita, Arben!
Do vish në kinema me ne?



- Më falni, zotëri,
a mund t'ju ndihmoj?

- Mbaruam, më duket...



- Jo, të lutem!
Kam edhe një pyetje për klimën.



PYESIM _____

1. Në çfarë situatash janë thënë secila prej fjalive?
2. Përse fillojnë me përshëndetjet miqësore: "Mirëdita, jo, të lutem, më falni"?

MËSOJMË

Për të tërhequr vëmendjen e atij me të cilin duam të hyjmë në bisedë ose të njihemi, është mirë t'i drejtohem me një përshëndetje miqësore. Përshëndetje miqësore, që mund të përdoren për të hyrë në bisedë me të tjerët janë: Mirëdita! Të lutem! Më falni! Pastaj mund t'i tregoni emrin dhe diçka për veten tuaj. Një bisedë mund ta filloni edhe duke pyetur me mirësjellje për diçka ose duke folur për kohën, për cilësinë e shërbimeve të tjera, në varësi të situatës në të cilën ndodheni.



- Albit, - tha e menduar mësuesja, - i ka ndodhur një aksident ...

Pardje pa në rrugë një vajzë të vogël tri vjeçare, që u shkëput nga trotuari e nxitoi të kalonte në anën tjetër. Një makinë po afrohej me shpejtësi. Albi u hodh me vrap, kapi vajzën dhe e shpëtoi, por vetë u rrëzua. Shoferi frenoi menjëherë, por rruga ishte lagur nga shiu dhe makina i vrau këmbën e djathtë. Vajza e vogël është mirë, por Albi ka dy ditë në spital. Këmbën ia kanë vënë në allçi. Së shpejti këmba do t'i shërohet fare dhe ai do të kthehet në shkollë.

Shokët dhe shoqet e Albit shprehin mendimet e tyre për veprimin e tij.

Vera: - Unë mendoj se ai veproi shumë mirë.

Zana: - Ti ndoshta ke të drejtë, sepse veprimi i tij i rrezikoi jetën.

Dritani: - Sipas mendimit tim ai veproi ashtu si duhet.

Gazmendi: - Unë kam përshtypjen që mund të vepronte ndryshe...

Keti: - Kështu mendoj edhe unë, u tregua trim.

Drita: - Ndoshta ai nuk kishte kohë të gjente një rrugëdalje tjetër për të shpëtuar vajzën.

Mira: - Jam i një mendjeje me ty, Keti.

Andia: - Nuk jam dakord, sepse ai pësoi aksident për vete...

Agimi: - Po, por megjithëatë ishte veprim i rrezikshëm.

Valeri: - E keni gabim, njeriu mund t'i ndihmojë të tjerët, por, pa rrezikuar jetën e tij.



PYESIM

- Cilat fjali shprehin një mendim, arsyetim?
- Cilat fjali miratojnë një mendim?
- Cila fjali shpreh një dyshim?
- Cilat fjali plotësojnë një pikëpamje?
- Cila fjali shpreh një kundërshtim?

MËSOJMË

Një fjali mund:

1. të shprehë një pikëpamje:

- Unë mendoj se ai veproi shumë mirë.
- Sipas mendimit tim ai veproi si duhet.

2. të miratojë një pikëpamje:

- Kështu mendoj edhe unë, u tregua trim.
- Jam i një mendjeje me ty Keti.

3. të shprehë një dyshim:

- Po, por me gjithë atë ishte veprim i rrezikshëm.
- Ju keni ndoshta të drejtë, por, kjo i rrezikonte jetën Albit.

4. të plotësojë një mendim:

- Unë kam përshtypjen që mund të vepronte ndryshe.
- Ndoshta ai mund të gjente një rrugëdalje tjetër.

5. të kundërshtojë një pikëpamje:-

- Nuk jam aspak dakord, ai pësoi aksident për vete.
- E keni gabim, njeriu mund t'i ndihmojë të tjerët, por pa rrezikuar jetën e tij.



• Shkruani një tekst të shkurtër në fletore (10-15 fjali) duke përdorur të dhëna zyrtare e shkencore mbi tema si: "Sjellja e mirë në rrugë", "Punësimi në Shqipëri", "Sportet në Shqipëri", "Mjedisi dhe Ekologjia" etj. Mos harroni që të citoni burimet e informacionit.

Për të parashtruar një pikëpamje mund të përdorim shprehje si këto: - Unë mendoj se..., - Mendimi im është se..., - Sipas mendimit tim..., - Për mendimin tim..., - Besoj..., - Jam i bindur..., - Sipas meje..., - Për mua..., - Ajo që mendoj unë, është... - Pikëpamja ime është se...

Për të shprehur një dyshim për një mendim mund të përdorim shprehje si këto: -Varet..., - Po, megjithatë, ... - Përkundrazi, ... - Nuk duhet harruar që..., - Ju keni ndoshta të drejtë, por ... , - Nuk e kuptoj përse..., - Mos duhej...

Për të plotësuar, stërholluar një pikëpamje mund të përdorim shprehje si këto: - Më duket se..., - A nuk të duket që..., - Unë kam përshtypjen që..., - Është e mundshme..., - Në parim..., - Ndoshta...

Për të kërkuar sqarime plotësuese mund të përdorim shprehje si këto: - Nuk e di në se ju kam kuptuar, por..., - Çfarë doni të thoni me këtë..., - A mund të më sqaroni...

Për të miratuar një mendim mund të përdorim shprehje si këto: - Kështu mendoj edhe unë... , - Jam dakord..., - E miratoj..., - Jam i bindur (i sigurt), që..., - Jam i një mendjeje me ty..., - Ju keni të drejtë..., - Pa dyshim!, - Është pikërisht ajo që mendoj., - Sigurisht., - Pa dyshim., - Natyrisht., - Ta kisha thënë...,

Për të kundërshtuar një mendim mund të përdorim shprehje si këto: - Nuk jam aspak dakord..., - E keni gabim., - Është e pakuptimtë ..., - Nuk mendoj kështu., - Në këtë çështje nuk jam dakord me ty.

PËRMBLEDHIM

Për të paraqitur pikëpamjet tona, për të shprehur një dyshim, për të kërkuar një sqarim, për të miratuar diçka etj., përdoren mjete të ndryshme gjuhësore.



USHTROHUNI

1. Imagjinoni një takim në park me një shok të ri, që pak e njihni. Si do të vepronit konkretisht?

Kujdes të respektoni rregullat e pjesëmarrjes në diskutim.

2. Imagjinoni takime njerëz të ndryshëm:

- gjatë një udhëtimi me prindërit,
- me komshinjtë e rinj,
- në shkollë, ditën e parë.

Si do të vepronit konkretisht?

3. Paraqitni një ose disa situata ku mund të përdoren shprehjet:

- Mirëdita!
- Mirëmëngjes!
- Më falni!

4. Cili është qëndrimi juaj ndaj një shoku të ri:

	PO	JO
E shikoni?		
I buzëqeshni?		
Mendonit t'i flisni?		
I flisni?		
Keni një lloj frike...		
I flisni i pari!		

5. Mami vendos që ju të mos shkoni në festë. Jepni mendimin tuaj për këtë vendim të mamit.

6. Një shoku juaj është futur me vrap në det për të shpëtuar jetën e një fëmije të vogël në rrezik. Jepni mendimin tuaj për veprimin e tij.




KUJDES

Të japësh mendimin tënd, do të thotë të vlerësosh pozitivisht ose negativisht, drejtpërdrejt ose me nuanca një problem ose një situatë të caktuar. Jepni mendimin tuaj duke pasur parasysh situatën konkrete dhe bashkëfolësin.

Vështrojmë

- Më pëlqen të kem një kamera, që të regjistroj çaste nga jeta e kafshëve.



- Do të doja shumë të vizitoja disa nga vendet më të bukura të Evropës.

- Sa keq që nuk kam një kamera, sepse do të regjistroja çaste të bukura nga jeta e kafshëve.



-Më vjen keq që nuk kam një makinë, sepse do të vizitoja disa nga vendet e Afrikës.



PYESIM

- Çfarë shprehin dy fjalitë e para?
- Si fillojnë dy fjalitë e para?
- Çfarë shprehin dy fjalitë e dyta?
- Si fillojnë dy fjalitë e dyta?

MËSOJMË

Një fjali mund të shprehë:

- një dëshirë: - Më pëlqen të kem një kamerë, që të regjistroj çaste nga jeta e kafshëve.
- Do të doja shumë të vizitoja disa nga vendet më të bukura të Evropës.
- një keqardhje: - Sa keq që nuk kam një kamera, sepse do të regjistroja çaste nga jeta e kafshëve.
- Më vjen keq që nuk kam një makinë, sepse do të vizitoja disa nga vendet e Evropës.

Për të shprehur: - një dëshirë mund të përdorim shprehje si këto:

- Më pëlqen... , - Shpresoj që (se) ... , - Kam (shumë) shpresë që (se) ... ,
- Dua +lidhore... , - Do të doja (shumë) + lidhore... , - Kam dëshirë + lidhore... ,
- Uroj +lidhore... , - Ajo që dua është + lidhore... , - Besoj që (se) ... ,
- Besoj +lidhore... , - Kam besim që (se) ... , - Ah, sikur të mundja... ,
- Ah, sikur të isha... , - Ah, sikur të kisha...

Për të shprehur: - një keqardhje mund të përdorim shprehje si këto:

- Fatkeqësisht... , - Më vjen keq që... , - Është për të ardhur keq që... , - Sa keq që... , - Po ta dija se... - Sikur ta dija...

PËRMBLEDHIM

Për të paraqitur pikëpamjet tona, për të shprehur një dyshim, për të kërkuar një sqarim, për të miratuar diçka etj., përdoren mjete të ndryshme gjuhësore.



LEXOJMË

- Unë jam pak a shumë dakord për ndryshimet, po ajo që nuk kuptoj unë është se ti ke vendosur të prishësh fare kontratën, pa më pyetur mua.
- Duket e drejtë, por unë dëgjova që ti kishe vendosur të punoje diku tjetër?
- Nuk e pranoj. Ti duhet të më kishe pyetur mua.
- Po ti nuk po vije fare në punë dhe unë mendova se...
- Dhe ti vendose vetë të prishje kontratën?
- Ke të drejtë, duket jam nxituar. Po e rregullojmë këtë problem!



PYESIM

- Çfarë shprehin dy fjalitë e para?
- Çfarë shprehin dy fjalitë e dyta?
- Çfarë shprehin dy fjalitë e treta?
- Si fillojnë katër fjalitë e para?
- Si janë ndërtuar dy fjalitë e fundit?
- Bëni komentet përkatëse.



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

40

Para se të bëjmë një vërejtje ose kritikë, është mirë t'i bëjmë ndonjëherë lëshim bashkëbiseduesit duke pranuar një pjesë të pikëpamjes së tij:

- **Unë jam pak a shumë dakord**, po ajo që nuk kuptoj unë, është se ti ke vendosur të prishësh kontratën, pa më pyetur mua.
- **Duket e drejtë**, po megjithatë shtrohet pyetja, përse nuk ke marrë edhe mendimin tim?

Në një situatë të zakonshme familjare, kur duam të bëjmë vërejtje ose kritika mund të përdorim shprehje si këto:

- Duket e drejtë, po megjithatë shtrohet pyetja...,
- Po, nuk është e gabuar, po si mund të shpjegohet që...,
- Unë jam pak a shumë dakord, por, ajo që nuk kuptoj unë është...

Në një situatë më pak familjare, mund të bëjmë vërejtje përmes pyetjesh të drejtpërdrejta:

- | | |
|------------------------------------|-------------------------------|
| - Si ka mundësi ta kesh bërë këtë? | - Çfarë kujton ti se jam unë? |
| - Me ç'të drejtë e ke bërë këtë? | - Ç'është kjo që po bën ti? |
| - Si ke guxuar? | |

Ose mund të shprehemi:

- Ti je i pasjellshëm dhe mendjemadh.
- Nuk ju lejoj ...,
- Nuk pranoj...,
- Ti s'më ke thënë të vërtetën.

Jo të drejtpërdrejta:

- Nuk e di përse...?
- Asnjëri nuk e di se përse...?
- Si shpjegohet që...?
- Nga se vjen kjo...?

PËRMBLEDHIM

Për të paraqitur pikëpamjet tona, për të shprehur një dyshim, për të kërkuar një sqarim, për të miratuar diçka etj., përdoren mjete të ndryshme gjuhësore.



Shpërndarja e informacionit

Sot të gjithë e përdorin internetin, sepse kompjuteri, tableti, laptopi, telefonat celularë, kanë gjetur përdorim të gjerë. Teknologjitë e prodhimit të tyre përmirësohen çdo ditë. Njerëzit japin dhe marrin mesazhe me njëri - tjetrin, nga një kontinent në tjetrin, me një shpejtësi shumë të madhe. Kjo teknologji është një nga shpikjet më të mëdha të shekullit XX, që sjell shumë të mira për njerëzimin.

Komunikimit zanor me mesazhe, i shtohen edhe dërgimi i fotografive të njëri-tjetrit në kohë rekord. Duket se ka një garë të madhe të kompanive të mëdha, për të arritur në aparate sa më cilësorë.

Nga kjo garë ka fitim individit dhe shoqëria, sepse siç e patë edhe në mësimet e kaluara, ju mund të bëni shumë kërkime në kompjuter, për të mësuar më shumë për një problem të caktuar, jo vetëm në fushën e gjuhës shqipe, por edhe për: mjedisin, historinë, gjeografinë, teknologjinë, shoqërinë njerëzore, të shihni ngjarje të aktualitetit, të dëgjoni muzikë, të lexoni libra, të shihni filma, të mësoni për astronominë, udhëtimet kozmike etj.

Kompjuteri, i lidhur me internetin do t'ju ndihmojë për projekte të ndryshme që doni të realizoni.



Kompjuter

Diskutim

1. Argumentoni pse teknologjia e informacionit, komunikimit me anë të internetit, konsiderohet një nga shpikjet më të mëdha?
 2. Cilat janë ndryshimet dhe ngjashmëritë midis fjalëve: libër, media, televizion, internet?
 3. Cili është ndryshimi i një salle interneti nga një sallë biblioteke?
 4. Ku do të donit të ishit dhe pse?
 5. Cili është libri i fundit që keni lexuar?
 6. Si ndihesh pasi lexon një libër të bukur? Po pasi ke parë një film të bukur?
- Shkruaji mendimet në fletore dhe trego ndryshimin.



Shpërndarja e informacionit me internet

ATDHEU

O atdhe! Më je i dashur sa më s'ka,
 Më je nënë, më je motër e vëlla.
 Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,
 Je m'i miri nga çdo gjë që ka ky dhe.
 Ty përditë nëna ime të ka parë,
 Dheu yt në fund atë e pati marrë,
 Numëruar t'i pat lulet syri i saj;
 Tek ti lindi, tek ti vdiq ajo pastaj.
 Ti ke parë gjysh stërgjyshërit e mi.
 Dhe eshtrat e tyre tretur i ke ti.
 O shpirt, teje ata kurrë s'qenë ndarë,
 Pranë teje patën qeshur, patën qarë.
 Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,
 Nënë që s'ke vdekje kurrë, faqehënë.
 Dhe pse ha, o dhe, ti bijt e tu të mjerë,
 Numri i tyre në vend mbetet kurdoherë.
 Begatoje, o imzot, ti këtë vend!
 Falu njerëzve mbrodhësi e falu shend!
 Hi u bëshin kurdoher' armiq e tij!
 Gaz përjetë paçin zotërit e tij!
 I begat', i lulëzuar qoft' ai,
 Një të ardhme pastë plot me lumturi.

Kjo pjesë është marrë nga libri "Ëndërrimet".



Naim Frashëri

NAIM FRASHËRI (1848 - 1900) është poeti më i madh i Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Lindi në Frashër, fshat i Përmetit, ku edhe mori mësimet e para. Shkollën e mesme e kreu në Janinë, ku njohu letërsinë greke-latine dhe kulturën europiane.

Më pas shkoi në Stamboll, ku qëndroi dy vjet. Pas shfaqjes së tuberkulozit, kthehet në vendlindje, ku qëndroi po ashtu dy vjet, duke shëtitur maleve për klimë më të mirë. Më 1882 shpëngulet në Stamboll, ku iu përkushtua botimit të librave shqip. Ka botuar, ndër të tjera veprat: "Lulet e verësë", "Bagëti e bujqësi", "Histori e Skënderbeut" etj.

KUPTOJMË DHE NDJEJMË

1. Çfarë është atdheu për poetin?

2. Si i kuptoni vargjet:

*Nga ç'ke rrotull më i shtrenjtë ti më je.
 Je m'i miri nga çdo gjë që ka ky dhe!*

3. Në cilat vargje poeti vë përballë atdheun me gjëra të tjera të vlefshme të jetës? Cila dashuri fiton mbi çdo dashuri tjetër?

4. Çfarë e lidh njeriun përjetësisht me atdheun:

- vendlindja e nënës _____
- interesat ekonomike _____
- varret e stërgjyshëve _____

Ilustrojeni mendimin tuaj me vargje.

5. Në këtë vjershë poeti tregon një lidhje jo vetëm të përhershme, por edhe të thellë me atdheun:

P.sh.: Dheu yt në fund atë e pati marrë.

Gjeni dhe lexoni me intonacionin e duhur edhe vargje të tjera që e shprehin këtë.

6. Pyesni prindërit ose gjyshërit për jetën e stërgjyshërve tuaj që kanë vdekur. Pastaj imagjinoni si kanë ecur, si kanë punuar, kanë jetuar në ato vende, që ju shkelni dhe sot.
Flitni për ndjesitë që do t'ju shkaktojë ky meditim.

7. Në këtë vjershë gjejmë vargje me të cilat poeti i drejtohet atdheut, si dhe vargje ku poeti shpreh lutjet dhe urimet e tij.
Gjejini këto vargje dhe bëni dallimin ndërmjet tyre.



Kërkoni në internet podcast-e apo video me kritika letrare mbi periudhën e "Rilindjes Kombëtare". Bëni një përmbledhje të shkurtër (10-15 fjali) me faktet më të veçanta që mësuat. Mos harroni që të citoni burimin e informacionit.





FJALË DHE SHPREHJE

- nga çka rrotull* këtu: nga të gjitha gjërat e tjera që ka jeta
është- a këtu: mbeturinat e skeletit të njeriut të varrosur prej kohësh; kockat
begatoje jepi pasuri e lumturi
mbrodhësi- a fat i mirë
i begatë i pasur, i lulëzuar



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

- Dashurinë e madhe për atdheun poeti e shpreh me epitete.**
Çfarë cilësie shprehin ato?
- Jeta dhe vdekja në atdhe shprehen me hollësi mjaft të bukura artistike.** Gjejini ato:

Jeta
Ty përditë nëna ime të ka parë

Vdekja
Dheu yt në fund atë e pati marrë

- Fjala nënë përdoret në dy kuptime.** Qarkojini në poezi dhe shpjegoni kuptimin e tyre.
- Epiteti që përdor poeti për atdheun faqehënë**, shpreh mjaft bukur disa kuptime që lidhen me këndvështrimin e njeriut për vendlindjen.

Plotësoni:

Për poetin, natyra e atdheut është _____

Për poetin, koha sa jeton atdheu _____

Kudo që të jetë poeti dashuria për atdheun _____

- Vini re se rendi i gjymtyrëve ka ndryshuar.**

Kjo bëhet vetëm për hir të rimës, që poezia të ruajë melodinë, apo edhe për të theksuar, për të vënë në dukje diçka të rëndësishme.

Gjeni në vargjet e mëposhtme pjesët përbërëse të fjalisë që kanë ndryshuar rendin. Shkruajini në rendin e zakonshëm:



Nga çka rrotull ti më i shtrenjtë më je _____

Numëruar t'i pat lulet syri i saj _____

Dhe eshtrat e tyre tretur ti i ke _____



DETYRË

Provoni të shkruani katër fjali me urime për atdheun në formë vargjesh, si te kjo poezi.

KTHIMI I SKËNDERBEUT NË KRUJË

Vargjet e mëposhtme janë marrë nga poema "Historia e Skënderbeut" e Naim Frashërit.

Krujë o qytet i bekuar,
prite, prite Skënderbenë!
Po vjen si pëllumb i shkruar
të shpëtojë mëmëdhenë.
Shqiptarët t'i shpëtojë
nga zgjedh' e keqe e Turqisë
edhe ty të të nderojë,
që je kreu i Shqipërisë.
Ka pas trima shqipëtarë,
që s'u trembej syri kurrë,
në zemër të tij ka zjarrë,
është i urtë e trim, e burrë.
Mirë se erdhe, o verë
që na prure mirësinë,
dhe për shumë vjet të tjerë
e zbukurofsh Shqipërinë!
O moj vash' e Shqipërisë
që më rri duke mejtuar,
pa i zhvish rrobat e zisë,
arriti dit' e uruar.
Zbardhi fusha, ndriti mali,
nga armët e trimërisë,
hingëllin e s'mbahej kali,
që sill mbretinë e Shqipërisë.



Poezia

Teksti :“ Kthimi i Skënderbeut në Krujë” është shkruar nga poeti Naim Frashëri. Vargjet kanë secili nga tetë rrokje, janë pra, tetërorësh.

Në këtë poezi fjalët në fund të vargjeve rimojnë.

Poezia, është gjini letrare që përfshin tekste të shkruara në vargje që kombinojnë ritmin dhe rimën për të shprehur, ndjenjat e poetit.

Gjuha e poezisë është e figurshme, dallon nga gjuha e komunikimit të përditshëm. Për grekët dhe romakët e vjetër, poezia ishte gjuha e perëndive, të cilën ishin të aftë ta përdornin vetëm disa njerëz të veçantë, poetët.



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Nga po kthehej Skënderbeu?
2. Pse po kthehej?
3. Përshkruajeni Skënderbeun duke përdorur vargjet e Naimit.
4. Në cilat vargje shprehet gëzimi i poetit?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Përse autori e quan Skënderbeun “pëllumb i shkruar”?
2. Përse autori e quan ditën e kthimit të Skënderbeut “dit’ e uruar”?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Kush është autori i këtij teksti?
2. A ka personazhe në këtë tekst?
3. A tregohet në këtë tekst një ngjarje që kanë një fillim, një vazhdimin dhe një përfundim, pra që kanë hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen?
4. Çfarë dallimi ka ky tekst me tekstet treguese?
5. Si është ndërtuar ky tekst?
6. Çfarë është ky tekst?

PAMJE

Kjo pjesë është marrë nga libri
"Psallme murgu".

Që lart nga qielli
në hapësirë, si lëmsh i zjarrtë
u rrëkëlye dielli
kur perëndoi,
Por mb' udhë, majë shkëmbi të një mali -
takoi të jetë mali i lartë,
meqë dot hovin nuk e ndali
keq u përpoq, mend kryet i dërmoi!
Si hej zu gjaku të rrjedhi,
U skuqnë ujërat edhe toka,
U skuqnë rreth e retë;
tej kresht' e maleve me dëborë shtruar
dhe bredhat majavat - q'u dukshin si burbuqe,
u lyen ngjyrë trëndafil;
dhe deti i tërë u bë pasqyr' e kuqe:
I larë qe me gjak secili,
sikur prej dore magjistari t'ishin ndërruar!



ASDRENI

ASDRENI (1872- 1947) ishte poet, publicist dhe atdhetar i shquar i Rilindjes Kombëtare, i njohur si autor i Himnit të Flamurit Kombëtar. Ai emigroi në Bukuresht- Rumani, ku u bë një figurë kyçe e kolonisë shqiptare me poezi demokratike e patriotike. Mori pjesë gjallërisht në përpjekjet për çlirimin kombëtar dhe u shqua si veprimtar i saj. Në krijimet e para poetike që i përmbodhi në librin "Rreze Dielli" (1904), Asdreni vijoi traditat e poezisë së Naim Frashërit, lartësoi dashurinë për atdheun, nxiti bashkatdhetarët të rreshtoheshin në luftën për çlirim nga zgjedha turke.



FJALË DHE SHPREHJE

u rrëkëlye ra duke u rrotulluar
hov-i vrulli, lëvizja e menjëhershme
dhe me shumë forcë
kresht/ë-a maja e malit



KUPTOJMË DHE NDJEJMË

1. Për ç'dukuri natyrore flet poeti në këtë vjershë?

2. Si e përfytyron poeti diellin:

siç është në jetë apo si një qenie me shpirt?

Gjeni ato vargje që ilustrojnë mendimin tuaj.

3. Në këtë vjershë poeti jo vetëm sodit peizazhin.

Cilat janë ndjesitë që e pushtuan poetin?

habia _____

dhimbja _____

indiferenca _____

admirimi _____

mospëlqimi _____?

4. Po juve çfarë ndjesish keni gjatë perëndimit të diellit?

A ndjeni që t'ju pasurohen ato pasi lexoni këtë poezi?





STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Gjeni krahasimin me të cilin poeti përshkruan diellin në çastin e perëndimit.
2. Cila është ngjyra kryesore me të cilën piktori do ta pikturonte këtë peizazh?
3. Ndaluni në marrëdhënien që krijon poeti:

e kuqja

perëndimi

gjaku

Cila ndodh vërtet në natyrë?

Cila ndodh në imagjinatën e poetit?

4. Me ç'hollësi e jep poeti përhapjen e përskuqjes së diellit:

Për shembull, u skuqën ujërat dhe toka.

5. Similituda (krahasimi i zgjeruar) në vargun e fundit:


sikur prej dore magjistari t'ishin ndërruar të nxit imagjinatën dhe të shton habinë që të shkakton ndërrimi dhe bukuria e natyrës.

A e keni menduar ndonjëherë për këtë? Në ç'mënyrë?

Nëse jo, le t'ju shërbejë kjo poezi për të pasuruar fantazinë dhe mendimin tuaj.

Përfytyroni disa dukuri të natyrës duke i shpirtëzuar:

p.sh. : gjethet e pemëve pëshpërisin, hëna buzëqesh...



...u skuqën ujërat dhe toka.



...gjethet e pemëve pëshpërisin...



DETYRË

Përpiquni t'i ktheni vargjet në prozë duke ruajtur sa më shumë origjinalitetin e tyre.



QIPARISI DHE MOLLA E BARDHË

*Kjo pjesë është marrë nga poema
"Kënga e sprasme e Balës".*

E, ndërsa ne po mendonim
Që në varre t'i mbulonim,
Përtej urës një vajzë
Na u dëftua si një hije.
Flok't i kishte të ndërlikur,
Syt' të futur thell' në ballë,
Me fustanin copë-copë
E me këmbë të përgjakura:
"O ushtarë, o vëllezër,
Ju përher' të lumë qofshi!
Mbase pat' në këtë fushë
Një kalorës trim të ri
Me një karkall-o të artë,
Me një tuf' flokësh të verdhë.
E ka ballin porsi dielli.
Ka dy sy si dy shkëndija,
Dy shkëndija të shkrepimës;
E ka gojën si unazë.
Edhe fjalëzën të ëmbël,
Porsi hojet e pranverës
Deh, ju lutem, më kallëzoni!"
Sy ndër sy ne u vërejtëm,
Në lot sytë na u mbytën,
Helmi buzën na e qepi.
Ajo u zverdh e na vështroi
E u kthye dhe, sa e pa
Shtrirë t'vdekurin mbi dhe,
Dha një britmë e në krahë
E ftohtë si borë i ra.
Vam t'i flisnim, s'u përgjegj,
Vam' ta preknim, nuk lëvizi,
Vam, ta ngrinim e na vdiq...
Jan' dy varre në Vajkal;
Fle te njëri Pal Golemi
E mbi të mbiu një lis
Me gjith' gjethet në blerim.
Fle te tjetri Niku i Petës,
Vasha e Lalës i fle pranë,
Se, si u deshën përmbi dhe;
Ashtu duhen dhe nën dhe;
Atje mbiu një qiparis
Mbiu dhe një mollë e bardhë!



Gavril Dara

GAVRIL DARA i Riu lindi më 1826 në Pallaci të Sicilisë në një familje trashëgimtare bujarësh shqiptarë, që kishin kaluar përtej Adriatikut pas vdekjes së Skënderbeut. Dara i Riu u bë poeti i një familjeje me kulturë kombëtare. Ai u mor me drejtësi, gazetari e poezi, filozofi e arkeologji dhe ishte kërkues i shkrimeve të vjetra shqipe. Librat i la dorëshkrime. Në dorëshkrim mbeti edhe kryevepra: "Kënga e sprasme e Balës", që u botua e plotë në vitin 1906 në Katanxaro. "Kënga e sprasme e Balës" ka figura poetike të freskëta, ka strukturë artistike të lidhur. Është kryevepër e poezisë romantike shqipe.



KUPTOJMË DHE NDJEJMË _____

- Për ç'kohë dhe për ç'ngjarje bën fjalë kjo pjesë?**
- Cilët janë katër personazhet e kësaj pjese?**
(Cili personazh përfaqëson përemrin vector ne?)
- Përse vasha kishte ardhur në fushën e betejës?**
Ç'parandjente ajo?
- Vdekja e përnjëhershme e vashës është një mënyrë poetike për të shprehur:**
dashurinë e saj të madhe për mikun e zemrës _____
apo
një zgjidhje e çastit për të na mallëngjyer ____?
Ilustrojeni përgjigjen tuaj me vargje.
- Në baladën "Besa e Kostandinit" nëna dhe vajza vdesin në të njëjtin çast. A tregon kjo hollësi për mbështetjen e G. Darës në krijimtarinë popullore?**
(Kujtoni dhe fundin e baladës së Gjergj Elez Alisë).
- Çfarë do të shprehë autori në mbyllje të baladës me vargjet:**
Se, si u deshën përmbi dhe;
Ashtu duhen dhe nën dhe;
Atje mbiu një qiparis
Mbiu dhe një mollë e bardhë!
Ç'tregon, çelja e qiparisit dhe e mollës së bardhë?



FJALË DHE SHPREHJE

<i>na u dëftua</i>	na u shfaq, na doli papritur përpara
<i>të ndërlisur</i>	të ngatërruar
<i>të lumë qofshi</i>	të lumtur qofshi (urim)



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Siç e thamë kjo pjesë është shkëputur nga një poemë.

Poema është një tregim ose rrëfim jo në rreshta, por në vargje. Ajo zakonisht flet për një ose më shumë ngjarje, ka disa personazhe dhe zakonisht është e gjatë. Shkruhet në vetën e parë ose të tretë.

Në ç'vetë është shkruar kjo poemë?

2. Gjeni hollësitë (detajet) me të cilat e përshkruan vajzën poeti:

u dëftua si hije

Ç'tregojnë ato për gjendjen shpirtërore të vajzës?

3. Gjeni krahasimet me të cilat vajza përshkruan portretin fizik të Nikut:

Ç'tregojnë ato:

për cilësitë morale të Nikut

për lidhjen ndërmjet vashës dhe Nikut?

4. Me ç'krahasim jepet vdekja e vashës? A ju pëlqen krahasimi? Vini re se poeti përdor dy cilësi të dëborës:

ftohtësinë dhe bardhësinë.

Ç'do të tregojë me cilësinë e parë dhe me të dytën.

(A nuk ju duket se i kundërvihet me të dytën cilësisë së zezë të vdekjes?)

5. Vini re se brenda kësaj pjesë poeti përdor vargje me ndërtime të ndryshme gjuhësore. Ndaluni në tri vargjet që futen mes vargjeve të tjera, pa e prishur melodinë e tyre:

Vam t'i flisnim, s'u përgjegj,

Vam ta preknim, nuk lëvizim

Vam ta ngrinim e na vdiq...

Cilat veta përdoren brenda një vargu? Ç'efekt jep pjesa e dytë e vargjeve e ndërtuar me folje mohore?



1. Kërkoni në fjalorin online përkufizimin e fjalëve: "publicist", "fantazi", "bujar", "kulturë", "melodi", "portret", "moral" dhe "melodi".


Shkruani në fletore përkufizimet e tyre, duke u përpjekur që të kujtoni saktë kuptimin. Matni kohën e procesit dhe regjistroni në fletore.

2. Shkruani me kompjuter përkufizimin e fjalëve më lart.

Matni kohën e procesit dhe regjistroni në fletore.



Kjo pjesë është marrë nga poema " Andrra e jetës" e poetit Ndre Mjeda. Në të poeti flet për jetën e vështirë malësore dhe njëkohësisht shpreh ndjenjat e tij për gëzimet dhe brengat e jetës. Pjesa tregon për lumturinë që i fal nënës përkëdhelja e fëmijës.



Ndre Mjeda

*E kandshme asht hana
Kur del me zana,
E n'tokë me dritë përndaret.
Hyjzit që shndrisin
E që shëtisin
Nëpër qiell, janë t'bukur fare.*

*Kur del agimi
E rruzullimi
Me nji dritë kuqloshe mbulohet,
E përmbi kashta
Shndrit pika lashta,
Zemra për mall gazmohet.*

*Asht i madh shendi,
Kur ndihet shpendi
Ndër pyje tuj pingrue;
E knaqshme a nji lule
Kur ju përkule,
O fllad i leht, me e lmue.*

*Por s'i ngjet qielli,
Nuk i ngjet prilli
As flladi që shëtit lulet
E me erna veshet,
Foshnjës që i qeshet,
Nanës, kur mbi të përkulet.*



FJALË DHE SHPREHJE

- përndaret* përhapet, shpërndahet
- hyjzit* yjet
- kuqloshe* në ngjyrë të kuqe
- pika lashta* pika e vesës
- tuj pingrue* duke cicëruar, duke kënduar
- fllad-i* erë e lehtë e freskët dhe e këndshme



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

1. Cilit çast ia kushton poeti këto vargje?

2. Në tri strofat e para poeti jep peizazhe të ndryshme:

a. nata me hënë b. agimi kuqalosh c. pylli me këngë e lule ç. natyra në muajin prill

Çfarë përfytyrimesh ju ngjallin këto peizazhe?

3. Po të pikturonit, për ç'peizazhe do të përdornit ngjyrat e mëposhtme?

të gjelbrën me nuancat e saj; _____

blunë me të argjendtën; _____

të kaltrën me të kuqen; _____

të kaltrën me të gjelbrën? _____

Përse zgjodhët këto ngjyra?

4. Si jepet lidhja ndërmjet nënës dhe fëmijës:

Si një lidhje gjaku:

e përkohshme

e respektueshme

e përjetshme

e bukur

e ftohtë

e ngrohtë

e mrekullueshme

e thellë

e paqëndrueshme

5. A ju ndodh ndonjëherë ta imagjinoni veten tuaj foshnjë në duart e nënës. Çfarë ndjesish për nënën ju pushtojnë ato çaste?

50



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Kjo pjesë është shkruar në dialektin gegë. Le të studiojmë disa nga fjalët e saj duke i kthyer në normën letrare:

e kandshme - e këndshme

asht - është (a - formë e shkurtuar e asht)

hana - hëna

hyjzit - yjet

nji - _____ tuj - _____ erna - _____ lmue - _____ veshet - _____

2. Poeti për të shprehur kënaqësinë e nënës, kur i qesh fëmija, jep disa krahasime (pa e quajtur të nevojshme praninë e lidhëzës si) dhe vetëm në dy vargjet e fundit të kësaj kënge nxjerr në pah idenë e tij.

A ju pëlqen kjo mënyrë poetike që përdor poeti? A ju tërheq befasia që ju shkaktojnë dy vargjet e fundit? Përse?

3. Në ç'mënyrë janë vendosur rimat në këtë poezi?



DETYRË

Zgjidhni njërën nga kërkesat e mëposhtme:

1. Gjeni dhe shkruani disa figura ose hollësi artistike me të cilat do ta përshkruanit ju foshnjën që i qesh nënës në kraharor.
2. Kthejini këto vargje në prozë duke u përpjekur të ruani sa më shumë origjinalitetin e saj.

FSHATI IM

Kjo poezi është shkruar nga A. Z. Çajupi kur Shqipëria ishte nën sundimin osman. Në këtë poezi autori godet qëndrimin jo të drejtë ndaj gruas.

Maletë me gurë
fushat me bar shumë,
aratë me grurë,
më tutje një lumë.

Burrat nën hije
lozin, kuvendojnë,
pika që s'u bie,
se nga gratë rrojnë!

Gruaja për burrë
digjet në diell
punon e s'ri kurrë,
as ditën e diel.

Fshati për karshi,
me kish'e me varre,
rrotull ca shtëpi
të vogëla fare.

Gratë venë në arë,
dhe në vreshta gratë,
gruaja korr barë,
punon dit'e natë.

O moj shqipëtarke,
që vete e nget qetë
edhe dreke darkë
kthehesh e bën vetë.

Ujëtë të ftohtë,
era pun'e madhe
bilbili ia thotë,
gratë si sorkadhe.

Gratë në të shira
në të vjela gratë,
ikinë pa gdhirë,
kthehenë me natë.

Moj e mjera grua
ç'e do burrë zinë
që ftohet në krua
dhe ti mban shtëpinë?



ANDON ZAKO ÇAJUPI

(1866-1930) lindi në fshati Sheper të Zagorisë.

Kur ishte 15 vjeç shkoi në Egjipt.

Atje ndoqi mësimet në liceun francez. Studimet e larta për drejtësi i bëri në Zvicër. Punoi si avokat në Misir. Çajupi është një nga poetët më të e shquar shqiptar të Rilindjes. Poezitë e tij i ka botuar në vëllimin "Baba Tomori". Ndër veprat e tij përmendim pjesët teatrore: "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër", "Pas vdekjes", "Buri i dheut".



FJALË DHE SHPREHJE

- më tutje* më larg
- karshi* përballë
- sorkadhe-j* femra e kaprollit
- pika* sëmundje që sjellë vdekje të menjëhershme



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Çfarë përshkruan Çajupi në tri strofat e para?
2. Po në strofën e katërt përse flet?
3. Çfarë paraqet autori në strofat 5, 6, 7?
4. Po dy strofat e fundit të poetit si mund të vlerësohen?
-si revoltë e autorit;
-si pakënaqësi e autorit;
-si dëshpërim i autorit;
-si thirrje e autorit?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Me ç'lloj strofe është ndërtuar poezia?
2. Sa rrokje kanë vargjet e kësaj poezie?
3. Bëni vlerësimin tuaj për poezinë. Përpiquni ta argumentoni.

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Në sa pjesë mund ta ndajmë këtë poezi?
2. Çdo pjesë i vini një titull.
3. Çfarë lloj fjalish përdor autori për të përshkruar bukurinë e fshatit?
4. Lexoni dhe bëni komentet tuaja për këto vargje të autorit:
*Burrat nën hije
lozin, kuvendojnë,
pika që s'u bie,
se nga gratë rrojnë!*

KËNGË PËR VDEKJEN E SKËNDERBEUT

*Kjo pjesë është marrë nga libri: “
Vepra të zgjedhura” të shkrimtarit
arbëresh Jeronim de Rada.*

Cila erë do ta rrëmbejë vallë këtë trup? O, sa orë hareje shpresoi ai dhe s’pati kurrë! Të rrethuar nga rrufe e dallgë ne s’dimë ku iku toka: mbetëm ne në këto vise. Pse, moj re, ti çahesh dhe hap një qiell të bardhë mbi viset e vendlindjes?

Edhe veriu fryn më fort dhe duke na harruar shkon mbi det. Ndofta nuk e di se për fatin tonë të zi ne jemi brengosur. Ja, lindi agimi i vendit tim. Po shoh prapë fushat e zbehta dhe kodrat gjethezeza: ja shtëpitë e nënës sime, ja gratë e rritura me mua, që të ngritura pa gdhirë dalin në dritaret e shtëpive të vështrajnë ditën.

Ato janë të brengosura se Skënderbeu u bë dhe. Kur u nisa unë më pyesnin: O Serafinë, a ke vallë një nënë që të të presë në breg dhe të të shtrëngojë me duar që i dridhen, gjymtyrët e tua të freskëta? Apo do të jesh e vetmuar atje si toka që njerëzit e shkelin me këmbë dhe s’e vënë re?

Këmbanat mbrëmë kumbonin në zi në të gjitha brigjet, se heroi vdiq: dhe ja, nëpër altare u shuan qirinjtë, veç drita e vatrës i ndriçoi shtëpitë. Në ëndërr ishin bërë mospërfillës ndaj tokës së mbjellë me pemë dhe hënës. Medet! Nga dheu nuk ngrihet më ai, në fushim vetëm çadra e tij mungon...

Po pse vallë, kur dielli u shua në mal, vajtuam se kishim humbur rrugën dhe vetë dielli mbeti pa vajtim?...



Jeronim De Rada

JERONIM DE RADA arbëresh lindi 29 nëntor 1814 në Siçili dhe vdiq në 28 shkurt 1903. Ishte mbledhës i madh i folklorit, gazetar, jurist, shkrimtar. Është një nga shkrimtarët që ka ndikuar më shumë në shekullim e 19’ për rilindjen kombëtare në Shqipëri. Jeronim de Rada e arriti kulmin e krijimtarisë së tij në vitin 1866 kur botoi në Firence: “Këngët e Milosaos”. Ky libër përmban rapsoditë më të bukura shqiptare.



FJALË DHE SHPREHJE

<i>orë hareje</i>	orë të gëzuara, kohë të lumtura
<i>hare - ja</i>	gëzim
<i>viset</i>	vendet
<i>veri - u</i>	erë e ftohtë që fryn nga veriu
<i>u bë dhe</i>	këtu, iu tret trupi nën tokë
<i>dielli u shua në mal</i>	dielli u zhduk, perëndoi prapa malit
<i>pika</i>	sëmundje që sjellë vdekje të menjëhershme



KUPTOJMË TEKSTIN

1. Kujt i kushtohet kjo pjesë? Ç’dini ju për të?
2. Kush vajton për kryetrimin?
3. Ç’kishte ndodhur me Serafinën dhe njerëzit e saj pas vdekjes së Skënderbeut?
4. Çfarë ndodhi mbrëmjen kur vdiq heroi?



1. Bëni një kërkim në internet me fjalët kyçe: “rilindja kombëtare shqiptare në diasporë”. Për çfarë bëhet fjalë?
2. Shkruani në fletore një përmbledhje të shkurtër (10-15 fjali) nga sa lexuat.





VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN



1. Serafina vajtonte fatin e zi sepse:

Kishte vdekur _____ ai që _____.
 Jetonte larg _____ dhe vuante nga _____.
 Përse autori i lidh bashkë këto dy brenga të heroinës?

2. Çfarë ndjesish janë derdhur në këtë pjesë:

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> malli | <input type="checkbox"/> dashuria |
| <input type="checkbox"/> kënaqësia | <input type="checkbox"/> vajtimi |
| <input type="checkbox"/> brenga | <input type="checkbox"/> hareja |
| <input type="checkbox"/> entuziazmi | <input type="checkbox"/> keqardhja? |



3. Kur autori thotë:... vajtuam se kishim humbur rrugën dhe vetë dielli mbeti pa vajtim (pasi përëndoi), ai shpreh këtu pesimizmin e tij. Të ndjesh pesimizëm (ose të ndihesh pesimist, do të thotë të mbetesh pa shpresë; të mos shpresosh për ditë më të mira, për një fat më të mirë). Cilën rrugë kishte humbur personazhi? Cilën shpresë?

4. Dashuria dhe malli për vendlindjen janë po aq të fuqishme sa hidhërimi dhe brenga për vdekjen e Skënderbeut. Ilustrojeni këtë mendim duke lexuar fjali nga pjesa.



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Kur lexojmë këtë pjesë, zbulojmë në të disa karakteristika të poezisë:

asaj i mungon fabula (ngjarja),
 në të autori derdh ndjenjat e tij,
 përdor një figuracion të pasur.

Kjo pjesë quhet **prozë poetike**, pra qëndron ndërmjet prozës dhe poezisë.

Figurat më të përdorura në të janë pyetjet retorike.

Nënvizoni në libër pyetjet retorike dhe shpjegoni (me ndihmën e mësuesit) kuptimin e tyre.

2. Gjeni dhe shkruani hollësitë (detajet) me të cilat autori përshkruan zinë e madhe që shkaktoi vdekja e Skënderbeut.

p.sh.: Këmbanat kumbonin në zi...

(Plotësoni me laps ose në fletoren tuaj).

3. Ndaluni në metaforat e kësaj shprehjeje:

Të rrethuar nga rrufe e dallgë/ne s'dimë ku iku toka.

Së pari gjeni çdo të thotë autori me fjalët:

rrufe e dallgë është fjala për luftërat, _____, _____; toka është fjala për tokën _____.

Së dyti gjeni kuptimin e dy shprehjeve:

Të rrethuar nga rrufe e dallgë d.m.th.

a. ikëm mes detit...

b. ikëm me plagë...

S'dimë ku iku toka d.m.th.

a. u larguam nga...

b. e humbëm...

Bashkujini tani këto kuptime në një fjali të vetme.

JETESA E SHQIPTARIT

Ky tekst është marrë nga libri "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët" i Pashko Vasa. Në këtë tekst ai na tregon se shqiptarët jetonin bashkërisht dhe kishin marrëdhënie tepër njerëzore ndërmjet tyre.



Pashko Vasa

Jetesa që bëhet në Shqipëri është fare e vjetruar, patriarkale. Çdo fis ka kryetarin e vet dhe pleqtë, që e qeverisin e që ushtrojnë drejtësinë sipas dokeve e zakoneve të tyre të vjetra, të bazuara mbi kanunin e gjakut. Kryetari dhe pleqtë e kanë trashëgim nga prindërit e tyre vendin që zënë në fis, por kjo nuk u jep të drejtë për asnjë përfitim nga populli. Kryetari dhe pleqtë mund të hidhen në gjyq porsì të tjerët për çështje të së drejtës së përgjithshme dhe mund të ndëshkohen me të njëjta dënime; një kryetar që vret, vritet edhe ai, kjo i thotë të gjitha.

Pa hyrë në hollësi që nuk i përfshin punimi ynë, do të shtrojmë para lexuesit një pjesë të ligjeve të vjetra që rregullojnë marrëdhëniet e banorëve ndërmjet tyre.

Kush vjedh duhet t'i kthejë dyfishin atij që ka pësuar vjedhjen dhe, veç kësaj, duhet të paguajë një gjobë që e përfiton kryetari me pleqësinë. Njeriu që vritet duke vjedhë, çnderohet, nuk thuhet se ai vdiq si trim.

Një borxhli duhet të lajë borxhin ashtu siç e ka marrë, në mall ose në para.

Prona është e shenjtë, askush nuk ka të drejtë të cenojë pasurinë e tjetrit. Çështjet e së drejtës tokësore, të pronësisë dhe të kufijve gjykohen nga pleqësia, e cila në këto rrethana, detyrohet të betohet përmbi gur. Vendimet janë të pakundërshtueshme e, sidoqoftë, të zbatueshme.

Këto ligje janë të barabarta për të gjithë; ndryshimi i fesë nuk u ndërron asgjë atyre. Barazia e të drejtave është e plotë për të gjithë pa dallim; doket e zakonet sigurojnë vazhdimësinë e tyre dhe zbatimin më të përpiktë.

Mysafiri është i paprekshëm, të drejtat e mikpritjes nuk mund të shkelen në asnjë mënyrë. Ai që vret ose keqpërdor mysafirin e vet, çnderohet, dëbohet nga fisi dhe asnjëri nuk mund të bëjë krushqi me familjen e tij, ky turp

PASHKO VASA (1825-1892) lindi në Shkodër. Ishte autodidakt. Në moshën 22 - vjeçare iku në Itali dhe sherbeu si oficer kalorësie. Nga Italia shkoi në Stamboll. Mori pjesë aktive në themelimin e shoqërive kulturore shqiptare. Pati funksione të larta në Stamboll. Në vitin 1883, për meritat e tij, u emërua Guvernator i Përgjithshëm i Libanit. Vdiq në Bejrut të Libanit. Ka shkruar poezi dhe vepra në prozë. Një pjesë e tyre janë shkruar në gjuhë të huaj. Veprat e tij kryesore janë: "Shqypnija dhe shqyptarët", "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët", "Bardha e Temalit".

është i përjetshëm, as gjaku, vetë, nuk mund ta lajë. Ai që vret mysafirin e një tjetri, i ka borxh dyzet gjaqe, të cilat fisi që ka bërë mikpritjen, ka të drejtë t'i kërkojë fisit të atij që ka vvarë mysafirin.

Burri që vret një grua, çnderohet; turpi bie mbi gjithë pjesëtarët e familjes së tij. Ata quhen vrasës grash.

Sikurse edhe fisi ka kryetarin e tij, ashtu edhe çdo familje ka të vetin, atë që është më i madh në moshë. Gruaja më e moshuar e familjes është zonja e shtëpisë. Meqenëse jetesa është krejt patriarkale, pjesëtarë e një familjeje janë shumë. Ka familje që numërojnë deri në njëqind e njëqind e njëzet veta. Burrat marrin urdhrat nga kryetari që drejton, dhe i zbatojnë; ky i ka në dorë të gjitha (gjërat) e të gjithë (njerëzit), pa qenë e mundur që t'i bëhet kundërshtim. Respekti për pleqërinë s'ka kufi. Zonja e shtëpisë ushtron të njëjtin pushtet mbi gratë dhe vajzat. Po të qëllojë që pjesëtarët e një familjeje të ankohen për njëri-tjetrin, kryetari i familjes vetë dora, gjykon, ndëshkon dhe pajton sipas rrethanave. Të ngresh krye kundër vendimit të kryetarit është një veprim që sjell pas qortimin nga të gjithë dhe që çnderon atë që kryen atë faj.





Shqiptari është përkorë dhe kënaqet me të ngrëna shumë të varfra. Buka e misrit, djathi dhe qumështi janë ushqimi i tij i zakonshëm. Ai pi ujë dhe nuk e përdor verën e rakinë, veçse me shumë kufizim. Vishet lehtë, i qëndron të ftohtit e të nxehtit dhe duron lodhjen e skamjen. Për miqësinë ka një adhurim dhembshurie edhe besnikëri që i qëndron çdo prove.

Entuziazmohet lehtë dhe frymëzohet nga e bukura, madhështorja dhe nga bëmat e shkëlqyera. Ai është poet. Kushdo e di se malësori shqiptar, duke shkuar drejt dënimi me vdekje,

ka borxh të thurë aty për aty një këngë, të cilën e këndon pa mburrje dhe pa dobësi, ndërsa e ëma dhe të afërmit e ndjekin pas, me dhimbjen në thellësi të zemrës, por me buzë në gaz, deri në atë vend ku duhet ta ekzekutojnë. Këngët e atyre që vdesin si trima, mbeten edhe përsëriten nga të rinjtë. Pushka dhe jatagani janë armët e zemrës për shqiptarin, sidomos pushka, është shoku i tij i pandarë; e përkujdes dhe e lëmon me një dashuri krejt të veçantë, ai betohet për armët e tij, ashtu siç betohet për zotin apo për besën. Armët e bukura. Ja pasuria dhe krenaria e tij!



FJALË DHE SHPREHJE

- patriarkal* i vjetëruar
fis-i bashkësi njerëzish që qeveriseshin sipas të drejtës zakonore, kanunit
doket zakonet
kanun-i përmbledhje ligjesh popullore të pashkuara
cënoj prish
e drejta tokësore pronësia mbi tokën
i përkorë copë e vogël



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Si jetonin malësorët shqiptarë në kohën e autorit?
2. Çfarë organizimi kishin?
3. Ç'detyra dhe ç'të drejta kishte kryetari i familjes?
4. Çfarë ligjesh kishte për miqtë, vjedhësit dhe borxhlinjtë?
5. Po familja si funksiononte?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Ç'është kanuni?
2. Çfarë është pleqësia?
3. Ku duket nderimi dhe bujaria e shqiptarit për mikun?
4. Ç'virtete të larta të shqiptarit vihen në dukje në fundin e pjesës?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Çfarë bën autori në këtë tekst?
 - jep të dhëna dhe shpjegime për diçka që nuk njihet nga lexuesi?
 - tregon një ngjarje që ka hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen?
 - përshkruan natyrë ose një personazh?
2. Çfarë teksti është:
 - tregues,
 - përshkrues,
 - shpjegues?

LUFTA E MASHKULLORËS

Kjo pjesë letrare është marrë nga libri me kujtime "Kryengritja shqiptare" i Mihail Gramenos. Në këtë pjesë shkrimtari përshkruan betejën e çetës së Çerçiz Topullit me turqit. Ajo u zhvillua më 18 mars 1908 në Mashkullorë, një fshat afër Gjirokastrës. Mihal Grameno ishte anëtar i çetës së Çerçizit dhe mori pjesë në këtë betejë.



Mihal Grameno

Në orën 7 zuri lufta e rregullshme edhe e rreptë. Ushtria ishte përhapur edhe na kish rrethuar nga të gjitha anët, edhe që andej na luftonte. Nuk dua të shtoi, po përkundrazi, të pakësoj numrin e ushtrisë, që përbëhej më tepër se 150 shpirt, kurse ne nuk ishim, siç dihet, veçse pesë shpirt. Përveç kësaj, nuk duhet harruar që ne bënim ekonomi të madhe në fishekë, se gjithnjë Çerçizi bërtiste: "Mos harxhoni, o shokë, fishekë më kot!"

Plumbat na vinin si breshëri, po ne, si ca statuja, qëndronim në vendet tona, edhe u përgjigjeshim me plumba, dhe duke qëlluar këndonim këngë kombëtare.

Kërkoj ndjesë, se më mungon fuqia e duhur për të treguar, zbukuruar edhe stolisur, siç meriton, burrërinë dhe trimërinë që tregoi trimi ynë kapedan, luftëtar i madh dhe i patrembur, që nderoi armët e Shqipërisë! Po, kapedani ynë i shtrenjtë, Çerçizi u tregua si një dragua në këtë luftë, kështu që historia kombëtare do të mburret me emrin e këtij djali të ri, po burri të madh të Shqipërisë.

Vetëm edhe vetëm atëherë munda të besoj historinë e kombit tonë me burrërinë dhe trimërinë e stërgjyshërve tanë. Vetëm atëherë munda të kuptoj e të çmoj vleftën e këtij djali trim, të cilit me gjithë që ishte rritur i përkëdhelur, nuk i trembej syri kurrë nga vdekja.

Kokëjashtë, me leshrat përpjetë, vërtitej më gjithë anët si një komandant i madh, me pushkën në dorë dhe gjashtaren në brez duke na mburrur ne edhe duke qëlluar mbi ushtarë. Fytyra e tij këtë ditë ishte më e çelur se kurdoherë, edhe jo sikur luftonte, po sikur kërcente.

Shumë herë e qortoja dhe, e këshilloja të mos nxirrte kryet përjashta nga mbrojtja me gurë që kishim forcuar, meqenëse Çerçizi shumë herë nxirrte kryet përjashta dhe u fliste ushtarëve turqisht, që të hiqeshin mënjane dhe të mos

MIHAL GRAMENO (1872- 1931) lindi në Korçë. Që fëmijë mori rrugën e kurbetit për në Rumani. Atje ra kontakt me lëvizjen patriotike shqiptare. Mori pjesë në çetat e lirisë (1905-1908). Ka botuar librat: "Mallkimi i gjuhës shqipe", "Vdekja e Pirros", "Oxhaku", "E puthura" dhe "Varri i pagëzimit". Ka botuar edhe një libër me kujtime nga jeta e tij në çetë me titullin: "Kryengritja shqiptare". Vdiq në Shqipëri më 1931.

vriteshin vëlla me vëlla. Edhe oficerët i ftonte të dilnin në shesh e të luftonin një për një, po, ata, të fshehur, i përgjigjeshin me dinakëri e me fjalë të ëmbla që të jepeshim, se u vinte keq të vriteshim, duke i premtuar jo vetëm falje, por edhe një rytbe të madhe nga Padishahu.

Me këto mënyra anadollakët përpiqeshin të na humbitnin e te na demoralizonin, prandaj Çerçizi, duke i sharë rëndë, nxirrte kryet dhe u thoshte:

"Jemi bij të Skënderbeut edhe nuk jepemi, po do të luftojmë gjer në orën e fundit, se shqiptari sipas zakonisht, di të vdesë me nder për atdheun!" Mirëpo ushtarët këtë prisnin: të nxirrte pakëz kryet Çerçizi që, pas urdhrit që kishin, me vrap të shtinin të gjithë përmbi atë.

Ah, edhe sot e sjell ndërmend tmerrin që kam ndjerë, kur pashë Çerçizin t'i derdhej gjak prej ballit! I verdhë si dylli, i thashë me dëshpërim: "E ç'na bëre more derëzi, që na preve krahët? Pse nuk dëgjon këshillat e mia, po të gënjyen turqit gjer të plagosën?" Vrapova t'i jap ndihmën e duhur, por Çerçizi duke fshirë gjakun, më tha: "Mos u dëshpëro, Mihal se nuk i jam plagosur, po një cifël prej guri më goditi".

Edhe shtiu me zemërim mbi ushtarin që e kish qëlluar, dhe e shtriu përdhe. Çerçizi qëllonte kaq mirë, sa të rrallë besoj ndodhen të këtillë qëllonjës.





FJALË DHE SHPREHJE

- shpirt-i* këtu: person, njeri
- ndjesë-a* falje
- dragua-oi* figurë mitologjike
- e përrallve* këtu: trim i madh
- leshtrat* këtu: flokët
- rytbe-ja* pozitë zyrtare
- cifël-a* copë e vogël
- jepem* dorëzohern

Kësisoj, luftuam gjer në orën 2 pas dreke, kur dëgjuam trumbetën të buçiste. Gjer në atë kohë ishin vrrarë 8 ushtarë. Ne pandehëm që do të shkonin, edhe u gëzuam, po oficerët i mblodhën që t'u jepnin të tjera urdhra, se pas pak nisi, në buçimë të trumbetës, një luftë kaq e rreptë, sa nuk tregohet. Plumbat na vinin rrëke si breshëri edhe të pareshtur, kaq dendur, sa nuk mundnim të zbraznim dot ndonjë.

Plani i oficerëve ishte që shumica e ushtarëve të mbante një zjarr të pareshtur, kurse pakica, nën hije të plumbave, të afrohej edhe të na shtrëngonte të jepeshim ose të na vriste. Ky plan ishte fort bukur i përgatitur, po kapedani ynë guximtar dhe trim, Çerçizi, me gjashtaren e tij, i pengonte që të mos afroheshin duke na thënë edhe neve që të shtinin, verbërisht, për t'i frikësuar edhe të mos guxonin që të afroheshin pranë nesh.

Kjo luftë kaq e rreptë mbajti gjer në orën 4-5 edhe pastaj, si e panë që plani i tyre nuk u solli ndonjë dobi, zunë ta rrallonin luftën edhe ca nga ca të hiqen, të lodhur, të lagur e të dëshpëruar, duke lënë edhe dy të vrrarë!



Përshkrimi

Në tekstin "Lufta e Mashkullorës", autori përshkruan betejën e zhvilluar në Mashkullorë ndërmjet çetës së udhëhequr nga Çerçiz Topullit dhe turqve. Autori ka zgjedhur nga ajo ngjarje disa nga elementet më të rëndësishme dhe më tipike për këtë situatë. Foljet në pjesët përshkruese të këtij teksti janë, kryesisht, në të pakryerën.

Teksti "Lufta e Mashkullorës" është përshkruar në pjesën kryesore të tij.



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Ku zhvillohen ngjarjet?
2. Kur zhvillohen?
3. Përshkruani betejën me turqit.
4. Çfarë plani bënë oficerët turq?
5. Si përfundoi beteja me turqit?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Kush është Çerçizi?
2. Çfarë pamje ka ai? Përshkruajeni.
3. Çfarë cilësish ka ai? Përshkruajini.
4. Përse nuk arritën turqit të mposhtin luftëtarët shqiptarë?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Kush i paraqet ngjarjet në këtë tekst?
2. Çfarë bënë autori në këtë tekst?
3. A tregohen ngjarje në këtë tekst?

UJKU DHE QENGJI

Dhentë ne vathë po rrinin,
qentë ndënë hije po flinin,
bariu fyellit i binte,
e gjësendi re më s'vinte.

Ujku erdhi dhe nga vrima
e gardhit, si vetëtima
hyri në vathë laduti,
djalli e pru' edhe e futi.

Një qengj që ishte i rritur
dhe fare i pastërvitur,
iu qas, nga, fjala e zunë,
i tha: - Pse erdhe këtunë?
i tha: - Sheshi i lulëzuar
dhe ky përroi i kulluar
më prunë mua këtunë.

Ta dish fort mire se unë,
me pak ujë e me dy fletë
rroj e kam rrojtur në jetë...

Qengji i varfër me të qetë
i tha: - Në është kjo e vërtetë
eja këtu, bashkë të rrojmë
nëpër sheshe të kullorim
e zemrën ta zhbrensim.

Me të thënë këtë fjalë
dhe nga vatha duke dalë,
qengjin ujku më s'e priti
po e zu e kollofiti!

Qysh mund të mbetet gjallë
ëngjulli bashkë me djallë
Botën mos e gjykoni
me fjalët që u dëgjoni,
mos u shikoni ç'tregojnë
Po vini re ç'gjë punojnë.



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË _____

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Ku ishin dhentë? Po bariu çfarë po bënte?
2. Kush erdhi në vath si hajdut?
3. Çfarë e pyeti qengji?
4. Po ujku çfarë i tha?
5. Po qengji, pasi dëgjoi fjalët e ujkut, çfarë i tha?
6. Si iu përgjigj ujku qengjit?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Kush është *ëngjulli* në këtë tekst?
2. Po *djalli* kush është?
3. Pse autori i emërton njërin "*ëngjull*" e tjetrin "*djallë*"?
4. Çfarë mendimi keni ju për secilin prej tyre.
5. Si i kuptoni fjalët e ujkut:
"Ta dish fort mire se unë,
me pak ujë e me dy fletë
rroj e kam rrojtur në jetë..." ?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. A janë reale apo të imagjinuara ngjarjet në këtë tekst?
2. Çfarë janë personazhet e këtij teksti?
3. Cila është domethënia ose morali e këtij teksti?



1. Merrni pranë një orë ose pajisje dixhitale dhe matni kohën që ju duhet për të kopjuar fabulën në fletore.
2. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.

Fabula

Në tekstin: "Ujku dhe qengji" tregohen ngjarje imagjinuare, jo të vërteta. Personazhet janë kafshë me tipare njerëzore (ujku dhe qengji). Një tekst i tillë quhen fabul. Fabula, është tekst i shkurtër, në vargje ose në prozë, që jep një mesazh që ka kuptim, domethënie a moral të caktuar. Morali i kësaj fabule është kritikë ndaj pabesisë, ligësisë, ndaj atyre që ndryshe flasin e ndryshe veprojnë.

Për fabulat e tyre shquhen Ezopi, në lashtësi, La Fonteni në shekullin XVII.

Në Shqipëri shquhen poetët: Naim Frashëri, Andon Zako Çajupi etj.



BRETKOSA QË DO TË TRASHET SA NJË KA

Bretkosa sa një ve,
pa një ka sa një deve,
dhe nakari nuk e la,
desh të trashet sa një ka.
Kur vu këtë gjë ndër mend,
vajti u shtri në një vend.
duke ngrënë duke pirë,
që të fryhet sa më mirë.

- Shihni, shihni sa u rrita, -
thërriste e thoshte përdita.
- Mos u mburr e mos u mbaj,
- i thoshin shoqet e saj.
- Shihni, nuk jam sa demi?
- Jo! - Shikoni! - Jo, të themi.
- Pa shikoni këtë bark
si të kaut. - Jo, je larg!
Bretkosa nga marazi
u fry, u fry gjersa plasi.
Shumë njerëz në botë
thonë se janë të zotë,
si bretkosa mendohen,
mburren e lëvdohen.

Përkthyer nga A. Z Çajupi



ZHAN DË LA FONTEN

ZHAN DË LA FONTEN (1621-1695). Zhan dë la Fonten është shkrimtar francez. Ka shkruar shumë tregime, novela, komedi dhe romane, por emri i tij u bë i njohur me fabulat, të botuara në vitet 1668, 1678, 1693. Që në librin e parë të fabulave ai i kujton lexuesit se u drejtohet kafshëve për të mësuar njerëzit. Përmes tyre ai godet: dhunën, hipokrizinë, mashtrimin, gënjeshtërinë, lakminë, egoizmin etj., dhe vlerëson: lirinë, dashurinë, punën, njeriun, drejtësinë etj. Emri i La Fontenit ka qenë i njohur prej kohësh në vendin tonë. Rilindësit tanë i vlerësonin fabulat e tij dhe shqipëruan disa prej tyre.



FJALË DHE SHPREHJE

nakar-i zili, smirë

Mos harroni

- Çdo fabul ka një kuptim ose domethënie të veçantë.
- Personazhet e tyre janë kafshë me tipare njerëzore.
- Morali gjendet në fillim ose fund të ngjarjeve të treguara.
- Morali i tekstit më lart është se: "nuk duhet të mburremi për gjëra që nuk i arrijmë dot"



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Çfarë pa bretkosa e vogël?
2. Çfarë dëshire i lindi bretkosës kur pa kaun?
3. Çfarë bëri për t'u bërë si kau?
4. Çfarë filloi të thotë?
5. Po shoqet çfarë i thoshin?
6. Çfarë ndodhi pastaj?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. A janë reale apo të imagjinuara ngjarjet në këtë tekst?
2. Çfarë janë personazhet e këtij teksti?
3. Çfarë është ky tekst?
4. Cili është morali i këtij teksti?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Çfarë mendimi keni ju për mençurinë e bretkosës?

2. Lexoni këto vargje dhe bëni komentet tuaja.

*Shumë njerëz në botë
thonë se janë të zotë,
si bretkosa mendohen,
mburren e lëvdohen.*

3. Çfarë figura letrare vini re në këto vargje:
*Bretkosa sa një ve,
pa një ka sa një deve,
dhe nakari nuk e la,
desh të trashet sa një ka.*

GOMARI DHE QENI

Një trim udhëtar
hipur mbi gomar,
vinte në pazar,
dhe qeni me gaz
e kish marrë pas.
Në një shesh me bar,
dhe me lule shumë,
zbret udhëtar
dhe bie në gjumë.
Atëherë gomari
qëndroi te sheshi,
hëngri bar sa deshi,
s'pyeti për qenë
që mbeti pa ngrënë.
"Shok, tha qeni i mjerë,
ti dhe perëndia!
Vdiqa nga uria!
Bjerë në shesh, bjerë;
pak bukë të marr,
që ke mbi samar,
se s'kam ngrënë sot!"
"Dale, - tha veshgjati,
të zgjohet im zot",
Qeni, nga inati,
po qante me lot,
se s'duronte dot,
dhe për këtë shkak

u shtri ndënë hije.
Atëherë për pak,
del nga një korije
një ujk i madh si ka.
Kur e pa gomari pranë,
nga frika veshët i ranë
dhe qenit i tha:
"Ngrehu të më ruash,
të lutem, o mik,
se jam në rrezik!
"Thirr sa të duash,
tha qeni, s'luaj dot.
Prit ashtu, më rruash,
të zgjohet im zot.
Duhet të durosh
se nuk ka dyshim
që do të shpëtosh,
se je shumë trim,
e nuk ke të sharë
dhe s'ke nevojë për mua!"
Atë çast u afrua
ujku dhe shqeu gomarë.
Këtë fjalë mos harroni:
"Shoku-shokun të ndihmoni,
se, si bëni,
do të gjeni".



FJALË DHE SHPREHJE

e kish marrë pas e ndiqte pas
korie-a pyll i vogël, zabel
i ranë veshët u tremb
më rruash më rrofsh

KUPTOJMË DHE
ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Kush erdhi me gomar?
2. Çfarë kishte marrë me vete?
3. Çfarë bëri udhëtar?
4. Çfarë bëri gomari kur po flinte udhëtar?
5. Çfarë i kërkoi qeni gomarit?
6. Si iu përgjigj gomari?
7. Kush erdhi papritmas?
8. Çfarë i kërkoi gomari qenit?
9. Po qeni si iu përgjigj?
10. Si përfundon ngjarja?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Cilët janë personazhet kryesore në këtë tekst?
2. Çfarë mendimi keni ju për qëndrimin e gomarit?
3. Lexoni këto vargje dhe bëni komentet tuaja.
"Ngrehu të më ruash,
të lutem, o mik,
se jam në rrezik!
"Thirr sa të duash,
tha qeni, s'luaj dot.
Prit ashtu, më rruash,
të zgjohet im zot.
4. Si i kuptoni ju fjalët e autorit:
Këtë fjalë mos harroni:
"Shoku-shokun të ndihmoni,
se si bëni,
do të gjeni".

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. A janë reale apo të imagjinuara ngjarjet në këtë tekst?
2. Çfarë janë personazhet e këtij teksti?
3. Cili është morali i këtij teksti?
4. Çfarë është ky tekst?

Lexojeni duke e dramatizuar këtë fabul: një nxënës të bëhet autori, tjetri të lexojë fjalët e qenit dhe një tjetër fjalët e gomarit.



KORBI DHE DHELPA

Kushedi sa e kanë thënë
lajka është gjë e ndyrë,
një mynxyrë.
Fjal' të kota paskan qenë,
lajkatari di se ç'bën
dhe përherë
ndër të tjerë
ndonjë skut në zemër gjen.
Dikur fati i madh
Korbi i dërgoi
një copëz djathë.
Korbi fluturoi
mu përmbi një bredh
e këtu si erdh
copëzën që mbante,
u gatit ta hante.
Por (shans i mallkuar)
andej duke shkuar
dhelprën na takoi
erën e dëgjoi
djathin e shikoi,
djathin e robëroi.
Dinakja aherë
me bishtin në erë,
mbi dy këmbët ngritur,
te pema avitet
zë dhe jargavitet,

plot me ëmbëlsirë.
"Pëllumbesh' sa mirë!
Syçkëzat e tua,
qafëza që ke
më marrosën mua!
Stërpërrallore je!
Upupu, se ç'pendël!
Bobo, sqepi yt!
Edhe unë do mend,
ti do kesh në fyt
një zëth engjëllor!
Turp mos ki!
Hajt, këndo, o yll qiellor,
se me këtë bukuri,
dhe zë tëmbël po të kesh,
ti do të bëhesh mbretëreshë
hem mbi kafsh' e hem mbi shpeshë!"
Kok' e korbit s'është në vete
kur dëgjon këtë profete:
vjen vërdallë,
bëhet dhallë!
E gëzimi mu në fyt
i zë frymën, gati e mbyt,
dhe, që zërin të tregojë,
hapi sqepin, klithi "krra".
Djathi ra.
Dhelpra e priti mu në gojë!
Përkthyer nga A. Z. Çajupi



Ivan Krilov

IVAN KRILLOV (1768-1844) është poet rus. Është i njohur për fabulat e tij të bukura, që e radhitën krahas Ezopit të Greqisë së vjetër dhe La Fontenit francez. Ka shkruar 201 fabula ku godet të metat, veset e njerëzve dhe të qeveritarëve.



FJALË DHE SHPREHJE

- lajkë-a* fjalë të bukura që i thuhet dikujt për t'i bërë qejfin
- i ndyrë* i keq
- mynxyrë-a* një gjë e keqe
- skutë-a* një vend i fshehur, qoshe
- shans-i* rast i mirë, fat
- jargavitet* i lëshon goja lëng
- shpeshë* shpendë
- profete* parashikuese



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Çfarë janë lajkat për autorin?
2. Çfarë i dërgoi fati korbit?
3. Çfarë bëri dhelpra kur pa korbin me copën e djathit?
4. Po korbi si veproi?
5. Si përfundon ngjarja?
4. Lexoni këto vargje dhe i komentoni.
"Pëllumbesh' sa mirë!
Syçkëzat e tua,
qafëza që ke
më marrosën mua!
Stërpërrallore je!
Upupu, se ç'pendël!
Bobo, sqepi yt!

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Cilët janë personazhet kryesor në këtë tekst?
2. Çfarë mendimi keni ju për Korbin?
3. Po për dhelprën si mendoni?
1. A janë reale apo të imagjinuara ngjarjet në këtë tekst?
2. Çfarë janë personazhet e tekstit?
3. Cili është morali i këtij teksti?
4. Çfarë është ky tekst?



DITA E FLAMURIT

E duam flamurin e kuq me shkabën e zezë me dy krerë, se është flamuri ynë, se nën të do të rrojmë të lirë, të nderuar dhe kryelartë në mes të kombeve të qytetëruara të Evropës.

E nderojmë flamurin e kuq me shkabën e zezë me dy krerë, se është flamuri i kurorëzuar me nder e me lavdi i kryeushtarit dhe luanit të shkëlqyer që çuditi botën me trimërinë e tij duke thyer njëzet e pesë vjet me radhë njërën pas tjetrës ushtritë më të forta të asaj kohe, të kryesuara prej sulltanëve më të mëdhenj të Turqisë. Kur Evropa, dridhej nga mizoritë Otomane, dragoi shqiptar, që s'dinte ç'është frika, me një grusht trimash të zgjedhur, vërvitej mbi armikun si rrufe që tundte malet dhe shkëmbinjtë dhe u jepte arratinë kuçedrave aziatike me atë shpatën e tij të rëndë që vetëtinte dhe tmerronte, nën atë flamur të kuq me shkabën e zezë me dy krerë.

E ngremë lart flamurin e madh të Skënderbeut, se ai, që e mbajti i thirri tërë botës me trumbetë ç'është i zoti të bëjë Shqiptari kur bashkon trimëritë me besën, me nderin dhe me dashurinë e vendit të tij. Papa, Kryetari i Krishterimit në Perëndim, Republika e Venedikut, mbretëresha e deteve dhe të gjithë mbretërit dhe princat e Evropës në kohën e Skënderbeut e përshëndoshën flamurin tonë me bekime, pagëzime dhe lavdërime.

E qamë kur u ul për katërqind e pesëdhjetë vjet, se Shqipëria u shua nga lista e shteteve të lira dhe varfëria, mjerimi dhe robëria e shtypën dhe e vogëluan.



Fan Stilian Noli

FAN STILIAN NOLI (1872 - 1965) lindi në Qytezë, fshat i banuar nga shqiptarë në Turqi. Ai qëndroi në Shqipëri pak kohë, nga viti 1920 deri më 1924. Për një kohë të shkurtër qe edhe kryeministër i qeverisë së parë demokratike në Shqipëri. Është ndër poetët e mëdhenj shqiptarë, dramaturg, studiues, publicist dhe mbi të gjitha një nga përkthyesit më të mëdhenj shqiptarë. Shkroi veprat: "Historia e Skënderbeut" dhe "Bethoveni dhe Revolucioni Francez". Është ndër përkthyesit e mëdhenj shqiptarë. Ka përkthyer kryevepra botërore si "Hamleti", "Makbethi", "Otello". Jul Çezari etj.

Por kur u ngrit dhe valoi përsëri në Vlorë dhe u salutua në Durrës me gjëmime topash prej anijeve të fuqishme evropiane, kockat e shenjtëruara të Skënderbeut u drithëruan në varr dhe ne, kur e pamë si në ëndërr, derdhëm lot mallëngjimi, gazi, shprese dhe kryelartësie kombëtare.

E kuptojmë këtë ditë historike, se mësuam ç'do me thënë flamuri i huaj, shpatë, kamxhik dhe zjarr armiku; fshatra të djegura, ara të shkretuara; pleq, gra, fëmijë të therur pa mëshirë a të arratisur në shpella e përrenj, të zhveshur, të zbathur, pa bukë, të rrahur prej të ftohtës, të çjerrurë prej urisë, të shtrydhur prej sëmundjeve, me syrin të errur prej helmit dhe dëshpërimit. Nga goja e kësaj ushtrie dëshmorësh të pafajshëm të barbarisë dhe pashpirtërisë së armiqve të pabesë në Shqipërinë e shkretuar dhe zemra e të gjithë shqiptarëve të mërguar e të shpërndarë si zogjtë e korbit në viset e huaja, ngrihet sot një lutje e nxehtë, e mëshirshme, e mallëngjyer përpara fronit të Perëndisë.

O zot i madh, i drejtë dhe i dhëmbshuruar, shpëtoje popullin dhe vendin tonë të mjerë dhe nderoje përsëri me liri nën flamurin tonë, flamurin e Skënderbeut, flamurin e kuq me shkabën e zezë me dy krerë.





KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Kush e ka shkruar tekstin e mësipërm?
2. Përse flet autori në këtë tekst?
3. Sipas autorit:
 - përse e duam flamurin?
 - përse e nderojmë flamurin?
 - përse e ngritëm lart flamurin?
 - përse qamë kur u ul flamuri?
 - përse u gëzuam përsëri më 1912?
4. Si i argumenton autori mendimet e tij?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Çfarë simbolizon flamuri sipas Fan Nolit?
2. Përse e përshëndoshën flamurin tonë me bekime, pagëzime dhe lavdërime: Papa, Kryetari i Krishterimit në Perëndim, Republika e Venedikut, mbretëresha e deteve dhe të gjithë mbretërit dhe princat e Europës në kohën e Skënderbeut?
3. Po flamuri i huaj në tokën shqiptare çfarë simbolizon për autorin?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Kujt i drejtohet ky tekst?
2. A ka personazhe në këtë tekst?
3. Çfarë bën autori në këtë tekst?
 - përshkruan natyrë ose një personazh?
 - jep të dhëna dhe shpjegime për diçka që nuk njihet nga lexuesi?
 - jep prova ose argumente për të mbrojtur mendimin e tij?
 - tregon një ngjarje që ka hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen?
4. Çfarë teksti është:
 - tregues,
 - përshkruar,
 - shpjegues,
 - argumentues?

Teksti argumentues

Në tekstin "Dita e Flamurit" autori synon të argumentojë mendimin e tij për vlerën e flamurit si simbol i rezistencës dhe luftës për liri të shqiptarëve, si edhe të na bindë për këtë edhe ne. "Dita e Flamurit" është tekst argumentues. Në tekstet argumentuese sillen, prova ose argumente për të mbrojtur një mendim, po edhe për t'i bindur të tjerët mbi atë çështje.




1. Shkruani në fletore një shkrim të shkurtër (rreth 10-15 fjali) mbi aktivitetet që zhvillohen pranë vendbanimit tuaj gjatë festave të nëntorit. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.
2. Shkruani me kompjuter krijimin tuaj duke përdorur programin Word. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.
3. A mund ta përktheni krijimin tuaj në gjuhë të huaj? Në cilën gjuhë? Si do të vepronit?

GJUHA SHQIPE

Porsi kanga e zogut t'verës,
qi vallzon n'blerim të prillit
porsi i ambli flad i erës
qi lëmon gjijt e trandafilit,
porsi vala e bregut të detit,
porsi gjama e rrfesë zhgjetare,
porsi ushtima e nji tërmetit:
njashtu asht gjuha jonë shqiptare.

Pra mallkue njaj bir shqiptari,
që këtë gjuhë të Perëndisë,
trashigim si na e la i pari,
trashëgim s'ia len fëmijës;
edhe atij iu thaftë goja,
qi e përbuzë këtë gjuhë hyjnore,
e në gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
flet e t'veten len mbas dore.

Nëpër gjuhë shqipe bota mbarë
ka me u njohtë se ç'fis ju kini,
ka me u njohtë ju për shqiptarë,
trima n'za sikurse jini.
Prandaj n'se e doni fisin,
mali, bregu dhe malsia,
prej nji goje t'brohorisim:
"Me gjuhë t'veten rroftë Shqipnia".



Gjergj Fishta

GJERGJ FISHTA (1871- 1940) lindi në fshati Fishtë të Zadrimës. Studimet e para i mori në Shkodër dhe pastaj në Bosnjë. Është një nga autorët më të shquar shqiptarë. Mori pjesë aktive në lëvizjen kombëtare kundër zgjedhës osmane dhe luftoi kundër synimeve shoviniste serbe. Veprat kryesore të tij janë: "Lahuta e Malësisë", "Mrizi i Zanave", "Anzat e Parnasit", "Gomari i Babatasit" etj.



FJALË DHE SHPREHJE

gjamë-a këtu: gjënim

rrfesë zhgjetare këtu: rrfesë që godet

në za të dëgjuar



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Kujt i këndon Fishta në strofën e parë?
2. Kë mallkon në strofën e dytë?
3. Si e vlerëson në strofën e tretë?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Çfarë mjeti letrar përdor autori për të treguar forcën dhe bukurinë e gjuhës shqipe?
2. Lexoni dhe bëni komentet tuaja për këto vargje të autorit:

*edhe atij iu thaftë goja,
qi e përbuzë këtë gjuhë hyjnore,
e në gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
flet e t'veten len mbas dore.*

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Me ç'lloj strofe është ndërtuar poezia?
2. Sa rrokje kanë vargjet e kësaj poezie?
3. Bëni vlerësimin tuaj për poezinë.



ZOTI TË DHASHTË

Ky tregim është marrë nga vëllimi me vepra të zgjedhura të Migjenit. Tregimi flet për një nga plagët më të rënda të shoqërisë, varfërinë. Varfëria nuk shërohet me fjalë të bukura si “Zoti të dhashtë”. Për ta zhdukur varfërinë duhet të punojmë e të luftojmë të gjithë së bashku.

Dikush trokiti në derë...

- Kush a?
- A po na fal ndoj send, zojë?
- Zoti të dhashtë!
- Na fal ndoj send, të dhashtë zoti shëndet...
- Hajt! Zoti të dhashtë!

Po lypsi e di se ç’do me thanë “zoti të dhashtë”!
mos me pasë kurrë, mos me ngranë kurrë.

Prandaj, me ma tepër fuqi i bie derës, e tash përbrenda asht zani ma i rreptë.

- Hajt, more! Zoti të dhashtë! A merr vesht!

Lypsit medoemos i duhet me marrë vesht. E le atë derë, mësyn në të dytën, të tretën, të katërtën, e kështu me radhë të gjithë dyert e asaj rruge. Kjo rrugë sot për sot asht rruga e veprimit të tij. Nesër asht ndoj rrugë tjetër. E lypsit, që troket nga dera në derë, diku i falin ndoj send, diku i thotë e zoja e shtëpisë: “S’kam, besa”, dhe lypsi atëherë asht i butë, shkon tue mbajtë në mend këtë derë për me ardhë ndoj ditë tjetër. Por atë “zoti të dhashtë”! lypsi s’e duron, s’do ta dëgjojë. Ai e di mirfilli se ç’do me thanë “zoti të dhashtë”! Edhe atë, i cili e përcjell me ato dy fjalë, ai fillon ta mënijë. Kurrë ai s’i ka ndamë këto dy fjalë njenën nga tjetra. Kudo që dëgjon fjalën “zot”, ai pa dashje ia shton atë “të dhashtë” dhe në tru të tij krijohet diçka, që s’kuptohet, që mnihet. Se ai asht i sigurt se “zoti të dhashtë”! do me thanë me u tallë. Një ditë, me një buzëqeshje ironike, duel lypsi nga një ndërtesë, me kryq në majë, se aty kishte vështruar këto fjalë: “Zoti që kujdeset për zogjtë e qiellës, s’ka me i lanë njerëzit të vdesin nga uja”. Heu, - thoshte lypsi tue dalë, - sot nuk asht njashtu. Zoti ndoshta kujdeset për trumcakët, edhe për priftin, por për mue s’e besoi. Mue edhe shokët e mij na harron edhe bota, e si të mos na harrojë zoti, që s’na ka parasysh. Por thonë se zoti... - këtu lypsi i preu



Millesh Gjergj Nikolla, MIGJENI

MILLOSH GJERGJ NIKOLLA, MIGJENI (1911- 1938) lindi në Shkodër më 1911. Migjeni është pseodonimi i tij. Punoi si mësues në malësi të Shkodrës dhe në qytet. Vdiq më 1938 në Itali. Është poet dhe prozator. Ka botuar përmbledhjen me poezi “Vargjet e lira” dhe në prozë librin “Novela të qytetit të veriut”.

dhe shpejtoi mbrapa një plaku me bastun.

- Zotni, të lutem, më fal ndoj” send...
- Zoti të dhashtë!

Lypsi shtrëngoi dhambët për të ndalë gjuhën, e cila ishte gati të kalojë kufirin e njerëzisë. Shtrëngoi dhe grushtet e thonjtë që tash sa kohë nuk i kishte premë, iu ngulën në dhanat e duarve. Përpara vetes nuk sheh asgjë tjetër, veç objekte mnije...

Atij pak kush i ndihmon, pse janë shumë lypsa. “Kujt t’i epet ma parë?” - arsyetonte lypsi së fundi.

Prandaj ma me taktikë, zotnij, mos thoni” zoti të dhashtë”.



FJALË DHE SHPREHJE

<i>kush-a</i>	<i>kush është</i>
<i>ndoj</i>	<i>ndonjë</i>
<i>medoemos</i>	<i>domosdo</i>
<i>mirfilli</i>	<i>shumë mirë</i>
<i>mënij</i>	<i>urrej</i>
<i>ironike</i>	<i>tallëse</i>
<i>u-ja</i>	<i>uria</i>
<i>bastun-i</i>	<i>shkop për t’u mbështetur</i>
<i>njerëzi-a</i>	<i>mirësjellje</i>
<i>objekt-i</i>	<i>send</i>



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

**Teksti i mësipërm është shkruar në dialektin e veriut.
Thoni çfarë ndryshimesh vini re me gjuhën letrare.**

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Kush trokiste nga një derë në tjetrën?
2. Çfarë kërkonte lypësi nga zonja?
3. Po ajo si i përgjigjej?
4. Çfarë nuk duronte dot lypësi?
5. Çfarë tha lypësi kur pa të shkruar në kishë:
"Zoti që kujdeset për zogjtë e qiellës, s'ka me i lanë njerëzit të vdesin nga uja?"
6. Pse i shtrëngoi dhëmbët lypësi?
7. Çfarë thotë në fund lypësi?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Përse atë që e përcjell me fjalët "zoti të dhashtë" lypësi "fillon ta mënijë"?
2. Komentoni fjalët e lapsit :
"Mue edhe shokët e mij na harron edhe bota, e si të mos na harrojë zoti, që s'na ka parasysh."
3. Pse në fund të tregimit lypësi thotë:
"Atij pak kush i ndihmon, pse janë shumë lypsa. Kujt t'i epet ma parë?"

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Për çfarë flitet në këtë tekst?
2. Kush i tregon ngjarjet?
3. Si janë renditur ngjarjet në këtë tekst?
4. Në çfarë kohe janë foljet?
5. Në çfarë vete tregohen ngjarjet?
6. Çfarë mësojmë nga ky tekst?

Tema dhe Ideja

Për të përcaktuar temën e një pjese letrare apo jo letrare bëjmë pyetjen: për çfarë flitet?

Përcaktimi i temës është i nevojshëm për të kuptuar një tekst letrar ose jo letrar. Shpesh herë titulli i një teksti a një vepre shpreh temën e tij.

Në tregimin "**Zoti të dhashtë**", tema është "varfëria.

Në çdo vepër letrare, tregim, dramë ose vjershë, autori, përveçse tregon diçka, kërkon të na mësojë diçka.

Pra, ai, na thotë se ç'mendon, ç'ide ka për atë që tregon dhe ç'mësim duhet të nxjerrim prej saj.

Pikërisht kjo është ideja e një vepre letrare. Kështu, për ideja e tregimit "**Zoti të dhashtë**", është se "varfëria nuk shërohet me fjalë të bukura".



KROI I FSHATIT TONË

I

Kroi i fshatit tonë, ujë i kulluar,
ç'na buron nga mali duke murmuruar.

Venë mbushin ujë vashat anembanë,
cipëzën me hoje lidhurë mënjanë;

cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,
gushën si zambaku, buzët si burbuqe.

E si mbushin ujë, bubu! ç'm'u ka hije!
ndaj këthehen prapë me hap nusërie;
ndezur ylli i ballit si yll shenjtërie..

II

Kroi i fshatit tonë, ngjyrë argjend i lyer,
që nga rrëzë malit, ç'na buron rrëmbyer.

Venë pijnë ujë trimat anembanë,
takijet me lule përmbi sy mënjanë.

III

Kroi a fshatit tonë, tetë sylynjarë,
në tetë krahina qenka kroi i parë;

qenka një në botë, s'paskërka të dytë,
ç'na shëroka plagët, ç'na shëroka sytë!...



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Përse flet autori në këtë tekst?
2. Si e paraqet ai kroin e fshatit në pjesën e parë dhe të dytë të tekstit?
3. Si i përshkruan ai vajzat e fshatit?
4. Po trimat si i paraqet autori?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Si është ndërtuar ky tekst?
2. Çfarë figurash artistike përdor autori në këtë poezi?
3. Çfarë thekson autori në këtë poezi?



Lasgush Poradeci

LASGUSH PORADECI ishte pseudonimi i *Llazar Gushos*, që lindi në Pogradec në 1889. Studimet e mesme dhe të larta i kreu në Greqi, Rumani dhe Austri. Është poet i shquar dhe përkthyes i madh. Librat e tij me vjersha janë: "Vallja e Yjeve" dhe "Ylli i Zemrës". Ka përkthyer poezi të poetëve të mirënjohur: J.V. Gëtes, H. Hajnes, R. Berns, A. Pushkinit etj. Poeti shumë i dashur shqiptar vdiq në 1987.



FJALË DHE SHPREHJE

- cipëz-a* këtu: shami koke
hoje-a qëndisje anës një rrobe
takije-a kësulë me majë
sylynjar-i gyp prej druri nëpër të cilin rrjedh uji, lëfyti i kroit

Përshkrimi

"Kroi i fshatit tonë" është një poezi ose vjershë e shkruar nga poeti Lasgush Poradeci, në strofa dyshe.

DREMIT LIQERI

“Dremit LIQERI” është një vjershë e shkruar nga poeti Lasgush Poradeci në librin: “Vallja e yjeve”.

Mi zall të pyllit vjeshtarak,
Dremit liqeri pa kufi,
Ai ndaj fundesh u përflak
Posi me zjarr e me flori.

Posi me flakë - u ndez e kjoj,
E vetëtiti plot magji,
E yll' i ditës perëndoj
Në qetësi dhe dashuri.

Tashti po shuhet nënë mal
Qytet' i ngrysur në të zi.
Po ndizen yjtë dal - nga - dal
Plot bukuri! Plot fshehtësi!

Në këtë çast perëndimor,
Ndaj po më dehen sytë - e mi,
Kuptoj si shpirtin vjershëtor
Ma frymëzon një mall i ri.

Lasgush Poradeci



FJALË DHE SHPREHJE

Zall gurë të vegjël që sjell lumi me vete

Vetëtiti shkëlqeu

Yll' i ditës Dielli

Shuhet këtu, fshihet pas malit

Çast perëndimor kohë perëndimi



1. Regjistroni në fletore disa të dhëna nga: Fan Stilian Noli, Gjergj Fishta, Migjeni dhe Lasgush Poradeci (vendlindja, jetëgjatësia, numri i vëllimeve krijuese, veprat etj.).
2. Formoni me kompjuter një tabelë duke përdorur programin Excel, ku të regjistroni të dhënat që mblodhët. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.





KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË



1. Cilës pjesë të një dite i kushtohet kjo vjershë:

mëngjesit _____,

mesditës _____,

pasditës _____,

Përse, çfarë ka ndjerë poeti?

Me cilat fjalë do ta ilustronit ju mendimin tuaj?



2. Çfarë do të thotë poeti me fjalën u përflak?

3. Çfarë përshkruan poeti në këtë vjershë? Ilustroni zgjedhjet tuaja me vargje nga vjersha.

4. Çfarë gjendjeje shpirtërore ju krijohet kur lexoni përshkrimin e poetit me vargje në këtë vjershë?



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Vini re se me sa kujdes i zgjedh fjalët poeti:

Në këtë çast perëndimor,

Ndaj po më dehen sytë - e mi,

Kuptoj si shpirtin vjershëtor

Ma frymëzon një mall i ri.

Shpjegojini këto vargje siapas përftytyrimit që ju krijojnë.

2. Rimat krijojnë një melodi mjaft të bukur kur lexojmë vjershën.

Qytet' i ngrysur në të zi.

Po ndizen yjtë dal - nga - dal

Plot bukuri! Plot fshehtësi!

Po vajzat dhe trimat e fshatit çfarë simbolizojnë?

3. A përputhet kjo melodi me gjendjen shpirtërore që të krijon vjersha? A e ke ndjerë veten ndonjëherë kështu, i mahnitur para detit, liqenit apo një mali të lartë?



DETYRË

Bëni një krijim të shkurtër në fletoren tuaj, për natyrën atje ku ju jetoni, sepse vendi ynë është shumë i bukur, në çdo stinë.

FUQIA E MUJIT

Teksti "Fuqia e Mujit" është marrë nga përmbledhja "Tregime të moçme shqiptare" të Mitrush Kutelit. Kjo përmbledhje përmban legjenda të moçme shqiptare në të cilat tregohen trimëritë e pashoqe të dy vëllezërve, Mujit dhe Halilit, si edhe të shokëve të tyre kreshnikë. Sipas shpjegimit popullor, fuqia e këtyre kreshnikëve kishte prejardhje të mbinatyrshme.



Mitrush Kuteli

Na ishte qëmoti andej, larg, në Jutbinën kreshnike një malësore që kishte dy djem: Mujin dhe Halilin. Muji s'e kishte moshën sa e kishte shtatin. Ishte i mençur, i matur dhe i duruar. Ashtu ishte edhe Halili. Mirëpo i ati, malësori, ishte njeri i varfër, prandaj, sapo hodhi shtat i madhi, Muji, dhe u bë për punë, ai e pajtoi rrogëtar te një zotëri. Ky zotëri e bëri Mujin bari lopësh dhe e dërgoi në bjeshkë t'i kulloste.

Sot mirë, nesër mirë, një ditë, s'di sesi, i humbi lopët nëpër bjeshkë. I kërkoi pas tragës, s'la lug e shteg pa shkelur, gjer në të mugëtit e nuk i gjeti dot. Atë natë Muji nuk u kthye në shtëpi. Qysh të kthehej vetë, pa lopët?! I zoti do të bënte gjëmë të madhe, barinjte e tjerë, shokët, do ta qeshnin.

Si u lodh së kërkuari shteg më shteg e lug më lug, kur perëndoi dielli, Muji u ul i lodhur e i pikëlluar buzë një shkëmbi. Aty e zuri e zeza natë. Tha të marrë një sy gjumë, të presë gjersa të agojë dita e pastaj të dalë rishtas bjeshkëve për të kërkuar lopët. Mirëpo te shkëmbi, ku kish ndenjtur të prehej, na qenkëshin dy djepe me dy foshnja të njoma. Muji iu afrua t'i shikojë. I pa se ishin shumë të mitura dhe iu dhimbën. I përkundi ngadalë, i vuri në gjumë.

Pas mesnate, papritur, u dukën te shkëmbi dy drita shumë të bardha. Jo, s'ishin drita, po dy zana të veshura me dritë.

Ato e panë Mujin tek po përkundte lehtë djepet e foshnjave. U çuditën e i thanë:

- Cili je ti e ç'kërkon në këtë vend? A mos ke humbur gjësendi?

- Unë jam bari lopësh, rrogëtar, - u tha Muji. - gjithë ditën bredh bjeshkëve pas kullotave. Sot më ndodhi një e keqe e madhe: humba lopët e tim zoti e dola t'i kërkoj. Nata më zuri bash në këtë vend e u ula të prehem, të fle. S'munda të mbyll sy, se qanin këto dy foshnjat. M'u dhimbën e u përkunda djepet. Mezi i vura në gjumë.

MITRUSH KUTELI (1907-1967), emri i vërtetë i të cilit Dhimitër Pasko, lindi në Pogradec. Mësimet fillore i mori në vendlindje, të mesmet në Selanik dhe të lartat në Bukuresht.

Më 1947 u arrestua për pikëpamjet e tij demokratike. U lirua nga burgu në vitin 1949. Pas kësaj kohe e deri në fund të jetës punoi si përkthyes. Vdiq në Tiranë më 1967. Ka botuar shumë vepra, ndër të cilat: "Net shqiptare", "Ago Jakupi", "Mall e brengë", "Tregime të moçme shqiptare".

Po ju ç'jeni? Ç'e keni këtë dritë të bardhë që ju ka veshur fytyrën e shtatin?

Ato e njohën Mujin, se e kishin parë nga larg bjeshkëve, krojeve e mrizeve tek mërzenite lopët. I thanë:

- Ne jemi zanat, Muj. Dolëm, si çdo natë, lart e poshtë nëpër botë që të ndihmojmë njerëzit e mirë e të drejtë. I lamë foshnjat vetëm. Ti paske qene njeri i mirë, i paske përkundur e i paske vënë në gjumë. Rrofsh e qofsh! Na thuaj tani, o Muj, ç'kërkon të të japim për të mirën që na bëre? A do forcë, Muj? A do mall e gjë? A do dije? A do gjuhë? Kërko ç'të duash e ne do të ta japim.

Ja se ç'u thotë Muji zanave:

- Mua, moj zana të bardha, më kanë halë në sy barinjte e tjerë, më ngacmojnë, më bien në qafë. A e keni në dorë të më bëni të fortë që t'i mund të gjithë?

- Vetëm kaq do, Muj?

- Kaq.

I thotë zana zanës:

- Motër, a i japim Mujit qumësht gjiri, që ta bëjmë të fortë?

- I japim, motër.

Zanat i japin Mujit qumësht gjiri, dhe e ngijnë me tri pika. Muji e ndien veten menjëherë shumë të fortë, sa mund të shkulë nga rrënja një lis bjeshke. Zanat i thonë:

- Pa të shohim, Muj, sa i fortë je. Kape atë





shkëmb që duket aty pranë dhe ngrije lart.

Zanat i tregojnë Mujit një shkëmb që peshon sa tri pendë qe bashkë. Muji ulet, e kap shkëmbin, e shkul nga vendi, e peshon në duar, e ngre te nyja e këmbës. Më lart nuk e ngre dot. E lëshon poshtë.

Prapë i thotë zana zanës:

- Duhet t'i japim edhe pak qumësht Mujit, që të bëhet më i fortë.

Muji pi rishtas qumësht zane, e kap shkëmbin, e peshon në duar, e ngre në gju. Më lart nuk e ngre dot. E lëshon poshtë e ulet të prehet.

- T'i japim edhe pak gji Mujit, - thonë zanat. I japin edhe njëherë gji. Mujit i rritet fuqia. Merr shkëmbin e peshon mirë e mirë në duar, e ngre gjer në brez. Më lart nuk e ngre dot. Zanat e shohin e i thonë shoqja shoqes:

- Prapë duhet t'i japim gji.

Muji pi edhe njëherë qumësht zane e bëhet i fortë si dragua. E ngre shkëmbin dhe e vë në cep të supit, e mban lart e qëndron në shtyllë, s'tundet fare. I pyet zanat:

- Më thoni moj zana të bardha, ku ta flak këtë shkëmb? A ta flak në fushë të Jutbinës?

Zanat e shikojnë buzagaz e i thonë shoqja shoqes:

- Të mos i japim më gji Mujit, se po t'i japim, ky e shemb botën anembanë.

Pastaj zanat nisin e pyesin Mujin hollë e hollë për nënë e babë, për vëllanë, për gjithë Jutbinën. Ndërkaq hëna e bardhë rri lart mbi kryet e tyre e i këqyr tek kuvendojnë. Hija e shkëmbit nis e zgjatet prapa mbi gremina. Në bjeshkë fryn fladi i freskët i natës. Shushurijnë gjethet e aheve, gurgullojnë krojet e ftohta.

Si e pyesin mirë e mirë, ja se i thonë zanat Mujit:

- O Muj, ne duam të të bëjmë vëllam. Ti ç'thua?

- Vëllam më doni, vëllam më paçi, o zana të bardha, - u thotë Muji. - kur të jem ngushtë, do t'ju thërras të më jepni dorën.

- Mirë o vëllam, sa herë të jesh ngushtë, të na thërrasësh e ne do të vijmë të të japim dorën.

Kur nis të zbardhë agu i dritës mbi kreshtat e bjeshkëve zanat marrin djepat e zhduken. Muji fërkon sytë, mundohet të shohë se ku shkuan, por nuk sheh veçse një tragë drite që lenë prapa zanat. Ngrihet shpejt, lan sytë në krua, shkon lugjeve, gjen lopët, i vë përpara e niset për në

shtëpi. Kur zbret në fushë të Jutbinës, sheh se aty ka rënë dielli e ka ndritur botën. Në fushë janë mbledhur gjithë shokët e tij, barinjtë, që e kanë zakon të lodrojnë e të munden shoq me shoq. Ata i thërrasin:

- Eja, Muj, të luftojmë.

Ja ç'bën Muji: sapo nis lodrimi, kap bariun më të fortë e peshon në duar, e hedh dhe e pret disa herë, pastaj e vërvit pesë konopë përpjetë.

Barinjtë e tjerë e shikojnë të trembur. "Ç'qenka bërë kështu Muji ynë?" dhe prapsen, largohen.

- A ka ndonjë tjetër që do të mundet me mua? - pyet Muji. Po ata ua kanë mbathur me të katra e s'kthejnë kokën të shikojnë.

Muji qesh e shkon t'i shpjerë lopët të zot.

Që aty kthehet në shtëpi të shohë nënën, babanë e vëllanë.

Që atë ditë Muji nis e punon, punon e lufton, shkon për gjah bjeshkëve dhe del gjithnjë faqebardhë.





FJALË DHE SHPREHJE

- i mitur* i vogël
Zanë-a figurë mitologjike me aftësi të jashtëakonshme
prehem pushoj, çlodhem
mriz-i vend ku kalon vapën bagëtia
mërzej kaloj vapën në hije (për bagëtinë)
ngij ngop
dragua-oi në përralla njeri shumë i fuqishëm që lufton kundër kuçedrës
vëllam-i vëllezër gjaku, që kanë pirë gjak nga një-tjetri
tragë-a gjurmë
konop-i litar; këtu: masë gjatë sie prej pesë metrash



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

72

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Ku zhvillohen ngjarjet?
2. Në cilë kohë zhvillohen?
3. Kush ishte Muji?
4. Çfarë i ndodhi Mujit?
5. Si veproi Muji, kur i humbën lopët?
6. Çfarë ndodhi pastaj?
7. Çfarë bën zanat për të ndihmuar Mujin?
8. Çfarë bëri Muji kur zbardhi dita e re?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Deri në çfarë mase janë të vërteta ngjarjet e këtij teksti?
2. Ku dallon teksti që lexuat nga një përrallë?
3. Cili është morali i këtij teksti?
4. Çfarë është ky tekst?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Cilët janë personazhet kryesore në këtë tekst?
2. Ku dallohet Muji nga qeniet e tjera njerëzore?
3. Si i përfytyroni ju zanat?
4. Po Muji çfarë cilësish ka?
5. Përse zanat e bënë Mujin vëllam?

Hiperbola

Në tekstin "Fuqia e Mujit", ndër të tjera lexojmë:
Zanat i japim Mujit qumësht gjiri... Muji e ndien veten shumë të fortë, sa mund të shkulë nga rrënja një lis bjeshke... Sapo nis lodrimi, kap bariun më të fortë e peshon në duar, e hedh dhe e pret disa herë, pastaj e vërvit pesë konopë përpjetë.
Poeti popullor, me qëllim e zmadhon atë, i jep përmasa shumë më të mëdha se është në të vërtetë, përdor, pra, hiperbolën. Hiperbola është figurë artistike, përmes së cilës autori, duke dashur të vërë në dukje një tipar, një veçori veprimi a dukurie, e zmadhon, e jep me përmasa shumë më të mëdha sesa realiteti. Në të vërtetë është konteksti që na ndihmon për të dalluar atë. Legjendat popullore shqiptare janë plot me hiperbola, të cilat i hijeshojnë ato.



KËNGA E DHOQINËS

Për shqiptarin besa është e shenjtë. Ideja themelore e tekstit "Kënga e Dhoqinës" është se shqiptari për të mbajtur fjalën e dhënë ngrihet edhe nga varri.

Ditën e Pashkës në drekë,
seç u therr një ka në fshat.
Vajta e mora një okë mish
dhe e hodha në kusi;
me vrap dola në avlli
të marr një kërcu të zi.
Të më shpiket një stih;
me vrap m'u hodh në kusi,
më helmoi djemt e mi;
nëntë djem e nëntë nuse,
të nënta me djem në duar!
Nëntë djepe ç'm'i përmbyse,
nëntë pajë ç'm'i zhurite
nëntë dyfekë ç'm'i shite!
Kostandin, të ardhte gjëma,
martove Dhoqinën larg,
larg e larg mërguar
tre male kaptuar!

Ditën e Pashkës së madhe
Dhoqina na hidhej valle.
Kostandini u ngrit nga varri;
rrasa iu bë kalë,
balta iu bë shalë!

Vrap e vrap e te Dhoqina.
- Mirë se erdhe, im vëlla!
Në ke ardhë për të mirë,
të vishem si gjeraqinë,
në ke ardhë për të keq,
të vishem si kallogre.
- Jo, motër, sikundër je!

E hipi në vithe të kalit.
Zogjtë udhës thoshin:
"cili-viu,-uiu-viu,
kush ia bën, ia bën veriu!
Kini parë e s'kini parë?
Shkon një zogëz bishtbardhë,
i vdekuri me të gjallë!"

Venë gjer te dera e kishës.
- Ikë, moi Dhoqinë,
se kam punë n'ajodhimë,
se aty kam shtëpinë.

Shkon Dhoqina gjer te dera.
Çëk, çëk në portë.
- Ç'je ti që kërcet në portë?
Mos je bushtër a murtajë?
A mos je zonja murtajë,
që më hëngre djemt' e mi?

- Hap, moj nënë, derënë,
jam Dhoqin' e vetëmë!
- Me cin erdhe, moj Dhoqinë?
- Unë arçë me Kostandinë.
- Ç'Kostandinë, moj t' ardhte gjëma?
Kostandini i vdekur,
ç'bën tre vjet pa tretur?

Një në prak e një në derë,
plasën si qelqe me verë.

Populli



Legjenda ose gojëdhëna

Në tekstin "Kënga e Dhoqinës" tregohen ngjarje historike që mund të kenë ndodhur dikur, po që janë shtuar e zbukuruar nga fantazia e popullit. Teksti "Kënga e Dhoqinës" është një legjendë ose gojëdhënë.

Në dallim nga përrallat ku tregohen ngjarje jo të vërteta, krejt të trilluara ose të imagjinuara, në legjenda ose gojëdhëna tregohen ngjarje që mund të kenë ndodhur, po që janë shtuar e zbukuruar. Legjendat ose gojëdhënat mund të jenë edhe në prozë edhe në poezi.



- 1. Krijoni skica të thjeshta në fletoren e vizatimit mbi legjendën që lexuat.**
- 2. Vizatoni me kompjuter krijimet tuaja duke përdorur programin Paint.**
- 3. Me ndihmën e mësuesit/es, printoni një poster artistik të krijimit digjital që krijuat.**



FJALË DHE SHPREHJE

<i>Pashkë-a</i>	Krishtlindjet	<i>gjëmë-a</i>	fatkeqësi
<i>okë-a</i>	masë peshe rreth 1,50 kg	<i>kaptoj</i>	kapërcej
<i>avlli-a</i>	oborr	<i>rrasë-a</i>	këtu: guri i varrit
<i>shpiket</i>	del papritur, shfaqet	<i>gjeraqinë-a</i>	hpend grabitqar, si skifter
<i>stihë-a</i>	në krijimtarinë popullore një si gjarpër që helmon ushqimet e njerëzve	<i>kallogre-ia</i>	murgeshë, këtu: grua e mjerë
<i>zhurit</i>	përvëloj	<i>ajodhimë-a</i>	pjesë e kishës
<i>dyfek-u</i>	pushkë	<i>bushtë-a</i>	femra e qenit; këtu grua e keqe
		<i>murtajë-a</i>	sëmundje ngjitëse



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Kur zhvillohen ngjarjet?
2. Ku zhvillohen?
3. Kush flet në këtë tekst?
4. Çfarë bëri nëna e Dhoqinës ditën e Pashkës?
5. Çfarë fatkeqësie i ndodhi nënës së Dhoqinës ditën e Pashkës?
6. Po vajza e saj, Dhoqina, ku ndodhej ditën e Pashkës kur ndodhi fatkeqësia?
7. Përse e mallkon nëna Konstandinin?
8. Çfarë bëri Konstandini?
9. Përse nuk besoi nëna që ishte Dhoqina?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Cilët janë personazhet kryesor në këtë tekst?
2. Lexoni këto vargje dhe bëni komentet tuaja.
*Kostandin, të ardhhtë gjëma,
martove Dhoqinën larg,
larg e larg mërguar
tre male kaptuar!*
3. Si i kuptoni ju fjalët e nënës së Dhoqinës?
- *Me cin erdhe, moj Dhoqinë?*
- *Unë arçë me Kostandinë.*
- *ÇKostandinë, moj t' ardhhtë gjëma?*
*Kostandini i vdekur,
ç'bën tre vjet pa tretur?*

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. A mund të kenë ndodhur ngjarjet e paraqitura në këtë tekst?
2. Në qoftë se po, deri në çfarë mase mund të jenë të vërteta?
3. Cili është morali i këtij teksti, çfarë mësoni?
4. Çfarë është ky tekst?



NË QYTETIN E LILIPUTËVE

Kjo pjesë është marrë nga libri "Udhëtimet e Guliverit" të shkrimtarit anglez Xh. Suift. Në kapitullin e parë të librit flitet për udhëtimin e personazhit kryesor, Guliverit të cilit i mbytet anija dhe ai gjendet në një ishull ku jetonin liliputët, njerëz me trup shumë të vogël. Në këtë libër gërshetohen bukur ngjarjet reale me ato fantastike.



Xhonatan Suift

Nuk e di se ç'u bënë shokët e mi të barkës, ata që iu qepën shkëmbit, dhe ata që mbetën në anije; po besoj se u mbytën të gjithë: sa për mua, notova më tym dhe për fat më shtyu era nga ana e tokës. U shtriva në një lëndinë, ku bari ishte fare i njomë dhe i butë, si mëndafshi; dhe pas një çike më mbërtheu një gjumë i rëndë, që s'e kam bërë kurrë në jetë; dhe fjeta pothuaj nëntë orë, sa kur u zgjova, dielli ishte ngritur lart. Bëra të ngrihem, po nuk u ngrita dot; i shtrirë siç isha në kurriz, ndjeva se këmbët e krahët i kisha të lidhur nga të dy anët përtokë; po kështu ishin lidhur edhe flokët, që i kam pasur të gjatë e të trashë. Madje pashë plot fije shumë të holla rreth trupit, nga squetullat e gjer te kofshët.

Papritmas ndjeva se më lëvriu diçka te këmba e majtë, nga ku më kaloi ngadalas në kraharor e po më ngjitej pak nga pak në mjekër. Pashë një njeri të gjallë, që nuk e kishte shtatin as gjashtë gishtërinj të gjatë që mbante në duar një hark e një shtizë. Po në këtë kohë pashë se e ndiqnin pas edhe të paktën nja dyzet të tjerë. I habitur siç mbeta, lëshova ca britma aq të forta, sa të gjitha ato krijesa të vockla u larguan të llahtaritura.

Kur pushuan britmat, dëgjova njërin prej tyre që thirri: - *Tolgo Fonak*, dhe në çast ndjeva se ma shpuan dorën e majtë më se njëqind shigjeta të vockla e të holla si gjilpëra. Pastaj lëshuan në erë një breshër tjetër shtizash që më binin në trup, sido që nuk i shikoja, dhe plot të tjera më nguleshin në fytyrë, që përpiqesha t'i largoja me dorën e djathtë.

Kur e panë ata kocomicë se po rrija urtë, i prenë të shtënat, po nga zhurma e poterja, që sa vinte e shtohet, kuptova se edhe ata po roitnin si bleta. Përballë veshit të djathtë, për më tepër se një orë, dëgjova zhurma njerëzish që punonin. Kur ktheva kokën nga ajo anë, aq sa më lejonin kunjat e kordonat, pashë se kishin ngritur një tribunë ndonjë këmbë e gjysmë të lartë - që mund të nxinte nja katër nga këta xhuxhmaxhuxhër - dhe nja dy a tri palë shkallë për t'u ngjitur. Së andejmi njëri prej tyre, që dukej njeri me rëndësi, më mbajti një ligjëratë të pasosur, që nuk e kuptova fare.

Iu përgjigja me pak fjalë, po me një theks të përlurur, duke ngritur dorën e majtë dhe sytë ndaj diellit, sikur t'i qaja hallin se po vdisja urie, meqë s'kisha vënë gjë në gojë prej shumë orësh, para se të mbytej anija.

Ai zbriti nga tribuna, urdhëroi të vendosnin plot shkallë në të dy brinjët e mia, nëpër të cilat u ngjitën ndo njëqind veta, që pastaj m'u drejtuan nga goja, të ngarkuar me kofina plot me mish, që ishin grumbulluar e dërguar atje me urdhër të mbretit, me t'u marrë vesh se kisha arritur unë. Vura re se kishte çdo lloj mishi, nga kafshë të ndryshme, po nuk i dallova dot se ç'ishin kur i shijova. Kishte kofshë, shpatulla, brinjë që dukeshin si prej dashi, të gatuar mirë, po më të vockla se krahët e një lareshe. Gllabëroja njëherësh nja dy a tri të atilla bashkë me tri bukë të mëdha, sa plumbat e pushkës. Tek m'i binin gjitha këto të ngrëna, ata dukeshin shumë të habitur e të mahnitur, që shikonin trupin tim sa një mal dhe atë urinë time të pasosur.

Bëra një shenjë tjetër për t'u treguar se kisha etje; duke parë se s'kisha të ngopur në të ngrënë, ata menduan se edhe etja ime nuk mund të shuhej lehtë dhe gjetën një marifet të bukur: ngritën me mjeshtëri një nga vozet më të mëdha që kishin sjellë me verë, e rrukullisën gjer te dora ime, pastaj e ngritën më këmbë dhe i hapën grykën. E rrëkëlleva njëherësh pa mundim, se nuk kishte më tepër se një gjysmë litër; i përngjante disi verës së Burgonjës, por ishte edhe më e shijshme. Më sollën një fuçi tjetër, e piva dhe ua bëra me shenjë të më binin ca të tjera, po i kishin mbaruar. Si panë që bëra gjithë këto mrekullira, zunë të thërrisnin nga gëzimi dhe të hidhnin valle mbi kraharorin tim.

Pas një copë here, kur panë se isha ngopur, para meje doli një nga të parët e vendit, që e kishte dërguar Madhëria e tij, mbreti. Ai e mori vesh që i lutesha të më zgjidhnin; më dha të

kuptoja se do të më shpinin ashtu siç isha, po duke m'u zotuar me ca shenja të tjera se do të më jepnin të haja e të pija sa të më shihnin sytë, dhe se do të më mbanin shumë mirë.

Paspakkohe dëgjova një breshërduartrokitjesh, që ndërpritej dendur nga brohorimat.

Ai popull e ndan qimen më katërsh në matematikë e në mekanikë, shkenca që mbreti i tyre i nxit e i përkrah. Perandori ka ca makina të mrekullueshme për mbartje, që mund të ngrenë anije lufte (nganjëherë nëntë këmbë të gjata) dhe t'i shpien nga pyjet ku janë ndërtuar, gjer në bregdet. Pesëqind inxhinierë e zdrukthëtarë u ngarkuan të stisnin një prej këtyre makinave, që të më mbartte mua. Ishte një qerre shtat këmbë e gjatë e katër e gjerë, që mbahej mbi njëzet e dy rrota, e ngritur një gjysmë këmbë nga dheu. Një mijë e pesëqind nga kuajt më të mirë të

perandorit më tërhoqën gjer në kryeqytet, sipas nesh, nja gjysmë milje më tutje.

Ecëm pareshtur tërë ditën e ditës dhe natën e gdhiva në fushë, me pesëqind roje përçark, gjysma me pishtarë dhe gjysma me harqe dhe shigjeta, gati të më gjuanin po të merrja arratinë. Ndaj të gdhirë vazhduam udhën dhe aty nga dreka arritëm afër kryeqytetit. Gjithë oborrtarët, me perandorin në ballë, kishin dalë të më shikonin, po oficerët madhorë nuk e lanë Madhërinë e tij ta vinte kokën në trastë, duke hipur mbi trupin tim.

Nuk e them dot me fjalë habinë e poteren e popullit, kur më panë që u ngrita e po barisja. Meqe vargonjtë e këmbës së djathtë ishin afro gjashtë këmbë të gjatë, jo vetëm mund të veja e të vija në një hapësirë gjysmë rrethi, po kisha mundësi të hyja barkas gjer te dera e madhe dhe të shtrihesha në faltore.



FJALË DHE SHPREHJE

- liliput - i* njeri me trup të vogël, gishto
- iu qepën shkëmbit* u ngjitën sipër shkëmbit
- pas një çike* pas pak
- poter/e - ja* zhurmë e madhe, shamatë, e shkaktuar nga zënka e dy ose më shumë njerëzve
- po roitnin* këtu: po shtoheshin
- kocomi - u* personazh përralle, një fëmijë i zgjuar, por me trup të vogël
- tribun/ë - a* vend i ngritur e i zbukuruar para një sheshi, ku rrinë udhëheqësit
- mbajti ligjëratë* mbajti fjalim
- kofin/ë - a* kosh i madh i thurur me purteka, që përdoret për të mbajtur fiq, rrush etj.
- gjetën një marifet të bukur* gjetën një mënyrë të përshtatshme
- m'u zotuan* më premtuan, më dhanë fjalën
- ai e ndan qimen më katërsh* ai është shumë i zgjuar dhe i zoti
- mbart* shpie diçka nga një vend në tjetrin duke e mbajtur vetë ose duke e vënë në ndonjë automjet
- bares* eci, lëviz nga një vend në një tjetër
- faltor/e - ja* vendi ku falen besimtarët
- këmb/ë - a* masë gjatësie, një këmbë është e barabartë me 32 cm.





KUPTOJMË TEKSTIN



1. Çfarë kishte ndodhur me varkën dhe me shokët e Guliverit?
2. Çfarë ndjeu dhe çfarë pa Guliveri kur u zgjua nga gjumi?
3. Si arritën ta ushqenin dhe ta transportonin atë liliputët?



VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN

1. Përse liliputët e ndaluan luftën kundër Guliverit:

u frikësuan prej tij **apo** e kuptuan se ai s'donte t'u bënte keq?

2. Çfarë cilësish të liliputëve dalin në dukje në këtë pjesë, shënoni me + ose - .

- | | | |
|---------------------------------------|-------------------------------------|--------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> të egër, | <input type="checkbox"/> mikpritës, | <input type="checkbox"/> të dashur, |
| <input type="checkbox"/> mendjelehtë, | <input type="checkbox"/> të zgjuar, | <input type="checkbox"/> kureshtarë, |

3. Shkrimtari përdor imagjinatën e tij për të përshkruar vendin e liliputëve dhe aventurën e Guliverit. Cilat janë ato gjëra që ndodhin vërtet në jetë dhe cilat janë të fantazisë së autorit.

(Nënvizoni në tekst me një vijë të parat dhe me dy vija të dytat, ose përdorni dy lapsa me ngjyra të ndryshme).

pamja e liliputëve

mënyra si e ushqyen dhe e transportuan Guliverin

sjellja e liliputëve

mënyra e organizimit të shtetit të tyre

Ilustrojeni mendimin tuaj me shembuj nga teksti.

77



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Për ta bërë sa më interesant dhe tërheqës përshkrimin e tij, shkrimtari i zbulon një nga një çuditë që i ngjasin Guliverit. Përmbli dhini ato në pesë fjali.

Për shembull: 1. Kur hapi sytë Guliveri, pa se ishte i mbërthyer për tokë.

2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

2. Mësoni këto shprehjet, pasi të keni shpjeguar kuptimin e tyre:

a) notova në tym - notova pa e ditur se ku veja (kot së koti).

b) qesha në tym -

c) eca në tym -

Gjeni dhe shkruani edhe shprehje të tjera nga teksti:

3. Gjeni epitetet:

bari ishte _____

gjumë _____

Si i kuptoni ato?

4. Çfarë përfytyrimi ju ngjall krahasimi:

liliputët po roitnin si bleta _____

Numri i tyre sa vinte e _____

Zhurma e tyre ishte si e _____

Interesimi i tyre ishte i _____

ROBINSONI NË ISHULL DHE "PESHORJA" E TIJ...



Kjo pjesë është marrë nga libri "Robinson Kruzo" i shkrimtarit anglez D. Defo. Autori tregon për një njeri (Robinsonin) që iu mbyti anija dhe deti e nxori në një ishull të shkretë. Në këtë ishull ai jetoi i vetëm shumë vjet dhe arriti ta përballonte jetën në sajë të vullnetit dhe mençurisë së tij. Kjo pjesë është shkëputur nga ditari i personazhit kryesor, Robinsonit.

... "Këtu më nxori deti më 30 të Vjeshtës së parë..."

Në fillim u mërzita tepër, se do ta humbisja dhe kuptimim e kohës... Për këtë, në anë të një druri fillova të shënoj përditë nga një vijë; vijën e shtatë e bëja kurdoherë dy herë më të gjatë. Me këtë sistem pata kalendarin tim të ndarë në javë, muaj e vite.

Midis gjithë atyre sendeve që mora nga anija, shtiva në dorë edhe gjëra pa ndonjë vlerë të madhe, po që më hynin shumë në punë. Këto harrova t'i përmendja më parë si, fjala vjen, pena, bojë, letër etj., që i kisha gjetur në kabinat e kapitenit të parë, të kapitenit të dytë, të topçiu dhe të marangozit; nja tri a katër busulla, që i mora si i gjeta, pa ditur nëse do të më hynin në punë apo jo.

Nuk duhet të harroj se në anije kishim një qen dhe dy mace, që kanë një histori të çuditshme, të cilën do ta tregoj. Të dyja macet i mora me vete, kurse qeni u hodh nga anija në det dhe me not arriti në ranishte, posa solla ngarkesën e parë. Për shumë vjet me radhë ai qe shërbëtori im besnik, s'linte pa më sjellë asgjë nga ç'kishte mundësi të më sillte.

Thashë se kisha gjetur bojë, pena dhe letra; i përdora me kursimin më të madh dhe do t'jua provoj se mbajta shënim tërë punët e mia, po, kur m'u mbarua boja, s'munda më të shkruaja dhe, sido që bëra çmos, nuk munda të sajaja bojë tjetër. Meqë më mungonin veglat e duhura, punët shkonin shumë ngadalë dhe kështu m'u desh një vit që ta plotësoja krejt rrethimin e banesës time. Hunjtë, me të cilët e rrethova, qenë aq të rëndë, sa mezi i ngrija dhe m'u desh një kohë e gjatë për t'i prerë e për t'i shpënë gjer në banesën time. Nganjëherë më duheshin dy ditë vetëm për të prerë dhe për të shpënë gjer në vend një nga këta hunj të trashë dhe një ditë e tërë për ta ngulur në dhe.

Për këtë punë përdorja një dru të trashë; më vonë përdora një qysqi hekuri, po dhe kjo nuk ma pakësoi mundimin tim të madh.

DANIEL DEFO (1660-1731), Londër. Daniel Defo filloi të shkruante novela kur mbushi gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nxori nga dora gjëra të mrekullueshme të cilat u bënë të njohura në gjithë botën. Ishte shkrimtar, gazetar, i cili njihet me veprën e tij të famshme: Robinson Kruzo. Ai mësoi në një shkollë fetare dhe më pas filloi tregëtinë. Duke shitur e blerë mallra të ndryshme, bëri shumë udhëtime nëpër Evropë. Ai punoi shumë me gazetën e tij, ku botoi më shumë se 500 shkrime me emrin e vet, më shumë se çdo shkrimtar tjetër në gjuhën angleze.

Duke e menduar mirë hallin ku ndodhesha, doemos nuk mund të mos isha i pikëlluar. Tërë vrerin tim e shfrevë në letër. Por, sado të pikëlluara të ishin këto mendime, arsyeja ime filloi, pak nga pak, ta mposhte dëshpërimin. Me sa mundesha, përpiqesha ta ngushëlloja veten, duke menduar se mund ta kisha pësuar dhe më keq, dhe krahasoja të keqen me të mirën me një paanësi të plotë.

Këto shënime tregojnë qartë se zor të ketë rënë ndokush në një gjendje më të mjerë. Megjithatë, kjo kishte në vetvete si anën pozitive, ashtu edhe anën negative, për të cilën duhej të isha mirënjohës. Përvoja e hidhur e një njeriu që ka provuar fatkeqësinë më të madhe në botë, tregon se ne mund të gjejmë kurdoherë një ngushëllim, një shpresë për të ardhmen. Kështu, shpirti zuri shpejt të më ngjallej dhe s'më lëshoi zemra. Për ta forcuar edhe më tepër veten, vura në kandar të mirat dhe të këqijat dhe arrita në përfundimin se kishte të tjerë që e kishin pësuar më keq, dhe unë mund të kisha mbaruar edhe më keq.

Pra, hoqa dorë nga zakoni që t'ia ngulja sytë detit dhe të rroja me shpresën se mund të dukej ndonjë anije në horizont. Iu përvësua me mish e me shpirt punës, për ta bërë më të rehatshëm banimin tim në atë ishull.



- **Shkruani një tekst të shkurtër duke përdorur të dhëna zyrtare e shkencore mbi tema si: "Shpikjet e pesë viteve të fundit", "Udhëtimet më të pamundura", "Inteligjenca Artificiale dhe infrastruktura" etj.**





TË KËQIJAT:	TË MIRAT:
<p>Më hodhi fati në një ishull të zymtë e të pabanuar dhe nuk kam asnjë shpresë shpëtimi.</p> <p>Jam i vetmuar dhe i shkëputur nga tërë bota dhe jam i dënuar të vuaj në mjerim.</p> <p>Jam i mërguar nga tërë njerëzit, jam i vetmuar, i dënuar nga shoqëria e njerëzve.</p> <p>Kam fare pak rroba të vishem dhe së shpejti nuk do të kem me se të mbuloj trupin.</p> <p>Jam i pambrojtur nga sulmet e njerëzve ose të bishave.</p>	<p>Por jam gjallë, nuk u mbyta, siç u mbytën të gjithë shokët e mi të udhës.</p> <p>Por, shpëtova nga vdekja dhe ai që më shpëtoi për mrekulli jetën, mund të më shpëtojë edhe nga gjendja ime e mjerë.</p> <p>Por nuk vdiqa urie në këtë vend të shkretë, ku njeriu nuk ka me se të ushqehet.</p> <p>Por, po jetoj në një klimë më të nxehtë ku njeriu mund të rrijë edhe zhveshur.</p> <p>Por, ishulli ku rashë është i pabanuar dhe nuk kam parë asnjë shtazë grabitqare, siç pashë në brigjet e Afrikës.</p> <p>Çdo të kisha bërë sikur të kisha dalë në bregdetin e Afrikës?...</p>



FJALË DHE SHPREHJE

- bëj çmos* bëj çdo gjë të mundshme, nuk lë gjë pa bërë për të arritur diçka
- sajoj* bëj nga e para diçka shpejt e shpejt me gjëra të rastit, rregulloj diçka
- qysqi - a* shufër e trashë hekuri, me majë nga njëra anë
- kurnac - i* dorështrënguar; koprac; (e kundërta e tij është njeriu zemërbardhë, zemërmirë)
- vrer - i* hidhërim i madh, helm
- shfrej* nxjerr jashtë me vrull atë që ndiej në shpirt, nxjerr inatin kundër dikujt
- breng/ë - a* vuajtje shpirtërore, hidhërim
- brengos* shkaktoj brengë, hidhërim
- i, e zymtë* i errët e pa dritë, i ngrysur këtu, ishull i shkretë, pa njeri
- i, e mërguar* i larguar nga vendlinda
- shtaz/ë - a* kafshë e egër
- bilanc - i* përfundim (ose pasqyrë) që del nga krahasimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve.



KUPTOJMË TEKSTIN _____

1. Përmbliidhni në disa fjali veprimet kryesore që bëri Robinsoni pasi shpëtoi. (me laps)

2. Ritregoni me zë pjesën sipas pikave të planit, në fletoren tuaj.



VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN

1. Si e kuptoni shprehjen që përdor autori:

"Arsyeja ime filloi, pak nga pak ta mposhte dëshpërimin...?"

Ç'tregon kjo për cilësitë e personazhit të Robinsonit:

është

kurajoz
me vullnet
frikacak
mendjepjellor
i zgjuar
praktik
i ngathët
i shkathët?



Nga kjo vepër e shquar e Daniel Defo-së, janë realizuar shumë filma artistikë.

Nga më të bukurit është ai ku rolin e Robinsonit e luan aktori i famshëm irlandez Pirs Brosnan (Pierce Brosnan).

2. Duke u nisur nga shembulli i Robinsonit, tregoni një ngjarje nga jeta juaj, kur jeni ndodhur në një çast të vështirë. Pastaj plotësoni me shkrim në fletoren tuaj tabelën e mëposhtme:

Të këqijat Të mirat

3. Si mendoni ju a duhet ta lëshojë njeriu veten para një fatkeqësie? Përse jo?

80



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Vini re me kujdes mënyrën si i ka ndërtuar

autori fjalitë ku shpreh:

Të këqijat **dhe** të mirat **që i kanë ndodhur**.

Fjalitë e të këqijave nuk pranojnë asnjë mundësi kundërshtimi.

Jam i vetmuar.

Nuk kam asnjë shpresë.

Plotëso me laps: _____

2. Fjalitë e të mirave, të gjitha fillojnë me por, dhe gjithashtu përdoret dhe folja mund. Përse?

Por jam gjallë

Plotëso me laps: _____

3. Shpjegoni me fjalë të tjera këto shprehje:

s'më lëshoi zema _____

vura në kandar të mirat dhe të këqijat _____

iu përvështa me mish e me shpirt punës _____

4. Mësoni këto shprehje, ku kryesore është fjala zemër:

më gëzon zemra,

më qan zemra,

ma do zemra.

Shpjegoni si i kuptoni këto shprehje? Përdorini ato në të folurin tuaj.



NË BALONË

Kjo pjesë është shkëputur nga libri "Pesë javë në balonë", i shkrimtarit të madh francez Zhyl Vern. Në atë kohë nuk ishte shpikur as aeroplani, as nëndetësja, as radioja as televizori. Megjithatë, Zhyl Verni flet për këto shpikje. Shkrimtari tregon aventurat e doktor Fergusonit dhe të shokëve të tij në Afrikë.



Zhyl Vern

ZHYL VERN (1828-1905) është shkrimtar i njohur francez. Ka shkruar 57 romane, kryesisht romane fantastiko-shkencore me aventura. Librat më të njohur të tij janë: "Pesë javë në balonë", "Nga toka në hënë", "Kapiteni pesëmbëdhjetëvjeçar", "Rreth botës për 80 ditë", "Njëzet mijë milja nën det", "Bijtë e kapitenit Grand" etj. Disa nga romanet e tij janë botuar edhe në shqip.

Balona ikte me të shpejtë. Dallohej në perëndim toka e ulët në disa bregore në fund ishin pllajat më të larta të Ugandës dhe të Usogës. Era po frynte sa vinte e më shumë, me një shpejtësi prej afro 30 miljesh në orë.

Ujërat e Nianzës, të fryra me rrëmbim, po shkumëzonin si valët e detit. Nga disa dallgë të mëdha, që lëkundeshin edhe një copë herë të mirë pasi pushoi rrebeshi, doktori e kuptoi se liqeni duhej të ishte shumë i thellë. Gjatë kohës që ata e përshkuan me shpejtësi liqenin, u dukën në të vetëm nja dy barka druri, të gdhendura dosido.

- Ky liqen, - tha doktori, - me vendin e lartë që zë, është pa dyshim rezervuari i natyrshëm i lumenjve të pjesës lindore të Afrikës; me anën e shiut, qielli i kthen atij atë që i merr në formë avujsh. Me siguri që këtu do ta ketë Nili burimin vet.

- Do ta shohim, - iu përgjigj Kenedi.

Andej nga ora nëntë, bregu perëndimor u afrua; ai dukej i shkretë dhe i pyllëzuar. Era filloi të frynte pak nga lindja dhe ata mundën ta shihnin disi bregun tjetër të liqenit. Ai harkohej, gjersa përfundonte në një kënd shumë të hapur. Male të larta ngrinin kreshtat e thepisura në atë skaj të Nianzës. Po midis tyre, nëpër një grykë të thellë, kalonte një lumë i rrëmbyer, ujërat e të cilit dukeshin sikur vlonin.

Duke manovruar me balonën e vet, doktor Fergusonit e vërente vendin me sy të pangopur.

-Shikoni, - thirri ai, - shikoni, miqtë e mi! Tregimet e arabëve ishin të sakta. Ato bënin fjalë për një lumë, me anën e të cilit liqeni Ukereue derdhej në veri, dhe ky lumë ja ku është, tani ne po zbresim poshtë atij, ai po rrjedh me një shpejtësi që mund të krahasohet me tonën. Dhe ky ujë që po rrjedh nën këmbët tona, shkon e bashkohet, me siguri, me valët e Mesdheut. Ky është Nili!

-Ky është Nili! - përsëriti Kenedi që po rrëmbehej nga entuziazmi i Samuel Fergusonit.

- Rroftë Nili! - tha Xhoe, që thërriste me gjithë zemër "Rroftë" për diçka kur ishte i gëzuar.

Shkëmbinj shumë të mëdhenj e pengonin aty-këtu rrjedhën e atij lumi të mistershëm. Uji shkumëzonte; formoheshin vendetërrëmbyeshme dhe ujëvara që vërtetonin parashikimin e doktorit. Nga malet përfaqë vërshonin shumë

përrenj, të cilët zbardhnin nga shkuma kur zbritnin poshtë; të zinte syri me qindra të tillë. Shikoja të dilnin nga toka rrëke të holla uji, të përhapura andej këndeje, që kryqëzoheshin, bashkoheshin, shpejtonin secila më shumë dhe që të gjitha rendnin për tek ai përroi që lindte dhe që bëhej lumë pasi i përpinte të gjitha.

- Ky është Nili, - përsëriste doktori me bindje. - Origjina e emrit të tij i ka tërhequr shkencëtarët, ashtu si dhe zanafilla e ujërave të tij. Thonë se ky emër vjen nga greqishtja, nga gjuha e vjetër afrikane kopte, nga gjuha e Indisë së vjetër, sanskritishtja; po kjo s'ka rëndësi, meqë ai u detyrua ta zbulonte, më në fund, të fshehtën e burimeve të veta!

- Po, - tha gjahtari, - si mund të sigurohet njeriu se ky lumë dhe ai që kanë njohur udhëtarët e veriut është i njëjti?

- Do të kemi prova të sigurta, të pakundërshtueshme, - u përgjigj Fergusonit,

- në qoftë se era na ndihmon edhe një orë.

Malet po rralloheshin dhe po u bënin vend fshatrave të shumta, arave me susam, me kallam sheqeri etj.

- A do të ulemi këtu? - pyeti Xhoe.

- Ende jo. Madje, do të ngrihemi më lart për të kapur pamjen e përpiktë të vendit.

Hidrogjeni u bymye në më pak se dhjetë minuta. "Fitorja" qëndronte pezull në një lartësi prej dy mijë e pesëqind këmbësh mbi tokë.

Prej andej shquhej një rrjet i pështjelluar përrrenjsh, që derdheshin në shtratin e lumit. Shumica vinin nga perëndimi, duke kaluar midis kodrave të panumërta, në mes të fushave pjellore.

- Nuk jemi më larg se nëntëdhjetë milje nga Gontokoro, - tha doktori, duke parë hartën, - dhe në më pak se pesë milje nga pika ku kanë mbërritur zbuluesit e ardhur nga veriu. Le t'i afrohem tokës me kujdes.

"Fitorja" u ul më shumë se dy mijë këmbë.

- Tani, miqtë e mi, bëhuni gati për çdo të papritur.

- Gati jemi, - u përgjigjën Diku dhe Xhoe.

- Mirë!

Sakaq "Fitorja" është duke ndjekur shtratin e lumit dhe jo më lart se njëqind këmbë. Në këtë vend Nili është një njëqind metra i gjerë, me fshatra nga të dyja brigjet. Më tutje ai formon një ujëvarë të pingultë, një dhjetë këmbë të lartë, pra të pakapërcyeshme.

- Ja, kjo është ujëvara e treguar nga Debono, - thirri doktori. Pellgu i lumit zgjerohej dhe ishte me ishuj, të cilët Samuel Ferguson i vështronte sikur po i përpinte me sy; dukej se po kërkonte një pikë drejtimi, të cilën s'po e dallonte dot.

Pas pak, doktor Ferguson mori dylbinë dhe e drejtoi nga një ishull që shtrihej në mes të lumit.

- Katër pemë! - thirri ai. - Shikoni atje tej.

Me të vërtetë, katër drurë të veçuar dukeshin në fund të ishullit.

- Ky është ishulli Benga! Pikërisht ai është, - shtoi doktori.

- E pastaj? - pyeti Diku.

- Atje do të zbresim!

Dielli ishte në kupë të qiellit. "Fitorja" iu afrua ishullit. Spiranca, që u lëshua, u kap në një të çarë shkëmbi. Xhoeja rrëshqiti poshtë litarit.

- Shkallën! - thirri doktori. - Eja pas meje, Dik,

- Ç'kërkon të bësh?

- Eja të zbresim, kam nevojë për një dëshmi.

- Pas më ke.

- Xhoe, qëndro roje dhe hapi sytë mirë.

- Mos kini merak, përgjigjem unë për gjithçka.

- Eja Dik! - tha doktori duke shkelur në tokë.

E tërhoqi shokun e vet drejt një grumbulli shkëmbinjsh që ngriheshin në një skaj të ishullit. Atje ai kërkoi një copë herë, u fut nëpër driza e ferra dhe gjakosi duart. Befas ai e kapi gjahtarin për krahu.

- Shiko, - i tha.

- Shkronja! - thirri Kenedi.

Me të vërtetë, dy shkronja të gdhendura mbi shkëmb dalloheshin fare qartë:

A. D.

- A. D. - vijoi doktor Ferguson, - Andrea Debono! Vetë nënshkrimi i udhëtarit që është ngjitur më lart se kushdo tjetër në rrjedhën e Nilit!

- Ja një provë e gjallë, Samuel miku.

- A u binde tani?

- Ky është Nili. S'ka më asnjë dyshim.

Doktori i vështrroi edhe një herë ato shkronja të çmuara, të cilave u mori edhe formën, edhe madhësinë.

- Dhe tani, - tha ai, - në balonë! Mjaft që era të na shtyjë për disa orë drejt veriut dhe do të arrijmë në Gondokoro.

Pas dhjetë minutash "Fitorja" u ngjit lart me madhështi, ndërsa doktor Ferguson, në shenjë suksesi, valëviste një flamur.





FJALË DHE SHPREHJE

- Uganda dhe Usoga* vende në Afrikë
milje-a masë gjatësie, baras me 1,5 kilometër
rrebesh-i shi i fortë me rrëmbim
manovroj veproj me shkathtësi
entuziazëm –i gëzim i madh
i mistershëm i fshehtë e i pakuptueshëm
susam-i bimë barishtore
këmbë-a këtu: masë gjatësie prej 30-40 cm



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Ku zhvillohen ngjarjet?
2. Si e kuptoi doktori se liqeni ishte i thellë?
3. Përse shërbente liqeni?
4. Si e kuptoi doktori se lumi që po shihnin ishte Nili?
5. Po gjahtari çfarë tha?
6. Si e vërtetoi doktori se lumi që kishin parë ishte Nili?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Përse flet Zhyl Verni në këtë tekst?
2. Çfarë dini për ekspeditat shkencore për zbulimin e vendeve të panjohura?
3. Çfarë janë balonat dhe a ekzistonin ato në kohën kur shkruan Zhyl Verni?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. A janë të vërteta ngjarjet e këtij teksti?
2. Si mund ta vërtetoni që ngjarjet janë të krijuara dhe fantastike?
3. Çfarë është teksti i mësipërm?

Tregimi Fantastiko-Shkencor

Teksti “Në balonë” tregon një ekspeditë shkencore me balonë në një kohë kur ajo nuk ishte shpikur ende. Pra, autori parashikon me fantazinë e tij krijimin e mjeteve fluturuese.

“Në balonë” është një tregim fantastik-shkencor. Këto tregime paraqesin, ndër të tjera, vështirësitë e përparimit në fushën e shkencës dhe të zbulimeve gjeografike. Po, megjithatë, janë vepra optimiste. Zhyl Verni është themelues i kësaj gjinie letrare e cila trajton, kryesisht, tema që kanë të bëjnë me të ardhmen e njerëzimit.



- **Kërkoni në internet podcast-e apo video mbi udhëtimet e sportistëve shqiptarë në ekosisteme ekstreme. Shkruani një përmbledhje të shkurtër (10-15 fjali) me faktet që mësuat. Mos harroni që të citoni burimet e informacionit.**

KUSHTRIMI I TË PARËVE

Kjo pjesë është marrë nga romani "Kushtrimi i të parëve" e shkrimtarit të njohur amerikan, Xhek London. Thornton i bashku me disa shokë po kërkon ar në vendet e largëta të Alaskës, vende të panjohura e plot rreziqe. Qeni i tij quhet Bak. Ai e ka shpëtuar Bakun nga duart e njerëzve të ligj, prandaj Baku është gati të bëjë gjithçka për zotin e tij, Xhon Thornton.



Xhek London

Gjatë po atij dimri, Baku fitoi emër me një bëmë të re, e cila, sido nuk qe edhe aq heroike, i solli famë e lavdi të madhe. Emri i tij zulmëmadh tani zuri të përhapej anekënd Alaskës,

Asaj vepre i dha shkas një bisedë e filluar në tavernën "Eldorado", ku burrat rrinin e mburrnin qentë e tyre. Fama e Bakut kishte marrë dhenë, prandaj burrat përpiqeshin t'i gjenin të meta, ndërsa Thornton i bëhej copë që ta mbronte.

Fjalë pas fjale, pa shkuar as gjysmë ore, një burrë u ngrit e tha se qeni i tij qenkej aq i fortë sa të nisej, madje të rendte me një slitë të ngarkuar me pesëqind paunde; një i dytë doli e u mburr se qeni i hiqte dhe gjashtëqind paunde; një i tretë, që të mos mbetej pas shokëve shpalli se eskimezi i tij paskësh tërhequr jo më pak se shtatëqind paunde.

- Se mos është ndonjë punë e madhe! - ia bëri Thornton. - Baku im niset edhe me një mijë paunde!

- Dhe është i zoti t'i shkëpusë rrëshqitëset nga akulli dhe të ecë me atë barrë njëqind jarde? - pyeti Methjasoni, një nga pasanikët e Bonazës, ai burracaku i të shtatëqind paundeve.

- Po, - ia preu Xhon Thornton gjakftohtë.

- Mirë, - ia bëri Methjasoni, me një zë të qartë e të vendosur, që dëgjonin të gjithë sa ishin në atë tavernë. - Vë bast një mijë dollarë se qeni nuk ia del mbanë asaj pune. Ja ku janë!

Me këto fjalë ai erdhi e përplasi mbi banak një gese me pluhur ari të madhe sa një suxhuk.

Askush nuk piptiu. Të gjithë mendonin që fjalët e Thorntonit ishin vetëm një mburrje e kotë. Thornton i ndiente gjakun që i ziente e i hipte në kokë dhe hante me dhëmbë gjuhën që e kish futur në atë sherr. A mund t'i tërhiqte, vallë, Baku një mijë paunde?

- A m'i huan një mijë dollarë? - pyeti si me një pëshpëritje të njohur Brajenin.

- Ta pret mendja, - iu përgjigj Brajeni

XHEK LONDON (1876-1916) është shkrimtar i njohur amerikan. Ka shkruar më shumë se njëqind libra. Disa nga librat e tij si, *Dhëmbi i bardhë, Kushtrimi i të parëve, Tregimet e veriut, janë përkthyer edhe në shqip. Librat e tij, sidomos ata me kafshë, lexohen me kënaqësi nga fëmijë e të rritur në të gjithë botën.*

Dhjetëra njerëz, të mbështjellë me gëzofë të rëndë, me dorashka trasha meshini dolën në rrugë e qëndruan për qark slitës, po në një farë largësie. Slita e Methjasonit me një ngarkesë një mijë paunde (gati gjysmë tonelate!) rrinte prej dy orësh në ngricën e forte (termometri shënonte gjashtëdhjetë gradë nën zero!). Rrëshqitëset i kishte zenë e i kishte mbërthyer bora e ngjeshur dhe e ngrirë. Njerëzia vinin bast dy me një se Baku nuk do të ishte i zoti ta lëvizte sliten nga akulli.

Të dhjetë qentë e Methjasonit i zhmbrëjtën dhe vendin e tyre e zuri Baku me takëmet e veta. Ngashërimi që kish pushtuar të gjithë erdhi e kapi edhe Bakun. Qenit sikur i ra në erë se duhej të bënte një punë të madhe për Xhon Thorntonin.

U dëgjua një mërmërimë zërash që shprehnin admirim e habi për atë kafshë madhështore. Baku kish arritur në lulen e jetës; nga të njëqind e pesëdhjetë paundet e peshës së tij nuk kish asnjë gram dhjami të tepërt, po vetëm forcë e fuqi muskujsh ...

- E paç me shëndet, zotni, e paç me shëndet! - rrinte e llomotiste njëri nga pasanikët. - Ju jap në dorë që tani tetëqind dollarë për këtë qen, zotni. Dhe jam gati ta marr kështu, siç është.

Thorntoni ra në gjunjë për bri Bakut. Shtrengoi kokën e qenit me të dy duart dhe ngjeshi faqen në turirin e tij. Sot Thornton nuk e shkundte Bakun si me shaka dhe nuk i mërmëriste ato të shara e mallkime që shprehnin dashurinë e tij, po i pëshpëriste në vesh:





- Po më deshe të mirën, Baku... Po më deshe të mirën... - rrinte e përsëriste si me një fill zëri. Dhe Baku i përgjigjej me një angullimë që shprehte një padurim mezi të përmbajtur.

Njerëzia rreth e qark qëndronin e vështronin plot kureshtje. Puna sa vinte e bëhej misterioze; fjalët e Thorntonit tingëllonin si një përgjërë. Si u ngrit Thorntonin në këmbë, Baku ia kapi me dhëmbë dorën me dorashkë, ia mbajti një hop të shtrënguar në gojë, dhe pastaj ia lëshoi ngadalë, si me pahir. Kjo ishte përgjigja e heshtur e qenit, i cili rrekej të shprehte sipas mënyrës së tij dashurinë që ndiente.

Thorntoni u largua nga slita.

- Gati, Bak! - urdhëroi ai.

Baku hoqi rripat, pastaj i lëroi prapë. Qeni vepronte siç e kishin mësuar.

- Hy! - bërtiti Thorntonin. Zëri i tij erdhi e kumboi me një jeh të qartë e të prerë në heshtjen e rëndë.

Baku u lëkund më të djathtë, u kukëzua, sikur të zhytej në ujë, nderi rripat dhe, befas, me një hov të papritur, u hodh dhe qëndroi. Ngarkesa u drodh e u tund, ndërsa nën rrëshqitëset diç kërciti dhe u thye.

- Hy! - thërriti prapë Thorntonin.

Baku përsëriti të njëjtën lëvizje. Kërcitja erdhi e u bë një krismë e fortë, ndërsa slita dyndej e rrëshqitëset shkisinin ca gishtërinj anas.

Slita u shqit nga akulli që e mbante të ngulur në borë. Njerëzit rrinin e vështronin. Ata sikur kishin harruar të merrnin edhe frymë.

- Tani, marsh!

Urdhri i Thorntonit buçiti si një e shtënë pushke. Baku u turr përpara dhe i tendosi fort rripat. I gjithë trupi i tij u mblodh e u përmbodh për një përpjekje të tmerrshme, ndërsa muskujt rrëqetheshin e lëviznin nën qimet e dendura, sikur të ishin qenie të gjalla. Kraharori i gjerë mend cikete tokën, qafa e koka zgjateshin e shtriheshin, ndërsa këmbët çapitnin duke gërryer me putra dy lugje paralele.

Slita tundej e lëkundej dhe gati-gati po nisej. Një këmbë e qenit shkau dhe një burri i shpëtoi një psherëtimë e thellë. Po slita, me të dridhura, të tundura e të lëkundura, zuri të rrëshqiste përpara...

Rrëshqiti një gjysmë gishti ... një gisht ... dy gishta ... Pastaj slita mori hov, rripat u shtrinë, dhe Baku eci përpara.

Njerëzia shfrynin e gulçonin, të mbytur nga një ngashërim që nuk thuhet me gojë. Thorntonin rendte pas slitës dhe i jepte zemër Bakut me ca britma të gëzuara e të mprehta. Largësia ishte matur që më parë. Kur Baku zuri t'i afrohej turrës së drunjve që shënonin fundin e të njëqind lardëve, filluan të dëgjoheshin britma hareje që sa vinin e bëheshin përherë e më të forta. Ato shpërthyen dhe u shkrinë në një ulërimë të përgjithshme, kur Baku kaloi turrën e drunjve dhe qëndroi me urdhrin e Thorntonit. Të gjithë sa ishin, hidheshin e bënë si të marrë nga entuziazmi. Edhe Methjusoni e kishte humbur fare.

Thorntoni ra në gjunjë përpara Bakut. Balli i tij u poq me turirin e qenit, ndërsa duart e ashpra tundnin e shkundnin trupin e tij të rëndë. Ata, që ia behën të parët, dëgjuan Thorntonin që shante e mallkonte Bakun. Ai e nëmte ngadalë e me afsh, ëmbël e me dashuri.

- Na mahniti fare, zotni, - llomotiti një pasanik. - A ma shet për njëmijë dollarë rrumbullak, zotëri? Apo për një mijë e dyqind, zotëri? Thorntonin brofi në këmbë. Sytë i shndritnin dhe i shkëlqenin, dhe as që përpiqej të fshinte lotët që i rridhnin faqeve. - Jo, zotëri, - ia ktheu ai, - kurrën e kurrës, zotëri. Dhe në djall të vini, zotëri! Kaq kisha për t'u thënë.

Baku kapi me dhëmbë dorën e Thorntonit. Thorntonin e tundte poshtë e lart.


Dhe, sikur ishin shtyrë nga një ndjenjë e vetme, burrat u hoqën mënjanë. Nuk doli njeri aq i pagdhundur sa të prishte bisedën e filluar ndërmjet Thorntonit e Bakut.





FJALË DHE SHPREHJE

- bëmë-a** punë, vepër, veprim
zulumëmadh i famshëm
slitë-a mjet udhëtimit në borë, që tërhiqet nga kafshët
paund-i njësi mase gati gjysmë kilogrami.
jard-i njësi mase gati një metër
misterioz-e që ka diçka të fshehtë
rrekej përpiquej
kukëzohem përkulem



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Për çfarë bisedonin njerëzit në tavernën "Eldorado"?
2. Po Thorntonit çfarë tha?
3. Po Methjusoni si reagoi për fjalët që dëgjoji?
4. Përse "...Thorntoni ra në gjunjë përbri Bakut. Shtrëngoi kokën e qenit me të dy duart dhe ngjeshi faqen në turirin e tij...?"
5. Rilexoni skenën kur Baku filloi të tërhiqte slitën. Përpiquej ta riprodhoni atë.
6. Përse: "...filluan të dëgjoreshin britma hareje që sa vinin e bëheshin përherë e më të forta...?"

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Ku zhvillohen ngjarjet?
2. Kur zhvillohen, ngase karakterizohen ajo kohë?
3. Kush është personazhi kryesor?
4. Po personazhet tjera, si mund t'i përshkruash?
5. Çfarë lidhjesh kanë personazhet me njëri-tjetrin?
6. Jepni mendimin tuaj për Bakun dhe zotin Thornton.

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Përse Baku ishte bërë i njohur në tërë Alaskën?
2. Cila ishte gjendja shpirtërore e Thorntonit para se Baku të tërhiqte slitën?
3. Përse Baku arriti ta kalojë me sukses këtë provë të vështirë?

Teksti

Teksti, "Thorntoni dhe qeni i tij besnik", paraqet ngjarje të vërteta reale. Personazhet janë reale, ngjarjet renditen në mënyrë logjike. Teksti është tregim realist.




TOMI DHE HAKU MARRIN NJË FTESË

Kjo pjesë është marrë nga romani "Tom Sojeri dedektiv" që përfshihet në serinë e librave që kanë në qendër personazhin e Tom Sojerit, me të cilin ju jeni njohur.

Që të gjitha këto kanë ndodhur në pranverën e parë, pasi unë dhe Tom Sojeri e liruam zezakun Xhim nga ferma Arkansau e xhaxhait Silas, ku ndodhej i lidhur me zinxhirë si një skllav që dikur ishte arratisur. Ngrica kishte filluar të zbutej dhe çdo ditë që kalonte, të afronte me pranverën. Po fillonte koha kur ngriheshin balonat. Pastaj hyje menjëherë në verë dhe mund të shkoje të laheshe. Po trishtohesh kur vështron kalendarin dhe kupton se sa larg ndodhet vera! Fillon të psherëtish, të ngrysesh. As ti nuk e kupton përse je i shqetësuar. Duke vrarë mendjen, ashtu, në vetmi, kërkon një vend lart në kodër, anash pyllit, ulesh atje dhe vështron poshtë madhështorin Misisip. E hedh shikimin deri tutje - tëhu, përtej, ku horizonti duket i mbuluar nga mjegulla dhe tymi. Dhe çdo gjë është e heshtur dhe solemne, sikur të gjithë të dashurit kanë vdekur. Dhe për një çast të duket sikur do dhe ti të vdesësh, që të marrin fund të gjitha.

A e dini se ç'i thonë kësaj? Janë ethet e pranverës. Kështu quhen. Dhe kur të zënë, dëshiron - në të vërtetë as vetë nuk e kupton se çfarë dëshiron - por të dhemb zemra, kaq fort dëshiron. Ndien sidomos, një mall për të bredhur, se duhet t'u largohesh vendeve të vjetra që të lodhin duke i parë, dhe do të shikosh vise të reja. Këtë dëshirë ke: të ikësh dhe të bredhësh, të arrish larg, ndër vise të huaja, ku çdo gjë është misterioze, e mrekullueshme dhe romantike. Dhe në se nuk ke mundësi t'i realizosh tërë këto, kënaqesh edhe më me pak, ikën ku të jetë e mundur, vetëm të largohesh, madje të shtresh se ke patur fat.

Eh, mirë, pra, unë dhe Tom Sojeri ishim sëmure nga ethet e pranverës, dhe ishim sëmure tepër rëndë. Por nuk kishte asnjë kuptim që Tomi të përpiquej të largohej, sepse teza Poli - thoshte ai - nuk do ta lejonte të braktiste shkollën dhe të bridhte ku t'i tekej. Ja, pra, përse të dy rrinim



Mark Tuen

hundë e buzë. Një ditë, ndaj të ngrysur, tek ishim ulur në shkallët përpara shtëpisë, teze Poli doli me një letër në dorë dhe i tha:

- Tom, duhet t'i rregullosh plaçkat dhe të ikësh në Arkansau, sepse halla jote, Selli, ka nevojë për ty.

Sa nuk më ra të fikët nga gëzimi. Kujtoja se Tomi do të ikte me të katra te halla e tij dhe do ta puthte, por ai mbeti shtang në vend, si një shkëmb, pa nxjerrë asnjë fjalë. Më vinte të qaja kur e pashë që sillej në atë mënyrë, si një budalla, përpara një rasti të tillë. Rrezikoheshim ta humbisnim rastin, po të mos e falenderonte dhe t'i tregohej mirënjohës. Por ai rrinte aty, pa lëvizur nga vendi, kushedi se ç'po mendonte, ndërsa unë përpëlitesha dhe nuk dija se ç'të bëja. Hapi gojën papritur, shumë i qetë (isha gati ta pushkatoja për fjalët që shqiptoi):

- Më vjen shumë keq, teze Poli, por tani për tani nuk mundem. Të lutem të më falësh...

Teze Poli u habit pamasë dhe u nxeh me t'i dëgjuar këto fjalë të papjekura. Gjysmë minute nuk mundi të shqiptojë asgjë dhe mua më dha rastin t'i murmuris Tomit, duke i rënë me bërryl:

- Ke luajtur mendsh? Po shkelmon një fat të tillë...

Por ai m'u përgjigj, gjithashtu ngadalë dhe aspak i turbulluar:

- I dashur Hak Fin, dashke t'ia them troç se sa shumë dëshiroj që të shkoj? Do të bëhet menjëherë pishman, duke shpikur turli lloj sëmurdjesh, rreziqesh dhe pengesash dhe më në fund do t'i kthehet mendja krejtësisht. Lermë mua, se e di qysh duhet t'ia vërtis...

Këtë nuk e kisha menduar. Por Tom Sojeri kishte të drejtë. Kishte kurdoherë të drejtë - dhe ishte i gatshëm kurdoherë të të jepte një përgjigje, si i

thonë, "hazër - xhevap". Ndërkohë tezja e tij, Poli, siç duket e kishte marrë veten, sepse ia priti:

- Si the? Të të fal? Në jetën time nuk kam dëgjuar një gjë të tillë! Të më flasësh mua në këtë mënyrë? Leri fjalët dhe mblidhi plaçkat. Po të dëgjova edhe një herë se kërkon të falur për çka dashke dhe nuk dashke të bësh, do të të flak unë ty si një leckë...

Ndërkohë unë dhe Tomi ia kishim mbathur shkallëve. Kur arriti në dhomën e tij, Tomi më puthi i gëzuar. Ishte i lumtur që do të udhëtonim.



FJALË DHE SHPREHJE

pranvera e parë këtu: muaji i parë i stinës (mars)

hedh shikimin tutje - tëhu e hedh shikimin andej këtej, në të gjitha anët

solemn/e këtu: madhështore

misterioz/e përmban diçka shumë të fshehtë që mezi kuptohet

romantik/e që ka diçka ëndërrimtare, pak të fshehtë ose fantastike

eth/e - ja të dridhurat dhe të rrënqethurit e trupit (kur ka temperaturë të lartë).

Këtu: ethet e pranverës shkaktohen nga dëshirat e mëdha që ka trupi dhe shpirti i njeriut në stinën e rilulëzimit të jetës.

shtires bën ndryshe nga ç'ndien në të vërtetë

rrinin hundë e buzë rrinim të mërzitur

iki me të katra iki shumë shpejt

mbeti shtang mbeti pa folur dhe pa vepruar (sepse u habit shumë nga ajo që dëgjoji)

mirënjohës ia di vlerën të mirës që të bën dikush

pamasë shumë

fjalë të papjekura fjalë që thuhet pa u menduar mirë

murmuris në vesh pëshpëris në vesh, flas me zë të ulët

bëhet pishman pendohet për fjalët që ka thënë më parë (ose për veprimet që ka kryer më parë)

di ta vërtisë këtu: di si të sillet në çastin e duhur

përgjigjet "hazër xhevap" është i gatshëm në çdo çast të të japë përgjigjen që duhet.



KUPTOJMË TEKSTIN

1. Çfarë ndiejnë dy shokët në prag të ardhjes së pranverës?
2. Në ç'mënyrë iu erdhi atyre rasti që dëshironin?
3. Përse Tomi u tregua i përmbajtur para një ftese të tillë?



1. Kërko në internet me fjalët kyçe: "mark twain arthur". Për çfarë bëhet fjalë?
2. Shkruani një përmbledhje të shkurtër (10-15 fjali) me faktet që mësuat.





VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN



1. Si i kuptoni fjalët e autorit se Tomin dhe shokun e tij e kanë kapur ethet e pranverës? Shënoni + ose - për zgjidhjet e mëposhtme:

janë të sëmurë me temperaturë _____

janë të entuziazmuar _____

dëshirojnë të soditin natyrën _____

dëshirojnë të rrinë brenda në shtëpi _____

kanë mall për t'u larguar diku _____

janë të bezdisur _____

janë të trishtuar _____

2. Po ju çfarë ndieni kur shihni se dimri është duke ikur, se kanë filluar të çelin lulet, të vijnë zogjtë? Numëroni disa nga dëshirat që doni t'i realizoni. Plotësoni me laps.

3. A e qortoni Tomin se u soll keq me teze Polin, apo veprimi i tij ju bën të vini buzën në gaz? Përse?

4. Si do të silleshit ju po të ishit në vendin e Tomit, nëse do të merrnit një lajm të shumëpritur?

5. Çfarë pëlqeni më tepër te Tomi:

- Shpirtin e tij të lirë, ëndrrat e bukura, mençurinë për t'i bërë "hile" tezes?

- Për se ai ju tërheq si personazh?

89



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Lexoni me vëmendje këto shprehje:

a) Dhe për një çast të duket sikur dhe ti, do të vdesësh...

b) Sa nuk më ra të fikët nga gëzimi...

c) Isha gati ta pushkatoja për fjalët që shqiptoi...

Autori i përdor ato jo në kuptimin e tyre të vërtetë, por për të treguar në shkallën sipërore ndjenjat e personazheve të tij.

Shpjegoni si i kuptoni ato?

2. Me cilat fjalë të Tomit dhe Teze Polit, autori zbulon cilësi të tyre.

Gjejini dhe plotësoni disa nga cilësitë e Tomit dhe teze Polit.

3. Shpjegojini me fjalët tuaja këto

shprehje: bridhte ku t'i tekej, rrinin hundë e buzë



Aventurat e Tom Sojerit dhe Hekelberi Finit, të Mark Tuen janë bërë shumë herë film, janë nga filmat klasikë më të dashur edhe të gjeneratës suaj.

MIRËNJOHJA

Kjo pjesë është marrë nga libri i shkrimtarit italian Edmond de Amiçis "Zemra". Në këtë libër është treguar historia e një viti shkollor, e shkruar nga një nxënës i një shkolle bashkiake të Italisë. Libri ka formën e një ditari, ku autori ka derdhur të gjitha mbresat dhe ndjenjat e kohës së fëmijërisë.



Edmond De Amiçis

31, e shtunë

Jam i sigurt se shoku yt Stardi nuk qahet kurrë për mësuesin e tij. Kur the se mësuesi nuk ishte në terezi dhe se e kishte humbur durimin, këto fjalë i shqiptove si me maraz. Mendo pakëz se sa herë tregohesh i paduruar me babanë e me nënën tënde! Padurimi që tregon ti me ta është një faj i rëndë. Mësuesi ka të drejtë ngandonjëherë ta humbasë durimin. Mos harro se ai mundohet prej sa e sa vjetësh për fëmijët, e megjithëse shumë djem e kanë dashur e nderuar, ka patur shumë të tjerë që nuk ia kanë ditur për nder gjithë ato të mira që u ka bërë, që nuk ia njohin mundimin: se ju i shkaktoni më shumë hidhërimë se sa gëzime. Mendo se, po të ishte në vendin e tij edhe njeriu më i mirë i botës ngandonjëherë do ta humbiste durimin. Pastaj, sikur ta dije se sa herë mësuesi shkon në shkollë me ethe në trup, vetëm e vetëm se nuk është aq i sëmurë sa të marrë lejë. Dhe e humbet durimin se vuan; e kur sheh se nuk ia dini për nder, po e shkelnë të mirën me këmbë, i lëndohet shpirti. Nderojë dhe duaje mësuesin tënd, o bir. Duaje, se e do dhe e nderon edhe babai yt; se ai e shkrin jetën e tij për të mirën e fëmijëve, që do ta harrojnë; duaje se ai ta çel e ta ndriçon mendjen dhe të edukon shpirtin, se një ditë, kur të bëhesh burrë dhe kur nuk do të jemi gjallë as unë, as ai, do të të shfaqet fytyra e tij pranë simes; atëherë do të të kujtohet ajo fytyra e tij fisnike, ngandonjëherë e vrerosur dhe e lodhur që sot nuk të lë ndonjë mbresë, e që do të të mundojë edhe pas tridhjetë vjetësh; do të turpërohesh dhe do të të vijë keq që nuk e ke dashur e nuk je sjellë mirë me të. Duaje mësuesin tënd, se ai bën pjesë në atë familjen e madhe të mësuesve të fillloreve, që gjenden në atdheun tonë, të cilët janë si baballarët shpirtërorë të sa e sa miliona fëmijëve që po rriten bashkë me

ty, punëtorë, që nuk çmohen e nuk nderohen sa duhet, që po i përgatisin vendit tonë një popull më të mirë nga ai i sotmi. Nuk më pëlqen të më duash as mua, në qoftë se ti nuk e tregon atë dashuri dhe me gjithë ata që të bëjnë mirë, dhe i pari ndër ta, pas prindërve, është mësuesi. Duaje siç do të doje një vëllanë tim: duaje kur të përkëdhel e kur të qorton, kur është i drejtë dhe kur të duket i padrejtë, duaje kur është i gëzuar e i dashur, po ta duash edhe më fort kur ta shohësh të vrerosur. Duaje kurdoherë. Shqiptojë gjithnjë me respekt fjalën - mësues - se pas emrit të babait është fjala më bujare dhe më e ëmbël, që mund t'i thuash tjetrit.

BABAI YT



Im atë kishte patur të drejtë: mësuesi nuk ishte në qejf dhe e kishte humbur durimin, se nuk ishte mirë me shëndet; dhe vërtet, po bëhen tri ditë që në vendin e tij ka ardhur mësuesi i ri...

BIBLIOTEKA E STARDIT

Mbasdite shkova te Stardi, që e ka shtëpinë përballë shkollës. Të them të vërtetën, më erdhi zili nga biblioteka e tij. Nuk është i pasur e s'ka si blen shumë libra, por i ruan me shumë kujdes si ato të shkollës dhe ato që i falin prindërit. Të gjitha të hollat që i japin, ai i vë nënjanë dhe i harxhon në librari. Në këtë mënyrë ka krijuar një bibliotekë të vogël. Kur i ati e kuptoi se është i dalldisur pas librave, i bleu një raft të bukur prej arre, me një perde të gjelbër dhe ia ka lidhur pothuajse të gjitha librat, me ngjyra që i pëlqejnë atij. Kështu, tani ai tërheq një kordon, perdja e gjelbër shkon e vjen dhe shihen tri radhë librash me ngjyra të ndryshme të renditura bukur, të ndritura, me titujt e praruar në shpinën e tyre; libra

tregimesh, udhëtimesh e vjershash; disa prej tyre kanë edhe figura. Atij i vjen shumë për dore t'i kombinojë ngjyrat: librat e verdhë i vendos pranë të kuqëve, të

verdhët pranë të zinjve, të kaltërit me të bardhët, në mënyrë që të duken

bukur prej së largu; pastaj ai kënaqet shumë kur arrin t'i renditë edhe më bukur. Ka bërë edhe një katalog, është tamam si

një nëpunës biblioteke. E gjen kurdoherë pranë librave

duke i shpluhurosuar, duke i shfletuar dhe duke i

vërejtur se si janë lidhur. Ai i ruan si dritën e syve: i

hap me shumë kujdes me ato duart e tij të shkurtra

e të trasha duke u fryrë faqeve e ato duken ende të

gjitha si të reja. Po unë, që i kam prishur të gjitha

të miat!... Sa herë që blen ndonjë libër e lëmon me

gëzim, shkon dhe e vë në një vend, e merr prapë,

e vështron nga të gjitha anët dhe e ruan si ndonjë

thesar. Një orë të tërë që ndenjëm bashkë, nuk bëri

gjë tjetër veçse më tregoi librat. Atij i dhimbnin sytë

prej leximit. Pas pak kohe, hyri në dhomë i ati, një burrë

i trashë e i shkurtër. I ra nja dy a tri herë qafës me dorë, duke

më thënë:

- Ç'thua ti për këtë kokëshkëmb? Kjo kokë në të ardhmen do të bëhet me të vërtetë diçka.

Kur e përkëdhelte i ati, Stardi përpëliste sytë si ndonjë langua. Nuk di si të them, po e vërteta është se nuk ma kishte qejfi të bëja shaka me të. S'më mbushej mendja që ishte vetëm një vit më i madh se unë. Kur më tha te dera: - Mirupafshim! - me atë fytyrën e tij vazhdimisht të ngrysur, desh iu përgjigja:

- Të marr dorën! - si një burri të madh. Kur u ktheva në shtëpi, i thashë tim eti:

- Nuk e kuptoj, Stardi nuk para është i mprehtë, nuk ka sjellje të bukura, për së pari duket pothuajse qesharak, po megjithatë më bën që ta nderoj.

Babai im m'u përgjigj:

- E nderon, se është me karakter.

Dhe unë i thashë përsëri:

- Për një orë që ndenjëm bashkë, ai nuk foli as pesëdhjetë fjalë, nuk më tregoi asnjë lodër dhe nuk qeshi asnjëherë, po prapëseprapë u kënaqa me të.

Im atë m'u përgjigj: - Të pëlqen se e çmon.





FJALË DHE SHPREHJE

mirënjohj/e-a dashuria ose respekti që kemi për dikë, që na ka ndihmuar ose na ka bërë një të mirë.

nuk ishte në terezi nuk ishte në rregull, nuk ndihej mirë.

humb durimin nuk e përmbaj veten, nuk qëndroj dot i qetë (gjakftohtë, pa u nxehur).
Këtu: nuk u tregua i qetë, i përmbajtur (në sjelljen me fëmijët).

më erdhi zili Këtu: ndjeva dëshirën t'i kisha unë librat që kishte shoku

i lëndohet shpirti mërzitet shumë, fyhet

të shoh të vrerosur të shoh shumë të hidhëruar, të pikëlluar

vrer-i helmi

bujar/e fisnik, zemërgjerë

është i dalldisur për libra i do shumë librat

e praruar e larë në ar

i vjen për dore di të bëjë mirë diçka



KUPTOJMË TEKSTIN

92

1. Thoni me fjalët tuaja këshillat që babai i jep djalit në letrën e tij.

2. Si kujdeset Stardi për bibliotekën?

3. Shkruani nga dy fjali për çdo fragment, ku të përmbliidhni përmbajtjen e tyre. (me laps)

- a. _____
- b. _____
- c. _____



1. Cilat faqe interneti zyrtare do të përdornit për të ditur të gjitha përkthimet në gjuhën shqip të shkrimtarit "Edmond de Amiçis"?

2. Shkruani në shfletuesin e internetit adresën: www.bksh.al
Për çfarë bëhet fjalë?

3. Sa është numri i shtëpive botuese, që e kanë përkthyer autorin në shqip?



VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN

1. Shkruani se cilat janë disa arsye që e kanë detyruar babanë të këshillojë djalin:





2. Numëroni disa nga shkaqet që e bëjnë mësuesin të humbasë durimin dhe të mos silltet mirë me nxënësit. A duhet të mendoni keq për të? Përse? Plotësoni më poshtë:

Ai të lavdëron _____
Mësuesi të qorton _____

3. Si e kuptoni shprehjen e babait të Stardit:“

Kjo kokë në të ardhmen do të bëhet me të vërtetë diçka”.

4. Shënoni me laps, me + cilësitë që ka njeriu me karakter:

- i mençur
- mendjelehtë
- serioz
- me kulturë
- i paditur
- e mban fjalën
- llafazan
- shet mikun
- mirënjohës
- i duruar



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

93

1. Në ç'vetë janë shkruar këto dy fragmente. Ku ndryshojnë ato nga njëra-tjetra në mënyrën si i ka shkruar shkrimtari?

2. Si mund të thuhet ndryshe këto shprehje? Shkruajini me laps sipas modelit.

- iu lëndua shpirti _____ *u ndje i fyer*
- shkel të mirën me këmbë _____
- nuk ishte në qejf _____
- humbi dashurinë _____

** Nënvizoni shprehje të tjera dhe shpjegoni kuptimin e tyre.*

3. Duke u nisur nga shprehjet , që ka përdorur shkrimtari për ta përshkruar sa më bukur natyrën e Stardit, nxirrni disa nga cilësitë e tij:

- Shoku yt Stardi nuk qahet kurrë për mësuesin _____
- I ruan librat si dritën e syve _____
- I dhimbnin sytë prej leximit _____
- Ç'thua ti për këtë kokëshkëmb? _____
- Stardi nuk ka sjellje të bukura, por më bën ta nderoj _____



DETYRË

Lexojeni edhe njëherë fragmentin e dytë dhe përpiquni ta vizatoni bibliotekën, sipas përfytyrimit që ju ngjall përshkrimi i saj. (Mos harroni të përdorni disa ngjyra për librat e tij).

PRINCI DHE LULJA

Pjesa është zgjedhur nga libri "Princi i vogël" i shkrimtarit - aviator francez Antuan Ekzyperi, i cili vdiq i goditur nga aeroplanët gjuajtës fashistë, tek kryente detyrën ushtarake.

Në këtë libër gërshetohen natyrshëm elementë të përrallës me tregimin fantastik. Kjo e bën librin në pamje të parë të duket sikur është shkruar për fëmijët. Por, në të vërtetë, autori përpiqet të japë mendimet dhe ndjenjat e tij për botën feminare dhe botën e të rriturve.



Antuan De Sent Ekzyperi

...Ditën e pestë princi më pyeti papritmas:

- Qengji, gjersa ha shkurret, me siguri do të hajë edhe lulet?

- Qengji ha çdo gjë që i del përpara.

- Edhe lulet me gjemba?

- Po. Edhe ato.

- Po atëherë gjembat pse duhen?

Unë këtë nuk e dija. Isha tepër i zënë atë çast, se po mundohesha të zhvidhosja një bulon të avionit që ishte shtrënguar tepër. Isha helm e vrer, sepse dëmtimi që i kishte ndodhur motorit, po më dukej përherë e më i rëndë dhe uji i pijshëm, që po sosej, ma shtonte edhe më tepër shqetësimin e ma kallte edhe më thellë frikën për ato që më prisnin, ndoshta në një të ardhme të afërt.

- Hë, po gjembat pse duhen?

Princi i vogël, kur pyeste, s'të ndahej pa i dhënë një përgjigje. Ma kishte sjellë në majë të hundës buloni, ndaj dhe ia këputa kot:

- Gjembat s'hyjnë fare në punë, po lulet, na tregojnë haptas se sa të liga janë!

- Oh!

Dhe, pasi heshti një grimë, u hodh e tha qejfprishur:

- Nuk të zë besë! Lulet janë qenie të dobëta. Të padjallëzuara. Dhe si të tilla përpiqen ta sigurojnë veten ashtu si munden dhe si u duket më mirë. Dhe ja, me ato gjembat kushedi se si u duket vetja, pandehin se i kallin tmerrin tërë botës...

Nuk iu përgjigja, se në atë çast po thoja me vete: "Në qoftë se ky bulon nuk zhvidhohet do ta këput me çekiç dhe do ta hedh në hava!" Po princi i vogël s'më la prapë të qetë në hallet e mia.

- Dhe kështu pra, ti mendon se lulet...

- Jo, jo! Unë s'mendoj asgjë! - Ja këputa ashtu kot! - Se unë merrem me ca gjëra serioze, jo me ca gjepura!

Më vështroi i habitur.

- Me ca gjëra serioze?!

Unë qëndroja përballë tij me çekiç në dorë dhe me gishta të nxirë nga grasoja, kërrusur mbi një send që atij me siguri i dukej shumë i shëmtuar.

- Po flet njëllonj si të mëdhenjtë!


Më erdhi pak turp dhe u skuq; por ai vijoi më tej, pa mëshirë:

- Ti po i ngatërron të gjitha..., ti të gjitha po i bën lëmsh!

Ishte zemëruar vërtet. Dhe tundte e shkundte në ajër, në inat e sipër, ato krelat e tij të arta.

- Unë di një planet ku banon një zotëri si një

Kopertina origjinale e librit nga autori





spec i kuq. Ai tërë jetën e tij nuk i ka marrë erë kurrë një luleje. Dhe s'ka soditur kurrë një yll. Dhe s'ka dashur kurrë një njeri. Dhe s'është marrë kurrë me gjë tjetër në jetën e tij, veçse me mbledhje. Dhe tërë ditën e ditës ai një çikë e një çikë thotë kështu si ti: "Jam një njeri serioz unë! Një njeri serioz". Dhe fryhet sakaq me mburrje. Po ai s'është një njeri, është një kërpudhë.

- Një çfarë?

- Një kërpudhë!

Princi i vogël ishte zbehur tani nga inati.

- Ka disa milionë vjet që lulet prodhojnë ato gjembat e tyre, dhe ka disa milionë vjet që dhentë, megjithatë, i hanë lulet. Po atëherë, si, nuk qenka një punë serioze që të mundohesh të kuptosh si e përse lodhen ato kaq shumë për të nxjerrë ca gjemba që nuk u hyjnë kurrë në punë? Lufta e dhenve me lulet nuk qenka vallë një gjë me rëndësi? A nuk është kjo më serioze dhe më e rëndësishme sesa mbledhjet e njëfarë zotërie trashalug e kuqalosh? Dhe sikur unë të njoh një lule të vetme në llojin e saj në tërë botën, që nuk ekziston asgjekundi, veç në planetin tim, dhe të cilën një qengj mund ta përlejë ndonjë mëngjes,

sa hap e mbyll sytë pa e çarë fort kokën, as kjo s'na paska rëndësi?

U skuq, pastaj vijoi:

- Në qoftë se dikush do një lule që s'e ka shopen në asnjë nga milionë e milionë yjet që janë në qiell, kjo mjafton që ky dikushi, kur ta shohë atë, të jetë i lumtur. Dhe thotë ky njeri me veten e vet: "Lulja ime është atje diku..." Por në qoftë se qengji e ha lulen, atëherë për të është njëlloj sikur befas të gjitha yjet të jenë shuar! Dhe si, nuk na qenka me rëndësi kjo?

Nuk mundi të thoshte më tepër. Shpërtheu befas në të qara. Nata ndërkaq kishte rënë. I kisha vërvitur veglat mënjane. Aq më bënte tani për çekiçin, për bulonin, për etjen e për vdekjen. Në një yll, në një planet, në timin, në Tokë, kishte një princ të vogël, që duhej ngushëlluar! E mora në prehër dhe zura ta përkundja, ta nanuritja e t'i thosha: "Lules që do ti, nuk i kanoset ndonjë rrezik... Qengjit unë do t'i vizatoj një mëgojzë... Dhe lules një parzmore... Dhe..." Dhe s'dija më as vetë ç't'i thosha. Më dukej vetja shumë i pazotë e i ngathët. Nuk dija se çfarë duhej thënë e çfarë s'duhej thënë... Oh, mbretëria e lotëve është një mister i madh...



FJALË DHE SHPREHJE

isha helm e vrer isha shumë i pikëlluar, i mërzitur, i hidhëruar
po sosej po mbarohej

më kallte frikën më fuste frikën, më frikësonte

ma sollli në majë të hundës më nevríkosi, më bezdisi

ia këputa kot fola pa kuptim

qejfprishur që ndihet jo mirë prej sjelljes së dikujt

gjepur/ë - a gjëra pa rëndësi

aq më bënte nuk kishte më rëndësi për mua

mister - i diçka e panjohur, që nuk e shpjegon dot, shumë e fshehtë

i trishtuar kur ndien të vuash nga malli ose nga diçka tjetër që nuk e shpjegon dot



KUPTOJMË TEKSTIN

1. Çfarë i kishte bërë shumë përshtypje princit të vogël dhe çfarë kërkonte të dinte nga miku i tij i madh?
2. Për se princi i tregoi mikut historinë e zotërisë si spec i kuq?
3. Çfarë ishte për princin, gjëja më serioze në këtë jetë?



VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN

1. Imagjinoni dy skenat që përshkruan shkrimtari:

Miku i rritur rri mbi motorin e aeroplanit me duar tërë graso.

Princi qëndron para një luleje i shqetësuar.

Plotësoni më poshtë gjërat që shqetësonin:

Mikun e rritur

Princin e vogël

Cilat janë, sipas jush, gjërat që lidhen me botën shpirtërore dhe cilat me jetën e përditshme?

2. Kujtoni dhe ju ndonjë skenë të ngjashme, që ka ndodhur ndërmjet jush dhe prindërve tuaj (kur ata kanë qenë të zënë me punët e tyre).



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Për se autori i përdor tripikëshat në pjesën e fundit?

2. Në pjesën ku princi tregon për zotërinë si spec i kuq, janë disa fjali që fillojnë me “dhe”. Ç’ka dashur të përforcojë shkrimtari me këtë përsëritje?

3. Cilat janë cilësitë e njeriut si: spec i kuq? Shënoni + ose - . (me laps)

- i ftohtë
- egoist
- i inatosur
- pa pasion
- me imagjinatë
- i sakrificës

4. Kur princi shpjegon se cilat janë për të gjëra serioze, ai bën disa pyetje, të cilave iu përgjigjet po me pyetje. Ç’regon kjo për gjendjen shpirtërore të princit?

5. Si e kuptoni shprehjen në inat e sipër?

Shtoni dhe disa të tjera po me këtë ndërtim gjuhësor:

në zemërim e sipër
në të qeshur e sipër



DETYRË

Lexoni bukur fjalët e princit të vogël.

Mos harroni të shprehni në zë notat e trishtimit dhe të zemërimit në fjalët që ai thotë.



SERAFINA

Kjo pjesë është marrë nga libri "Tradhti në sarajet Topiase" e shkrimtarit për fëmijë Odhise Grillo. Shkrimtari ka përshtatur bukur në prozë poemën "Serafina Topia" të poetit arbëresh Jeronim De Rada.



Odhise Grillo

Bozdari ishte ulur mbi një shkëmb të gërryer nga kripa e të rrahur nga valët e detit dhe sytë i kishte hedhur tutje fushës, që vjeshta e kishte ngjyer me lloj - lloj ngjyrash. Poshtë tij shtrihej deti, që përplasej në breg gjithë zhurmë.

Në krye të lirishtës u duk Serafina, hipur mbi kalin pullali. Pas i vinte Zara.

Bozdari u ngrit dhe zbriti nga shkëmbi. Pas pak Serafina u ndodh pranë tij.

- Ti, Zara, shiko mos vjen njeri, ndërsa ne po rrimë këtu, - tha princesha dhe nisi të ngjitej mbi shkëmb pa ndihmën e shokut të vet. Pas e ndoqi Bozdari.

- Ishim më mirë në lirishtë, Serafinë, - i tha ai.

- Jo, jo, Bozdar. Më pëlqen të rri mbi shkëmb, edhe pse është thepa - thepa. Dua të shoh detin. Më pëlqen shumë kaltërsia, prandaj mos ma hiq këtë kënaqësi.

Ata u ulën mbi dy pllaka të lëmuara, që i kishin lëpirë valët e detit për sa e sa kohë. Dikush i kishte vënë atje dhe kështu kishte krijuar një kënd të qetë e të bukur për dy vetë. Që aty shihej deti, fusha dhe tokat dukagjinase.

Bozdari nuk priti t'i tregonte ndonjë gjë Serafina, po e pyeti pa u ulur mirë, me zemrën që i përpëlitej e me buzën që i dridhej:

- A erdhën Dukagjinasit te Zonja e Madhe?

Ajo mezi e nxori fjalën.

- Erdhën...

- Dhe çfarë ju thanë?

- Lidhëm krushqinë me ta, Bozdar...

Sa dëgjoji këto fjalë, Bozdari u pre dhe u zverdh si limon.

- Mos ma thuaj atë llaf, Serafinë, se më vrave! Po a lidhet krushqi me vrasësit vetëm e vetëm për dy - tri copë fshatra që do t'ju kthejnë Dukagjinasit?

Meqë nuk i morëm dot me shpatë, edhe pse u vramë e u premë kaq e kaq herë, nëna jote kërkon t'i marrë me krushqi, ë? - Po mendon keq,

ODHISE GRILLO (1931 -2003). Ka mbaruar studimet e larta për gjuhë e letërsi shqipe dhe për gazetari në Universitetin e Tiranës. Përmbi dyzet vjet ka punuar në revistën *Hosteni* dhe në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Është autor i shumë librave, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Mali të Zi. Është nderuar me dhjetëra çmime kombëtare e ndërkombëtare dhe disa libra të tij janë përkthyer në greqisht, italisht, arabisht etj. Pjesa më e madhe e botimeve të këtij shkrimtari i takon letërsisë për fëmijë.

o Bozdar, e po na fyen rëndë. Si ti jam plagosur edhe unë. Ndoshta ca më tepër se ti.

Se të dy i kemi dhënë fjalën njëri - tjetrit... Nëna dhe Komneni nuk e bënë për fshatrat, siç kujton ti, po për gjithë principatën e për gjithë Arbërinë.

- Dhe ti do të shkosh nuse në Dukagjin?

- Për të mirën e Topiasve bëj edhe më shumë.

- Hapu, o dhe, të futem i gjallë!

Me të vërtetë e ke? Kam përpara Serafinën, apo ndonjë njeri tjetër?

- Ta them me gjithë zemër. Ti vetë më ke mësuar që mbi çdo gjë të vë atdheun, apo jo? Më mirë të vuaj unë gjithë jetën duke qenë e ndarë nga ti, se të vuajë Arbëria!

Bozdari mori kokën në duar dhe heshti. Serafina po e shikonte me dhembje e me lot në sy dhe kujtonte bisedën që kishte bërë dy orë më parë me Ndrekon në dhomën e gjumit. Ndrekoja e kishte joshur me premtime dhe e kishte frikësuar me kërcënime.

I kishte treguar edhe kulaçin, edhe kërbacën që ta prishte fejesën me Nikun, por ajo nuk kishte pranuar.

Atëherë ai i kishte zënë në gojë Bozdarin, se Ndrekoja e dinte që ata kishin lidhur fjalë për t'u martuar bashkë.

Serafina i kishte mbushur sytë me lot.

Ndrekoja në fillim kujtoi se e theu, po kur ajo tha se Bozdari do ta kuptonte e do ta falte, u xhindos dhe iku si i marrë...

- Ç'po mendon, Bozdar?

- Mendoj për jetën tonë që e ke ti në dorë...

Po të duash, na bën të lumtur, po të mos duash, na bën fatkeqë...

- Ajo që u prish, nuk ndreqet më... A ngjitet buka e thyer?

- Ka një rrugë, Serafinë, dhe ti duhet të ecësh nëpër të, në qoftë se më do me të vërtetë.

Serafina e pyeti se cila ishte ajo rrugë. Bozdari iu përgjigj:

- Të ikim e të shkojmë tek ungji yt, Gjon Kastrioti. Atje s'do të na gjejë asgjë e keqe, princ Gjoni do të na dojë e do të na rrethojë me mirësi e dashuri. Aq më tepër se nuk ka asnjë nga djemtë afër. Më besol!

- Bozdar, e keqja që na gjeti, na e ka prishur edhe gjakun, edhe mendjen... Jemi si i mbyturi që nuk di ku të kapet dhe mbahet për flokësh... Po si mund të shkojmë në Gur të Bardhë, apo që

të vëmë në grindje krejt Arbërinë? Apo do që ta ndajmë e ta përçajmë më keq nga ç'është? Po të bëjmë ashtu si thua ti, Topiasit do të bëhen armiq me Kastriotët e me Dukagjinastit. Pastaj Dukagjinastit do të armiqësohen më keq me ne Topiasit e do të bëhen armiq edhe me Kastriotët, me të cilët venë e vijnë...

Do të bëhej një ngatërrësë, sa nuk do të merrte vesh i pari të dytin dhe kështu osmanët do ta gjenin rrugën të hapur.

Bozdari e dëgjonte i dëshpëruar dhe në fillim i dha të drejtë me mendje, po jo me zemër. Më vonë iu duk se nuk po kuptonte asgjë nga ato që po i thoshte Serafina.

Jo Topiasit, jo Kastriotët, jo Dukagjinastit, jo Osmanët. Po ç'vlenin të gjitha këto, kur ai po humbiste shoqen e jetës dhe lumturinë?

Ajo që kishte përpara dhe fliste si burrë, ishte princesha shëndetligë, që nuk ta mbushte syrin, apo një tjetër? Mos e gënjenin sytë? S'e paskësh njohur fare! Serafina që dukej e brishtë, paskësh qenë e hekurt!



FJALË DHE SHPREHJE

lirisht/ë - a livadh i vogël në mes të një pylli

lidhën krushqi lidhën miqësi dy familje mbi bazën e një martese

më vrave këtu: më hidhërove shumë

e kishte joshur ia kishte marrë mendjen me diçka tërheqëse (joshëse)

i kishte treguar e kishte marrë me të mirë, por dhe e kishte kërcënuar dhe kulaçin dhe kërbacin

e brishtë këtu: e ndjeshme, e pafuqishme për të përballuar vështirësitë

e hekurt këtu: pa shumë ndjenjë, e fortë për të përballuar vështirësitë e jetës.



1. Matni kohën që ju duhet për të kopjuar në fletore gjashtë paragrafët e parë të shkrimit.

2. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.



KUPTOJMË TEKSTIN

1. Në ç'kohë zhvillohet ngjarja e këtij tregimi?

2. Cilat ishin disa nga problemet kryesore që e shqetësonin në atë kohë tërë Arbërinë?

3. Tregoni me fjalët tuaja bisedën ndërmjet Serafinës dhe Bozdarit.



VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN



1. Si ju duket vendimi i Serafinës për t'u ndarë nga Bozdari:

(Plotëso me laps)

- shenjë egoizmi _____
- shenjë dobësie ndaj nënës _____
- rrugëdalje për t'i ardhur në ndihmë Atdheut _____
- mendjelehtësi _____
- shenjë vullneti e sakrifice _____
- mençuri _____

Argumentoni përgjigjet tuaja duke lexuar edhe pjesë nga teksti.

2. Cilat janë arsyet që Bozdari e kundërshton vendimin e Serafinës:

- nuk i dhimbset atdheu _____
 e do shumë Serafinën _____
 sepse dyshon te karakteri i Serafinës _____
 është paksa egoist _____
 është paksa i rrëmbyer _____
 bëhet xheloz _____?

Argumentoni zgjedhjet tuaja. Ilustrojini me pjesë nga teksti.

3. Pasi të plotësoni ushtrimet e mësipërme thoni si e përfytyroni ju portretin fizik dhe moral të dy personazheve.

4. Për hir të Atdheut, Serafina sakrifikon dashurinë. Si e vlerësoni veprimin e saj? A njihni ndonjë personazh tjetër nga letërsia jonë ose e huaj që kryen një veprim të tillë?

5. Çfarë ndieni për dashurinë e Serafinës dhe të Bozdarit që këputet në mes:

- keqardhje _____ trishtim _____ mëshirë _____
 kënaqësi _____ indiferentizëm _____ dhimbje _____? Për se?

99



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Si i kuptoni dy epitetet që cilësojnë Serafinën:

e brishtë - e hekurt

A e përjashtojnë ato njëra - tjetrën?

2. Në të folurin e personazheve autori fut disa shprehje që vënë në dukje dhe gjendjen e tyre shpirtërore:

Për shembull Bozdari thotë: Mos e thuaj atë llaf Serafinë se më vrave... (Plotëso me laps)

Serafina: Si ti jam e plagosur dhe unë...

- Plotëso:** Bozdari: _____
 Serafina: _____
 Bozdari: _____
 Shpjegoni kuptimin e tyre.



DETYRË

Bëni një krijim të shkurtër me temën: "I dhashë të drejtë me mendje, jo me zemër"

DJEMTË E RRUGËS PAL

Kjo pjesë është marrë nga libri me të njëjtin titull i shkrimtarit hungarez F. Molnar. Libri është i mbushur me ngjarje nga bota fëmijërore; me gëzimet, lojërat, shqetësimet e tyre.



Ferenc Molnar

Sheshi i rrugës Pal ishte një truall i shtruar e i ngjeshur, dhe zëvendësonte për bukuri lëndinat e fushat e hapura amerikane. Dhe në fund, ato stivat e druve, për ne ishin bota e tërë: qyteti, pylli, mali i thepisur, me një fjalë, atë vend e pagëzonim me një emër të ri, sa herë që ndryshonim lodrat. ..aspak dëshirë ta përshëndeste. Luajti një thërrime bishtin me gëzim, ashtu siç bëjmë ne kur i falemi kalimthi ndonjë miku, duke çikur me nxitim strehën e kapeles. Pastaj u lëshua në pikë të vrapit duke lehur me zemërim. Edhe Nemeçeku e ndoqi me të katra. Hektori qëndroi rrëzë një stive, ku nisi të lehte edhe më me tërbim. Kjo ishte njëra nga ato stivat, ku djemtë kishin gatitur një kështjellë. Arriti në majë të stivës duke mërmëritur edhe një herë me zë të shuar “mos kij frikë, Nemeçek”. Po tek u mat të kaptojë pragun e ulët të kështjellës, u llahtarisi aq fort, sa i mbeti këmba e ngrirë përpjetë.

- Bo - bo - o - o! - thirri.

Përbri flamurit, me këmbën e djathtë mbi pragun e kërcunjve, qëndronte posi shtyllë Frank Açi, ai Frank Açi i tmerrshëm, armiku i tyre i betuar, prijësi i djemve të Kopshtit Botanik. Këmishën e gjerë verdhane ia gufonte era me furi. Franku qeshi me tallje e i tha vogëlushit me një zë të qetë:

- Mos ki frikë, Nemeçek, - po Nemeçekut i kishte hyrë frika në palcë, dhe fluturonte si era. Hektori iu qep prapa, dhe që të dy ia mbajtën me të katra nga fusha, duke dredhuar nëpër rruginat e stivave.

...Dera e gardhit, nga ana e fushës, trokiti katër herë me radhë. Nemeçeku u kujtua përnjëherë: ishte parulla e tyre. Rendi te derëza e mbyllur e i hoqi shulin. Hyri Boka e pas tij Çeli e Gerebi. Nemeçekut nuk i pritej sa t'u kallëzonte ngjarjen e llahtarshme, po, megjithatë, nuk harroi se ishte një ushtar i thjeshtë dhe se duhej t'i nderonte eprorët e tij. Mori qëndrimin “gatitu”, dhe nderoi si ushtarët.

- T'u ngjatë! - ia pritën oficerat. - E, kemi gjë të re?

Nemeçeku po gulçonte, se donte t'ua rrëfente gjithë punën njëherësh.

- Na piu e zeza! - thirri.

- Çfarë?

- Medet! S'do më besoni!

- Po ç'ka ngjarë?

- Frank Açi ishte këtu!

Kur dëgjuan emrin e tij, të tre oficerat ngrinë në vend prej llahtarit.

- S'është e vërtetë, - tha Gerebi.

Nemeçeku vuri dorën në zemër e tha:

- Për zotin!

- Mos bëj be, - i thirri Boka. E për t'i dhënë më shumë rëndësi urdhrit të tij i tha:

- Gati - i - tu!

Nemeçeku përplasi takat e këpucëve. Boka iu afrua e i tha:

- Pa na kallëzo fill e për pe se ç'ke parë.

- Tek ecja nëpër rrugina, - tha Nemeçeku, - dëgjova qenin që po lehte. Iu vura pas. Kur dola te kështjella e mesit, ndieva një zhurmë të lehtë, nga sipër. U ngjita gjer në majë të stivës. Bubul! Ç'më panë sytë! Frank Açin me këmishë të verdhë.

- Ku? Në majë? Te kështjella?

- Po, mu në majë, - belbëzoi leshverdhi, që ishte gati të betohej sërish. Dorën e vuri në zemër, por e uli përnjëherë, se e vështroi ashpër Boka. Pastaj vazhdoi:

- Na ka rrëmbyer edhe flamurin.

- Nderohem t'ju them, - ia nisi Kolnai, - se kur hymë e gjetëm derën hapur. Sipas rregullores, dera duhet të mbyllet brenda me lloz.

Boka u kthye nga shokët që kishin hyrë prapa tij. Ata nisën të vështrojnë Nemeçekun, që vuri dorën në zemër për të zënë be se nuk e kishte lënë ai derën hapur, po kapiteni ia preu fjalën në mes:

- Kush hyri i fundit?

Që të gjithë mbetën gojëkyçur. Nuk paskej hyrë njeri i fundit. Po Nemeçeku u kujtua, u çel e u përtërit në fytyrë e tha:

- I fundit hyri zoti kapiten.

- Unë? - pyeti Boka.





- Si urdhëron.

Si u mendua pakëz, Boka tha me një hije të rëndë e pa dredha:

- Vërtet, se luan gjë. Harrova ta mbyll derën.

Zoti toger, të lutem ma shkruaj emrin në Librin e Zi.

Gerebi, nxori nga xhepi një bllok të vogël të zi, dhe shënoi me shkronja të mëdha: "Jani Boka".

E për ta sjellë ndërmend përse e kishte shkruar, përbri emrit të tij vuri edhe fjalën "derë".

Kështu u pëlqente atyre. Boka qe një djalë i drejtë. Dënimi që i dha vetes ishte një shembull i shkëlqyer burror, shembull që e kishin dhënë dendur vetëm burrat e ndritur romakë, siç e kishin parë nëpër ushtrimet latine. Po edhe Boka ishte njeri, vërtet që urdhëroi të shkruhej emri i tij në Librin e Zi, po që atë çast iu kthye Nemeçekut që e kishte kallëzuar, e i tha:

- Ama, edhe ti, s'të pushon gjuha fare...



FJALË DHE SHPREHJE

të ndrydhur në shtëpi që rrinë gjithë ditën brenda në shtëpi
ndalim kazermë arrest, qëndrimi në një vend të izoluar i ushtarëve që thyejnë disiplinën
i hyri frika në palcë u tremb shumë, u frikësua shumë
e tregoi fill e për pe e tregoi ngjarjen me hollësi



KUPTOJMË TEKSTIN

- Rilexoni me kujdes hyrjen e pjesës. Përse autori iu drejtohet në veçanti djemve të fshatit? Çfarë kënaqësish kanë ata më tepër se djemtë e qytetit?** _____
- Përse autori thotë se loja kishte shumë kapitenë dhe oficerë dhe vetëm një ushtar. Ç'tregon kjo për natyrën e këtyre djemve? Po të Nemeçekut?**
- Çfarë ju pëlqen në natyrën e Bokës dhe çfarë s'ju pëlqen?**
- Ritregojeni në fletore përmbajtjen e kësaj pjese duke u ndalur në:**
 - vendin ku luajnë fëmijët
 - lojën e tyre të parapëlqyer
 - organizimin e lojës
 - ndodhinë që u shkaktua nga gabimi i Bokës.



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

- Pjesa është shkruar me humor, i cili më tepër ndihet se sa është i dukshëm. Kjo duket te:**
 - serioziteti me të cilin luajnë fëmijët;
 - sinqeriteti i Nemeçekut
 - pranimi i gabimit nga Boka dhe më pas shfryrja që i bën Nemeçekut.
- Mësoni këto shprehje së bashku me të kundërtat e tyre:**

fluturoi si era *ngriu në vend;* *u gëzon zemra* *u qan zemra;*
u çel në fytyrë *vrenjt në fytyrë*
- Shpjegoni kuptimin e këtyre shprehjeve, sipas modelit. Plotësoni me laps.**

i rënë nga qielli *ishte shumë i mirë;* *u lëshua në pikë të vrapit* _____
s'të pushoi goja _____ *na kallëzoi fill e për pe* _____



DETYRË

Përshkruani në fletore vendin ku keni qejf të luani, ose një nga lojërat që ju pëlqen më shumë.

Atë ditë më mirë të mos e kishim marrë Bulinën me vete. Po ta dinim se ç'do të ngjiste, do t'i flisnim që të kthehej, dhe ajo, sigurisht, do të ishte kthyer, sepse i kuptonte të gjitha urdhrat që i jepnim. Veç... ne s'na bënte zemra të ndaheshim prej saj e ta linim në shtëpi, kur shkonim në fushë.

A mund ta përzinim Bulinën që e donim aq shumë, sa s'dinim ç'të bënim për të? Ne merrnim qëllimisht bukë në magje për t'ia dhënë Bulinës.

Gëzimi ynë s'kishte kufi kur Bulina hidhej si një portier i shkathët dhe i priste në erë koret e bukës. Pastaj, në shenjë falënderimi luante bishtin dhe ndiqte me sy lëvizjet e duarve tona, nëse kishim edhe një gjë tjetër për t'i falur.

Kur ne shkonim të luanim me top, Bulina rrinte afër vendit ku linim xhaketat, këpucët e çorapet. Shrinte këmbët e para, vinte mbi to kokën e madhe me veshë të vegjël dhe bënte sikur flinte.

Edhe atë mëngjes, kur u nisëm për në arat e Bairit, Gurorja e mori me vete. Ishim nja pesë a gjashtë fëmijë me një tufë lopësh, viçash, manarësh dhe mushkash dhe Bulina ecte herë pas nesh e herë përpara.

Aty pranë shkonte xhadeja e bardhë, si një fjongo mes fushës. Mbi të shumë rrallë kalonin makina. Kamionët së largu dukeshin si të ndarë në dy pjesë dhe ne i ndiqnim derisa na humbitnin nga sytë.

Papritur, aty nga dreka, dikush vuri re një tym të bardhë që ngrihej sipër xhadesë. - Po vijnë makina, y ... sa shumë që janë!

Bulina ngriti veshët dhe lehu mbytur.

Makinat ushtarake gjermane po kalonin me radhë njëra pas tjetrës, si ca qenie të gjalla, të lodhura e të mërzitura nga vapa dhe rruga e gjatë.

Si pa e kuptuar, u afruam te ledhi afër xhadesë. Në timon shikonim fytyrat e vrenjtura të ushtarëve gjermanë dhe rrobat e tyre të zbardhura nga pluhuri. Mbi ballë u binte streha e gjatë e kapeleve. U afrua edhe Bulina. Ajo filloi t'u lehte makinave me zërin e saj të ngjirur e të thellë. I ndiqte pas një copë rrugë dhe kthehej sërish te ne, duke tundur bishtin leshtor.

Ne po kënaqeshim.

Në kthesë u duk një veturë e vogël. Bulina e ndoqi edhe atë nja tridhjetë metra, duke i shkuar



Naum Prifti

NAUM PRIFTI lindi në Kolonjë më 1937 dhe vdiq në Amerikë në vitin 2023. Njihet sidomos për vëllimet me tregime për të rritur dhe për fëmijë. Ka botuar disa libra me tregime si: "Litari i zjarrtë", "Tregimet e fshatit", "Një pushkë më shumë", "Njerëz të kësaj toke", "Njëqind vjet" etj., dramat "Mulliri i Kost Bardhit", "Plumbat e shkronjave", si edhe komedinë "Dasmë pa nuse". Për fëmijë ka botuar përmbledhjet: "Legjenda dhe rrëfime për Skënderbeun", "Erë mali erë fushe", "Cikoja dhe Beni", dramën "Zani partizani". Ka botuar edhe përralla për fëmijë.

anës e duke iu turrur me egërsi. Papritur vetura ndaloi e prej saj doli një oficer i gjatë. Bulina, nga vrulli që kishte marrë, sa s'u përplas pas makinës.

Oficeri gjerman hodhi dorën në këllëf, e shkopsiti dhe nxori prej andej një revole me grykë të gjatë.

Bulina e pa tytën e zezë të revoles dhe e ndjeu se ç'e priste. Nguli këmbët e para në tokë, uli kokën dhe u kthye në të djathtë.

- Bulina! Bulina! - thirrëm ne. - Ik shpejt, ik shpejt!

Gjermani qëllloi. Bulina u rrëzua. Pastaj ai shikoi nga ne me përçmim, futi revolen në këllëf dhe i hipi makinës sërish.

Ne rendëm te Bulina që po kuiste. Një plumb e kishte marrë në kërbishte, kurse një tjetër në gjoks. Nga të katër vrimat vazhdonte t'i rridhte gjak.

Guri e ngriti në duar. U përpoqëm ta ndalnim gjakun duke i vënë gishtin mbi plagë, por s'qe e mundur. Gjaku vazhdonte të rridhte. Nxorëm

shamitë, grisëm këmishët për t'i lidhur plagët, por të gjitha qenë pa dobi, lecat skuqeshin menjëherë prej currilave të gjakut, kurse sytë e Bulinës po e humbitnin shkëlqimin.

Filluam t'i përkëdhelnim kokën dhe Bulina, si për të na falënderuar, mundohej të lëpinte duart tona.

Dridhma filluan të përshkonin trupin e saj, të cilat sa vinin e bëheshin me të dobëta e më të rralla. Pastaj sytë iu mjegulluan dhe Bulina e vari kokën.

E ulëm në tokë. Sytë tanë qenë mbushur me lot.

Në rrugë vazhdonin të kalonin makina të tjera gjermane.





FJALË DHE SHPREHJE

- magje-ja** orendi druri ku përgatitim bukën
manar-i qengj që shkon pas të zotit
xhade-ja rrugë
mbytur këtu: me zë të ulët
ledh-i vend i ngritur anës rrugës
kuis zëri që lëshon qeni kur e rrahin
kërbishte-ja pjesa e trupit poshtë kurrizit...
curril-i fill i hollë lëngu që del me forcë, çurg



Një histori të ngjashme me "Bulinën", mund ta shihni nëse do të kërkonte në internet filmin e vjetër shqiptar për fëmijë: "Tomka dhe shokët e tij, me regjizore Xhanfize Keko. Në anglisht titulli është: **"Tomka and his friends"**.



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

Thoni kuptimin e këtyre shprehjeve duke u mbështetur në shpjegimet që jepen më poshtë. s'dinim ç'të bënim për të, s'na bënte zemra, e priste në erë (e rrëmbente fluturimthi, nuk mundnim, e donim shumë).

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Ku po shkonin fëmijët?
2. Çfarë morën me vete?
3. Çfarë ndodhi papritur?
4. Çfarë bëri Bulina?
5. Çfarë bëri oficeri gjerman?
6. Si vepruan fëmijët?
7. Si përfundon ngjarja?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Përse fëmijët e morën me vete Bulinën?
2. Përse gëzimi i fëmijëve nuk kishte kufi?
3. Si ishte Bulina?
 - e shkathtë
 - mirënjohëse
 - besnike

Vërtetoheni me pjesë nga teksti.

1. Përse fytyrat e ushtarëve gjermanë ishin të vrenjtura?
2. Si i shikoi fëmijët oficeri gjerman pasi qëllloi Bulinën?
3. Përse oficeri i shikoi fëmijët me përçmim?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Kush i tregon ngjarjet në këtë tekst?
2. Cilët janë personazhet?
3. Personazhet janë të vërtetë apo të imagjinuara?
4. Ngjarjet e paraqitura a janë të vërteta apo të imagjinuara?
5. A renditen ngjarjet sipas rendit të zhvillimit të tyre?
6. Përcaktoni fillimin, vazhdimin dhe fundin e ngjarjes.
7. Çfarë është teksti i mësipërm?

Tregimi Realist

Në tekstin "Bulina" tregohen ngjarje që kanë fillimin ose hyrjen, vazhdimin, zhvillimin (ngjarjen) dhe fundin, mbylljen ose zgjidhjen. Ngjarjet janë të vërteta, realiste, sepse tregimi është shkruar për kohën kur vendi ynë, në Luftën e Dytë Botërore, ishte i pushtuar nga nazistët gjermanë. Personazhet janë të vërtetë, realistë. Ngjarjet renditen sipas radhës së zhvillimit të tyre. Të gjitha këto bëjnë që "Bulina" të jetë një tregim realist.



1. Shkruani në fletore një shkrim të shkurtër (rreth 10-15 fjali) mbi pëlqimet tuaja të kinematografisë apo artit skenik shqiptar. A keni ju një zhanër të preferuar? Pse?
2. Shkruani me kompjuter krijimin tuaj duke përdorur programin Word. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroni atë në fletore.
3. A mund ta përktheni krijimin tuaj në gjuhë të huaj?
4. Si do të vepronit për të ditur nëse përkthimi është i saktë?

KËSHTJELLA

*Kjo pjesë është marrë nga romani "Kështjella" i Ismail Kadaresë.
Romani flet për mbrojtjen e Kështjellës së Krujës nga luftëtarët shqiptarë.*



Ismail Kadare

Vazhdojnë sulmet e tyre të njëpasnjëshme. Qëkurse në horizont u dukën retë e para, që ikën përsëri të trembura ashtu siç erdhën, ata i dendësuan në një mënyrë të pabesueshme sulmet, duke mos marrë parasysh asgjë.

Çdo ditë, në valë të pambaruara ata vërshojnë drejt mureve tona, që janë çarë në shumë vende nga topat, mbështetin qindra shkallë, ngjiten, përlëshen, përpiqen të shkallmojnë portën e dytë, sprapsen dhe sulen përsëri me furi të dyfishtë.

Gjergji ynë i sulmon pothuaj çdo natë. Porsa varrosin ushtarët e vrarë gjatë ditës, nëpër mure, ata shpejtojnë të përlëshen me sulmuesit e natës dhe porsa varrosin ushtarët e vrarë natën, shpejtojnë përsëri të ngjiten në bedenat.

Ne mbetëm ditë e natë këtu në mure. Na merren mendtë nga uria dhe etja.

Para katër ditësh, kur ata filluan serinë e re të sulmeve, ushtarët e tyre, që mundën të ngjiteshin në të çarat e mureve dhe në bedena, lëshuan shumë kafshë të sëmura, kryesisht minj, të cilët u shpërndanë brenda kështjellës. Në pusin e tretë, që porsa po jepte kovat e para të ujit, ranë minjtë e sëmurë. Dy puset e tjera i shpëtuan rojat, që rrinë ditë e natë te gryka e tyre. Ata porsa dëgjuan britmën "minj", "minj", i mbyllën menjëherë grykat me kapakët e hekurt. Një pjesë e ushqimeve gjithashtu është infektuar. Kovaçët tanë, duke punuar ditë e natë, bënë disa qindra

ISMAIL KADARE është figurë e shquar e letërsisë dhe kulturës shqiptare. Është poet, romancier, studiues, publicist, përkthyes.

Ka lindur në Gjirokastrë më 1936 dhe vdiq në vitin 2024. Ka botuar librat me poezi: "Ëndërrime", "Shekulli im", "Motive me diell" etj., librat me tregime "Qyteti i jugut", "Ëmblema e dikurshme", "Ura me tri harqe", "Ëndërr mashtruese" etj., romanet "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kronikë në gur", "Kështjella" etj.

Ismail Kadareja ka shkruar edhe vepra për fëmijë, poezi dhe pjesë teatrore. Veprat e Kadaresë janë përkthyer e botuar në shumë vende të botës. Laureat i disa çmimeve të rëndësishme në vendin tonë dhe në botë.

çarqe, që u vendosën kudo nëpër kështjellë. Ditë e natë dëgjohej krisma e tyre e thatë, që nuk i lë ushtarët të vënë një sy gjumë.

Ata provuan çdo gjë kundër nesh, duke filluar nga topat e gjer te minjtë e infektuar. Ne qëndruam e po qëndrojmë. E dimë që kjo qëndresë po na kushton shtrenjtë dhe ndoshta do të na kushtojë edhe më shtrenjtë. Por dikush duhet të qëndrojë. Në rrugën e hordhisë së çmendur, gjithmonë duhet të çohet dikush dhe këtë herë koha na zgjodhi ne. Koha na vuri përpara dy rrugë: rrugën e lehtë të nënshtrimit dhe rrugën e rëndë të luftës. Ne zgjodhëm të dytën. Ne mund të zgjidhnim të parën, në qoftë se do të mendonim vetëm për veten tonë. Ne mund të ngrysnim ditët tona në paqe, pranë parmendës dhe ullinjve, por kjo do të ishte paqja e vdekjes.

Tërbimi i tyre ka arritur kulmin. Po bie ora e provës së madhe. Tani qielli po mbushet me re. Ato po dynden nga të gjitha anët e horizontit, sikur shpejtojnë për të bërë kasaphanë të përgjakur.





FJALË DHE SHPREHJE

me furi me forcë

beden-i pjesë e ngritur si dhëmb në murin e një kështjelle,

seri-a varg, radhë

i infektuar që ka mikrobe

hordhi-a ushtri e madhe e mizore e pushtuesit



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

Thoni kuptimin e këtyre shprehjeve duke u mbështetur në shpjegimet që jepen më poshtë.
vë një sy gjumë

po na kushton shtrenjtë

po bie ora e provës së madhe

(po vjen çasti vendimtar, fle pak, po na kushton shumë humbje, vuajtje).

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Kush e ka rrethuar kështjellën e Krujës dhe pse?
2. Çfarë bëjnë çdo ditë turqit?
3. Po Gjergj Kastioti, Skënderbeu, si u përgjigjet?
4. Çfarë lëshuan ushtarët turq në kështjellë?
5. Po ushtarët shqiptarë si vepruan?
6. Si vazhdojnë ngjarjet pastaj?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Kush i tregon ngjarjet e këtij teksti?
2. Cilët janë personazhet?
3. A janë personazhet figura historike?
4. Ngjarjet e paraqitura a janë të vërteta apo të imagjinuara?
5. Çfarë është teksti i mësipërm?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Nga e kuptojmë që kështjella ka kohë që është e rrethuar?
2. Ku ndodhet Skënderbeu?
3. Çfarë bëjnë armiqtë për t'i detyruar luftëtarët e kështjellës që të dorëzohen?
4. Rilexoni këtë pjesë:

Ata provuan çdo gjë kundër nesh, duke filluar nga topat e gjer te minjtë e infektuar. Ne qëndruam e po qëndrojmë. E dimë që kjo qëndresë po na kushton shtrenjtë dhe ndoshta do të na kushtojë edhe më shtrenjtë. Por dikush duhet të qëndrojë. Në rrugën e hordhisë së çmendur, gjithmonë duhet të çohet dikush dhe këtë herë koha na zgjodhi ne. Koha na vuri përpara dy rrugë: rrugën e lehtë të nënshtrimit dhe rrugën e rëndë të luftës. Ne zgjodhëm të dytën. Ne mund të zgjidhnim të parën, në qoftë se do të mendonim vetëm për veten tonë. Ne mund të ngrysnim ditët tona në paqe, pranë parmendës dhe ullinjve, por kjo do të ishte paqja e vdekjes.

5. Nënvizoni fjalitë ku duket vendosmëria e trimave të Skënderbeut?
6. Cilën nga të dy rrugët zgjedhin ata dhe pse?
7. Jepni mendimin tuaj për qëndresën e shqiptarëve.

Tregimi Historik

Në tekstin "Kështjella e rrethuar" tregohen ngjarje të vërteta jo të imagjinuara apo fantastike. Ngjarjet e paraqitura në "Kështjella e rrethuar" zhvillohen në shekullin XV. Skënderbeu, luftëtarët shqiptarë dhe turqit janë personazhet e këtij teksti. Personazhi i Gjon Kastriotit, Skënderbeut është figurë historike. Tregimi është historik.



MAGJIA

*Kjo pjesë është marrë nga romani "Kronikë në gur", i Ismail Kadaresë.
Në këtë roman autori krahas fëmijërisë së tij, trajton edhe probleme të kohës.*

Atë ditë ne po luanim me gurë, kur befás, njëri prej nesh thirri me tmerr:

Magjia!

Vrapuam të gjithë te shoku dhe qëndruam rreth e rrotull si të ngrirë. Ai ishte bërë dyllë i verdhë dhe tregonte me gisht në tokë. Atje, mes gurëve, dukej një magji, e madhe sa një grusht. Vështruam me sy të trembur njëri-tjetrin dhe fjalët na ngecën në grykë. (Më vonë Xhixhoja më shpjegoi se fjalët na i kish marrë magjia). Por pastaj papritur, na erdhi një guxim i marrë, ashtu siç ndodhë ndonjëherë në ëndërr, kur gjendesh i vetëm e pa shokë në ndonjë udhë të shkretëtë, gjysmë të errët dhe zemra fillon të të rrahë nga frika, sepse e ndien që nëpër këtë udhë të përçudnuar, diçka e keqe do të ndodhë dhe pret nga çasti në çast që të shfaqet e liga, po ajo vonon dhe ti pret akoma, ndërsa frika të shtrihet; gjersa atje përtej lëviz diçka, një fytyrë gjysmë e ndriçuar, që avitet dhe ty të priten gjunjët, zëri të humbet, mekesh i tëri, po papritur në çastin e fundit qëllon që të kap një fuqi e çmendur, gjymtyrët të çlirohen, zëri të vjen si bubullimë dhe, duke ulërirë, sullesh i tëri mbi hijen e keqe për t'u përleshur, dhe zgjohesh.

Kështu na qëlloi dhe neve.

- Magjia, - ulëriu befás Iliri me sa zë që kishte në kokë dhe u sul drejt saj, e rrëmbeu në dorë dhe e ngriti përpjetë.

- Magjia, magjia, - ulërimë edhe ne të tjerët dhe, pa kuptuar as vetë shkakun, të gjithë u nisëm në pikë të vrapit, tatëpjetë sokakut.

Iliri vraponte i pari dhe të gjithë ulërinin, thërrisnim, ngulçonim me gëzim, frikë dhe tmerr përzier bashkë.

Kanatet e dritareve nisën të hapeshin me zhurmë njëra pas tjetrës dhe gratë e plakat nxirrnin kokat e trembura dhe pyesnin.

- Ç'bëhet kështu?

- Magjia, magjia, - ulërinim ne, duke bredhur si një lumë i tërbuar, poshtë e

përpjetë lagjes, me britma e ulërima.

Kako Pinoja doli duke bërë kryq në dritare, nusja e bukur e Nazos buzëqeshi me sytë e mëdhenj, Mane Vocoja nxori tytën e gjatë të dyfekut nga baxha e çatisë, kurse Isai me syzet e mëdha si dy diej.

- Ilir ziu, - thërriste gruaja e Mane Vocos, duke shkukur faqet e duke na ndjekur pas - Ilir, të keqen, hidhe magjinë, hidhe!

Por Iliri s'dëgjonte. Atij i ishin zgurdulluar sytë, ashtu si të gjithëve dhe vraponte përpara dhe ne vraponim pas tij.

- Magjia, magjia!

Nënat na thërrisnin nga dritaret, nga portat, nga muret. Ato nduknin faqet, na kërcënonin, qanin, po ne vraponim dhe nuk e lëshonim magjinë. Ne atë lëmsh të mbështjellë me lecka të neveritshme, na dukej sikur mbanim ankthin e qytetit.

Më në fund u lodhëm. Ndaluam në sheshin e Zamanit dhe të gjithë ishim të djersitur, të pluhurosur, mezi merrnim frymë. Dhe na dukej sikur do të pëlcisnim nga kjo hare e madhe.

- Ç'do të bëjmë tani? - tha njëri.

- Ta djegim. Ka njeri shkrepëse?

Dikush kishte shkrepëse vërtet.

Iliri i vuri flakën magjisë dhe e hodhi përdhe. Ndërsa ajo digjej, ne nisëm të thërrisnim prapë duke brohoritur nga gëzimi...





FJALË DHE SHPREHJE

i përçudnuar i shëmtuar

mekem këputem

sokak-u oborr i vogël

ankth-i ndjenjë e rëndë ndrydhëse, shtypëse, shqetësim i madh



1. Regjistroni të dhëna mbi botimet në gjuhë shqipe dhe të huaj të Ismail Kadare, duke përdorur faqen zyrtare të Bibliotekës Kombëtare: www.bksh.al
2. Formoni me kompjuter një tabelë duke përdorur programin Excel ku të regjistroni të dhënat që mbledhët. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Çfarë po bënin fëmijët atë ditë?
2. Çfarë ndodhi papritmas?
3. Si vepruan fëmijët pastaj?
4. Çfarë bëri Iliri?
5. Si reagueshan njerëzit e lagjes?
6. Çfarë bënë fëmijët në fund?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Pse u mbetën fjalët në grykë fëmijëve?
2. Çfarë tregojnë për gjendjen shpirtërore të fëmijëve fjalët e autorit:
"Iliri vraponte i pari dhe të gjithë ulërinin, thërrisnim, ngulçonim me gëzim, frikë dhe tmerr përzier bashkë."
3. Përse gruaja e Mane Vocos thërriste:
"- Ilir ziu, Ilir, të keqen, hidhe magjinë, hidhe!"
4. Përse nënat nduknin faqet, kërcënonin, qanin?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Cilët janë personazhet në këtë tekst?
2. Si mund t'i ndajmë ata?
3. Vlerësoni personazhet fëmijë dhe personazhet të rritur?
4. A tregohen ngjarje në këtë tekst?
5. Çfarë bënë autori në këto fragmente të tekstit, tregon apo përshkruan diçka:
Vrapuam të gjithë te shoku dhe qëndruam rreth e rrotull si të ngrirë. Ai ishte bërë dyllë i verdhë dhe tregonte me gisht në tokë. Atje, mes gurëve, dukej një magji, e madhe sa një grusht. Vështruam me sy të trembur njëri-tjetrin dhe fjalët na ngecën në grykë. Iliri vraponte i pari dhe të gjithë ulërinin, thërrisnim, ngulçonim me gëzim, frikë dhe tmerr përzier bashkë.
Kanatet e dritareve nisën të hapeshin me zhurmë njëra pas tjetrës dhe gratë e plakat nxirrnin kokat e trembura dhe pyesnin.
 - Ç'bëhet kështu?
 - Magjia, magjia, - ulërimim ne, duke bredhur si një lumë i tërbuar, poshtë e përpjetë lagjes, me britma e ulërima.
6. Çfarë është ky tekst?



PJESË NGA "DITARI I ANA FRANKUT"

Këto pjesë janë marrë nga "Ditari i Ana Frankut". "Ditari" është shkruar nga Ana Frank, një vajzë trembëdhjetëvjeçare nga Holanda, me origjinë hebre. Ditari i saj paraqet krimet e bëra nga nazistët gjatë Luftës së Dytë botërore.



Ana Frank

Eshtunë, 20 qershor 1942.

Provoj një ndjesi vërtet të çuditshme, kur mendoj se do të mbaj një ditar. Jo vetëm pse nuk kam shkruar ndonjë gjë kurrë më parë, por edhe për shkak se kam përshtypjen se më vonë, as mua dhe askujt tjetër, nuk do t'i bëjnë përshtypje rrëfimet e një çupe trembëdhjetëvjeçare. Epo, nuk më bëhet vonë. Mua më pëlqen të shkruaj. Dhe gjithsesi dua të shfrij njëherë e mirë.

"Letra është më e durueshme se njerëzit". M'u kujtua ky proverb një ditë kur e ndjeva veten paksa të trishtuar dhe, duke mbështetur kokën mbi duar, nuk dija ç'të bëja: të rrija në shtëpi, apo të dilja. Më në fund nuk luajta vendit dhe u zhyta në mendime. Po, letra është më e vërtetë e durueshme, dhe unë nuk kam ndër mend që këtë fletore, me emrin e bujshëm "ditar" t'ia tregoj ndokujt, përveç ndonjë shoku ose shoqeje të denjë për këtë emër. Prandaj nuk më bëhet vonë, nëse ky ditar nuk do t'i interesojë askujt tjetër. Dhe tamam për këtë, po i rrëfhem një ditari, sepse unë nuk kam asnjë shoqe të vërtetë. Këtë dua ta shpjegoj më mirë, sepse askush nuk do ta besonte sesi një çupkë trembëdhjetëvjeçare mund të ndihet e vetmuar në jetë. Në fakt, kjo nuk është e vërtetë. Unë kam prindër të dhembshur dhe një motër gjashtëmbëdhjetë vjeçe. Kam edhe gati tridhjetë të njohur, ato që zakonisht i quajmë shoqe. Kam një karvan adhurues, që përpiqen si të shkëpusin ndonjë buzëqeshje prej meje dhe kur nuk ia dalin, rreken të më tërheqin vëmendjen në orën e mësimin, duke përdorur një pasqyrë. Unë kam teze e halla, daja e xhaxhallarë dhe një shtëpi që s'ka të sharë. Pra, duket sikur shkon fjollë gjithçka, mua nuk më mungon asgjë, përveç një shoqeje të zemrës!

Me të njohurit e mi vetëm mund të argëtohem ose të flas për gjërat e zakonshme, të përditshme. Për biseda intime, jo, as që bëhet fjalë. Ndoshta faji është imi, po ç'rëndësi ka, fatkeqësisht nuk shpëtoj dot prej saj. Ja ja përse më duhet ditari. Për ta përfytyruar sa më mirë këtë shoqe zemre, aq të dëshiruar, nuk dua

ANA FRANK ishte një vajzë me origjinë hebreje që jetonte në Holandë. Lindi më 1 qershor 1929. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, nga viti 1942 deri 1944, ishte e detyruar të fshihej bashkë me prindërit në tavanin e një depoje në Amsterdam. Gjermanët, kur i zbuluan, i internuan në kampin e përqendrimit: "Bergen".

Dy muaj para se të çlirohej Holanda ajo vdiq.

të shkruaj në ditarin tim vetëm ngjarje dhe kaq, por dua që ditari të bëhet shoqja ime, një shoqe që quhet Kiti!...

E premte, 9 tetor 1942.

E dashura Kiti! Sot kam vetëm lajme të trishtueshme. Miqtë dhe të njohurit tanë çifutë po i arrestojnë. Numri i tyre po rritet gjithnjë e më shumë. Gestapoja së pari silltet njerëzisht me ta. I ngarkojnë në vagonë kafshësh dhe i çojnë te kampi i çifutëve, Vesterbork. Vesterborku duhet të jetë i tmerrshëm. Për mijëra njerëz që janë atje ka pak WC dhe vende për t'u larë. Tregojnë se në baraka flenë burra, gra e fëmijë. Të ikësh është e pamundshme. Njerëzit e kampeve dallohen nga flokët e qethur dhe shumë të tjerë nga karakteristikat e jashtme të çifutëve.

Kur është këtu në Holandë kaq keq, si do të jetë vallë, atje larg ku i çojnë? Radio Londra flet për dhoma gazi: kjo ndoshta është metoda më e shpejtë e asgjësimit. Para pak kohe, para derës së Mipit, natën, ishte ulur një grua plakë, topalle. Ajo duhej të priste automobilin e Gestaposë që i mbledh njerëzit një nga një. Plaka dridhej nga frika. Artileria e mbrojtjes kundërajrore gjëmonte. Rrezet e projektorëve prisnin errësirën. Por Mipi nuk guxonte ta fuste brenda plakën. Këtë gjë gjermanët e dënojnë shumë rreptë.

Edhe Eli rri e heshtur dhe e trishtuar. Dirkun, mikun





e saj, e kanë dërguar në shërbim në Gjermani. Aeroplanët anglezë lëshojnë bomba me miliona kilogramë. Gjykime të tilla idiote si: Eh, po milionat s'do të bien mbi të", ose "Një bombë mjafton", më duken pa takt dhe të papjekura. Dirku sigurisht nuk është i vetmi. Çdo ditë udhëtojnë trenat plot me të rinj që i nisin me forcë. Tregimi im i trishtueshëm nuk mbaron. Ke dëgjuar ndonjëherë për njerëz që i marrin peng? Gjermanët kanë menduar këtu diçka

mjaft të rafinuar. Kjo është më e tmerrshme se çdo gjë tjetër. Kapin kuturu qytetarë të pafajshëm dhe nuk i lirojnë më. Po qe se zbulojnë gjekundi ndonjë "sabotim" dhe nuk gjejnë fajtorët, atëherë si dënim pushkatojnë një numër të këtyre njerëzve të kapur peng. Kjo thuhet haptas edhe nëpër gazeta. Çfarë njerëzish janë këta gjermanët? Në këtë popull bëja pjesë edhe unë dikur. Pastaj Hitleri na hoqi nënshtetësinë, kjo ka shumë kohë.

Ditari

Ditari është një përmbledhje shënimesh, përshtypjesh dhe ndjenjash të përditshme a të përkohshme, që mbahen për ngjarje nga jeta personale ose shoqërore. Ditari i paraqet ngjarjet ashtu siç kanë ndodhur nga dita në ditë, kronologjikisht. Ditari mund të jetë edhe vepër artistike. Në këtë rast, përveç përshkrimit të ngjarjeve, jepen edhe mendimet, ndjenjat.



FJALË DHE SHPREHJE

- Gestapo-ja* policia gjermani
peng-u gjëja ose njeriu që i lihet dikuj si dëshmi për realizimitn e premtimeve
i rafinuar dinak
kuturu pa i numruar



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Si fillon teksti?
2. Çfarë ndjente Ana kur filloi të shkruante?
3. Përse Ana ndjehej e vetmuar?
4. Çfarë i shkruan ajo Kitit?
5. Çfarë ishte kampi i hebrenjve (çifutëve) në Veterbork?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Kujt i drejtohet Ana Franku në ditarin e saj?
2. Kush ishte Kiti?
3. Cila është tema dhe ideja e këtij ditari?
4. Çfarë dini për qëndrimin e nazistëve ndaj hebrenjve?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. A ka personazhe në këtë tekst?
2. Çfarë bën autori në këtë tekst?
3. A tregohen ngjarje që kanë fillimin, vazhdimin dhe fundin?
4. A janë të vërteta ngjarjet e treguara në këtë tekst?
5. Si renditen ngjarjet në këtë tekst?



"Ditari i Ana Frankut" është shkruar si një letër drejtuar një mikeshë imagjinare. Ai është botuar për herë të parë, jo i plotë, më 1947 nga i ati, **Oto Frank**, i vetmi që shpëtoi gjallë nga familje Ana Frankut. Ditari i plotë është botuar më 1986, pas vdekjes së Oto Frankut. "Ditari i Ana Frankut" është një dëshmi tronditëse e një fëmijërie të vështirë, si edhe i ndjekjes e torturave dhe shfarosjes së qindra mijëra hebrenjve nga nazistët gjermanë. "Ditari i Ana Frankut" nga një ditar personal është kthyer në një vepër artistike e vlerësuar në mbarë botën. Është përkthyer në më shumë se shtatëdhjetë gjuhë të botës, përfshirë edhe gjuhën shqipe. Ana Franku është përfshirë në listën e 100 njerëzve më të shquar të shekullit XX.



KRENARIA E NJË TOREADORI

Kjo pjesë është marrë nga vëllimi me tregime "Dëborat e Kilimanxharos" të Ernest Heminguej. Manueli është një toreador i njohur dhe i respektuar. Pas disa vitesh, ndonëse në moshë jo të re, Manueli ngul këmbë të ndeshet. Ai nuk e fiton ndeshjen, por ruan me krenari deri në fund dinjitetin e tij.



Ernest Heminguej

Në mes të arenës, nën dritën e fenerëve, Manueli qëndronte përballë demit, i ulur mbi njërin gju. Ai ngriti muletën me të dy duart dhe demi iu vërsul me bisht të ngritur. Manueli iu mënjanua brirëve dhe kur demi iu hodh prapë, ai përshkoi me muletë një gjysmë rrethi dhe demi ra në gjunjë.

- Po, ai është toreador i shkëlqyer, - tha njëri nga turma.

Manueli u ngrit dhe e falënderoi publikun për duartrokitjet. Demi u ngrit më këmbë dhe po priste kokulur.

"Shkurt dhe drejt", - mendoi Manueli dhe iu hodh demit. I mëshoi shpatës, por kur goditi demin i kërceu nga duart. Ai ra me fytyrë për tokë, kurse demi arriti, pot Manueli i shtrirë e shtynte turirin e demit me këmbë. Ai u ngrit dhe me forcë mori shenjë. Me shpatë përpara iu sul demit. Përsëri ai e shtyu. Manueli u flak prapa dhe u përplas me forcë në rërë. Qëndronte pa lëvizur. Demi po e shtynte me brirë. Ai ndjeu se si briri i demit po e godiste mbi brez. Fytyra e Manuelit qe zhytur në rërë. Demi kapi me bri një mëngë të xhakëtës dhe e grisi krejt. Në këtë kohë u tundën pelerinat dhe demi e la Manuelin e u sul pas tyre.

Manueli u ngrit në këmbë dhe vrapoi të marrë një shpatë të re, duke fshirë gjakun nga fytyra. Ai përsëri iu afrua demit dhe me shpatë u hodh mbi të, por ajo përsëri nuk u ngul. Ajo qe shtrembëruar dhe Manueli e drejtoi te gjuri i tij. Në këtë kohë publiku filloi të lëvizte i shqetësuar.

- Demi qenka i tëri prej kocke,- tha me keqardhje një djalosh.

Manuelit po i dilte gjak nga fytyra. Djaloshi i tha:

- Më mirë shko në infermieri, - por Manueli nuk e dëgjoi. Ai nuk mposhtej lehtë, ndonëse tani ishte i plagosur. Ai përsëri u sul te demi dhe me forcë të madhe ia nguli shpatën. Demi ra poshtë. Manueli ngriti drejt turmës dorën e tij. Deshi të fliste, por diçka e pengoi. U kollit dhe ra

ERNEST HEMINGUEJ (1898- 1961) është shkrimtar i shquar amerikan. Gjatë Luftës së Parë Botërore erdhi vullnetar në Europë me një autokolonë të Kryqit të Kuq. Më 1918 u plagos rëndë. Pasi u kurua, u kthye në vendlindje, në Çikago. Është dekoruar me medaljen e argjendtë të trimërisë. Ka botuar shumë vepra ndër të cilat: "Në kohën tonë", "Kodrat e gjelbra të Afrikës", "Dëborat e Kilimanxharos" dhe "Plaku dhe deti" me të cilin mori çmimin "Nobel" në vitin 1954.

në tokë. Dikush u afrua dhe e ngriti. E dërguan në infermieri. E shtrinë në tryezën e operacionit. Manueli qe lodhur shumë. Gjoksi i digjte si zjarr. Kollitej. Suritoja fliste me Renatën. Nuk ishte hera e parë që Manueli shtrihej mbi tryezën e operacionit. Suritoja seç i tha duke ngritur gërshërën. Ah, ja ku qëndron puna. Ata duan t'i presin gërshetin e toreadorit.

- Ti nuk do ta bësh këtë,- tha Manueli.

- Qetësohu,- tha mjeku, - mua vetëm s' më eci fati. Ja, kështu. Unë isha në formë të shkëlqyer. Më thoni ju, a nuk është e vërtetë kjo?

- Dhe e vë në dyshim? - tha Suritoja.

- Ti ishe në formë të shkëlqyer.

- Unë përsëri do të dal në arenë dhe do të fitoj,- tha Manueli. Sanitari vuri maskën mbi fytyrën e tij.

Ai mori frymë thellë dhe ndjeu erën e njohur të kloroformit. Të tjerët rrinin pranë duke vështruar me vëmendje lëvizjen e Manuelit...





FJALË DHE SHPREHJE

- toreador-i* njeri që ndeshet me dema
arenë-a sheshi ku zhvillohen ndeshjet me dema
muletë-a këllëfi i shpatës
kloroform substancë kimike, për të mos ndjerë dhimbjen



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Ku zhvillohen ngjarjet?
2. Kur zhvillohen ngjarjet?
3. Përshkruani ndeshjen e Manuelit me demin?
4. Përshkruani reagimin e publikut.

ANALIZOJMË TEKSTIN


1. Kush është Manueli?
2. Çfarë pamje ka ai? Përshkruajeni.
3. Çfarë cilësish ka ai? Përshkruajini.
4. Përse nuk arriti Manueli ta mundë demin?
5. Si i kuptoni pohimet që vijnë:

*Unë përsëri do të dal në arenë dhe do të fitoj, - tha Manueli. Sanitari vuri maskën mbi fytyrën e tij.
Ai mori frymë thellë dhe ndjeu erën e njohur të kloroformit...*

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. A tregohen ngjarje në këtë tekst?
2. Çfarë bën autori në këtë tekst?
3. Çfarë është ky tekst:

- përrallë,
- përshkrim,
- apo një tregim?



SHTËPIA FLUTURUESE

Kjo pjesë është marrë nga vëllimi me tregime: "Xhipi në televizor dhe ndodhi të tjera në orbitë", i shkrimtarit të shquar italian Xhani Rodari.



Xhani Rodari

XHANI RODARI (1920-1980) është shkrimtar i njohur italian. Lindi në Novara. Punoi si mësues, pastaj gazetar. Vdiq në Romë në vitin 1980. Është shkrimtar i shquar për fëmijë. Disa nga veprat e tij janë: "Aventurat e Tonino të Pavdekshmit", "Udhëtimi i shigjetës së kaltër", "Aventurat e Çipolinos", "Xhipi në televizor dhe ndodhi të tjera ne orbitë".

Atë vit, zoti Pankracio, duke punuar gjatë kohës së lirë, ngriti me duart e veta një shtëpi për të kaluar pushimet, sipas një projekti të menduar që në fëmijëri. Ishte një shtëpizë e mrekullueshme, e tëra prej druri, me çati të kuqe e grila të gjelbra. I kishte të gjitha kjo shtëpi: kuzhinën, qilarin, dhomën e zotit Pankracio e të zonjës Luçia, dhomëzën e fëmijëve, që ishin dy që quheshin Laura e Xhaneto, dhe, natyrisht, edhe banjën, se familja Pankracio e donte pastërtinë. E, pra, veçoria e kësaj shtëpize nuk ishte oxhaku, edhe ky me atë çatizën e vet të kuqe që dukej si ndonjë fole zogjsh, as ballkoni i vogël përpara hyrjes, me ato katër karriget lëkundëse, një për secilin pjesëtar të familjes. Veçantia e vërtetë e saj u pa ditën e parë të pushimeve, kur zonja Luçia dhe fëmijët zunë vend në karriget e veta (secili në të vetën, ku, që të mos i ngatërronin, na kishin pikturuar emrin në shpinëz), ndërsa zoti Pankracio u zhduk në një skutë të çuditshme prapa banjës dhe thirri:

- Gati?

- Gati! - lu përgjigjën zërat gazmorë të Laurës e të Xhanetos.

Zoti Pankracio ndezi motorin dhe shtëpiza u ngrit fluturim si ndonjë pëllumb ose helikopter, duke lëshuar një shtëllungë guximtare tymi.

Fëmijët vraponin në oborr me duart në kokë.

- Ç'bën kështu, zoti Pankracio? U marrose?

Zonja Luçia u zgjat nga ballkoni për t'u valëvitur një shami.

- Mos kini frikë, gjithçka është në rregull.

- Po fluturojmë, - klithën hareshëm si dy dallëndyshe Laura me Xhaneton.

Roja i Bashkisë i fryu bilbilit.

- A e keni patentën zoti Pankracio?

- Çfarë patente, ore?

- Desha të thosha dëshminë. Nuk lejohet të ngasësh aeroplanin pa dëshmi.

- Po ky s'është aeroplan, është shtëpi. S'kam

dëgjuar ndonjëherë t'i kërkohet dëshmi babait për të drejtuar shtëpinë e vet. Shtëpia që ngritur tashmë lart në qiell dhe zëthet e Laurës e të Xhanetos nuk dalloheshin më nga zërat e zogjve të vegjël.

- E mjera zonja Luçia, psherëtiu një fqinjë, - që i ka rënë për bashkëshort një burrë si ky.

- Sa njeri i mirë dukej...

Shtëpia fluturuese u zhduk prapa një reje të vogël. U duk një çast majë kodrës e, më në fund, s'u pa prej saj veçse një pikëz e kuqe (çatia që shkëlqente nga dielli) dhe një fjollë tymi që era e fryu tej.

Gëzimi i vërtetë sundonte në bord. Zonja Luçia, që kishte ëndërruar ngahera të udhëtonte me aeroplan, dilte orë e çast nga kuzhina ku po gatuante drekën, kërkonte nga i shoqi që





t'i tregonte emrat e lumenjve e të maleve, se i pëlqente shumë gjeografia. Laura dhe Xhanetoja zgjatnin nga ballkoni rrjetat fluturuese, më shumë për t'u zbavitur sesa me shpresë të zinin zogj; zogjtë ç'është e vërteta, rrinin shumë larg, përveç një trumcaku që kish qëndruar mbi oxhak e shëtiste kështu falas duke fishkëlyer.

Zoti Pankracio herë pas here zhdukej në një skutë që t'i hidhte një sy motorit. Sa herë vinte sërish në ballkon, nuk i rrihej pa pyetur.

- Çdo gjë në rregull, komandant, - përgjigjeshin Laura e Xhanetoja. Zoti Pankracio fërkonte duart. - Mrekulli. Kësaj po i thonë që të nisesh për pushime.

Aty nga mbrëmja, zonja Luçia pa se kishte harruar kutinë e kakaos.

- S'prish punë. - e qetësoi i shoqi. - Shih atje poshtë një fshat të vogël ku mund të mbarojmë punë.

Drejtoi shtëpinë fluturuese fill për te sheshi, lëshoi një shkallë prej litari dhe zbriti për të blerë kakao.

Tërë njerëzia e fshatit ishin jashtë me kryet përpjetë. Merrni me mend se ç'thoshin.

- Shih sa të marrë! A bëhet shtëpi pa themele, pa bodrume ...

- Mbase janë akrobatë. Pa dale, mos keni gjë shfaqje sonte?

Kurse fëmijët e fshatit ishin mbledhur rrëzë shkallës së litartë. Ndonjë, madje, edhe kishte ngjitur shkallën e parë dhe kolovitej.

Mami, - thirri Laura, - thuaju të mos e prekin shkallën tonë.

- Ç'të keqe ka? - ja ktheu zonja Luçia buzagaz, - se mos do të na hanë. Lërimi të luajnë, bile po deshët thirrni ndonjë edhe ngjiteni lart.

- Hej, - thirri Xhanetoja duke u zgjatur nga ballkoni, - doni të hipni lart për të luajtur?

- Fëmijët lëshuam një thirrme gëzimi dhe u turrën shkallëve përpjetë. Po prindërit u sulën të tmerruar t'i zbrisnin në tokë, pa pyetur fare për kundërshtimet e të bijve.

Zoti Pankracio po kthehej me kutinë e kakaos në dorë, qetë-qetë e pa i shkuar mendja fare për të keq, kur u gjend para një komisioni baballarësh që i folën me kërcënim:

- Shporruni një orë e më parë nga fshati ynë, sa pa ju ardhur ndonjë e keqe. Nuk duam në vendin tonë hajdutë fëmijësh.

Zoti Pankracio e kuptoi se nuk ishte rasti të qëndronte e të bënte fjalë.

- Do të ngrihem, zonja e zotërinj. Erdhi koha të mbledhim shkallën.

- Ashtu, ju lumtë, sa më shpejt!

- Duket se nuk ju pëlqejnë gjërat e reja, - thirri zoti Pankracio nga ballkoni.

- Jo, jo, nuk na pëlqejnë.

Shtëpia fluturuese u nis përsëri. Zonja Luçia kishte ndezur llambën e kuzhinës. Fëmijët e fshatit e panë me keqardhje tek largohej në qiellin gati të kredhur në terr atë dritëz të ëmbël. Sa keq! Kushedi kur mund t'u rastiste të shihnin në ato anë një lodëz të rrallë si kjo.

Zoti Pankracio e zbriti shtëpinë majë një mali për të kaluar natën.

Fëmijët i lejuan, para se të flinin, të kapnin xixëllonja e bulktha. Sa qejf ishte!

Në agim familja Pankracio u zgjua nga krisma e një bubullime. Laura me Xhaneton dolën në ballkon ku u ndodhën përpara një pamje mrekulluese e tmerruese njëherësh: re të zeza të ngarkuara me shtrëngata rrethonin anëmbanë malin e po ngjiteshin mbi çatinë e shtëpisë fluturuese si të donin ta përzinin.

- Babi! Mami! Shtrëngata!

Dhe shkuan të gjenin mburojë te shtrati i prindërve, ku zoti Pankracio po flinte për shtatë

palë qejfe, ndërsa zonja Luçia me rrobë dhome, kishte shkuar të shihte nëse ishin mbyllur mirë dyert, dritaret e kanatet.

- Ç'po ndodh? - pyeti më në fund zoti Pankracio, duke u zgjuar prej një bubullime më të fortë se të parat, që kishte tundur malin, sikur donte ta bënte copë e çikë. Shtrëngatë? Shumë mirë, shumë mirë. Komandanti do të marrë masa menjëherë.

Ashtu si qe, me pizhame, u fut te skuta dhe ndezi motorin. Shtëpia u ngrit duke u lëkundur, e rrëmbyer sakaq nga shtjellat e erës, e fshikulluar nga shiu.

- Kam frikë, - u ankua Laura.

- Gjithçka në rregull? - pyeti në atë çast zoti Pankracio tek dilte nga skuta. Po kësaj radhe atij iu përgjigjën vetëm vështrimet e trembura të katër syve të veckël, të veckël.

- Babi, - pyeti Xhanetoja, - do të zbresim tani?

- E ku të zbresim, tetari im i dashur?

- Po në tokë, pra... në një vend të mbrojtur.

- Në tokë, the? Pse, i marrë jam unë? Pa vështro, vështro edhe ti Laura. Fëmijët u shtrënguan pas t'et dhe vështruan poshtë, nga dritarja e rrumbullakët hapur në dysheme që zakonisht mbulohej me qilim. Sa larg, e tretur tutje, e frikshme, ishte toka nën tërbimin e stuhisë

- Po ku do të vemi, atëherë?

- Zoti Pankracio shënoi me gisht: - Lart, më lart.

- Po shtrëngata pikërisht prej andej lart po zbret!

Atje lart retë ishin edhe më të zeza, shtilleshin erëra më të tërbuara, shpërthenin vetëtima e bubullima njëra pas tjetrës, njëra mbi tjetrën në një përleshje të çmendur.

Po zoti Pankracio vuri buzën në gaz.

- Mos kini frikë fare, me këtë shtëpinë tonë fluturuese ne do të arrijmë strehën më të sigurt.

Tani të dy fëmijët, pa folur asnjë fjalë, kishin rrasur kryet në fustan të nënës, për të mos dëgjuar bubullimat që trokisnin potershëm nëpër mure dhe tundnin orenditë. Erdhi një çast më pas bubullimat sikur u larguan, zhurma e ujëvarës që sajonte shiu tek përplasej mbi çati pushoi sakaq. Laura me Xhaneton dëgjuan

një përplasje kanatesh, pastaj zërin e gëzuar të babait që thërriste:

- Të gjithë në vendet e manovrës! Të gjithë në vendet e manovrës!

Këto fjalë donin të thoshin se gjithsecili duhej të shkonte në tarracë të ulej në karrige lëkundëse. A kish si bëhej kjo midis atij ferri?

- Hajt tani, të shkojmë. - thoshte nëna. - Duhet kurdoherë t'i bindemi komandantit.

S'kishim ç'të bënim, veç të bindeshim. Po sytë i hapëm vetëm si u ngjitëm në tarracë. Dhe menjëherë u desh t'i mbyllnim përsëri nga lëbyrja.

- Dielli! Dielli! Shtrëngata pushoi! Urra!

- Jo, jo, - tha zoti Pankracio, - shtrëngata ja tek është, atje poshtë, nën këmbët tona. Shihni si zvarritet, si sulet për të na arritur. Po s'na arrin dot!

Nën këmbët e tyre gjëmonte oqeani i zi i reve, përshkuar anekënd prej vetëtimave zigzage. Po përreth e përmbi ta qielli ishte i kaltër, i pastër, ngazëllues dhe dielli shndriste në qetësi.

- Diell ka kurdoherë, - tha zoti Pankracio, edhe përmbi uraganin më të frikshëm shkëlqen dielli. Puna është të arrish gjer atje. Ne, me shtëpinë tonë fluturuese, do të ngrihemi përmbi stuhitë. Dhe tani, zonja Luçia, a nuk po e bën atë kakaon e ngrohtë për ekuipazhin?

Kjo qe dita e parë dhe nata e parë e një pushimi të paharrueshëm në bordin e shtëpisë fluturuese.





FJALË DHE SHPREHJE

manovër-a veprim që bëhet për drejtimin e një anije
lëbyrje-a cipë e hollë që pengon vështrimin



1. Vizatoni me kompjuter “shtëpi fluturuese” duke përdorur format gjeometrike që ofron programi Paint.
3. Me ndihmën e mësuesit/es, printoni posterin e krijimit dixhital.



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Çfarë ëndrre kishte pasur zoti Pankracio?
2. Çfarë bëri për të realizuar ëndrrën e tij?
3. Si ishte shtëpia që ndërtoi zoti Pankracio?
4. Çfarë ndodhi kur zoti Pankracio ndezi motorin?
5. Po roja e Bashkisë çfarë i kërkoi?
6. Çfarë kishin harruar?
7. Çfarë ndodhi papritmas?
8. Si reagan Laura dhe Xhanetoja?
9. Po komandanti si veproi?
10. Si përfundoi ngjarja?



Kopertina e librit me tregime në original

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Përshkruani shtëpinë fluturuese?
2. Përse ishin të shqetësuar njerëzit e familjes?
3. Lexoni pjesët dhe bëni komentet tuaja.
 - *E mjera zonja Luçia, psherëtiu një fqinjë, - që i ka rënë për bashkëshort një burrë si ky.*
 - *Sa njeri i mirë dukej...*
 - Tërë njerëzia e fshatit ishin jashtë me kryet përpetetë. Merrni me mend se ç'thoshin.*
 - *Shih sa të marrë! A bëhet shtëpi pa themele, pa bodrume ...*
 - *Shporruni një orë e më parë nga fshati ynë, sa pa ju ardhur ndonjë e keqe. Nuk duam në vendin tonë hajdutë fëmijësh.*
4. Lexoni pjesët dhe bëni komentet tuaja.
 - *Diell ka kurdoherë, - tha zoti Pankracio, edhe përmbi uraganin më të frikshëm shkëlqen Dielli. Puna është të arrish gjer atje. Zoti Pankracio e kuptoi se nuk ishte rasti të qëndronte e të bënte fjalë.*
 - *Do të ngrihem, zonja e zotërinj. Erdhi koha të mbledhim shkallën.*
 - *Ashtu, ju lumtë, sa më shpejt!*
 - *Duket se nuk ju pëlqejnë gjërat e reja, - thirri zoti Pankracio nga ballkoni.*
 - *Jo, jo, nuk na pëlqejnë.*

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT


1. Ngjarjet e këtij teksti janë reale apo fantastike?
2. Personazhet e këtij teksti janë reale apo fantastike?
3. Karakterizoni personazhet fëmijë dhe prindër?
4. A vini re ndryshime ndërmjet këtij tekst dhe atij të Zhyl Vernit?

Teksti

Teksti: “Shtëpia fluturuese” paraqet ngjarje fantastike. Personazhet janë reale, ngjarjet renditen në mënyrë logjike. Teksti është tregim fantastik.

AKILI MUND HEKTORIN

Kjo pjesë është marrë nga libri: "Iliada" i autorit Stavri Trako. Ky libër është një përshtatje për fëmijë e poemës "Iliada" të Homerit. Në këtë pjesë jepet çasti kur ndodh ndeshja e famshme ndërmjet Akilit dhe Hektorit, që simbolizon luftën e egër ndërmjet grekëve dhe trojanëve.



HOMERI

Akili mund Hektorin

Zeusi mori peshoren dhe vuri në balancë fatin e dy heronjve. Kupa e kobshme e prijësit trojan rëndoi drejt Hadit. Atë çast dhe Apoloni hoqi dorë nga Hektori. Atëherë dhe Athinaja iu afrua Akilit dhe i pëshpëriti: «O Akil, unë jam me ty, ndaj mos ki frikë, se të dy do të dalim fitimtarë. Ndalo pak e merr frymë dhe unë do t'ia mbush mendjen Hektorit të ndalojë e të luftojë me ty. « Akili iu bind e u ul të pushonte, ndërsa Athinaja u drejtua tek Hektori e i tha: « Hektor, shumë po të mundon Akili, prandaj qëndro e lufto si burrat përkrah meje. Hektori e besoi dhe mori zemër. Qëndroi përballë Akilit e tha:

- O Akil, më s'do të ik siç të ika deri tani, kur i rashë tri herë rreth qytetit të madhërisëm të Priamit. Përballë teje s'do të më trembet syri. Ja do të të vras, ja do të më shkulësh shpirtin. Por më parë të lidhim besën që fituesi do t'ia dorëzojë kufomën kundërshtarëve.

Akili e vështroi rëndë - rëndë e i tha:

- Hektor, o armik i urryer, unë nuk pranoj të lidh besë me ty, se fort mirë e di që kurrë ujku me qengjin nuk u lidhën me besë midis tyre dhe as luani me njeriun. Mblidhi forcat dhe lufto si burrat e trego trimëri, se këtu ke për të larë gjakun e Patroklit me gjakun tënd.

Kështu tha e ushtën e lëshoi me sa fuqi që kishte, por Hektori u përku shpejt përpara dhe ushta i kaloi sipër kokës dhe u ngul tej përdhe. Athinaja mori ushtën dhe ia dha prapë Akilit. Kur i erdhi radha përsëri Hektorit, ai fort mirë e mori shenjën dhe e lëshoi ushtën drejt Akilit. Vërtet nuk gaboi, por shqyti i Akilit, ia prapsoi tej ushtën. Hektori u shtang, ngaqë nuk kishte ushtë tjetër, prandaj thirri në ndihmë Athinanë, e cila nuk dukej kurrkund. Hektori e kuptoi fort

HOMERI ishte poet i Greqisë së lashtë. Për jetën dhe veprën e tij letrare të jashtëzakonshme kritikët kanë mendime të ndryshme, në lidhje me dy poemat e nivelit botëror: Iliada dhe Odisea. Është vërtetuar arkeologjikisht se poemat përveç fantazisë poetike, pasqyrojnë ngjarje të vërteta historike, që kanë ndodhur më parë se të krijoheshin ato.

mirë dredhinë e saj dhe tha: « Çfarë fatkeqësie është për mua që hyjnitë po më shtyjnë drejt mortjes. Edhe pse për shumë kohë Zeusi dhe Apoloni më deshën, tani e shoh që më kanë braktisur e mortja e zezë po më afrohet. Një gjë kam në dorë: «të luftoj si kreshnik e të mos vdes pa nder e lavdi». Nxori shpatën dhe u turr drejt Akilit si një shqiponjë që sulet nga maja e malit drejt e në lëndinë, për të kapur ndonjë qengj. Atë çast dhe Akili u lëshua me egërsi mbi Hektorin, duke mbajtur në dorë heshtën, maja e së cilës vetëtinte si ylli i parë i mbrëmjes. Vërtetë Hektori mbante të veshura armë të bukura, që i rrinin për shtat trupit të tij vigan, por gryka, atje ku ndodhet filli i jetës, ishte i zbuluar. Aty mori shenjë Akili dhe heshta i doli trimit pas qafe. Hektorit iu lëkundën gjymtyrët dhe u plandos përdhe. Kur po binte përdhe, Akili foli:

- Ti kujtove, Hektor, se vrave mikun tim të dashur Patroklin, e i mposhte të gjithë burrat e dheut. Nuk e dije ti, vallë, se unë do t'ia merrja hakun, duke të marrë ty jetën? Trupin tënd do ta shqyejnë qentë, ndërsa Patroklin akejt do ta përcjellin me nderime.

Hektori iu lut në agoni:

- Pashë shpirtin tënd e të prindërve të tu, mos ma lër trupin të ma shqyejnë korbat e qentë.





Prano shpërblimin që do të japë babai e nëna ime, dhe jepua atyre kufomën time.

Akili ia ktheu rreptë:

- Mos zërë be për prindërit e mi, more i pafytyrë, se me urrejtjen që më ke ndezur, kam për të ta grirë mishin edhe sikur Priami të më japë dhjetëfishin e pasurisë që ke.

Kur filli i jetës po i shuhej, Hektori prapë foli:

- Tani po të njoh tamam ashtu siç të mendoja. Fytyrën e ke mizore, por më të zi e paske shpirtin. Por dije mirë se një ditë Paridi, me ndihmën e Apolonit, ka për ta marrë hakun.

Këto qenë fjalët e fundit të Hektorit dhe hija e vdekjes ia mbylli sytë.

- Edhe mua do të më marrë vdekja, - tha Akili ndërkohë, - por vdis njëherë ti, - dhe sakaq ia shkuli heshtën nga trupi.

Ndërkohë akejasit u afruan dhe askush nuk mbeti pa e goditur me heshtë trupin e Hektorit. Akili i zhveshi armët e kryetrimt dhe ua tregoi atdhetarëve të tij, duke u thënë:

- Tani, o akejas, që mposhta këtë vigan që ju solli shumë kobe, bëhuni gati të sulmojmë Ilionin, se trojanët nuk e kanë më Hektorin që t'u prijë.

Por ç'flas unë kështu?! Si harrova mikun tim të dashur Patroklin, që prehet pa vaj e vrer?

Le të kthehemi tek anijet e ta përcjellim Patroklin siç i ka hije!

Kështu foli Akili, lidhi trupin e Hektorit pas qerres e filloi ta zvarriste me kokë poshtë.

Aq shpejt e ngiste qerren sa trupi i Hektorit që zvarritej ngriti një re pluhuri.

Fytyra e bardhë dhe e hijshme u përbalt dhe u zhgërrye nga pluhuri. Edhe plaku Priam ta këpuste shpirtin, tek qante.

Në gjithë qytetin plasi vaji e gjëma. E gjithë turma mezi mbante Priamin, që desh të dilte jashtë ledheve.

- Më lini, o miqtë e mi, të shkoj tek anija e atij mizori e fodulli, që goditi fort zemrën e një plaku të mjerë e t'i lutem ndër gjunjë të më japë trupin e Hektorit, - thoshte ai.



Ndërkohë Andromaka, gruaja e Hektorit, nuk dinte gjë për vrasjen.

Në pallat ajo urdhëroi shërbëtorët t'i bënin gati ujin e ngrohtë Hektorit. Befas dëgjoi kujën e së vjehrrës e vrapoi drejt ledheve të qytetit, për të parë ç'kishte ngjarë. Kur mbërriti tek ledhet, e njohu trupin e Hektorit, që po zvarrisej në dhe. Një re e zezë i mbështolli sytë dhe ra pa ndjenja, pa mundur të qante.

Pranë iu ndodh e motra e Hektorit, që nuk e la të plandoset përdhe.

Kur u përmend, Andromaka zuri të qajë për fatin e zi të djalit të tyre, Astanjaksit.



KUPTOJMË TEKSTIN

1. Cilat perëndi morën pjesë në dyluftimin ndërmjet Akilit dhe Hektorit?
2. Çfarë bese kërkoi të lidhte Hektori me Akilin para dyluftimit?
3. Ritregojeni me fjalët tuaja mënyrën si u zhvillua dyluftimi.
4. Çfarë ndodhi pas vdekjes së Hektorit?



VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN

1. A e justifikoni zemërimin dhe egërsinë e Akilit, ndaj Hektorit? (Këtu kini parasysh se Hektori i kishte vararë Akilit mikun e tij më të ngushtë).
2. A ka të drejtë Hektori, kur i kërkon Akilit të zbatohen rregullat e luftës? Përse?
3. Hektori lufton për të mbrojtur trojet e tij nga akejt. Akili lufton për të marrë hakun e mikut të ngushtë. Nga cili hero anon simpatia juaj. Përse?
4. Plotësoni me laps tabelën e mëposhtme me cilësitë që ju përshtaten dy heronjve:

Cilësitë	Hektori	Akili
trim		
i pamëshirshëm		
dinak		
i drejtë		
i besës		
i egër		
idhnak		
i fortë		
i ndjeshëm		
hakmarrës		
mik besnik		

Cilat cilësi i kanë të përbashkëta të dy heronjtë?

5. Si e kuptoni braktisjen që i bënë hyjnitë Hektorit:

si hakmarrje _____
si fat të keq _____?

118



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Kjo pjesë është një përshtatje nga poezia në prozë. Autori ka ruajtur disa elemente të poezisë; kur vë ndajfoljen para foljes ose mbiemrin para emrit etj.
Gjeni në tekst disa ndërtime të tilla:
për shembull: *shumë po e mundon Akili...* (Plotëso me laps)

2. Gjeni krahasimet në pjesën e dyluftimit dhe shpjegoni kuptimin e tyre.
3. Ndaluni në shprehjen e figurshme *filli i jetës që përdor autori*. Cilësia e parë e fillit është të qenit i hollë, që mund të këputet në çdo çast. Ç'kuptim merr kjo cilësi pranë emrit *jetë*?
4. Ç'përfytyrim ju ngjall metafora *Hija e vdekjes i mbylli sytë Hektorit*? Çfarë ndryshimi ka ndërmjet kësaj dhe shprehjes së drejtpërdrejtë: *Hektori vdiq!*
5. Në dialogun që zhvillohet ndërmjet heronjve gjejmë fjalë nga më të egrat, sharje nga më të këqijat, betime dhe lutje të ndjera. **Gjejini ato dhe shpjegoni karakterin dhe gjendjen shpirtërore të heronjve gjatë dyluftimit.**
6. Cilat janë ato fjalë që pasqyrojnë më fort fatkeqësinë e trojanëve:
për shembull: *vaji*, _____, _____, _____, _____, _____.



JUL ÇEZARI

Pjesa është marrë nga tragjedia :“Jul Çezari”, e dramaturgut të njohur U. Shekspir, shkruar në mes të viteve 1599 -1601. Jul Çezari, perandor romak, erdhi në fuqi si çlirimtar i Romës e përhapës i qytetërimit romak. Por, më pas ai u bë tiran i egër. Republikanët: Bruti, Kasi, senatorë dhe miq të J.Çezarit, për të shpëtuar Atdheun nga shtypja e diktaturës, e vrasin. U duk se republikanët fituan. Por Mark Antoni me Oktavin, të nipin e Jul Çezarit, e ngritën popullin në këmbë dhe i përmbysin republikanët. Kasi dhe Bruti që të mos bien në duart e kundërshtarëve, vrasin veten njëri pas tjetrit. Populli u fut përsëri në një tirani të re.



Uilliam Shekspir

SHEKSPIRI konsiderohet si shkrimtari më i shkëlqyer i gjuhës angleze, një ndër shkrimtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, ndër shkrimtarët më të famshëm në botë. Ai ka qenë komediograf, dramaturg, por edhe aktor. Ai jo vetëm që shkroi disa tragjedi të jashtëzakonshme, të cilat hynë në historinë e letërsisë botërore, por edhe shumë komedi dëfryese për lexuesin.

I PARI QYTETAR
Qëndroni! Dhe le ta dëgjojm’ Antonin.

I TRETË QYTETAR
Pra, le të ngjitet në tribunën lart,
Do ta dëgjojmë. Eja, Mark Anton.

ANTONI
Me lejen e Mark Brutit, del përpara jush. (Ngjitet).

I KATËRTI QYTETAR
Ç’po thotë për Mark Brutin?

I TRETË QYTETAR
Me lejen e Mark Brutit, thot, del përpara nesh.

I KATËRTI QYTETAR
E mir’ e tij e do të mos na thotë
Këtu asgjë të keqe për Mark Brutin.

I PARI QYTETAR
Ky Jul Çezari ishte një tiran.

I TRETË QYTETAR
Po, pa dyshim, edhe të lumtur jemi,
Që Roma ka shpëtuar prej këtij.

I DYTË QYTETAR
Pushoni, të dëgjojmë, ç’thotë Antoni

ANTONI
Romanë bujarë!

QYTETARËT
Pushoni! Heshtni, ta dëgjojmë.
ANTONI
O miq, romanë, qytetarë, më dëgjoni,
Vinj ta varros, jo ta lëvdoj Çezarin.
E keqja që ka bërë çdo njeri i mbetet.
E mira i mbulohet shpesh në varr me koskat.
Ashtu i qoftë dhe Çezarit. Trimi Brut
Ju tha tani: Çezari qe ambicioz.
Në paska qenë ashtu, qe faji i rëndë shumë
Dhe rëndë shumë e pagoi Çezari.
Këtu, pas lejes Brutit e të tjerëve, -
Se Bruti është burr, i nderçim.
Të nderçim janë që të gjithë, ai dhe shokët, -
Vinj që të flas në funeralin e Çezarit.
Ish miku im më qe i drejtë dhe i besës.
Po Bruti thotë qe ambicioz,
Dhe Bruti është burr’ i nderçim.
Çezari i solli Romës shumë robër lufte
Dhe arkat me shpërblime ia ka mbushur.
Kjo qe ambicia e Çezarit? Si ju duket?
Çezari qante kur thërrisnin të vobegtët.
Ambicia duhet t’ish me zemër më të ashpër.
Po Bruti thotë qe ambicioz,
Dhe Bruti është burr’ i nderçim.
E patë që të gjithë se në Luperkalet
Tri her’ i dhashë një kurorë mbretërore

Edhe tri her' e hodhi, qe ambicje kjo?

Po Bruti prapë thotë qe ambicioz.

Dhe është pa dyshim, një burr i nderçim

S'dua të kundërshtoj ato që foli Bruti.

Po s'mund t'ju flas përveç ato që di.

Njëher' e deshtë që të gjithë - jo pa shkak,

Përse tani s'ju vjen asfare keq për të?

Nër egërsirat paske ikur, o gjykim,

Dhe njerëzit e paskan humbur arsyen!

Duroni, pak, se e kam zemrën te Çezari,

Aty, dhe pres sa të më kthehet prapë.

I PARI QYTETAR

Më duket që na flet me shumë arsye.

I DYTI QYTETAR

Po ta shikoni mirë punën, pati faj

Të madh Çezari.

I TRETË QYTETAR

Ashtu kujtoni, zotërinj?

Kam frikë mos ia zërë vendin një m'i lig.

I KATËRTI QYTETAR

E vutë re se ç'tha? E hodhi tej kurorën,

Ahere pa dyshim nuk ish ambicioz.

I PARI QYTETAR

Në qoft' ashtu, disa do ta pagojnë shtrenjtë.

I DYTI QYTETAR

I shkreti! I janë bërë sytë zjarr nga lotët.

I TRETË QYTETAR

S'ka burrë më bujar në Romë se Antoni.

I KATËRTI QYTETAR

Dëgjoni se po nis të flasë përsëri.



FJALË DHE SHPREHJE

roman-i - qytetar i perandorisë romake

funeral-i - ceremonia e varrosjes së një njeriu.



- Shkruani një tekst të shkurtër (10-15 fjali) duke përdorur të dhëna zyrtare e shkencore mbi Uilliam Shekspirin. Mos harroni që të citoni burimin e informacionit ku morrët të dhënat.

120



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

1. Për çfarë flet kjo pjesë?
2. Cilët janë personazhet e pjesës që lexuat?
3. Cili është roli i Mark Antonit?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Ç'qëndrim mbajnë qytetarët në fillim ndaj Brutit dhe ndaj Jul Çezarit?
2. Cili është qëllimi i fjalimit të Mark Antonit? Pse ai e thekson se i dha leje Brutit të flasë?
3. Si e përshkruan Brutin? Kush ka ndikuar, sipas Mark Antonit, te Bruti?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Theksimi i fjalëve: burrë i nderçim/ të nderçim janë të gjithë, mos bën të kundërtën?
2. Cilat vlera të Jul Çezarit vë në dukje Mark Antoni?
3. Ç'qëndrim mban populli në fillim të kësaj pjese e në fund të saj?
4. Nënvizoni në libër ato çaste kur Mark Antoni qorton popullin që nuk është mirënjohës ndaj Jul Çezarit.



VILHELM TELI

Kjo pjesë është marrë nga drama me të njëjtin titull të shkrimtarit gjerman J. V. Shiler. Në këtë dramë flitet për ngjarje që lidhen me kryengritjen e popullit zviceran kundër pushtuesve austriakë.

Dramë

(Pjesë nga akti III, skena III)

(Një lëndinë me pak pemë. Nga larg dallohet një kapele e vendosur mbi një hu. Është kapelja e sundimtarit të vendit. Para saj duhet të përkulen gjithë banorët që kalojnë andej. Për këtë qëllim, pranë kapeles janë vendosur dhe roje).

Personazhet kryesore në këtë pjesë janë:

- Vilhelm Teli** - fshatar, shigjetar i zoti.
- Valteri** - i biri
- Gesleri** - sundimtari i vendit
- Frishardi** - roja

- Valteri** - O babi, shih kësulën përmbi hu!
- Teli** - Pa lere tash kësulën. Eja, shkojmë!
(Kur do të shkojë, i del përpara Frishardi, duke i drejtuar ushtën)
- Frishardi** - Në emër të Kaizerit! Ndaluni!
- Teli** - Ç'kërkon prej meje dhe përse më ndal?
- Frishardi** - Ke shkelur urdhërin. Eja pas nesh!
- Leutoldi** - Nuk iu përule me nderime kësulës.
- Teli** - Lëshomë, or mik, të shkoj!
- Frishardi** - Në burg, në burg!
- Valteri** - Në burg tim atë! Ndhimë! Ndhimë!
Nxitoni miq të mirë, e na ndihmoni!
Kërkojnë të burgosin babin tim!
- Roselmani** - E ç'e ndalon atë njeri?
- Frishardi** - Është tradhtar, armik i Perandorit!
- Teli** - *(E kap dhe e shkund.)* Unë tradhtar!
- Roselmani** - Gabohesh! Është Teli, një qytetar i ndershëm e zemërbardhë.
(Gesleri, sundimtari, në kalë dhe një radhë e madhe trimash të armatosur, të cilët e rrethojnë skenën me një gardh ushtarësh.)
- Gesleri** - Hapuni!
Ç'është ky rrëmet i madh? Kush thirri ndihmë?
(Heshtje e gjithanshme.)
Kush qe. Kërkoj ta di! *(Frishardit).* - Ti eja këtu! Kush je dhe ç'e ke zënë atë njeri?
- Frishardi** - Zotëri i lartë, jam ushtari yt dhe po rri roje ndaj kësulës sate. Këtë njeri e kapa në ecje e sipër tek mohoi t'i falet kësulës, pas urdhrin tënd. Kam dashur ta burgos.
(Pas një heshtje.)
- Gesleri** - Keq, keq, o Tel, e urreke mbretin tënd, e mua që sundoj në vend të tij. Do t'ia mohosh



Johan Fridrih Shiler

FRIEDRICH VON SCHILLER lindi më 10 nëntor 1759 në Marbah dhe vdiq më 9 maj të vitit 1805 në Weimar. Njihet dhe pranohet nga Gëte-ja i famshëm, si autori më i shquar i letërsisë klasike gjermane. Shumë pjesë teatrale të tijat i përkasin repertorit standard të teatrit të gjuhës gjermane. Baladat e tij radhiten tek më të dashurat e poemave gjermane. Ai zë një vend të rëndësishëm në historinë e mendimit iluminist gjerman. Shileri është si embleme e filozofit, poetit, dramaturgut dhe historianit.



Filmi i fundit sipas dramës së famshme, është i Hollivudit, 2024.

nderimin e festës, që unë e vara të provoj besën tuaj. Qëllimin tënd të keq tani e mora vesh.

Teli - Më fal, i dashur zot! Prej pakujdesisë ka ngjarë, jo prej mospërfilljes sime. Të isha i mençur, nuk më thoshin Tel. Më fal, po tjetër herë nuk e bëj.

(Pas një heshtje).

Gesleri - Tel, flitet se në hark je mjeshtër i zoti dhe në nishan vë bast me cilindo.

Valteri - Është vërtet. Im atë, o zot, qëllon një mollë njëqind çape larg prej drurit.

Gesleri - Yt bir është ky, Tel?

Teli - Po, zotëri.

Gesleri - A ke të tjerë?

Teli - Edhe një tjetër.

Gesleri - Dhe prej të dyve, cilin do më shumë?

Teli - Njësoj më dhimbsen të dy bijt, zotëri.

Gesleri - Epo, Tel, pasi mundke të qëllosh një mollë një qind çape larg prej drurit, provoma mjeshtërinë. Rroke harkun. Ja tek e paske,. Bëju tani gati! Një mollë të qëllosh mbi kokën e djalit. Të këshilloj ta mbash nishanin mirë dhe mollën ta qëllosh që me të parën, se po e humbe rastin, humbe kokën.

(Të gjithë japin shenja tmerri.)

Teli - Zot, Ç'urdhër të llahtarrshëm po më jep! Si të qëlloj mbi kokën e tim biri! Jo i dashur, zot! S'e pate me gjithë mend! Na ruajt zoti! S'e pate me gjithë mend të duash gjë të tillë prej një prindi.

Gesleri - Një mollë do qëllosh mbi kokën e djalit! Ma kënda dhe të urdhëroj!

Teli - Më urdhëroni, si? Me harkun të shtije përmbi krye të birit tim ta dashur?

Vdes më mirë!

Gesleri - Ja shtjer, ja vdis së bashku me tët bir!

Teli - E qysh të bëhem vrasës i tim biri! Nuk ke fëmijë, zot, nuk mund të dish se ç'ndien zemra e një prindi!

Gesleri - Mor Tel, ç'u bëre befaz kaq i mençur! Më kanë thënë se je ëndërrues. I largohesh shoqërisë së njerëzve të tjerë. Ti do të jashtëzakonshmen. Prandaj sot të zgjodha një gjësend që lyp guxim. Një tjetër do mendohej; kurse ti mbyll sytë, e kap si trim dhe i del mbanë.

(Zgjat dorën drejt një dege peme që varet mbi krye të tij.)

- Këtu, ja molla. Po hapni vendin... Matni largësinë, as më pak as më shumë. Na u lëvdua që mund të shtjerë njëqind çape larg. Harkëtar, qëllo dhe mos e humb nishanin!

Rudolf Der Harras - Perëndi, u bë keq puna! Foshnjë, bjeri në këmbë Vogtit të të falë jetën!

Valter Fyrsti - *(I bie ndër këmbë.)* - Zotni Landvogt, sundimin tënd e njohim: në vend të së drejtës, ki mëshirë, merrma prej kamjes gjysmën, merrma që të gjithë! Po falja të gjorit atë këtë gjëmë.

Valteri - Gjysh, mos iu fal këtij njeriu të keq! Ku të qëndroj, më thuaj, nuk kam frikë.

Babai qëllon një zog tek fluturon. Pra, s'do ta prekë zemrën e të birit.

Shtahufaheri - Vogt, a s'ta prek kjo foshnje e mitur zemrën?

Gesleri - *(Rrëfen djalin).* Pa lidheni pas blirit!

Valteri - Të më lidhin! Nuk dua të më lidhin. Do qëndroj posi një shqerrë, nuk do marr as frymë. Po të më lidhni nuk e duroj dot; do përpëlitem ta këput litarin.

Rudolf Der Harras - Dal të të lidhim vetëm sytë, o çun.

Valteri - E përse sytë? A mos pandeh që i trembem shigjetës së tim eti? Do ta pres pa ndrojtje, pa lëvizur as qepallat. Rrëfeji, o babi, se ç'harkëtar që je! Nuk të beson, përpiqet të na prishë, ndaj për inat qëllo, godite mollën!

(Shkon te bliri, i vënë mollën mbi kokë.)

Teli - *(Ngreh harkun dhe shtron shigjetën).* Largohuni! Çelni rrugën!

Shtahufaheri - Tel! Ç'do të bësh? Se mos... Të dridhen duart, gjunjët të lëkunden.





- Teli** - (E lëshon.). Më zunë mjegull sytë.
Gratë - O Perëndi!
Teli - (Landvogtit.). Nuk mund të shtije. Ja ku ta kam zemrën. (Hap kraharorin.)
 Urdhëro ushtarët të më marrin jetën!
Gesleri - *Telit* Ti i bën të gjitha, Tel. Nga asgjë nuk tutesh. Dhe në lundrim je trim si në të gjuajtur. Tani shpëtues - ndihmoje veten! Me një të shtënë shpëtoi të gjitha! (Teli bën luftë të tmerrshme me vetveten, duart i dridhen dhe sytë i zgurdullon duke i drejtuar herë nga Landvogti, herë nga qielli. Befas kap pallaskën, nxjerr një shigjetë të dytë dhe e fsheh nën grykashkë. Landvogti i kqyr të gjitha këto lëvizje.)
Valteri - (Nën blirin.) Qëlllo baba. S'kam frikë.
Teli - S'kam ç'të bëj! (Mbledh veten dhe gatitet të shtjerë.)
Rundenci - (I cili tërë kohën kish qëndruar i tronditur pa masë, duke përmbajtur veten me zor, del përpara.) Zoti Vogt, mjafton! Mos shko më tutje, më tutje mos! E bëre provën tënde, qëllimin e arrite. Kur teprohet rreptësia e humbet qëllimin e mençur; dhe harku i ngrehur tepër, këputet shpejt.
Shtahufaheri - (Thërret.) Molla ra! (Ndërsa të gjithë qenë kthyer nga ajo anë dhe Berta ishte sulur midis Rudencit dhe Landvogtit, Teli kishte shkrehur harkun dhe kishte goditur mollën).
Roselmani - Djaloshi rron!
Shumë zëra - Dhe molla është goditur! (Valter Fyrsti lëkundet dhe mend rrëzohet, Berta e mban.)
Gesleri - (I habitur.) Si, shtiu me shigjetë? I çmenduri!
Berta - Yt bir jeton! Mblidh veten, atë i dashur!
Valteri - (Vjen duke nxituar me mollë në dorë.) Ja molla, babi! E dija unë që nuk do ta goditje birin tënd.
Teli - (Duke qëndruar me trup të kërrusur përpara, sikur do të deshte të ndiqte shigjetën. Harku i bie nga dora. Kur sheh djalin që po vjen, nxiton përpara me krahët e hapur, e pushton dhe e afron pranë zemrës me mall të zjarrtë; në këtë qëndrim bie pa fuqi për tokë. Të gjithë qëndrojnë të mallëngjyer).



FJALË DHE

- kësulë - a* kapele pa strehë
mori nishan përcaktoi mirë vendin ku do të qëllonte
ma kënda më pëlqen
çelni rrugën hapni rrugën, lëreni rrugën të lirë
tutesh trembesh, friksohesh



1. Kërkoni podcast-e apo video mbi "Vilhelm Tel" në dy faqet zyrtare:
www.tkob.gov.al
www.teatrikombetar.gov.al
2. Kur është shfaqur për herë të fundit kjo pjesë?



KUPTOJMË TEKSTIN _____

1. Në ç'kohë dhe në ç'vend zhillohet ngjarja e kësaj pjese?
2. Cilat janë personazhet kryesore të pjesës?
3. Çfarë u dha shkak për dënimin që i dha sundimtari Vilhelm Telit?
4. Ritregoni çastin emocionues me të cilin mbyllet pjesa.



VLERËSOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN

1. Ç'tregon urdhëri që dha Gesleri për natyrën e tij prej sundimtari? Ku qëndron mizoria e një urdhri të tillë?
2. Për se Teli vendos më në fund të qëllojë mollën mbi kokën e të birit:
 - pati frikë nga sundimtari _____
 - deshi të provonte zotësinë e tij _____
 - deshi të tregonte kurajon dhe gjakftohtësinë _____
 - ishte mendjemadh dhe i pashpirt _____
 - deshi të provonte papërkulshmërinë e njerëzve të thjeshtë që përfaqësonte _____
3. Teli do të shfaqë përparësinë e vet në krahasim me sundimtarin. Çfarë tregon kjo: forca qëndron te pozita shoqërore apo te vetitë fizike dhe shpirtërore të njeriut? Ilustrojeni mendimin tuaj me fjali nga pjesa.
4. Vendosja e kapeles mbi hu nga ana e njerëzve të sundimtarit është:

mençuri apo budallallëk,
virtyt apo ves,
respekt apo nënvleftësim për popullin që sundon?
Nga se mund të nderohet ose jo një sundimtar prej popullit të tij?



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

124

DRAMA

1. Kjo pjesë është shkëputur nga një dramë. Drama është një lloj letrar (në rreshta ose vargje) që shkruhet në formë dialogu për t'u shfaqur në teatër. Drama përbëhet nga fjalët që thonë personazhet, dhe nga të dhënat për skenën, mënyrën si flasin dhe si sillen personazhet etj.
Gjejini këto në këtë pjesë.
2. Drama ndërtohet sipas disa **akteve**. (Në çdo akt zhvillohet një ndodhi.) Vetë akti përbëhet nga disa **skena**. Çdo skenë ka një pjesë të ngjarjes që ndodh brenda një akti.
Nga cili akt dhe nga cila skenë e dramës është shkëputur kjo pjesë?
3. Në qendër të dramës qëndron një **konflikt** i fortë. Konflikti është një ndeshje që zhvillohet ndërmjet personazheve që kanë mendime dhe qëllime të kundërta. Kjo ndeshje në dramë zhvillohet nëpërmjet dialogëve dhe veprimeve të personazheve. Fjalët dhe veprimet e personazheve çojnë në zgjidhjen e konfliktit. Ato mbajnë peshë të madhe emocionuese. Veprimet e personazheve, mjediset ku ata jetojnë, peizazhi etj. realizohen nëpërmjet dialogëve të tyre. (Ndërsa në tregim ato plotësohen me fjalët e autorit).
Cili është konflikti që qëndron në bazë të këtij akti?
Në favor të cilit personazh realizohet ai?
4. Nga fjalët që thonë, personazhet zbulojnë dhe cilësitë e tyre. **Ndaluni në cilësitë e Vilhelm Telit, Valterit dhe Geslerit. Përse ata janë personazhet kryesore të dramës?**
5. Përveç personazheve kryesorë, ka edhe personazhe kryesore dytësore (që plotësojnë tërë ngjarjen).
Cilët janë ata në këtë pjesë dhe çfarë cilësish shfaqin?



DETYRË

Ndani pjesën në role dhe interpretojeni në klasë si në teatër ose bëni një mbasdite letrare.



VËLLAZËRI E INTERES

KRISTO FLOQI (1873 - 1951) lindi, në Korçë. Arsimin fillor e bëri aty ndërsa shkollën e mesme dhe universitetin në Athinë. Në moshën 23 vjeçare, u diplomua në drejtësi. Më pas punoi si avokat në Greqi e Shqipëri. Meqënëse përndiqej nga qeveria turke për shkak të veprimtarisë atdhetare, emigroi në SHBA, ku bashkë me Nolin e Konicën u bë njëri nga themeluesit e Federatës "Vatra" dhe redaktor i revistës "Dielli". Ka drejtuar disa botime periodike në Amerikë e Shqipëri. Ka shkruar katër drama: "Fe e kombësi", "Karlo Topija", "Pirro Neoptolemi" dhe "Triumfi i lirisë" dhe gjashtëmbëdhjetë komedi ndër të cilat përmendim: "Rrogat e nëpunësve", "Do të vras veten", "Vëllazëni e interesë", etj. Vdiq në Shqipëri pas disa vite burgimi.



Kristo Floqi

- Koci: A e pe se ç'pësuam?
 Marga: E pësuam shumë keq, po prapë të themi shyqyr, që u ndodh Miti e na shpëtoi nga një shndërrim i madh, se ku do futeshim nga bota?
 Koci: Pse u nxituam kaq fort? Ti e ke fajin!
 Marga: Unë, apo ti? Më duket se ti e ke më tepër! Ti e ke vëlla e duhej të silleshe mirë, mos më shiko mua!
 Koci: Po ti pse jo? Pse s'u solle dobare ti mirë? Po thuaj se gabuam që të dy e hidhi gunën tani!
 Marga: Sido që të themi, është e kotë! Tashti të shohim ç'do bëhet!
 Koci: Ta merr mendja se mund të na nxjerrë jashtë Miti, duke çfryrë për sa folmë ne?
 Marga: Atë s'e bën kurrë Miti, se i vjen turp nga bota, po të paktën e të na lerë të rrimë pa qira, pa s'ja themi as priftit! Për Mitin mjafton të na ketë nën thundër, që të mos kemi sy e faqe të flasim gjë, pa atë që thua s'e bën kurrë ai!
 Koci: Fundi për hair, do ta shohim edhe këtë!

Skena XVIII

(Të parët, Miti)

Miti (Hyn brenda i veshur bukur, me kapelë të lartë, me gante, me bastun, me sahat me qostek të florinjte, tamam si një gjentelman amerikan): Më falni, se erdha t'iu trazoj edhe një herë!

- Koci, Marga: Urdhëroni, urdhëroni vëlla i dashur!...
 Koci (Afrohet ta zërë për qafe): Vëlla i dashur, të kam vëlla, vëlla!...
 Miti: Ngadalë, ngadalë, mos më zërë, mos të të ngjit ndonjë morr!
 Marga (Fillon t'i hidhet për qafe).
 Miti: Ruaju, ruaju se unë kam tabor morrash përsipër! (E largon).
 Koci (Mitit): Të kam vëlla, s'na ndan gjë!
 Marga: Je shpëtimtari ynë!
 Koci: Aman, Miti, xhan, shpirt, na e fal gabimin!
 Marga: Ma fal edhe mua; një copë grua jam, leshgjatë e mendjeshkurtër!
 Miti: Pse, xhanëm, pse? Ju s'më keni bërë ndonjë faj, pse bëni kështu?
 Pa lini këto tani dhe uluni t'ju flas...
 Koci: Urdhëro e rri, zotërote, më parë.
 Miti: Unë s'mund të rri mbi kanapënë tuaj se jua ndyj.
 Marga: Bah, bah, bah, fjalë është ajo për të thënë?
 Miti (Margës): Ma the, zotërote, dhe e vura ndërmend, prandaj po ruhem! Uluni, ju lutem e më ndigjoni! (Koci me Margën ulen). Tani me Ballaurin s'kini më punë, ai e mori gjer me një hesapin e borxhit që i kishit dhe hoqi dorë. (Nxjerr nga xhepi një akt noterial). Ja, ky është akti noterial, që Ballauri pohon se mori prej jush 250 e ca lira turke dhe

jua shpengoi shtëpinë, pra, shtëpia është e juaja dhe e gëzofshi!
Koci me Margën (duke fshirë sytë vijnë t'i puthin dorën Mitit, po Miti i largon):
Faleminderit fort e fort!

Miti: S'kini përse; është një detyrë e një vëllait kjo!

Koci: Të na rrosh e të të kemi sa malet!

Marga: Ti je shpëtimtari ynë! Ti s'na le të turpërohemi! Të solli Perëndia këtu, që të mos shndërroheshim fare!

Kristo Floqi



FJALË DHE SHPREHJE

dobarem *dobare, të paktën*

për hajr *hair, mbarësi, mirësi, këtu:
për të mirë*

gante *doreza*

bastun - i *shkop që mbajnë pleqtë
për t'u mbështetur kur ecin*

qostek - u *zinxhiri i orës së xhepit*

tabaro *tabare, pallto*

lluks *luks, këtu: i bukur*

gjentelman - i *këtu: zotëri*

trazoj *shqetësoj*

tabore *taborr, këtu: grumbull*

hesap - i *llogari*

lirë - a *pare turke*

shpengoj *liroj*

126



KUPTOJMË TEKSTIN

1. Sa pjesë ka ky tekst dhe si quhet secila prej tyre?
2. Përse flasin personazhet në pjesën e parë?
3. Po në pjesën e dytë?
4. Çfarë kritikon autori përmes këtij teksti?



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

1. Cilët janë personazhet e këtij teksti?
2. Çfarë lidhje kanë ata me njëri-tjetrin?
3. Jepni mendimin tuaj për secilin prej tyre.
4. Çfarë bëhet në këtë tekst?
 - përshkruhet natyra apo një personazh;
 - shpjegohet diçka që nuk dihet nga lexuesi;
 - personazhet bisedojnë me njëri-tjetrin dhe jepen të dhëna për skenën etj;
 - tregohet një ngjarje që ka hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen?
5. Ky tekst është shkruar për t'u lexuar apo për t'u luajtur në teatër?

Komedia

Teksti “: Vëllazëri e interes”, i shkruar nga Kristo Floqi, është vepër teatrale e shkruar posaçërisht për t'u luajtur në teatër. Në këtë vepër vihen në lojë anët negative të dy personazheve kryesore, Kocit dhe Margës. Teksti nga është marrë kjo pjesë është një komedi. Komedia është një vepër teatrale, ku pasqyrohen e vihen në lojë dukuri shoqërore të shëmtuara, duke na bërë të qeshim me to.



DEBUTIMI IM NË BURGTEATËR

Kur jetoja në Vjenë, isha i ri dhe i varfër. Për të fituar bukën, u jepja mësimet private të gjuhës italiane disa nxënësve. Në atë kohë e ardhmja ime ishte shumë e errët. Nevoja për të jetuar, oreksi i madh, zorrët që më gërryenin, më detyruan të punoja si figurant në Burgteatër duke marrë çdo mbrëmje një shpërblim fare të vogël. Që të them të drejtën, pa u mburrur, nuk isha figurant, por ndihmëfigurant, ose më mirë të themi statist i thjeshtë. Për punën që bëja, merrja 1,35 marka për çdo shfaqje. Si statist, luajta rolin e një plaku grek në pjesën "Mjeshtër Palmira" dhe atë të një plaku romak në tragjedinë "Jul Çezari".

Por ja, në komedinë e Molierit, "Tartufi", m'u dha gabimisht roli i shërbëtorit të Tartufit, që kishte një emër: ai quhej Lorenc. Roli nuk ka asnjë fjalë, por atij i flet Tartufi, që e interpretonte Jozef Kainci. Atë unë e kisha parë shumë herë, kurse ai mua asnjëherë.

Tartufi hyn në skenë nga ana e majtë, i përcjellë prej shërbëtorit. Para se të dilnim në skenë, unë isha afër Kaincit dhe i thashë "mirëmbërma", por ai nuk ma vuri veshin dhe as më shikoi. Me gishtin tregues të dorës së djathtë, hoqi pluhurin nga sipërfaqja e një mobilieje dhe i tha inspektorit të skenës: "Duhet të kujdeseni që të ketë më shumë pastërti në teatër?!" Inspektori i nevrkosur iu përgjigj: "Zotni Kainc, ju lutem hyni në skenë" dhe shtoi, duke u drejtuar nga unë: "Edhe ju".



Aleksandër Moisiu

ALEKSANDËR MOISIU (1879-1953) lindi në Kavajë. Për arsye ekonomike, familja emigroi jashtë vendit në Itali dhe pastaj në Austri. Ka qenë aktor me famë botërore. Krijimtarinë teatrorë, Aleksandër Moisiu e nisi më 1899 në Austri, në skenën e Burgteatrit të Vjenës. Ka luajtur në skenat më të dëgjura në: Gjermani, Francë, Itali, Rusi etj. Ka luajtur role të ndryshme nga kryeveprat botërore të Shekspirit, Gëtes, Molierit, Eskilit etj. Ai mburrej me prejardhjen e tij shqiptare dhe mbante lidhje me shqiptarët kudo në botë.

I gatshëm dhe i shpejtë, Kainci filloi rolin e vet: "Lorenc, o shërbëtori im, më përgatit petkat e pendesës..." Në çast Kainci ngre sytë, shikimet tona kryqëzohen, ai thotë edhe tri fjalë dhe i mbahet goja.

Sufleri, një burrë i moçëm mjekrosh, i kujton aktorit fjalët e rolit. Mua më mbulojnë djersë të ftohta. Inspektori vrapon si një shpëtimtar dhe, më në fund, e ndihmoi Kaincin të dalë nga kjo gjendje e vështirë.

Pengimi që i ndodhi Kaincit, pati pasoja jo për të, por për mua, pasi të nesërmen, nisën të më kërkojnë në të gjithë Vjenën. Kur më gjetën, më thanë se zoti këshilltar mbretëror, doktor Shlenter, kërkonte të fliste me mua! Nga këto fjalë u çudita shumë.

Iu paraqita Shlenterit, i cili me njerëzi më tha që t'i recitoja diçka. "Nuk di gjë përmendsh", - i thashë dhe i premtova se do të mësoj diçka. Pas një bisede të shkurtër me kolegët e mi figurantë, vendosa të mësoi diçka nga "Rikardi III".

Këtë ia recitova doktor Shlenterit me një gjuhë të keqe, por ai, si më guximtar që ishte,

më paraqiti përpara kolegjiut drejtues të Burgteatrit.

Të gjithë personalitetet e mëdhenj si: Sonetali, Levinski, Bermaisteri, Harmani e të tjerë, pas një diskutimi serioz, vunë nënshkrimet e tyre në një copë pusullë, ku edhe sot mund të lexohen këto fjalë: "Aleksandër Moisiu, lindur..... Babai..... Shkolla e të tjerë, është i paaftë për t'u bërë aktor".

Po rrugët e fatit janë të çuditshme dhe unë ndoshta do t'i isha nënshtruar këtij vendimi sikur Jozef Kainci mos t'i kishte dhënë rëndësi atij pengimi të gojës, që i ndodhi kur më pa, dhe sikur të mos më kishte mbrojtur.

Ai më tregoi rrugën, që unë ndoshta do ta kisha humbur njëherë e përgjithmonë.



KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË



KUPTOJMË TEKSTIN

1. Ku dhe si jetonte Aleksandër Moisiu?
2. Çfarë roli iu dha në komedinë Tartufi?
3. Çfarë i ndodhi Kaincit në skenë?
4. Çfarë pasojash pati për Moisiun pengimi që i ndodhi Kaincit?
5. Si e vlerësoi komisioni Moisiun?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Kush ishte Jozef Kainci dhe si ishte ai?
2. Kush ishte doktor Shlenter dhe çfarë bëri ai?
3. Çfarë thotë në fund Moisiu për Kaincin dhe pse?

THELLOHEMI NË ANALIZËN E TEKSTIT

1. Çfarë bën autori në këtë tekst?
 - përshkruan natyrën apo një personazh?
 - jep të dhëna dhe shpjegime për diçka që nuk njihet nga lexuesi?
 - tregon një ngjarje që ka hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen?
2. Çfarë teksti është:
 - tregues,
 - përshkrues,
 - shpjegues dhe informues,
 - poetik?



1. Kërkoni në fjalorin online përkufizimin e fjalëve: "redakto", "periodike", "noter", "famë", "inspektor", "kolegjiut" dhe "personalitet".
2. Shkruani në fletore përkufizimet e tyre, matni kohën e procesit dhe regjistroni në fletore.
3. Shkruani me kompjuter përkufizimin e fjalëve më lart.



KARNAVALET E KORÇËS

Kjo pjesë është shkëputur nga vepra "Karnavalet e Korçës" e Spiro Çamorës. Vepra vë në lojë veset, zakonet prapanike, përruljen para parasë etj. Ngjarjet flasin për familjen e Nikollaq Jorganxhiut, tregtar manifakture nga Korça. Olimbia është gruaja e Nikollaqit.



Spiro Çomora

Personazhet

*Nikollaq Jorganxhiu, tregtar manifakture
Olimbia, gruaja e tij
Afroviti, çupa e tij
Nasta, shërbëtorja e tyre
Aspasia, motër e Olimbisë
Loni, nip i Olimbisë, profesor i gjimnastikës
Jani, profesor i filozofisë.
Ditka, mësuese*

SPIRO ÇOMORA (1918-1973) u lind në Vuno të Himarës. Studimet e larta i ka kryer në Romë për drejtësi. Ka punuar si redaktor në revistën "Hosteni". Ka shkruar poezi satirike dhe komedi. Ndër veprat e tij përmendim vëllimet me poezi: «Syfete», "Për njoftim, për veprim", "Maska dhe fytyra" etj.; komeditë: «Dy me zero», «Syleshi», «Karnavalet e Korçës», "Snobi" etj.

Ngjarjet zhvillohen në Korçë më 1936

Akti i dytë

- Olimbia - Urdhëroni... (*Jani ulet*). Nikollaqin e kam pakëz pa qejf...
- Jani - Po, zonjë, më lajmëroi Vaska. Tani si është?
- Olimbia - Me butur...
- Jani - Çfarë sëmundje është kjo zonjë?
- Olimbia - Në hundë, e flamosura!
- Jani - Në hundë?... E çfarë shenje ka?
- Olimbia - Ah, bela e madhe... Kullon tërë ditën...
- Jani - (*Duke qeshur*) Qenka rrufë!
- Olimbia - Rrufë, po çfarë rrufe! (*Me kuriozitet.*) Nga e folura nuk dukeni korçar.
- Jani - Jo, zonjë, jam nga Përmeti. (*Olimbinë fillon ta hajë dyshimi se mos ky është profesor Jani.*)
- Olimbia - Si ju duket klima e Korçës?
- Jani - E shëndetshme. Bën pakëz ftohtë, po durohet, s'ka lagështirë.
- Olimbia - Sa për klimë Korça jonë!... Tamam, si i thoni ju shkollarët, tropikale... (*pauzë*)
- Jani - Tropikale, jo, por...
- Olimbia - (*Që shikon vazhdimisht nga dera se mos vjen Afroviti.*)
Domosdo! Tamam tropikale s'mund të jetë, se po të qe tamam s'do ta duroni dot të ftohtët! ... Jini familisht këtu?
- Jani - Jo zonjë, vetëm. Prindërit e mi jetojnë në Përmet.
Kam edhe një motër të martuar atje.
- Olimbia - Në Venecia keni qenë?
- Jani - Jo s'më ka rënë rruga andej.
- Olimbia - Është një thagmë! Qyteti më i bukur i botës!
- Jani - Kam dëgjuar.

- Olimbia - Me të dëgjuar nuk është asgjë fare! Po ta shikoni, do të prisheni mendsh. Ato varka janë si automobila dhe ecin nëpër rrugët që janë mbushur me ujë...
- Jani - Keni qëndruar shumë në Venecia, zonjë?
- Olimbia - (Mëdyshas.) Unë?... Jo shumë... Fare pak gjëra arrita të shikoj... Vetëm tri ditë... Kish Nikollaqi punë...
- Jani - Po ndonjë qytet tjetër të Italisë keni parë?
- Olimbia - (Qesh me koketëri.) Nuk është për të thënë, por kur u kthym, udhëtua me tren tërë natën dhe nuk pashë asgjë.
- Jani - Interesant! E nga kaluat, zonjë?
- Olimbia - Nëpër Adriatik... (Pauzë)



FJALË DHE SHPREHJE

thagmë-a diçka që të çuditë
koketëri-i naze



STUDIOJMË GJUHËN E TEKSTIT

- Cilët janë personazhet?**
- Çfarë lidhje kanë dy personazhet e këtij teksti?**
- Si është Olimbia:**
e zgjuar, e prapambetur, mendjelehtë, e dashur, e sertë, e mirë, e keqe, gënjeshtare?
Çfarë bëhet në këtë tekst?
- përshkruhet natyra ose një personazh?
- shpjegohet diçka që nuk dihet nga lexuesi?
- personazhet bisedojnë me njëri-tjetrin dhe jepen të dhëna për skenën etj.?
- tregohet një ngjarje që ka hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen?
- Kush flet në këtë tekst?**
- A flet autori në këtë tekst?**
- Ky tekst është shkruar për t'u lexuar apo për t'u luajtur në teatër?**
- Çfarë është ky tekst?**



Marrë nga filmi: "Karnavalet e Korçës"



KUPTOJMË TEKSTIN

- Ku zhvillohen ngjarjet?**
- Kur zhvillohen ngjarjet?**
- Përse flasin personazhet në pjesën e parë të këtij teksti?**
- Po në pjesën e dytë?**
- Çfarë kritikon autori përmes këtij teksti?**

Vepra teatrale ose dramatike

Teksti "Karnavalet e Korçës" është një bashkëbisedim midis personazheve, emri i të cilëve gjendet para fjalëve të çdo bashkëbiseduesi.

"Karnavalet e Korçës", është shkruar posaçërisht për t'u luajtur në teatër. Autori në këtë tekst as nuk flet, as nuk jep vlerësimet e veta. Ky tekst është një vepër teatrale ose dramatike. Vepra teatrale ose dramatike, përveç dialogëve që zhvillohen ndërmjet personazheve, ka edhe të dhëna për skenën, dhe mënyrën si flasin dhe si sillen personazhet. Vepra teatrale ose dramatike ndahet në akte. Në çdo akt zhvillohet një ngjarje. Akti ka disa skena. Në një skenë paraqitet një pjesë e ngjarjes së treguar në një akt.



"Karnavalet e Korçës", në Teatrin Kombëtar, me artistët e mëdhenj: Violeta Manushi dhe Roland Trebicka



SI DHE PSE MËSOHET SHKRIMI KRIJUES

A. Të mësosh të shprehësh atë që ndjen

Nëse ju përmirësoni të shkruarit, do të keni komunikim më të mirë dhe më të thellë. Kur ju ushtroheni për të gjetur fjalën e duhur për një shkrim apo një poezi, përpiqeni t'u jepni zë emocioneve, figurave që përjetoni brenda jush. Nuk e dini ende si ta quani, por falë të shkruarit krijues gjeni mënyrën më të mirë për ta bërë, që sjell njohjen më të mirë të vetvetes.

B. Të zhvillosh plotësisht mendimet

Kur doni të thelloheni, mendoni nëpërmjet fjalëve në gjuhën letrare. Të shkruarit, është praktika që krijon lidhje ndërmjet fjalëve dhe fjalive më të ndërlikuara. Pra duke shkruar në mënyrë krijuese ju stërvitni mendimet tuaja, për ta interpretuar më mirë botën.

C. Të praktikosh empatinë

Të lexuarit dhe të shkruarit bazohen te empatia, prandaj janë dy aktivitete që nuk mund të ndahen dhe janë shumë të nevojshme në procesin e të mësuarit. Kjo për shembull ndodh ndërmjet një grupi nxënësish, një klase apo një komuniteti. Kur lexoni apo shkruani histori, viheni në rolin e personave të tjerë. Kur shkruani poezi, përdorni më tepër emocion. Ndjeni empati kur dëgjoni historinë e një personi tjetër, kur dikush nga shokët ju tregon ditën e tij. Kur krijoni, praktikoni më parë aftësitë tuaja të të dëgjuarit dhe të folurit, duke i shtuar komunikimit më shumë ndjenja njerëzore, pasion.

D. Të mësosh me kënaqësi

Të transformosh faktet në tregime, të ndihmon të kuptosh edhe më shumë se çfarë ka ndodhur. Të shkruarit e një tregimi të vogël, është si të ndjekësh një dialog teatral, duke u bërë vetë personazh i tregimit.

E. Të zhvillon bashkëpunimin

Një histori nuk tregohet kurrë vetëm me veten. Kur tregimi shkon te një botues, aty ka profesionistë: lexues, redaktor, ilustrator, kritik...Pra kur përfundohen punët në redaksi, tregimi merr formë më të plotë, sepse është frut i një pune të përbashkët. Një redaksi e vogël botuesi mund të krijohet edhe në klasë, duke ndarë detyrat. Kështu ju shfrytëzoni një krijim tuajin apo të një shoku klase, si një çast rritjeje, përballje idesh, bashkpunoni, mësoni që të çmoni kritikën dhe këshillat e "redaksisë".

K. Të shohësh në perspektivë

Shkrimi krijues, është ushtrim artistik që ju mëson t'i shikoni drejt gjërat, me vërtetësi. Kujtoni që nuk është i drejtë vetëm këndvështrimi juaj i gjërave. Në botë interpretimet mund të bëhen nga këndvështrime të ndryshme. Të shkruarit në mënyrë krijuese ndihmon zhvillimin e një pike të fortë, njohjen dhe respektimin e mendimit të të tjerëve.



Në Kosovë

Gryka e Rugovës

Kosova është veçanërisht e bukur në këto ditë nëntori me diell. Peizazhet e saj shpalohen butësisht në sytë tanë, toka pjellore, mullarë vjeshte që duken si të përshkurorë, kodrina, skërka e ujëvara aty-këtu dhe midis xhadeve, dasmat e famshme me flamur që për herë të parë i kisha parë në studion e Buzës. Kanë këto lëvizje dasmorësh një dinamikë të veçantë, një hov e një frymëzim të habitshëm.

Gjithë vitalitetin e kosovarëve e gjen në atë lëvizje, fëmijët e shumtë të ardhshëm, aty duket sikur e marrin startin.

Ujërat e Drinit të Bardhë, pishat e Deçanit, Gryka e Rugovës, më tutje Brezovica e freskët, bora në faqet e Sharrit, na mbështjellin dalngadalë si një valle e pafundme. Pas këtyre pamjeve, prapa mjegullës së kaltëreme, shfaqet e gjithëgjendshme kudo historia.

Ismail Kadare



PYETJE

132

1. Për se flitet në tekstin më lart? Si e shpreh entuziazmin ndaj bukurisë shkrimtari?
2. Ju pëlqen mënyra si e tregon autori?
3. Çfarë foljesh janë përdorur më shumë në këtë tekst?

MËSOJMË

- **Teksti “Në Kosovë” paraqet një pamje të Kosovës në një ditë nëntori me diell.**
 - Peizazhet e saj shpalohen butësisht në sytë tanë, toka pjellore, mullarë vjeshte që duken si të përshkurorë, kodrina, skërka e ujëvara aty-këtu dhe midis xhadeve, dasmat
 - e famshme me flamur që për herë të parë i kisha parë në studion e Buzës.
 - Ujërat e Drinit të Bardhë, pishat e Deçanit, Gryka e Rugovës, më tutje Brezovica e freskët, bora në faqet e Sharrit, na mbështjellin dalngadalë si një valle e pafundme.
- **“Në Kosovë” është një përshkrim.**
- **Përshkrimi paraqet tiparet fizike ose shpirtërore të njeriut, karakteristikat e një kafshe, të një objekti të një peizazhi natyror etj.**
- **Përshkrimi mund të jetë pjesë më vete, por shpesh mund të jetë pjesë përbërëse e një tregimi realist ose fantastik.**

Në përshkrim përdoren shpesh foljet: jam, dukem, kam dhe mbiemrat.

Kosova është veçanërisht e bukur në këto ditë nëntori me diell. Peizazhet e saj shpalohen butësisht në sytë tanë, toka pjellore, mullarë vjeshte që duken si të përshkurorë, kodrina, skërka e ujëvara aty-këtu dhe midis xhadeve, dasmat e famshme me flamur që për herë të parë i kisha parë në studion e Buzës.

Në përshkrim përdoren kryesisht e tashmja dhe e pakryera e foljeve.

Ujërat e Drinit të Bardhë, pishat e Deçanit, Gryka e Rugovës, më tutje Brezovica e freskët, bora në faqet e Sharrit, na mbështjellin dalëngadalë si një valle e pafundme. Pas këtyre pamjeve, prapa mjegullës së kaltëreme, shfaqet e gjithëgjendshme kudo historia.

Ku vendoset përshkrimi

- Në fillim të një tregimi kur përshkruhet vendi, rrethanat ku do të fillojë veprimi. Ky vend mund të jetë sipas rastit: një peizazh (pyll, mal, rrugë etj.), një mjedis i mbyllur (një shtëpi, dhomë, klasë etj.)
- Në brendësi të një tregimi: kur prezantohet një personazh i ri (e paraqesim duke përshkruar fizikun e tij, gjestet, qëndrimet, pra, portretin e tij).



KUJDES

1. Për të përshkruar gjëra që shihen mund të përdorim fjalë ose shprehje si këto: shoh, shikoj, vështroj, vë re, vërej, shquaj, diktoj, rrok me sy, hedh sytë, hedh vështrimin, hedh shikimin, sodit.
2. Për të përshkruar gjëra që dëgjohen mund të përdorim fjalë a shprehje si këto: dëgjoj, vë veshin, kap me vesh.
3. Për të përshkruar gjëra që preken mund të përdorim folje si këto: prek, kap, zë, cek.
4. Për të përshkruar gjëra që shijohen mund të përdorim fjalë a shprehje si këto: shije e ëmbël, (e thartë, e hidhur, e hollë, artistike), pa shije, më shijon etj.



USHTROHUNI

Pasi ta lexoni tekstin më poshtë, vini re se si përdoren elementet karakteristike të përshkrimit: foljet, mbiemrat dhe fjalori, nga autori i shquar.



Toka e Zjarrit

Do të ketë qenë me të vërtetë një pamje e çuditshme, kur katër anije, për herë të parë në historinë e njerëzimit, hynë me ngadalë e pa zhurmë në këtë ngushticë të heshtur e të zymtë, ku s'kishte hyrë njeri që prej kohëve të lashta.

Aty i priti një heshtje e llahtarshme. Kodrinat bregdetare dukeshin si male magneti, qielli, gjithnjë i veshur me re, varej poshtë, i vrenjtur dhe ujërat nxinin. Si hije midis hijeve të katër anijet lundronin në heshtje në këtë botë fantazmë.

Së largu shkëlqenin majat e maleve, të mbuluara me borë dhe era sillte frymën e tyre të ftohtë.

Nuk dukej asnjë qenie e gjallë rreth e qark, e megjithatë diku nëpër kodrina dalloheshin zjarre flakëruese, prandaj Magelani e quajti këtë tokë "Terra de Fuego"- Toka e Zjarrit.

Stefan Cvajg



1. Cilat faqe interneti zyrtare do të përdornit për të ditur ekspeditat e fundit në natyrën shqiptare dhe botërore?
2. Si i gjetët ato?
3. Në çfarë gjuhe përshkruheshin kryesisht ngjarjet?

1. Përshkrimet, tregimet, ditaret, letrat, poezitë etj., janë krijime me shkrim që kushdo i bën, që t'ua transmetojë të tjerëve madje edhe vetëm vetes (për shembull - ditari).

Ai që shkruan, krijon dhe do të krijojë lidhje të ndryshme me të tjerët. Këto prova të para që bëni, në forma të ndryshme: duke shkruar letra miqve që keni njohur në pushimet verore, shoqeve ose shokëve imagjinare, duke mbajtur përditë ditar, ku tregoni ngjarjet kryesore të ditës: situata gazmore që krijohen në klasë, etj., janë provat e para në rrugën e krijimit.

2. Letrat shoqërore që ia drejtojni një shoku, një shoqeje, një miku, një të afërmi, janë prova të para krijimi.

3. Kur i tregoni me shkrim një ngjarje një shoku, shoqe apo prindërve, duhet të keni parasysh këto rregulla:

a) tregimi të jetë interesant;

b) të ketë formën e duhur (fillon tregimi, zhvillohet ngjarja, përfundon ajo);

c) të jetë i qartë dhe të lexohet lehtë;

d) duhet të shpreheni me fjali të shkurtra, por interesante;

e) tregimi duhet të rrjedhë natyrshëm, me hollësira të lezetshme e komente, që ta kënaqë shokun tënd, lexuesin e ardhshëm.

g) stili përshkruet në fillimet tuaja krijuese, është më i përshtatshmi.

f) tregoni ngjarje të vërteta ku episodet të kenë rrjedhshmëri logjike etj.



USHTROHUNI

1. Gimi dëshiron t'i shkruajë të atit, i cili prej dy javësh ndodhet në një vend kurimi, sepse ka një sëmundje të vështirë, por që do të kalojë. Ai mendon t'i shkruajë babait kështu:

Në fillim e pyet për shëndetin, sepse ka shumë merak për të. Babai ishte heroi i tij, "supermeni" i familjes... Pastaj do ta gëzojë babain. I tregon që shkon mirë me mësim dhe ka marë notën 9 në gjuhën shqipe. Do t'i tregojë që jeta e tij, rrjedh e natyrshme dhe e larmishme. Me klasën të nesërmen, do të shkojnë një ekskursion mësimor në Durrës, për të parë "Muzuemin Arkeologjik". Ai i tregon për kohën, që për fat ka qenë e mirë, nuk ka rënë shi. Nuk do ta mërzisë, por do t'i tregojë të vërtetën, që Arta (motra) ka qenë sëmurë nga "bajamet", por është më mirë. Pastaj i tregon një situatë komike, kur mami desh ra duke vendosur perdet e lara, por për fat, shpëtoi...

Si mendoni, do ta lexonte me interes babai një letër të tillë? Cilave pjesë do t'u kushtojë më shumë vëmendje?

2. Shkruajini një shoku imagjinar (ditarit). Përdor udhëzimet për formën dhe stilin tërheqës të krijimit.

Në shkrimin tuaj tregoni se keni filluar të stërviteni me skuadrën e volejbollit të shkollës. Nuk po anashkaloni mësimet, por ju pëlqen shumë ky lloj sporti, megjithëse në stërvitje lodheni shumë. Ju mendoni se kjo pjesëmarrje aktive në sport do t'ju ndihmojë të bëheni në të ardhmen gazetarë sportivë. Keni mbetur aq të mahnitur nga lojërat olimpike dimërore, që sapo u zhvilluan, sa dëshironi patjetër të mësoni të ngjiteni me ski në Alpet e Shqipërisë, që kanë bukuri të rallë.

Tregojani shokut tuaj dëshirën e fshehtë që keni, të bëheni gazetar sportiv, por edhe shkrimtar tregimesh realiste, nga jeta e vërtetë.

Krijo dhe shkruaj në fletore ato që ndien pas dëgjimit të intervistës së shkrimtarit Indrit Budina

Gazetarja - Ju lutem, a mund të na tregoni se ju lindi dëshira për të shkruar?

I. Budina - Dëshirën për të shkruar e kam pasur që në fëmëni. Mësuesja e klasës së pestë hartimet e mia i lexonte me zë të lartë dhe i komentonte para klasës. Megjithatë, unë nuk besoja se një ditë do të bëhesha shkrimtar, sepse më dukej se këtë mund ta arrinin njerëz që kishin aftësi të veçanta.

Gazetarja - Diçka për shkrimin tuaj të parë?

I. Budina - Unë nuk e di, nuk e kujtoj kush është shkrimi im i parë. Po libri im i parë quhet: "Mësuesi im". Në të vërtetë është vëllim me poezi, i shkruar gjatë viteve të gjimnazit nga një adoleshent pasionant. Libri im i parë u prit shumë mirë dhe më nxiti të shkruaj libra të tjerë, në poezi e prozë.

Gazetarja - Cila është e veçanta e shkrimeve tuaja, që i bën ato kaq interesante dhe të pëlqyera për publikun e gjerë?

I. Budina - Nuk e di. Po e vërteta është se unë shkruaj ato që ndiej në natyrë e shoqëri. Në shkrimet e mia përqipem të jem sa më i vërtetë. Përjetimet e mia janë përjetimet e një njeriu që jeton, gëzohet, vuan bashkë me njerëzit. Ndoshta ndjeshmëria dhe dashuria për njeriun është e veçanta e veprave të mia.



Gazetarja - Ç'mendim keni për letërsinë shqiptare?

I. Budina - E kam të vështirë të jap mendim për këtë. Unë nuk jam studiues i letërsisë, po mund të them se ka suksese të rëndësishme në këtë fushë. Mendoj se letërsia duhet të pasurohet e modernizohet më tej, të zgjerojë këndin e vështrimit të jetës.

Gazetarja - Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

I. Budina - Nuk kam dëshirë të flas për plane. Krijimi nuk ecën me plan, megjithatë kam shumë shqetësime dhe shpresoj që, së shpejti, t'i jap publikut një vepër të re për fatin e krijuesit në shoqërinë e sotme.

Gazetarja - Ju faleminderit dhe suksese!

MËSOJMË

- Intervista është biseda që bën një gazetar/ gazetare, me një person (artist, shkrimtar, arkitekt) për ta pyetur për jetën e tij, për projektet e tij, për idetë e tij etj., me qëllim që t'ia bëjë të njohura publikut të gjerë sa më thjesht ato.
- Për të bërë një intervistë, duhet:
 1. Të përcaktoni njeriun që do të intervistoni, pra, të intervistuarin, të takoheni me të, t'i parashtroni kërkesën dhe pyetjet dhe pastaj të caktoni datën, vendin dhe orën e takimit.
 2. Të bëni gati pyetjet. Ato duhet të jenë të qarta dhe, mundësisht, sa më të shkurtra.
 3. Shpesh intervista fillon me një konstatim që pasohet nga një pyetje.
 4. Të jeni sa më i sjellshëm, të dëgjoni me kujdes, të mos e ndërprisni bashkëfolësin gjatë përgjigjes dhe të mos harroni ta falenderoni në fund të intervistës.



PYETJE

1. Lexoni tekstin dhe tregoni çfarë është?
2. Ku ndryshon intervista nga llojet e tjera të teksteve (poezi, prozë, dramë)?
3. Kush pyetet ose intervistohet dhe përse?
4. Si fillon intervista? Po pyetjet si janë?



KUJDES

Gjatë intervistës duhet të mbani shënime, pra, të mos mbështeteni vetëm në kujtesën tuaj. Kur të citoni fjalët e të intervistuarit, duhet t'i shkruani ato me kujdes dhe të merrni miratimin e tij për saktësinë e atyre që keni shkruar. Duhet shkruar vetëm e vërteta!



USHTROHUNI

1. Vazhdojeni këtë intervistë (në fletoren tuaj), sikur t'i keni të dyja rolet:

Intervistë me drejtoreshën e shkollës sonë, Mira Korabi.

Gazetari: - Ju jeni drejtoreshë e shkollës, a mund të na jepni një intervistë?

Drejtoresha: - Me kënaqësi.

Gazetari: Kur e keni mbaruar shkollën e lartë?...

Drejtoresha: - Unë...

2. Intervistoni njërin nga nxënësit e klasës suaj. Mbani shënime dhe krijoni një shkrim në formë dialogu, ku ju të jeni intervistuesi. Pasi të mbaroni krijimin tuaj, lexojeni intervistën para klasës, ose interpretojini së bashku (si teatër).

Shkrimi paraqitës është krijim. Ky lloj shkrim që ka për qëllim të flasë për disa probleme dhe tema të caktuara. Për këtë është e domosdoshme që gjatë përpilimit të shkrimit paraqitës të mbështetemi fort tek të dhënat dhe te dokumentet që zotërojmë, të cilat duhen paraqitur dhe vlerësuar me saktësi. Kur hartojmë shkrim paraqitës, duhet të kemi parasysh këto faza:

- Grumbullimin e të dhënave dhe fakteve;
- Klasifikimin dhe përshkrimin e të dhënave;
- Vërejtjet, ballafaqimin dhe kritikën ndaj të dhënave.

Ja një shembull shkrimi paraqitës krijuar e shkruar në mënyrë letrare nga Mihal Grameno në librin e tij: "**Kryengritja shqiptare**".

Lufta e Mashkullorës (fragment)

Në orën 7 zuri lufta e rregullshme edhe e rreptë. Ushtria ishte përhapur edhe na kish rrethuar nga gjithë anët, edhe që andej na luftonte. Nuk dua të shtoj, po përkundrazi, të pakësoj numrin e ushtrisë, që përbëhej prej më tepër se 150 shpirt, kurse ne nuk ishim, siç dihet, veçse pesë shpirt. Përveç kësaj, nuk duhet harruar që ne bënim ekonomi të madhe në fishekë, se gjithnjë Çerçizi bërtiste: "Mos harxhoni, o shokë, fishekët më kot!"

Plumbat na vinin si breshëri, po ne, si ca statuja, qëndronim në vendet tona, edhe u përgjigjeshim me plumba, dhe duke qëlluar, në këndonim këngë kombëtare.

Kërkoj ndjesë, se më mungon fuqia e duhur për të treguar, zbukuruar edhe stolisur, siç meriton, burrërinë që tregoi trimi ynë kapedan, luftëtari i madh edhe i patrembur, që nderoi armët e Shqipërisë! Po, kapedani ynë i shtrenjtë, Çerçizi, u tregua si një dragua në këtë luftë, kështu që historia kombëtare do të mburret me emrin e këtij djali të ri, po burri të madh të Shqipërisë.

Vetëm edhe vetëm atëherë munda të besoj historinë e kombit tonë me burrërinë edhe trimërinë e stërgjyshërvet tanë. Atëherë vetëm munda të kuptoj e të çmoj vleftën e këtij djali trim, të cilit, me gjithë që ishte rritur i përkëdhelur, nuk i trembej syri kurrë nga vdekja.

Kokëjashtë, me leshrat përpjetë, vërtitej më gjithë anët si një komandant i madh, me pushkën në dorë edhe gjastoren në brez duke na mburrur ne edhe duke qëlluar mbi ushtarët. Fytyra e tij këtë ditë ishte më e çelur se kurdoherë, edhe jo sikur luftonte, po sikur kërcente...

Referati

Referati, në krahasim me shkrimin paraqitës, është më i gjerë, ka një shtrirje më të madhe. Ai nuk është një përshkrim i thjeshtë, mbasi në të autori paraqet dhe mendimin e tij lidhur me atë për të cilën po shkruan.

Ka dy lloje referatesh: Referat teknik ose shkencor dhe Referat për udhëtime. Referati shkencor ka lidhje me një problem shkencor dhe për këtë shkruhet nga shkencarët, filozofët, teknikët.

Referati për udhëtime niset nga përvoja vetjake e atij që shkruan. Një përshkrim udhëtimi interesant në formë referati, ka shkruar **Vedat Kokona** me titull: "Nga Tirana në Stokholm". (Kërko **në internet** ose me adresën: **www. b.k.al**)



Vedat Kokona, shkrimtar, përkthyes dhe hartues i fjalorit frëngjisht-shqip.



PUNË ME TEKSTIN

- **1. Ndryshoje këtë pjesë** që është marrë nga një ditar, duke e kthyer në një krijim përshkrues të shkurtër, sa më realist.

12. 06. 2025

U nisëm herët për Durrës, por rrugës na u prish makina. Petriti që i di mirë këto punë, e rregulloi shpejt. Kur dolëm ne në plazh të laheshim, të tjerët kishin arritur para nesh. Mund të them se dje unë mësova një not të ri – notin bretkosë.

13. 07. 2025

As unë as të tjerët nuk e prisnim që natën të prishej moti e të binte shi. Po në mëngjes shiu pushoi dhe doli Dielli. Rrezet e ngrohta e thanë rërën menjëherë. Vëllai i vogël, Beni m'u lut t'i bëja me rërë një pallat. Unë i bëra nja kala – kalanë e Krujës. Dhe nuk e bëra keq. Edhe të tjerët thanë se i ngjante mjaft kalasë së Krujës.

14. 09. 2025

Sot, megjithëse është shtator, bën vapë dhe shkuam në Durrës. Për drejç më përvëloji në pulpë një kandil deti. Vendi m'u skuq, por mami më çoi menjëherë në infermeri, ku ma lyen pulpën e skuqur me një pomadë, të cilit nuk ia di emrin. Kur u ktheva përsëri në plazh, e pashë kandilin në rërë, të ngordhur. Nuk e di, po mua më erdhi keq për atë...

2. Mbaj shënime për një film, duke pasur në qendër të vëmendjes sidomos ngjarjen që tregohet në të, personazhet dhe skenat më të rëndësishme dhe të bukura.

Duke u mbështetur në shënimet e marra, përmbli dhe me shkrim si tregim origjinal dhe lexoja shokëve. Nëse atyre ju pëlqen, jeni në hapat e para të krijimit.

3. Ndiq në televizor një ndeshje futbolli, mbaj shënime për:

- lojtarët,
- për lojën,
- gjendjen e golave,
- dhe për veprimet më të bukura.

Duke u mbështetur në shënimet e tua, bëj një përshkrim krijues për paraqitjen e ndeshjes, duke shprehur edhe vlerësimin tuaj për lojën në tërësi.

4. Po organizohet një shëtitje me shkollën për disa ditë.

- Disa duan të shkojnë për të parë vende historike,
- Disa të tjerë duan të shkojnë në plazh për t'u larë etj.
- Ti vetë, ç'dëshirë ke. Ku dëshiron të shkosh?

Shkruaj skemën e arsyeve që do të sillje gjatë diskutimit për të mbrojtur dëshirën tënde.



- 1. Matni kohën që ju duhet për të kopjuar në fletore dy paragrafët e fundit të shkrimit "Lufta në Mashkullorë".**
- 2. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.**

ZBULOHEK NË EUROPË NJË VËZHgues I VJETËR ASTRONOMIK

Arkeologët kanë zbuluar vëzhguesin më të vjetër astronomik në Europë afër qytetit Gosek të shtetit *Saksoni-Anhalt* në Gjermani. Diametri i tij është 75 m. Ky vend arkeologjik ndodhet 25 km., larg pyllit të fshatit Nebra, ku u zbulua tre vjet më parë një disk i periudhës së *Bronzit të Hershëm*, i zbukuruar në ar.

Arkeologët mundën të përcaktojnë datën e vëzhguesit astronomik nëpërmjet metodës së karbonit, të zbatuar tek dy maja shigjetash dhe kockash të kafshëve të gjetura brenda unazave të vëzhguesit astronomik.

Analizat treguan se mosha e vëzhguesit astronomik është diku midis viteve 5000 - 4800 para erës sonë, gjë që e bën atë vëzhguesin astronomik më të vjetër në Europë. Ky vëzhgues astronomik është rreth 7000 vjeçar dhe me këtë moshë është më i vjetër se ai i zbuluar në Britani, i njohur me emrin Rrethi i Gurëve (*Stonehedge*, 2000 para erës sonë).

Arkeologëve iu tërhoq vëmendja për herë të parë më 1992, kur fotografitë nga ajri tregonin rregullsi gjeometrike të kodrinave në atë zonë. Megjithatë, gërmimet filluan më vonë.

Zbulimi arkeologjik në Gosek dallon qartë nga 180 vendet e tjera të ngjashme parahistorike të shpërndara nëpër Europë.

Zakonisht, në vendet e tjera ka katër porta që të çojnë në mjediset në formë rrethi, kurse në Gosek ka vetëm tri porta të tilla.

Astrofizikani Shloser i Universitetit të Ryhrit në Bohum pranon se vendi arkeologjik i zbuluar ka qenë ndërtuar për të vëzhguar dukuri astronomike të tilla si: lëvizjet e Diellit, lëvizjet e Hënës, yjeve dhe për të ndjekur kohën.

Për shkak se unazat dhe portat në rathët e brendshëm bëhen më të ngushta, sa më shumë i afrohemi qendrës, arkeologët mendojnë që vetëm pak njerëz lejoheshin të futeshin në unazën më të vogël. Arkeologët kanë gjetur mjaft dëshmi që provojnë që Goseku ishte një vend ku nderoheshin hyjnitë parahistorike.

Saimir Loni



PYETJE

Teksti është krijim:

a) publicistik, b) shkencor, c) artistik?
Argumentoni përgjigjen.

• Çfarë lloj teksti është:

a. vjetërsia e vëzhguesit më të madh astronomik,
b. zbulimi i vëzhguesit më të madh astronomik,
c. përshkrimi i vendit dhe i mjedisit ku ndodhet.
Argumentojeni mendimin tuaj.

• Cila nga shprehjet në vijim është e saktë?

a. Vëzhguesi më të vjetër astronomik ndodhet në Francë.
b. Arkeologët nuk mundën të përcaktojnë datën e vëzhguesit astronomik.
c. Vendi arkeologjik i zbuluar ka qenë ndërtuar për të vëzhguar dukuri astronomike të tilla si: lëvizjet e Diellit, Hënës, yjeve.



• **Forma e tregimit që mbizotëron në tekst si është?**

- a) përshkrim b) tregim në vetën e parë c) tregim në vetën e tretë.

Mësoni të argumentoni përgjigjen.

• **Si është qëndrimi ndaj objektit të tregimit?**

- a) subjektiv b) objektiv.

Mbi ç'bazë e nxirrni këtë përfundim?

• **Në tekst çfarë lloj tregimi përdoret:**

- a. tregimi kronologjik; b. tregimi retrospektiv; c. edhe njëra, edhe tjetra.

Argumento përgjigjen. Mëso të krijosh me këtë stil letrar, në vetën e parë.

PËRMBLEDHIM

Të treguarit e ngjarjeve në vetën e parë i jep tregimit të ngjarjes karakter subjektiv, kurse të treguarit e ngjarjes në vetën e tretë i jep tregimit të ngjarjes karakter objektiv.



USHTROHUNI

1. Të treguarit përdoret:

- a) në tekstet publicistike;
b) në stilin administrativ;
c) në përshkrimin e ambientit të brendshëm;
ç) në tekstet historike;
d) në ligjërimin bisedor.

Qarko numrin para përgjigjeve të sakta.

2. Lexoni fjalitë.

a) Fjalitë renditi si duhet për të përfutur tekstin në të cilin ngjarjet paraqiten në mënyrë kronologjike.

1° Gjergj Kastrioti lindi më 6 maj 1405. U mor peng nga Pushtuesit Osmanë që në moshë të mitur dhe u dërgua në oborrin e Sulltanit në Adrianopojë. Atje mori emrin Skënder (Aleksandër).

2° Ai nuk e harroi kurrë Atdheun e tij të dashur dhe priste me padurim rastin të kthehej në tokën që e lindi. Me vdekjen e të atit, ai shpresonte t'i zinte vendin, por në fakt sulltani e emëroi sanxhakbej jashtë tokave shqiptare.

3° Skënderbeu u nis kundër Janosh Huniadit nën komandën e bejlerbeut të Rumelisë. Ushtria osmane u shpartallua dhe u tërhoq në panik. Skënderbeu së bashku me 300 kalorës shqiptarë u kthye në atdhe, ku populli e priti si çlirimtar.

4° Pas mbarimit të shkollës, Gjergj Kastrioti "Skënderi" kreu detyra ushtarake në Ballkan e në Azinë e Vogël, duke u dalluar për trimëri dhe për këtë arsye iu dha titulli bej që do të thotë princ ose fisnik.

5° Me një ferman të rremë shtiu në dorë qytetin dhe garnizonin e Krujës dhe kështu më 28 nëntor 1443 u shpall rimëkëmbja e principatës së Kastriotëve. Mbi kështjellën e Krujës u ngrit flamuri shqiptar, me shkabën e zezë dykrenare.

b) Mënyra e të treguarit të vëzhguesit më të vjetër është:

1. objektive apo 2. subjektive?

c) Si do ta tregonit ju një ngjarje të tilë? Proveni në fletoren tuaj.





LEXONI



Nonda Bulka

Një hardhi e lartë me fletë të gjera dhe plot me kopanë rrushi që shkëlqenin si ar, vuri re një drenushë me brirë të gjatë që po kalonte me vrap aty pranë.

- Ja një drenushë e mjerë, tha pjergulla me vete, që s'di nga t'ia mbajë; po e ndjekin qentë, të gjorën! Sikur të kthente kokën këtej ngë unë do ta pështillja me fletët e mia dhe do ta fshihja nga sytë e armiqve.

S'kaloi shumë kohë kur drenusha, sipas zakonit që ka për të humbur gjurmët e ndjekësve, u kthye përsëri nga rruga që kish bërë dhe kështu pjergulla zemërgjerë pati kohë sa t'i thotë:

-Futu shpejt nën fletët e mia që të shpëtosh!

Drenusha i dëgjoi fërfëllimat e pjergullës dhe, pa humbur kohë, u struk nën fletët e gjera, pa bërë as më të voglën lëvizje. Qentë kaluan disa herë me radhë aty pranë, u kthyen përsëri, po s'mundën ta gjejnë. Ndofta era që frynte nga ana e kundërt ose kundërmimi i fortë i luleve bënë që qentë të mos e ndjenin erën e drenushës dhe të mos e zbulonin dot.

- Po largohen, ja po largohen – murmuriti lehtë pjergulla, e kënaqur që e shpëtoi drenushën e gjorë nga vdekja e sigurt.

Drenusha zgjati kokën përmes fletëve dhe vuri re se vërtet qentë dhe gjahtari ishin larguar mjaft.

NONDA BULKA ka qenë publicist, shkrimtar e përkthyes shqiptar. Lindi në Përmet në 1906 dhe vdiq në Tiranë në 1972. Studimet e para i mori në vendlindje, pastaj në Liceun e Korçës dhe shkollimin e lartë në Francë për drejtësi. Bulka u njoh si publicist e satirik duke trajtuar tema të ndryshme shoqërore, e më pas si tregimtar e poet. Provat me humor e ironi si dhe skicat në prozë, të botuara me pseudonimin Chri-Chri, u bënë të njohura për kritikën therëse ndaj kushteve politike e shoqërore nën qeverisjen e Mbretit Zog.

Po a dini se ç'bëri atëherë drenusha? Ajo harroi shumë shpejt të mirën që i kish bërë pjergulla dhe, pa pikë turpi, nisi të hajë njëren pas tjetrës fletët e pjergullës që e kishte shpëtuar nga rreziku....

Kur u ngop mirë e mirë dhe e la pjergullën gati lakuriq, pa fletë, doli jashtë. Në atë kohë gjahtarët dhe qentë po ktheheshin përsëri. Ata e panë e i lëshuan qentë, të cilët e kapën, e shqyen dhe e bënë copë-copë...


Nonda BULKA

LEXOJMË PËRMBLEDHJEN

Një hardhi vë re një drenushë që po kalon me vrap pranë saj. Pjergulla i thotë të fshihet në fletët e saj. Drenusha fshihet nën fletët e pjergullës. Qentë kalojnë disa herë po nuk e gjejnë dot. Pjergulla është kënaqur që e ka shpëtuar drenushën nga vdekja. Po drenusha e harron të mirën që i bëri pjergulla dhe nis të hajë fletët e pjergullës.... Kur del jashtë, qentë e kapin dhe e bëjnë copë-copë...

- Kush e ka shkruar tekstin "Drenusha dhe pjergulla"?
- Çfarë është teksti "Drenusha dhe pjergulla"?
- Teksti i dytë si është realizuar?
- Çfarë të dhënash janë ruajtur në përmbledhje?
- Çfarë elementesh janë hequr?
- Krahasoni kohët e foljeve të përdorura në të dy tekstet. Çfarë vini re?

Fragment tregimi



Mora një levrek të madh nga ata që kisha nxjerrë, i çava barkun dhe futa brenda një dinamit të tërë. Fitolin e lashë të gjatë. Kur sillej peshkaqeni ja, ja aty poshtë, ndeza fitilin dhe e vërvita në det levrekun me dinamit në bark. Peshkaqeni, me ta parë, e gëlltiti. Unë desh u çmenda nga gëzimi. Prisja nga çasti në çast që të pëlciste dinamiti. "Ma more të keqen!" - i thashë me zë. Dhe në këtë kohë u dëgjua një plasje e thellë, si në fund të dheut. Peshkaqeni bëri dhjetëra rrokullisje të shpejta si elika gjigante e vaporit. Herë i dukej koka mbi det, herë i dukej bishti. Deti u turbullua, sikur po bëhej kiameti. Peshkaqeni ende po rrokullisej si një përbindëh i tmerrshëm.

Sa i fuqishëm që ishte! Kurrë s'e besoja që peshkaqeni të mos ngordhte duke i plasur dinamiti në bark. Edhe shkëmbi çahet e thërrmohet nga dinamiti! Prita shumë minuta për të parë se ç'do ndodhte. Peshkaqeni po e humbiste forcën. Pak nga pak e rralloi rrutullimin. U zgjat. E, kur e pashë të kthehej me barkun nga dielli, thirra: "Ta mora hakun, baba!"

Petro MARKO

1. Përmbliidhni një ngjarje të veçantë tuajën, me një tekst të përafërt.

2. Shkruani në fletore përmbledhjen e një libri që ju ka pëlqyer.

Kujdes!

Kur bëni përmbledhjen e një libri:

- Tregoni titullin dhe autorin e librit.*
- Tregoni shkurt për çfarë flet libri, pra, temën kryesore të librit.*
- Pastaj tregoni disa fakte ose ngjarje interesante nga libri.*
- Së fundi tregoni a ju ka pëlqyer libri dhe pse.*

MËSOJMË

Përmbledhja është zëvendësim i një teksti më të gjatë me një tjetër më të shkurtër, por duke ruajtur të dhënat kryesore të tekstit fillestar. Përmbledhja është një tekst tjetër. Ajo duhet të jetë e kuptueshme për cilindo që nuk e ka lexuar tekstin.

Përmbledhja duhet të jetë e të njëjtit tip si edhe teksti i fillimit.

- *tregim* bëjmë përmbledhje treguese
- *shpjegim* bëjmë përmbledhje shpjeguese

Përmbledhja ka tri pjesë: a. hyrjen, b. zhvillimin dhe c. përfundimin.

- Një hardhi vë re një drenushë që po kalon me vrap pranë saj. Pjergulla i thotë të fshihet në fletët e saj.*
- Drenusha fshihet nën fletët e pjergullës. Qentë kalojnë disa herë po nuk e gjejnë dot. Pjergulla është kënaqur që e ka shpëtuar drenushën nga vdekja. Po drenusha e harron të mirën që i bëri pjergulla dhe nis të hajë fletët e pjergullës...*

c. Kur del jashtë, qentë e kapin dhe e bëjnë copë-copë.

Një tregim përmbliidhet në vetën e tretë dhe në kohën e tashme të dëftores. Duhet të ruhet rendi kronologjik ose radha e ngjarjeve dhe të dhënat kryesore. Dialogët duhet të ngjishen duke i kthyer në ligjëratë të zhdrejtë. Përshkrimet duhet të hiqen.

Teksti shpjegues përmbliidhet duke hequr të dhënat e dorës së dytë ose të panevojshme dhe duke i rigrupuar e lidhur me njëra-tjetrën ato që mbetën.

KRIJIM ME FAKTE HISTORIKE DHE FJALË TË HUAJA

Për të përshkruar një ngjarje historike shkrimtarëve ju duhet të përdorin fjalë ose toponime të huaja.

Në pallatin e Sinjorisë

Në **pallatin e Sinjorisë**, pesë ditë pas vdekjes së **Alvise Vivarin**, u mbledh **Këshilli i Dogjeve**.

Duhej caktuar piktori që do të vazhdonte punimet e lëna përgjysmë nga **Vivari** në **monumentin e Frarëve**.

Në mbledhjen e këshillit që thirrur edhe piktori shqiptar **Mark Bazaiti** dhe dy piktorë të tjerë

venedikas.

I pari i Këshillit të Dogjëve tha: "Monumenti i Frarëve duhet të mbarojë. Ne do të caktojmë se kush do të ketë të drejtën për të vazhduar punën e **mjeshtrit** të vdekur. Për këtë ju, (iu drejtua tre piktorëve) do të viheni në provë. Do të pikturoni nga një **subjekt** dhe, pas 10 ditësh, do të gjykojmë për punët tuaja e do të vendosim".

Moikom Zeqo



PYETJE

1. Kërkoni nëpër fjalorë origjinën e fjalëve me shkronja të zeza të theksuara.
2. A ka fjalë të tjera në këtë tekst që ju mendojnë se janë me burim të huaj. Thoni cilat janë ato.
3. Nga mund të jenë huazuar?

MËSOJMË

1. Në gjuhën shqipe përveç fjalëve me burim vendës ka edhe fjalë të huaja nga gjuhë të ndryshme:

- **Nga greqishtja:** *qersh*, *pjepër*, *lakër* etj.
- **Nga latinishtja:** *flokë*, *faqe*, *fytyrë*, *këmbë*, *prind*, *lepur*, *shëndet* etj.
- **Nga sllavishtja:** *trup*, *kockë*, *strehë*, *kovë*, *kyç*, *lopatë*, *mace*, *gozhdë*, *çekiç*, *krahinë* etj.
- **Nga turqishtja:** *penxhere*, *odë*, *aksham*, *bari*, *dauille*, *dyfek*, *çarçaf*, *çorape*, *hambar*, *manushaqe*, *bilbil*, *perde*, *raki*, *tepsi*, *xhezve*, *kafe*, *baba*, *xhaxha* etj.
- **Nga italishtja:** *bankë*, *barkë*, *vapor*, *velë*, *timon*, *trumbetë* etj.
- **Nga frëngjishtja:** *dosje*, *adresë*, *mesazh*, *plazh*, *autobus*, *kamion*, *shampanjë*, *festival*, *garazh*, *hotel*, *menu*, *taksi*, *reklamë* etj.
- **Nga anglishtja:** *futboll*, *gol*, *film*, *klub*, *piknik*, *pulovër*, *sandviç*, *sponsor*, *uiski*, *vikend* etj.

2. Këto fjalë kanë hyrë në gjuhën shqipe si rezultat i kontakteve që ka pasur gjuha shqipe me gjuhë të tjera si greqishtja, latinishtja, sllavishtja, turqishtja, italishtja, frëngjishtja dhe anglishtja.

3. Gjuhën shqipe me disa nga këto gjuhë e ka lidhur historia (kujtoni pushtimin romak, osman, italian, gjerman), kurse me disa të tjera fqinjësia, ekonomia dhe kultura.

4. Si rezultat i këtyre marrëdhënieve në shqipen kanë hyrë mjaft fjalë të huaja të cilat janë bërë pasuri e shqipes: *qersh*, *pjepër*, *lakër*, *këmbë*, *prind*, *lepur*, *trup*, *kockë*, *strehë* etj.

5. Disa nga fjalët e huaja janë të panevojshme dhe nuk duhen përdorur sepse për ato ekziston fjala shqipe:

distancë – *largësi*, *fenomen* – *dukuri*, *presion* – *trysni*,
instrument – *vegël*, *inicativë* – *nismë*, *ofendoj* – *fyej*

6. Kohët e fundit kanë hyrë në përdorim mjaft fjalë të huaja, si: *kasetë*, *disko*, *teleks*, *faks*, *komputer*, *semafor* etj.

Krijim me fakte historike - fjalë nga gjuhë të huaja

Në gjuhën shqipe kanë hyrë shumë fjalë nga gjuhët e tjera, megjithatë ajo ka ruajtur origjinalitetin e saj si gjuhë me strukturë fonetike, gramatikore dhe leksikore të veçantë. Rreth dy mijë fjalë të shqipes janë me origjinë shumë të lashtë ose siç quhen ndryshe me origjinë indoevropiane: ditë, natë, dimër, ujë, ha, pi, jam, kam, zog, dem, elb, etj.



KUJDES

Fjalët e mëposhtme që kanë hyrë nga greqishtja e vjetër, latinishtja ose nga italishtja a frëngjishtja, shkruhen dhe lexohen me l dhe jo me ll: atlas, gjeolog, holandez, kolonë, lotari, sandale, tablo, zoologji etj.

Krijim me fakte historike

Ky ishte Mark Bazaiti, shqiptar në Venedik, piktor i ri, që premtonte shumë.

- Si jeni mjeshtër? - i tha Marku Alvises që po lëngonte.

- Me sa duket po vdes, - buzëqeshi me hidhërim Alviseja.

- O jo, mjeshtër, jo... - tha djaloshi i prekur.

- Djalosh, shpejt, se s'kam më kohë, - tha me mundim Alviseja. - Ti e di se unë kam lënë përgjysmë monumentin e Frarëve. Aty kam pikturuar gjërat më të mira të jetës sime. Por mbetën të pambaruara. Ti duhet t'i vazhdosh, t'i përfundosh ato. Ti je krejtësisht i denjë për këtë!

Djaloshi Mark u përlot. Alvise Vivarini, një nga piktorët më të mëdhenj të Venedikut, po i bënte një nder të madh dhe po e vlerësonte si askush.

- Faleminderit, mjeshtër! - belbëzoi Marku me zë të ngashëruar.

Moikom Zeqo



MOIKOM ZEZO (1949-2020)

Ka qenë publicist, shkrimtar. Është autori i 62 librave me poezi, studime arkeologjike, histori artit, skenarë për filma e televizivë me karakter arkeologjik dhe kulturor. Krijimet e Moikom Zeqos janë përkthyer në gjuhët: anglisht, frëngjisht, greqisht, italisht etj.

Moikom Zeqo personalitet i njohur i kulturës sonë kombëtare, dallohet për stil lakonik, të ngjeshur e modern.



USHTROHUNI

1. Në tekstin më lart gjeni fjalët e huaja duke u konsultuar edhe me Fjalorin e Gjuhës Shqipe të kohëve të fundit. (shënojeni ato me shpjegime në fletoren tuaj).

Alvise Vivarini vdiq. Feneri i ndriçonte ballin e madh e të nxehtë. Marku e puthi në ballë me respekt. E shoqja e Alvises qante në heshtje. Qe muzgu i një fund dite të vitit 1502.

Jashtë dritares, ne peizazhin e mbrëmjes, ndritnin fenerët e gondolierëve. Brenda në dhomë ndriste feneri, me të cilin Alvise Vivarini kishte pikturuar kryeveprat e tij.

Moikom Zeqo

2. Zëvendësoni në fletore fjalët e mëposhtme me këto fjalë:

i sjellshëm, dhunë, përfundim, shtyllë, shmang, gjendje, shije, nismë, iniciativë, gusto, xhentil, violencë, devijoj, konkluzion, situatë, kolonë.

3. Çfarë mendimi keni për përdorimin e fjalëve të huaja? Sa dhe si duhen përdorur ato?



1. Shkruani në fletore një shkrim të shkurtër (rreth 10-15 fjali) mbi faktin historik që njihni më mirë (betejat e Skënderbeut me turqit) etj.

2. Shkruani me kompjuter krijimin tuaj duke përdorur programin Word.

Shiko si shkruhen fjalët te ushtrimi I dhe II.

- I.
- aviator, dialekt, dialektor; specialist; kantier, portier, malarie, mision, televizion, violinë, stadium, por austriak, industrial.
 - alkool, kooperativë, zoologji
- II.
- acid, central, elektrikist, koncert, recetë
 - olimpiadë, antologji, entuziazëm, simpati, teatër, temë, tezë
 - atlas, diplomat, diplomë, filozof, komplot, logjikë, lustër, psikologji,

MËSOJMË

- **Te fjalët që në shkrim kanë -ia-, -ie-, -io-, -iu , i -ja shqiptohet si j:**
aviator, diagnozë, dialekt, dialektik, dialektor, dialog, specialist, bankier, kantier, portier, malarie, mision, seksion, sesion, televizion, violinë, stadium, por austriak, industrial (pra, shqiptohen me i).
- **Te një numër fjalësh të tjera që kanë në trup grupet e mësipërme, i-ja ruhet në shqiptim:**
biokimi, biologji, miopi.
- **Fjalët me prejardhje të huaj që shkruhen me -oo- shqiptohen me -oo- dhe jo me -o- :**
alkool, kooperativë, zoologji etj.
- **Fjalët me prejardhje të huaj që kanë c+i,e shqiptohen me c e jo me ç:**
acid, central, ciklamin, ciklon, elektrikist, koncert, recetë etj.
- **Shqiptohen, ashtu siç shkruhen, pra me d, t, dhe jo me dh, th, fjalët ndërkombëtare me burim nga greqishtja si:**
olimpiadë, antologji, entuziazëm, maratonë, patolog, simpati, teatër, temë, tezë etj.
- **Shqiptohen me l dhe jo me ll fjalët me prejardhje të huaj si:**
atlas, diplomat, diplomë, falsifikim, filozof, ideologji, komplot, logjikë, lustër, psikologji etj.
- **Ndër fjalët me prejardhje të huaj ka të tilla që shqiptohen në mënyra të ndryshme. Ne po japim shqiptimin e drejtë të tyre.**
agjenci, autobus, bibliotekë, dispensë, dizenteri, egjiptian, ekskavator, ekskursion, higjienë, injeksion, inventar, juri, kazermë, makinë, qeramikë, regjisor, reumatizëm, volejball, zero.



1. Çfarë grupe zanoresh vini re në grupin e parë të fjalëve (I)?
2. Si shqiptohen grupet e zanoreve ia, ie, io, iu dhe oo në fjalët me burim të huaj?
3. Çfarë bashkëtingëlloresh vini re në grupin e dytë të fjalëve (II)?
4. Si shqiptohen bashkëtingëlloret c, d, t, l në fjalët me burim të huaj?

Gjatë komunikimit tonë me gojë ose me shkrim, përdorim fjalë. Në pjesën më poshtë ju do dalloni fjalët që mund të jenë të ndryshueshme ose të pandryshueshme në fjali

Fjalët e ndryshueshme

Këto fjalë ndahen në disa klasa, sipas veçorive të tyre. Këto klasa janë:

- Emrat.** Tregojnë frymorë, sende, dukuri etj. Kanë gjini të caktuar dhe ndryshojnë sipas trajtës (i shquar-i pashquar), numrit (njëjës-shumës) e rasës (emërore, gjinore, ..., etj.)
djalë-djali-djemve; dru-druri, drurëve; kohë-koha etj.
- Mbiemrat.** Shprehin cilësi të frymorëve, sendeve a dukurive. Përshtaten me emrat në gjini, numër e rasë.
djalë i vogël-djemve të vegjël.
- Përemrat.** Zakonisht zënë vendin e emrit. Lakohen në njëjës e në shumës ashtu si emrat.
ai-ajo-atyre etj.
- Foljet.** Tregojnë veprim ose gjendje të kryefjalës. Ndryshojnë sipas mënyrave, numrit, kohës, vetës.
shoh-pashë-shiko etj.
- Numërorët.** Tregojnë sasi të caktuar frymorësh a sendesh. → dy dallëndyshe etj.

Fjalët e pandryshueshme

Sipas rolit të tyre, fjalët e pandryshueshme ndahen në disa klasa:

- Ndajfoljet.** Plotësojnë një folje, një mbiemër ose një ndajfolje tjetër.
do të kthehemi përsëri, më i bukur, shumë bukur etj.
- Parafjalët.** Vihen përpara një emri një përemri a një numërori për t'i lidhur këta me fjalë të tjera në fjali.
dallëndyshet iknin në prag të dimrit.
- Lidhëzat.** Lidhin dy fjalë a dy grupe fjalësh në fjali ose pjesë të fjalisë së përbërë.
Djali pa gjethet e zverdhura dhe pemët e zhveshura. – Mos u mërzit, se do të kthehemi përsëri.
- Pjesëzat.** Plotësojnë kuptimin e një fjale a të një fjalie, pohojnë ose mohojnë një mendim.
Po, vogëlush...
- Pasthirmat.** Shërbejnë për të shprehur ndjenjat e folësit. Ua, edhe ti po ikën?!

Provoni njohuritë që keni

Një djalë i vogël pa dallëndyshe që iknin në prag të dimrit, dhe u mërzit. "Mos u mërzit, - i thanë ato, - se do të kthehemi përsëri." Djali pa gjethet e zverdhura që binin, dhe pemët që mbetën të zhveshura, e iu njomën sytë. "Mos qaj, - i thanë drurët, - në pranverë do të vishemi edhe më bukur." Djali u takua edhe me kohën. "Ua, edhe ti po ikën?!" - e pyeti i pikëlluar ai. "Po, vogëlush, dhe për këtë mërzitu vërtet, se iki e nuk kthehem më.

Mos harro: koha s'kthehet kurrë më!"

- Në fjalinë e parë, vini në shumës grupin emëror të kryefjalës dhe në njëjës kundrinorin e drejtë *dallëndyshet*.
- Shkruajeni fjalinë në fletoren tuaj.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

- Komento të gjithë shembujt e dhënë për të gjitha klasat e fjalëve, duke vërtetuar veçoritë dhe rolin e tyre.
- Në pjesën më lart, shkruaj në fletore nga një fjalë për çdo klasë të fjalëve, të ndryshueshme apo të pandryshueshme.

Theksi i fjalës

Lexoji fjalët e mëposhtme, trego cila rrokje shqiptohet me forcë më të madhe dhe fute në rreth:

- *Kala, rrufe, liri, bujar*
- *Flutur, dorë, punë, zemër*
- *Pjesëza, drejtëza, kumbulla*

Shqiptimi me forcë më të madhe i një rrokjeje të fjalës që ka më shumë se një rrokje, quhet THEKS I FJALËS.

A MUND TË MËSONI VETË NGA LIBRI?



- **Te cili nga grupet e mësipërme të fjalëve theksin do ta quaje fundor?**
- **Te cili grup fjalish theksin do ta quaje parafundor?**
- **Te cili grup fjalësh theksin do ta quaje tejfundor?**
- **A mund ta formulosh vetë rregullën për të tria llojet e theksit?**

Theksi quhet **fundor**, kur shqiptojmë me forcë më të madhe _____.

Theksi quhet **parafundor**, kur shqiptojmë me forcë më të madhe _____.

Theksi quhet **tejfundor**, kur shqiptojmë me forcë më të madhe _____.

Intonacioni

Kur flasim zëri me të cilin i shqiptojmë fjalitë, nuk është gjithmonë i njëjtë, herë vjen duke u ngritur dhe herë duke u ulur.

Lexo fjalitë:

- *Sot e ka Artani ditëlindjen?*
- *Artani sot ka ditëlindjen. (Zëri vjen duke u ngritur)*
- *U bëfsh 100 vjeç?*
- *Uroje shokun. (Zëri vjen duke u ulur)*

Këto ndryshime të zërit përbëjnë intonacionin e fjalisë.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, kur pyesim për diçka, zëri vjen duke u ngritur në fund të fjalisë.

Kurse, kur tregojmë diçka ose kur shprehim dëshirë a nxitje për diçka, zëri vjen duke u ulur.



MARGARITA XHEPA (1934 – 2025) ishte një aktore shumë e dashur shqiptare, një nga Zonjat e Mëdha të teatrit dhe filmit shqiptar që ka skalitur memorien e publikur shqiptare me role brilante që prej fillimit të saj, në vitet 60 dhe deri në ditët tona. Është nderuar me çmimet "Nderi i Kombit", "Artiste e Popullit", sepse me zërin e saj të ngrohtë ishte e suksesshme në radio e teatër në rolet e dramaturgjisë botërore dhe në veprat e shquara kombëtare.



RESHAT ARBANA lindi më 1940 në Tiranë. Ai është një nga aktorët më popullorë të radios, teatrit, dhe kinemasë shqiptare, me mbi 35 role, duke filluar që nga viti 1963. Në 1968, filloi punë në Radio Tirana. Nga viti 1977 e deri sa doli në pension ishte aktor i Teatrit Kombëtar të Tiranës. Suksesi më i madh i erdhi nga zëri i veçantë, theksi i përsosur, njohës i madh i gjuhës shqipe.

1. Trego prej sa tingujsh përbëhen këto fjalë:

mal, korr, thikë, llambë, ndreq, skalit, gjemb, vullnetar, yje, punëtor, shesh.

Shkruaj vetëm bashkëtingëlloret dhe trego në kllapa përbri secilës së ç'lloj është:

P.sh.: m (bashkëtingëllore e zëshme e tingullt).

2. Vini theksin në fjalët e mëposhtme dhe thuaj për çdo rast nëse është fundor, parafundor apo tejfundor. Trego ku lëviz theksi nga njëra fjalë tek tjetra.

blej – blerje – blerësve; end – endje – endëse – endëseve; mendje – mendimtar- i përmendur; kalë - kuaj – kuajve; gjurmë - gjurmoj – gjurmave.

3. Lexo fjalitë dhe vër re se para ç'lloj bashkëtingëlloreje janë përdorur shkronjat: s, sh, ç, z, zh në krye të fjalëve me shkronja të zeza.

a. Të rinjtë e sotëm janë shumë të zhvilluar.

b. Qyteti ynë sa vjen e po zbukurohet.

c. Rini, nxirre gëzimin tënd, të shpërthejë me vrull.

d. **Skuadra** e shkollës sonë doli kampione. Në ndeshjen e fundit ajo fitoi dy pikë shumë të çmuara.

e. Në atë fushën majtas ka nisur **shpimi** i puseve.

4. Shkruaj fjalët me kuptim të kundërt me këto:

përdor _____ *vesh* _____

i rregullt _____ *duken* _____

montoj _____ *bëj* _____

armatos _____ *qep* _____

5. Ndryshoja kuptimin këtyre fjalëve, duke u shtuar vetëm një bashkëtingëllore në fillim të tyre:

emër, besë, end, erë, daja, unë, arë, eci, ylli, iku.

6. Përgjigju me fjali që përbëhen vetëm nga një emër i pashquar në numrin njëjës.

- *(Si quhet dukuria: Lëkundje e fuqishme e një pjese së kores së Tokës?)*
- *(Kur ndien disa dridhje dhe e pyet ende i qetë bashkëfolësin nëse po ndodh kjo dukuri apo jo)*
- *Kur bindesh që po ndodh, dhe tmerrohesh.*

7. Shqiptoji përgjigjet me intonacionin përkatës dhe pastaj shkruaji duke vënë shenjat e duhura të pikësimit.

8. Krijë katër fjali me të cilat:

a) Të tregosh për diçka.

b) Të pyesësh për diçka.

c) Të urdhërosh dikë.

d) Të urosh dikë.

Shqiptoji me intonacionin e duhur dhe thuaj për çdo rast ç'lloj intonacioni është.

Shkruaji fjalitë duke pasur kujdes në përdorimin e shenjave të pikësimit.

Emri është ajo fjalë e ndryshueshme që emërton frymorë, sende ose dukuri.

Shkruaj çfarë emërtojnë emrat: nxënës, regjistër, fletore, gëzim, hare.

Në fjali emri mund të përdoret i vetëm ose në grup emëror, për shembull:

Djali (është përdorur i vetëm) është nga qyteti yt. (është përdorur në grup emëror)

Emri është bërthama e grupit emëror.

Klasifikimi i emrave

1. Emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm

Emrat e përgjithshëm tregojnë të gjithë frymorët a të gjitha sendet e të njëjtit lloj, për shembull: *djalë, regjistër, fletore, dhomë, miqësi, lumturi.*

Emrat e përveçëm tregojnë një prej frymorëve a sendeve, duke e dalluar nga të tjerët, për shembull: *Valbona, Kukësi, Ermira, Iliri, Prishtina, Korça, Gjergj Kastrioti, Leka i Madh.*

Janë të përveçëm, emrat dhe mbiemrat e njerëzve: Naim Frashëri, Ismail Kadare, Fatos Arapi.

Emrat e shteteve dhe kontinenteve: Shqipëria, Kosova, Italia, Franca, Holanda, Europa, Afrika.

Emrat e periudhave historike dhe ngjarjeve të rëndësishme: Mesjeta, Rilindja, Kongresi i Manastirit.

Emrat e institucioneve dhe të veprave letrare: Kuvendi Popullor, Presidenca, "Kështjella", etj.

Të gjithë emrat e përveçëm dhe emërtimet e përveçme shkruhen me shkronjë të madhe: Muzeu Historik Kombëtar, Ylli Polar, Antarktida, Malësia e Madhe, sheshi "Fan Noli", Bethoven, Jupiteri, etj.



KUJDES

Të gjithë emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.

Tiranë, 30 tetor 2025

I dashur Ilir,

Sot, në klasën tonë, erdhën dy nxënës të rinj: Valbona dhe Krenari. Valbona është nga Kukësi, kurse Krenari nga Berati. Të dy kishin ardhur me autobus.

Më pas na erdhi dhe një djalë tjetër, Altini, nga qyteti yt, nga Gjirokastra. Ai e kishte bërë rrugën nga bregdeti, me një taksì. I kishte pëlqyer shumë pamja e detit.

Ti e ke pasur shok në shkollë, se të njihje. Altini të dërgon përshëndetje dhe të uron nota të mira në regjistër. Tani ai banon në të njëjtën lagje me mua, pranë pallatit tim.

E ndiej që do të jemi miq me njëri - tjetrin.

Herën tjetër do të të tregoj më shumë për të, si po përshtatet me klasën tonë.

Të përqafoj me mall, Ermira

1. Shkruaj në fletore se cilët janë emra të përveçëm dhe cilët janë emra të përgjithshëm.

Në ç'gjini e në ç'numër janë emrat? Cilët janë të shquar e cilët të pashquar _____.

2. **Kërko në internet në adresën <https://www.scribd.com>** të gjesh materiale dhe shembuj të kategorive të emrave të përveçëm.

Për shembull: emrat e kafshëve, si: Baku i famshëm, apo Bambi, Haçiko etj.

Emra janë frymorë dhe jofrymorë

Emrat frymorë tregojnë qenie të gjalla (njerëzore ose jo), p.sh.: *nxënës, burrë, mik, zog, milingonë, dele etj.*
Emrat jofrymorë tregojnë zakonisht sende e dukuri, p.sh.: *Tiranë, klasë, miqësi etj.*

Emra janë konkretë dhe abstraktë

Emrat konkretë tregojnë frymorë ose sende që mund të shihen, të preken, p.sh.: *shok, regjistër, gur etj.*
Emrat abstraktë tregojnë veprime, dukuri, cilësi etj, të cilat nuk mund të shihen, të preken a të imagjinohen, p.sh.: *përhëndetje, urim etj.*

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Në letrën që i ka shkruar Ermira, Ilirit, dallo emrat frymorë dhe emrat jofrymorë, emrat konkretë dhe abstraktë. Thuaj çfarë tregon secili. Sa emra të përveçëm ka dhe si janë shkruar? _____ . _____

2. Thuaj nëse janë emra konkretë apo abstraktë, frymorë apo jofrymorë emrat më pas: **motër, harabel, kompjuter, autobus, veturë, vetëmohim, vit, televizor, helikopter, zgjuarsi.**

PËRSHKRIM VJESHTE

Ka ardhur **vjeshta**. Qielli është i kaltër dhe dielli i ndritur. Po rrezet e tij nuk djegin si në **verë**. **Era** fryn e lehtë, ta përkëdhel fytyrën. Ca **gjethë** të zverdhura shkëputen ngadalë nga degët e fluturojnë mbi **ujin** e lumit, si flutura të mëdha me krahë të artë.

Ishte **vjeshtë**. **Gjethet** ishin skuqur e rralluar. Frynte një **erë** e ftohtë cingërimë. **Uji** kishte nisur të ngrinte natën e të shkrinte ditën.

Liqeni ishte mbushur me shkumë të bardhë, ziente e gumëzhinte.

Të ftohtët ishte i lagësht. **Vera** tashmë ishte shumë arg.

Provoni njohuritë që keni

1. Në dy përshkrimet e mësipërme të një dite vjeshte, **emrat me shkronja të zeza** janë përdorur nga shkrimtarët në trajtë të shquar ose të pashquar.

Ilustro këtë ndryshim, duke treguar të njëjtin emër në të dyja trajtat, tek të dyja përshkrimet, dhe trego gjininë e emrit.

2. Po për emrat e tjerë që janë në tekst, por **nuk janë me shkronja të zeza**, mund të përcaktosh trajtën dhe gjininë?

Provo në fletoren tënde.



TRAJTA DHE GJINIA E EMRIT

1. Trajta e emrit

Në gjuhën tonë emrat përdoren në **trajtë të pashquar** dhe në **trajtë të shquar**:

Trajta e pashquar		Trajta e shquar
(një) vjeshtë	→	vjeshta
(një) ujë	→	uji
(ca) gjethe	→	gjethet



KUJDES

Për të pasur trajtën e pashquar të një emri, mjafton që t'i vëmë përpara me mend fjalën **një** (për numrin njëjës) ose fjalën **ca** (për numrin shumës) dhe të shqiptojmë ose të shkruajmë emrin: **(një) gjethe - (ca) gjethe**.

Për të pasur trajtën e shquar të emrit, e përfytyrojmë të përdorur si kryefjalë në fjali, pra që t'i përgjigjet pyetjes kush? cili? cila? etj.: cila? – gjethja.

Gjinia e emrit

Le t'i shkruajmë në të dyja trajtat, në numrin njëjës dhe disa nga emrat e përdorur në të dyja përshkrimet e mësipërme.

(një) vjeshtë	→	(cila?) vjeshta	(një) qiell	→	(cili?) qielli
diell	→	dielli	rreze	→	rrezja
verë	→	vera	erë	→	era
gjethe	→	gjethja	degë	→	dega
ujë	→	uji	flutur	→	flutura
krah	→	krahu	cingërimë	→	cingërima
natë	→	nata	ditë	→	dita

Vëmë re se në trajtën e shquar, numri njëjës, emrat mbarojnë me **-a**, me **-ja**, me **-i**, me **-u** ose me **-t**. Kur në numrin njëjës në trajtën e shquar emri mbaron me **-i** ose **-u**, është i gjinisë mashkullore. Kur mbaron me **-a** ose **-ja**, është i gjinisë femërore. Kur mbaron me **-t** (-të ose it: të zitë, të ecurit), është i gjinisë asnjënjësore.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Gjej emrat. Thuaj trajtën dhe gjininë e tyre.

Atë pasdreke të vrenjtur, kur të ftohtët e lagësht të hynte në palcë, sa të rrëqethej mishi, barka mezi hyri në liman. Deti, i egërsuar, buçiste e dallgëzohej duke përplasur dallgët me furi në breg. Një erë e fuqishme vinte nga jugu duke shtyrë retë dhe dallgët e shkumëzuara. Në det të hapët kishte shpërthyer stuhia.

2. Grupoji dy e nga dy këta emra duke i shkruar në çifte gjinish të ndryshme: vëlla, djalë, lopë, mbesë, pelë, nip, motër, vajzë, ka, burrë, dele, grua, dash, pulë, gjel, kalë.

3. Shkruaj përbri secilit emër në gjininë mashkullore emrin e gjinisë femërore të formuar prej tij: punëtor, kompjuterist, malësor, durrsak, gjysh, mjek, plak, ari, ujk, luan.

A mund ta zbulosh vetë?

Një nxënës ka shkruar në tabelën e zezë, format e njëjësit dhe të shumës të disa emrave.

E ka shkruar mirë ai shumësin e emrave? _____

Më poshtë tregohet njëjësi dhe shumësi i emrave, në katër kolona.



Njëjës (një)	Shumës (ca)	Njëjës (një)	Shumës (ca)	Njëjës (një)	Shumës (ca)	Njëjës (një)	Shumës (ca)
mal	male	fik	fiq	varg	vargje	rrëke	rrëke
flutur	flutura	zog	zogj	breg	brigje	mësues	mësues
kalli	kallinj	kungull	kunguj			tiranas	tiranas
prind	prindër	bir	bij			fletore	fletore
lumë	lumenj	dash	desh			lugë	lugë
shkop	shkopinj					radio	radio
fshat	fshatra					shtëpi	shtëpi

1. Në ç'trajtë i ka vënë emrat dhe ç'fjalë përdor përpara dy formave?

Çfarë duhet të bësh, pra, që të gjesh si formohet shumësi?

2. Ç'ndryshime ndodhin në grupet e ndryshme, kur formohet shumësi i emrave? Kërko shembuj te libri i historisë dhe shkruaj në fletore për ndryshimet që dallon.



Numri i emrit. Si formohet numri shumës?

Shumica e emrave tregojnë frymorë e sende të numërueshme, prandaj përdoren në të dy numrat: në njëjës e në shumës.

Në numrin njëjës emri tregon vetëm një frymor ose një send, kurse në numrin shumës tregon shumë të tillë.

Formimi i numrit shumës të emrave

1. Shumica e emrave në numrin shumës marrin mbaresa të ndryshme që i shtohen formës së njëjësit, si: -e, -ë, -a, -nj, -ër, -enj, -inj, -ra.

Trego shembuj nga tabela më lart.

2. Disa emra e formojnë shumësin duke ndërruar tinguj në krahasim me formën e njëjësit.

Në cilin grup do t'i gjesh shembujt?

Trego me shkrim shembuj të tjerë të formimit të numrit shumës të emrave.

3. Ka emra e formojnë shumësin edhe duke marrë mbaresë, edhe duke ndërruar tinguj.

Trego në shembujt e mësipërm mbaresën dhe ndryshimin e tingullit.

4. Një pjesë e emrave i kanë të njëjta të dyja format: edhe njëjës, edhe shumësin.

Në cilin grup i ka vënë nxënësi këta emra?

5. Shkruaj në fletoren e punës shumësin e këtyre emrave:

fusha, kodra, vegla, komb, ari, mulli, uji, nxënës, mësues, depo, breg, rrezik, dash, kungull, bir, xhep, përtac, kulaç, byrek, luan, historian, man, patëllxhan, karkalec, gol, divan, orar, thesar, panair, ciklon, proton, koral, elefant, atlet, karrocier, karafil, oficer, bajloz, tifo.



KUJDES

Emrat e gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me mbaresat –e dhe –ra, p.sh.:

vende, ujëra, në numrin shumës kthehen në emra të gjinisë femërore.

Në këtë gjini vihen edhe fjalët që i përcaktojnë, p.sh.:

Ky vend i bukur → këto vende të bukura. Ai ujë i ftohtë → Ato ujëra të ftohta.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Thuaj në ç'numër janë emrat dhe si e kanë formuar shumësin.

Poshtë në Drimonë kishte ardhur vera, lart në male ishte ende pranverë. Shkrinte akulli dhe dëbora, buçisnin rrëketë e përrenjtë, gurgullonin krojet begatore, harlisej bari i ri, bleronin drurët e shkurret. Ajri ishte plot me aroma aguliçesh, vjollcash dhe stolish të tjera pranverore.

2. Formo shumësin e këtyre emrave dhe shkruaji në fletore, siç ka bërë nxënësi në tabelë të zezë (në katër grupe):

trëndafil, natë, propozim, ujk, kopsht, shteg, pallat, pyll, shtëpi, rrobaqepës, dele, sy, televizor, peshk.

3. Shkruaj në tri shtylla të veçanta: emrat që përdoren vetëm në njëjës, emrat që përdoren vetëm në shumës, dhe ata që përdoren në njëjës dhe shumës.

mulli, plep, gëlqere, pranga, rrufe, vapë, të mbjellat, makarona, benzinë, komb, jug, shytat, lopatë, brymë, spinaq, të lashtat, qershi, breshër, lexues, errësirë.

Provoni njohuritë që keni

1. Lexoni tekstin dhe vini re format e ndryshme të emrit pishë.

Një fëmijë mori një sëpatë dhe preu në pyll **pishën** e vogël. E keni parë rrëshirën, lotin **e pishës**? Qante pisha, se ishte ndarë nga prindët, **nga pishat** e mëdha. Dhe **pishës** nuk ia kishte këputur jetën stuhia, por një djalë. Më erdhi keq **për pishën** e vogël, shumë keq... Por edhe djali e kuptoi gabimin. "Që ta ndreqësh këtë gabim, - i thashë, - t'i duhet të mbjellësh disa fidanë **pishe**."

2. Cilës pyetjeje i përgjigjet emri pishë në secilin rast dhe ç'rol luan në fjali?

MBAJENI MEND



Format që merr emri për të kryer funksione të ndryshme në fjali, quhen **RASA**:
Ndryshimi që pëson emri duke u vënë radhazi nga një rasë në tjetrën, quhet **LAKIM**:
Gjuha shqipe ka pesë rasa:

EMËRORE
(E.)

GJINORE
(Gj.)

DHANORE
(Dh.)

KALLËZORE
(K.)

RRJEDHORE
(Rr.)

Ndarja e emrave në lakime

Sipas tingullit me të cilin mbarojnë kur përdoren si kryefjalë në trajtën e shquar, në numrin njëjës, emrat ndahen në tri lakime:

1. Lakimi i parë

Emrat mashkullorë që mbarojnë me **-i**: (cili?) djali-lisi-vëllai-ftoi etj.

2. Lakimi i dytë

Emrat mashkullorë që mbarojnë me **-u**: (cili) miku-zogu-atdheu etj.

3. Lakimi i tretë

Emrat femërorë, që mbarojnë me **-a** ose **-ja**: vera-puna-delja etj.



KUJDES

Lakimi i katërt

Emrat e gjinisë asnjëse lakohen si emrat e lakimit të parë, vetëm se emëroren dhe kallëzoren e shquar i kanë të njëjta: të folurit.

Lakimi i parë → Emrat që mbarojnë me zanoren - i*Trajta e pashquar*

Rasa	Numri njëjës		Numri shumës	
	Pyetja	Forma e emrit	Pyetja	Forma e emrit
Emërore	cili?	(një)libër	cilët?	(ca) libra
Gjinore	i,e cilit?	i,e (një) libri	i,e cilëve?	i,e(ca) librave
Dhanore	cilit?	(një) libri	cilëve?	(ca) librave
Kallëzore	cilin?	(një) libër	cilët?	(ca) libra
Rrjedhore	prej cilit?	(prej) (një) libri	prej cilëve?	(prej)(ca) librash

Trajta e shquar

Rasa	Numri njëjës		Numri shumës	
	Pyetja	Forma e emrit	Pyetja	Forma e emrit
Emërore	cili?	libri	cilët?	librat
Gjinore	i,e cilit?	i,e librit	i,e cilëve?	i,e librave
Dhanore	cilit?	librit	cilëve?	librave
Kallëzore	cilin?	librin	cilët?	librat
Rrjedhore	prej cilit?	(prej) librit	prej cilëve?	(prej) librave

A MUND TË MËSONI VETË NGA LIBRI?

Thuaj përmendsh lakimin e emrit *libër* në të dyja trajtat.
Lako në të dyja trajtat, në njëjës e në shumës, emrin *lis*.

Lakimi i dytë → Emrat që mbarojnë me zanoren -u*Trajta e pashquar*

Rasa	Numri njëjës		Numri shumës	
	Pyetja	Forma e emrit	Pyetja	Forma e emrit
Emërore	cili?	(një) zog	cilët?	(ca) zogj
Gjinore	i,e cilit?	i,e (një) zogu	i,e cilëve?	i,e(ca) zogjve
Dhanore	cilit?	(një)zogu	cilëve?	(ca) zogjve
Kallëzore	cilin?	(një) zog	cilët?	(ca) zogj
Rrjedhore	prej cilit?	(prej)(një) zogu	prej cilëve?	(prej)(ca) zogjsh

Trajta e shquar

Rasa	Numri njëjës		Numri shumës	
	Pyetja	Forma e emrit	Pyetja	Forma e emrit
Emërore	cili?	zogu	cilët?	zogjtë
Gjinore	i,e cilit?	i,e zogut	i,e cilëve?	i,e zogjve
Dhanore	cilit?	zogut	cilëve?	zogjve
Kallëzore	cilin?	zogun	cilët?	zogjtë
Rrjedhore	prej cilit?	(prej) zogut	prej cilëve?	(prej) zogjve



Thuaj përmendsh lakimin e emrit zog në të dyja trajtat.
Lako në të dyja trajtat, në njëjës e në shumës, emrin shok.

Lakimi i tretë → Emrat që mbarojnë me - a; - ja

Trajta e pashquar

Rasa	Numri njëjës		Pyetja	Numri shumës	
	Pyetja	Forma e emrit		Forma e emrit	
Emërore	cila?	(një) motër	cilat?	(ca) motra	
		(një) lule		(ca) lule	
Gjinore	i,e cilës?	i,e (një) motre	i,e cilave?	i,e(ca)motrave	
		(një) luleje		i,e (ca) luleve	
Dhanore	cilës?	(një) motre	cilave?	(ca)motrave	
		(një) luleje		(ca) luleve	
Kallëzore	cilën?	(një) motër (një) lule	cilat?	(ca) motra (ca) lule	
Rrjedhore	prej cilës?	(prej)(një) motre (prej) (një) luleje	prej cilave?	(prej)(ca) motrash (prej)(ca) lulesh	

Trajta e shquar

Rasa	Numri njëjës		Numri shumës	
	Pyetja	Forma e emrit	Pyetja	Forma e emrit
Emërore	cila?	motra	cilat?	motrat
		lulja		lulet
Gjinore	i,e cilës?	i,e motrës	i,e cilave?	i,e motrave
		i,e lules		i,e luleve
Dhanore	cilës?	motrës	cilave?	motrave
		lules		luleve
Kallëzore	cilën?	motrën	cilat?	motrat
		lulen		lulet
Rrjedhore	prej cilës?	(prej) motrës	prej cilave?	(prej) motrave
		(prej) lules		(prej) luleve



Thuaj përmendsh lakimin e emrave: *motër, lule*, në të dyja trajtat.
Lako në të dyja trajtat, në njëjës dhe në shumës, emrat *nënë* dhe *dritare*.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Lexo pjesën dhe thuaj për çdo emër cilit lakim i përket. Shkruaj në fletore emrat me shkronja të zeza, pyetjen për secilin, rasën dhe numrin.

Migjeni dëgjonte zërat e fëmijëve pas murit të hollë prej thuprash dhe balte. Mbylli qepallat, sytë i digjnin nga lotët. Mësuesit i dolën para sysh fytyrat e tyre të zbehta, rrobat e rreckosura, këmbët e zbathura në opingat e grisura prej llastiku, sytë e hapur si në ethe, buzët e vogla të mavijosura, që dridheshin prej të ftohtit.

KUJDES!

Kur emri është në numrin shumës, për të dalluar rasën emërore nga rasa kallëzore, që kanë të njëjtën formë, emrin mendojeni në numrin njëjës, për shembull dëgjonte (cilët?) - zërat; (cilin?) - zërin (rasa kallëzore).

2. Ndërto tabelën e lakimit të emrit *ftua* në të dyja trajtat, në njëjës e në shumës, duke pasur si model lakimin e emrit *thua*:

{ (një) *thua*, i, e (një) *thoi*, (një) *thoi*, (një) *thua*, (prej) (një) *thoi*

{ (ca) *thonj*, i, e (ca) *thonjve*, (ca) *thonjve*, (ca) *thonj*, (prej) (ca) *thonjsh*

{ *thoi*, i, e *thoit*, *thoit*, *thoin*, *prejthoit*

{ *thonjtë*, i, e *thonjve*, *thonjve*, *thonjtë*, *prejthonjve*

3. Lako në numrin njëjës, në të dyja trajtat, emrat:

vëlla, pe, atdhe. (Kujdes te format: *vëllain, i, e njëperi, atdheun*, ku mund të gaboni...)

4. Shkruaj këta emra në trajtën e shquar, numri shumës, rasa emërore:

rrufe, kala, mik, djalë, peshk, ujk, njeri, mësues.

5. Emrat e mësipërm i shkruaj në trajtën e pashquar, numri shumës, rasa rrjedhore.

6. Shkruaj këta emra duke i vënë në rasën emërore njëjës të trajtës së shquar dhe në rasën gjinore njëjës, trajta e pashquar.

lakër, thupër, ëndërr, kokërr, pupël, ashkël, familje, zile, shoqe, dritare, ide, shaka, detyrë, brumë, ujë, kalë, krua, tra, kalli.

Shembull: *lakra; i/e një lakre • familja; i/e një familjeje.*

Përemri është klasë e ndryshueshme e fjalisë, që zëvendëson emrin. Përemri shmang përsëritjen e emrit në fjali. Ai tregon në mënyrë të përgjithshme emrat frymorë apo sendet, pa i emërtuar ato. Përemrat lidhen ngushtë me emrat dhe mbiemrat.

Përemrat kryesorë, janë: përemrat **dëftorë**, përemrat **vetorë**, përemrat **pyetës**, përemrat pronorë, përemrat lidhorë, përemra të pacaktuar, përemrat vetvetorë.

Përemrat përdoren gjerësisht në vend të emrave, mbiemrave dhe numërorëve.

Provoni njohuritë që keni

- Cili është qyteti që (i cili) të tërheq më shumë?... - e pyeta unë shoferin.
- Puka. Në atë qytet ka jetuar Migjeni... - mu përgjigj ai.
- Nga e di ti?
- E di, more vëlla, sepse e kam poetin tim.
- Cila është arsyeja? Meqë është shkodran?
- Jo, por unë, si lexues, Migjenin e pëlqej më shumë se cilindo poet tjetër. E kush ia kalon atij? Është i mrekullueshëm. A gjeni dot një tjetër të këtillë?

Gjej në tekst fjalë:

- a) që tregojnë vetën ose zënë vendin e një emri të përmendur më parë,
- b) që tregojnë sende, frymorë a tipare të tyre.
- c) që tregojnë se kujt i përket diçka.
- d) me të cilat pyesin për frymorë a sende.

Fjalët që dallove dhe për të cilat diskutuat në klasë, janë përemra.

Siç shihet, përemrat janë disa llojesh:

Përemri vetor

Është ajo fjalë e ndryshueshme që tregon: *vetën e parë (unë, ne)*, *vetën e dytë (ti, ju)* ose *vetën e tretë (ai, ajo, ata, ato)*. Vetëm ai i vetës së tretë zëvendëson në fjali një emër ose një grup emëror të përmendur më parë. Përemri vetor ndryshon sipas vetës, gjinisë, numrit dhe rasës.

Ja tabela e lakimit të tij në të dy numrat dh gjinitë:

Numri	Rasa	Veta e parë	Veta e dytë	Veta e tretë	
				Gjinia mashkullore	Gjinia Femërore
Njëjës	Emërore	unë	ti	ai	ajo
	Gjinore	-	-	i atij	i asaj
	Dhanore	mua, më	ty të,	atij, i	asaj, i
	Kallëzore	mua, më	ty të	atë, e	atë, e
	Rrjedhore	(prej) meje	(prej) teje	(prej) atij	(prej) asaj
Shumës	Emërore	ne	ju	ata	ato
	Gjinore	-	-	l atyre	l atyre
	Dhanore	neve,na	juve, ju	atyre,u	atyre,u
	Kallëzore	ne, na	ju, ju	ata,i	ato, i
	rrjedhore	(prej) nesh	(prej) jush	(prej) atyre	(prej) atyre

Siç shihet nga tabela, në rasat dhanore e kallëzore, krahas formave të plota të përemrit vetor, përdoren edhe trajtat e shkurtra: **më, të, i, e, na, ju, u**. Ne e uruam **atë**. Ose e vetme: Ne e uruam.
Në gjuhën shqipe përdoren shpesh pranë njëra - tjetrës dy trajta të shkurtra:
e para e rasës dhanore, e dyta e kallëzores, p.sh.: Arbeni **na e** tregoi përmbajtjen e romanit.
Rastet e përdorimit të dy trajtave të shkurtra pranë njëra – tjetrës:

- Ma** jep adresën e e-mail-it tënd.
- Ta** dhashë adresën e e-mail-it tim.
- Ia** dhashë edhe asaj adresën e e-mailit tim.
- Na e** dhe adresën e e-mail-it tënd.
- Jua** dhashë adresën e e-mail-it tim.
- Ua** dhashë edhe atyre adresën e e-mail-it tim.
- Na i** jepni edhe ne adresat e e-mail-eve tuaja.
- M'i** jepni edhe mua adresat e e-mail-eve tuaja.
- T'i** dhashë adresat e e-mail-eve tona.



Kompjuteri lidhet me internetin nga ku mund të shfletohen të dhëna nga më të ndryshmet.
Kërko informacione që të vlejné, nën kujdesin e prindërve!

Shënim. Nëse ke një adresë tënden në internet, shkruaju shokëve, shoqeve me e-mail, sepse mund të kesh arsye të ndryshme, si: sqarime për mësimet, do të saktësosh orën e një takimi me klasën etj. Do ta shikosh që është mënyrë e saktë dhe e mirë komunikimi. Duhet të praktikohesh që të mos shkruash me gabime.



KUJDES

Mbaji mend mirë të gjitha rastet!

Përemri dëftor

Është ajo fjalë e ndryshueshme që tregon frymorë **a sende** që ndodhen afër ose larg folësit, por edhe tipare të tyre (**i këtillë etj.**)

- **Trego përemrat dëftorë te pjesa në krye të mësimet.**
- Përemrat dëftorë janë: **ky, kjo, këta, këto, i këtillë, e këtillë, të këtillë, i tillë, e tillë;**
- **ai, ajo, ata, ato, i atillë, e atillë, të atillë, të atilla.**
- **Si mendon ti, cilët janë përemra dëftorë për afër dhe cilët janë për larg?**

Përemrat dëftorë ndryshojnë formë sipas gjinisë, numrit dhe rasës së emrit që shoqërojnë,
p.sh.: **ajo vajzë; ai djalë; asaj vajze; atij djali; këto vajza, këtyre djemve** etj.
Ata mund të përdoren edhe më vete: **Kjo** është motra ime.



KUJDES

Për të dalluar përemrat dëftorë ai, ajo, ata, ato, nga përemrat vetorë me të njëjtën formë duhet të mbash mend:

- Janë përemra **dëftorë**, kur pranë tyre mund të vendosen ndajfoljet **aty, atje**.
- Janë përemra **vetorë**, kur zëvendësojnë një emër të përdorur më parë.

Trego kur përemri ai përdoret si vetor dhe kur përdoret si përemër dëftor.

Përemri lidhor

Përemri lidhor **që (i cili)** përdoret në fjalitë e përbëra, në krye të pjesës së dytë, që përcakton një emër a përemër të përmendur në pjesën e parë. Ai shërben edhe për t'i lidhur të dyja pjesët.



Poshtë urës dukeshin **lundrat që (të cilat)** notonin mbi ujë. Muret e kështjellës janë lyer me gjakun e atyre **që (të cilët)** na kanë sulmuar.

- **Trego për këtë fjali pjesët e fjalisë së përbërë, përemrin lidhor dhe fjalën e pjesës së parë që përcakton. Çfarë është ajo?**

- Përemri lidhor **që** ka vetëm një formë.

- Përemri lidhor **i cili** ndryshon formë sipas gjinisë, numrit dhe rasës:

i cili, e cila, të cilët, të cilat, të cilit, të cilin, së cilës, të cilën, të cilëve, të cilave etj.



USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Gjej përemrat vectorë (trajta të plota dhe trajta të shkurtra). Thuaj vetën, numrin dhe rasën e tyre (për vetën e tretë, edhe gjininë)

Ju nuk e keni njohur atë, Mimoza Ilasticën. Ju nuk e dini se si na e prishte lojën. Ne luanim me litar, ajo kërcente pa radhë. Ne luanim kukafshehthi, ajo u kallëzonte shoqeve se ku ishim fshehur. Moza ishte sa ne, madje nga shtati ua kalonte disave prej nesh, por ajo ishte e përkëdhelur.

Vera u zëmërua e para me atë, pastaj u largua prej saj edhe të tjerat... Por ajo e kuptoi shpejt gabimin dhe na kërkoi të falur. Tani ne luajmë bashkë dhe e duam shumë.

2. Shkruaje pjesën duke vënë në vend të kllapave përemrat vectorë dhe në vend të pikave trajtat e shkurtra që janë hequr.

Drejtori i spitalit po ... shikonte këtë djalë me dashuri të madhe () u ngrit nga karrigia dhe tha:

– () je djalë i mirë, more usta i ri. () po t... plotësojnë dëshirën që t'... falësh sadopak gjak ustait tënd. Veç një gjë, djalë. Po ... thërras infermieren, që t'... bëjë analizat e gjakut.

Djali buzëqeshi.

– Kot ... bëni analizat, doktor. () jam i sigurtë se () kemi të njëjtin grup gjaku.

Ndërkohë infermierja kishte hyrë. () ... mori porosinë dhe doli bashkë me djalin. () mbaruan punë shpejt. Pastaj infermierja ... shoqëroi () dhe ... tregoi dhomën ku ndodhej usta Kasemi.

Djali ... hapi derën gjithë emocion. Burrit 55-vjeçar ... ndritën sytë.

– Eja, more bir! Sikur ... parandieja që do të vije.

3. Gjej përemrat dëftorë dhe thuaj nëse janë për afër apo për larg.

1. Si doli kjo këngë e kombit kaq e përhapur dhe kaq e kënduar.

2. Ky kor u themelua në Bukuresht aty nga fundi i vitit 1907.

3. Atë natë babai e mori të birin mënjanë dhe i foli gjatë.

4. Harroje këtë ndodhi dhe të fillojmë punën.

Përemri pronor

Është ajo fjalë e ndryshueshme që përcakton ose përfaqëson një emër, duke treguar se kujt i përket ajo çka tregohet nga emri, p.sh.: **tregimi yt; bluza jote, Nora, duhet rregulluar.**

Përemri pronor ka tri veta. Ai merr forma të ndryshme në njëjës e në shumës, si edhe sipas numrit e gjinisë të emrit që përcakton.

Numri	Veta	Përemrat vetorë	Njëjës		Shumës	
			m (libri)	f (fletorja)	m (libri)	f (fletorja)
			Përemrat pronorë			
Njëjës	I	Unë	Im	Ime	E mi	E mia
	II	Ti	Yt	Jote	E tu	E tua
	III	Ai ajo	I tij I saj	E tij E saj	E tij E saj	E tij E saj
Shumës	I	Ne	Ynë	Jonë	Tanë	Tona
	II	Ju	Juaj	Juaj	Tuaj	Tuaja
	III	Ata ato	I tyre I tyre	E tyre E tyre	E tyre E tyre	E tyre E tyre

Përemrat pronorë **im (ime)** dhe **yt (jote)**, kur përdoren më disa emra të farefisit, vendosen edhe përpara emrave: **im vëlla; ime motër; yt vëlla; jot motër** etj.

Përemrat pronorë përdoren edhe më vete, zëvendësojnë një send a frymor të përmendur më parë: *Poezia e tij është për t'u lavdëruar, kurse jotja, Nora, duhet rregulluar.*

Ja rastet e këtij përdorimi: **imi, yni, yti, juaji, imja, jona, jotja, juaja.**

Kurse në numrin shumës:

të miat, tanët, tonat, të tutë, të tuat, tuajt, tuajat, të tijtë, të sajtë, të tijat, të sajat, të tyre.

Përemri pyetës

Përdoret për të pyetur për frymorë apo sende, për sasinë, rreshtin ose tiparet e tyre.

Përemrat pyetës janë: **kush?, i cili?, ç?, çfarë?, sa?, i sati?, me se?** Shiko shembujt:

Kush e ka shkruar poemën "Bagëti e bujqësi"?

Cilin libër të dhuruan shokët për ditëlindje?

Ç'punë ke bërë sot?

Çfarë të dhemb? – pyeti mjeku.

Sa herë e ke parë këtë film?

I sati muaj i vitit është shtatori?

Me se po shkruan?



- Gjeni dhe shkruani në fletore disa përmra pyetës dhe përdorimin e tyre. Regjistroni me orë digjitale sa kohë u duhet në minuta dhe shënoheni kohën në fletore.**
- Detyra më lart është dhënë shumë herë, që nga matjet e kryera ju të dini kohën që ju duhet për detyrat, për një kërkim në kompjuter, për një projekt. Kështu do dini të organizoni më mirë ditën tuaj**

Përemra pyetës të ndryshueshëm

Këta përemra lakohen, ndryshojnë gjini dhe numër.

Përemri kush ndryshon sipas rasës (kush, kujt, kë) dhe përdoret për njerëz. Përemrat: cili / cila, cilët / cilat, ndryshojnë sipas gjinisë, numrit dhe rasës. Këta përemra kanë përdorim të gjerë, përdoren për njerëz, kafshë dhe sende.

Për shembull: Cila iku në det? Cili pyeti për mua? Cilat ndërtesa pëlqen? Cilët shokë erdhën? Cili shkrimtar lexoi poemën në radio? Cili nxënës erdhi dje në shkollë i pari?

Përemri pyetës "cili" përdoret edhe si përcaktues i një emri.

Për shembull: Cili poet erdhi sot në takim?

Përemri pyetës "kush" nuk përdoret asnjëherë si përcaktor, por gjithmonë është përemër.

Përemri "sa": ndryshon sipas numrit dhe lakohet. Tregon sasi, *për shembull: Sa fëmijë erdhën?*

Përemra Pyetës të Pandryshueshëm

Çfarë / Ç': Nuk ndryshojnë sipas rasës, gjinisë apo numrit. *Për shembull: Çfarë do të bësh?*

Ç'dukuri vutë re? Këta përemra duhet të përdoren sa më mire dhe saktë.

Nga **studuesit e gjuhës shqipe** është përcaktuar se kur përdoret përemri pyetës "**Kush**" dhe kur përdoret përemri pyetës "**Cili**"?

Me ndihmën e përemrave pyetës, bëhen pyetje për frymorë apo sende (objekte), për sasinë e tyre, rreshtin ku ato vendosen, për tiparet e tyre kryesore etj.

Përemri pyetës, "kush", ka kuptim shumë të pacaktuar dhe përdoret vetëm për njerëz.

Pra, kur përdoret përemri pyetës "kush", në mënyrë të drejtpërdrejtë duket interesi i ynë apo i dikujt për të njohur apo përcaktuar një njeri:

- *Kush të çoi në kinema? - Kush është ajo? - Kush të detyroi të vije këtu? - Kush erdhi për vizitë?*
- *Kush do të caktohet në vend të Almës? - Kush e mori Doruntinën? - E pe kush notoi më bukur?*
- *Kush ishte pas derës së drejtorit? Kush e shënoi golin e fitores?*

Përemrin pyetës, "cili", përdoret në fjali të ndryshme pyetëse edhe për frymorë, edhe për sende.

Zakonisht ky përemër zëvendëson përemrin, "kush", te frymorët, kur duhet të bëhet një përcaktim më i saktë i pyetjes. Pra, përemri pyetës, "cili" ka përdorim më të gjërë.

Ai përdoret kur pyetet për sende, por edhe kur duam të përcaktohet shumë saktë një frymor ose kur duhet të veçohet një frymor nga grupi ku ai bën pjesë.

- *Cili fustan të pëlqen më shumë, për ta veshur në ditëlindje? - Cili model kompjuteri i plotëson kërkesat e tua për programim? - Cilat filma vizatimorë të duken më interesantë?*

Shkurt, kemi:

Përemra pyetës të ndryshueshëm: **kush, cili, sa, cila, cilët, cilat**, dhe përemra pyetës të pandryshueshëm: **çfarë, ç'**.

Përemrat pyetës: **cili, cila, kush, i sati** etj., lakohen.

Përemrat pyetës: **ç'farë, ç'**, nuk lakohen.

Përemri pyetës që përdoret më shumë, **kush**, lakohet në r. emërore - kush? r.gjinore - i kujt?

r. dhanore kujt? (r. rrjedhore kujt?, pasi shoqërohet me parafjalën pranë, pranë kujt?

Përemri pyetës, **cili**, lakohet në r. emërore - cili? r.gjinore - i cilit? r. kallëzore-cilin

r. dhanore cilit? (r. rrjedhore cilit?).

Ai lakohet edhe në numrin shumës (**cilët, cilat**). Rasa gjinore, dhanore dhe rrjedhore përdoren rallë.



KUJDES

Kur pyesni për një send, nuk duhet të përdorni asnjëherë përemrin pyetës "kush".

MBAJENI MEND



Përemri **ç'** shkruhet gjithnjë me apostrof.

Përemri **çfarë?** e kërkon emrin që vjen pas, në rasën rrjedhore.

Çfarë reviste ke blerë?

Përemri i pacaktuar

Tregon frymorë ose sende në mënyrë të pacaktuar.

– Bledar, a pyeti **ndonjë** për mua?

– Po, **dikush** erdhi e të kërkoj. **Asnjë** prej nesh nuk e njihte.

Ja disa përemra të pacaktuar: **dikush, ndokush, kushdo, askush, gjithkush, një, njëri, ndonjë, ndonjëri, asnjë, asnjëri, secili, gjithsecili, cilido, çfarëdo, gjithçka, diçka, ca, disa, të gjithë etj.**



KUJDES

Përemrat e pacaktuar që kanë si pjesë të parë fjalët **gjithë** ose **kurrë** (**gjithkush, kurrkush** etj.), nuk shkruhen me **-ë-** në fundore të këtyre fjalëve, pra **gjithsecili** dhe jo gjithësecili, **kurrfarë** dhe jo kurrëfarë.

Përemrat e pacaktuar **njëri-tjetri** dhe **shoqi-shoqin** shkruhen me vizë në mes.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Gjej përemrat pronorë, thuaj cilës vetë i përkasin dhe cilin emër përcaktojnë.

Babai im është zooteknik i njohur. Shpesh mbrëmjeve ai na tregon për punën e shokëve të tij. “Kur isha i vogël, - tregon babai, - zinin miqësi me karrocierët dhe u hipnim kuajve të tyre. Njeri nga karrocierët njëherë i tha sime gjysheje:

– Ata nipat e tu po kënaqen duke bredhur mbi kuaj. – Veç ta dëgjonit gjyshen time:

– Puna juaj është mësimi, - na thoshte. – Pastaj, pse nuk luani me lodrat tuaja?

Unë e dua shumë babain dhe më pëlqen profesioni i tij. Kurse ai më thotë duke qeshur:

Sa mirë! Zooteknia do të jetë edhe profesioni yt.

– **2. Shkruaji fjalitë në fletore siç duhen, duke korigjuar gabimet.**

1. A iu përgjigj ai menjëherë pyetjes time?

2. Babai im është më i madh në moshë se tëndi.

3. Cili nga ekipet tanë luajti shumë mirë?

4. Dje kalova nga shtëpia e gjyshes tënde

5. Ditëlindja e jote po afron

3. Gjej përemrat e pacaktuar dhe dallo ata që përdoren të shoqëruar me emra.

Zoologu priti që të pushonin fëmijët. Asnjë i rritur nuk do të priste aq gjatë për të vendosur qetësinë. Ai nxori disa fletë të shkruara dhe nisi të lexonte temën “Dobia e zogjve”. Disa nga fëmijët dinin shumë gjëza për dobinë e zogjve, megjithatë asnjëri nuk pipëtinte. Askush nuk bënte zë.

Edlira donte të dinte diçka për shpendët e rrallë të vendit tonë, prandaj tha:

– A mund të bëjmë ndonjë pyetje?

Të tërë i drejtuan sytë nga ajo...

Folja është ajo fjalë e ndryshueshme që shpreh një veprim a një gjendje, për shembull:

veprim: bëj, shkruaj; **gjendje:** jam, gjendem, gëzohem etj.:

Folja është shumë e rëndësishme për fjalinë, se me të ndërtohet kallëzuesi, që është gjymtyrë kryesore e saj. Nuk formohet fjali pa folje!

Foljet kanë numrin njëjës dhe numrin shumës. **Unë punova** sot në kompjuter. **Ne punuam** dje.

Foljet zgjedhohen në vetën e parë, të dytë, të tretë, në numrin njëjës dhe shumës.

Foljet janë të zgjedhimit të: I, II, III dhe zgjedhohen në mënyra të ndryshme.

Provoni njohuritë që keni

1. Lexo çfarë i thonë në telefon të dy djemtë njëri - tjetrit.

Çfarë janë fjalët me ngjyrë të kuqe?

Cilat prej tyre tregojnë veprim?

Cilat prej tyre tregojnë gjendje?

2. Trego cilat folje janë në kohën e tashme.

Po në të ardhmen?



3. Sikur Altini të ishte duke mësuar me një shok tjetër, si do të përgjigjej?

Ç'mund të thuash për ndryshimet që ndodhin te fjala bëj?

Kur duam të analizojmë një folje, ne patjetër do shikojmë në fjali, në cilin numër është ajo, në cilën vetë, në cilën kohë ndodh veprimi (pasi ka kohë të ndryshme) dhe në cilën mënyrë ajo është zgjedhur (pasi ka mënyra të ndryshme). Studimi i foljeve fillon me pjesoren e tyre. Për shembull: folja është **mësoj**, pjesorja e saj është **mësuar**.

Në gjuhën shqipe, përveç foljeve të zgjedhimit të: I, II, III, kemi edhe **foljet kam dhe jam**, që quhen **folje ndihmëse**. Ato shërbejnë si mjete të rëndësishme gramatikore, që i shtojnë kuptimin fjalisë.

Për shembull ato ndihmojnë që në fjali të shprehet koha ose aspekti se si ndodh një veprim.

Ato shoqërojnë foljet kryesisht në formën pjesore ose paskajore.

Për shembull shikoni foljen ndihmëse **kam** në fjalinë: kam mbaruar mësimin. Duket që me ndihmën e foljes kam, tregohet se veprimi është kryer, **mbaruar** është pjesorja e foljes **mbaroj**. **1. Shumica e foljeve kanë dy forma: formën veprorë dhe formën joveprorë:**

Forma veprorë e foljes tregon që veprimin e kryen kryefjala dhe e pëson dikush tjetër, p.sh.: *Besa e lau, e kreu dhe e vuri në karrocë motrën e vogël.*

Forma joveprorë e foljes tregon se veprimin e kryer nga dikush tjetër e pëson kryefjala, p.sh.: *Motra e vogël u la, u kreh dhe u vu në karrocë nga Besa.*

2. Foljet e të dyja formave ndryshojnë sipas vetës (veta I, II, III), numrit (njëjës, shumës), kohës dhe mënyrës.

Jep shembuj për ndryshimin e foljes sipas vetës dhe numrit.

Kohët e foljes

Folja mund të shprehë një veprim që kryhet në çastin kur flasim, para këtij çasti ose pas këtij çasti, p.sh.:

- në çastin kur flasim (në të tashmen): *Unë po bëj hartimin.*
- para çastit kur flasim (në të shkuarën): *Unë e bëra hartimin.*
- pas çastit kur flasim (në të ardhmen) : *Unë do të bëj hartimin.*



Në të shkuarën dallojmë 5 kohë: *të pakryerën, të kryerën e thjeshtë, të kryerën, më se të kryerën dhe të kryerën e tejshkuar.*

Në të ardhmen dallojmë dy kohë: *të ardhmen, të ardhmen e përparme.*

Le ta vendosim tani në grafik foljen **bëj** në të gjitha kohët e mundshme:

E SHKUARA	e kryer e tejshkuar: pata bërë	TANI	e tashme: bëj
	më se e kryer: kisha bërë		
	e kryer: kam bërë	E ARDHMJA	e ardhme: do të bëj
	e kryer e thjeshtë: bëra		e ardhme e përparme : do të kem bërë
	e pakryer : bëja		

A MUND TË MËSONI VETË NGA LIBRI?



- Cila është koha më e largët në të shkuarën ?
- Cila kohë e së shkuarës, tregon se veprimi nuk është përfunduar, ka qenë në të kryer e sipër?
- Cilat kohë të së shkuarës tregojnë një veprim të kryer, të përfunduar?
- Komento. Si duhet thënë: Unë i kisha blerë mollët dhe i pata ngrënë.
Apo: Unë i pata blerë mollët dhe i kisha ngrënë?
- Ç'ndryshim ka në kuptim?
Kur të vish ti, unë do të ha.
Kur të vish ti, unë do të kem ngrënë.

Mënyrat e foljes

Folja mund ta shprehë veprimin a gjendjen si diçka që *ndodh me siguri, si të mundshëm, si të kushtëzuar, si diçka që shkakton habi, si dëshirë ose si urdhër.*

Prandaj edhe ajo merr forma të ndryshme sipas mënyrave.

Në gjuhën shqipe folja ka gjashtë mënyra: dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore.

1. Mënyra dëftore shpreh një veprim a gjendje që ndodh me të vërtetë, me siguri (tani, më parë ose në të ardhmen):

Taulanti flet. Taulanti foli. Taulanti do të flasë.

2. Mënyra lidhore shpreh një veprim a gjendje që mund të ndodhë ose mund të kishte ndodhur:

- Të shkojmë te Krenari sa më shpejt! Sa mirë, sikur të kishim shkuar më parë!

3. Mënyra kushtore shpreh një veprim a gjendje që kushtëzohet nga një veprim tjetër:

- Po ta dija, do të vija edhe unë.

4. Mënyra habitore shpreh një veprim a gjendje që shkakton habi.

- Paske shkuar ti?!

5. Mënyra dëshirore shpreh një veprim a gjendje që e dëshirojmë:

- U gëzofsh me nipër e mbesa! E kalofshi mirë!

6. Mënyra urdhërore shpreh një veprim a gjendje në formë urdhri, kërkesë, këshille:

- Shko edhe ti me shokët. Nisu, të thashë!

Folja ka edhe disa forma që nuk ndryshojnë sipas vetës numrit dhe kohës. Këto quhen forma të pashtjellura dhe janë:

pjesorja: *mësuar, kapur, ngritur, pasur, qenë;*

përcjellorja: *duke mësuar, duke kapur, duke ngritur, duke pasur, duke qenë;*

paskajorja: *për të mësuar, për të kapur, për të ngritur, për të pasur, për të qenë;*

mohorja: *pa mësuar, pa kapur, pa ngritur, pa pasur, pa qenë.*

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Bëj në fletore tabelën, dhe në vend të foljes bëj, vër foljen punoj. Në cilën vetë, numër dhe mënyrë është folja që shkrove?

2. Thuaj në ç'mënyrë është përdorur folja në secilën fjali.

1. *Ylli i mëngjesit po ndrinte / dhe bilbilat po këndonin./ Vesa gjithnjë po binte / e lulet lulëzonin.*

2. *- Mirë se erdhe, o verë, / që na prure mirësinë. / Dhe për shumë vjet të tjerë / e zbukurofsh Shqipërinë!* 3. *- Gëzohu, - tha nëna, - se u kthye vëllai.*

4. *- Ju uroj të dilni faqebardhë, - na tha mësuesi.*

5. *- Kush për mua thënka se nuk di të punoj në kompjuter?!*

6. *- Po të ishe stërvitur më shumë, do të dilje i pari.*



Ndahuni në grupe prej 4 vetash dhe krijoni 12 fjali me foljet *kaloj* e *vij*, duke i përdorur në të gjitha mënyrat. *Fiton grupi që e kryen detyrën brenda kohës së caktuar dhe më saktë.*

- Shkruaj format joveprore të foljeve në formën veprorë: *shtrij, shtriva, kam shtirirë; kap, kapa, kam kapur; ngre, ngrita, kam ngritur.*
- Formo format e tjera të pashtjelluara duke u nisur nga pjesoret: *menduar, dhënë, lënë, vajtur.*

ZGJEDHIMI I FOLJES DHE FOLJET NDIHMËSE

Të gjitha format që merr folja gjatë përdorimit në mënyra, kohë, veta dhe numra të ndryshëm, përbëjnë atë që quhet **zgjedhim i foljes**.

Sipas mbaresës që marrin në formën veprorë, koha e tashme, veta e parë, numri njëjës i mënyrës dëftore. Foljet ndahen në tri zgjedhime:

1. Zgjedhimi i parë: foljet me **j** në fund → (unë) *punoj, shkruaj*;

2. Zgjedhimi i dytë: foljet me një bashkëtingëllore tjetër, të ndryshme nga **j**, në fund → (unë) *hap, flas, mbjell*;

3. Zgjedhimi i tretë: foljet me zanore në fund → (unë) *ha, rri*.

Në cilëndo mënyrë e formë të ndryshme të të jepet një folje, mendoje në mënyrën dëftore duke i vënë përpara **unë sot** dhe shiko me çfarë mbaron. P.sh., *luajtkan, zënçin, kape: (unë sot) luaj (I); (unë sot) kap (II)*.

FOLJET NDIHMËSE

Disa folje kanë zgjedhim të veçantë. Të tilla janë foljet **kam dhe jam**, të cilat quhen edhe folje ndihmëse. Folje ndihmëse është një folje që i shton kuptim funksional fjalisë në të cilën ndodhet.

Zgjedhimi i foljeve ndihmëse kam dhe jam, duhet mësuar mirë, se këto folje marrin pjesë në formimin e disa kohëve të foljes, si: *e kryera (kam mësuar), më se e kryera (kisha mësuar), e kryera e tejshkuar (pata mësuar) dhe e ardhmja e përparme (do të kem mësuar)*.

Zgjedhimi i foljeve kam, jam në mënyrën dëftore

Koha	e tashme	e pakryer	e kr.e thjeshtë	e kryer
Njëjës I	kam jam	kisha isha	pata qeshë	kam pasur kam qenë
Njëjës II	ke je	kishe ishe	pate qe	ke pasur ke qenë
Njëjës III	ka është	kishte ishte	pati qe	ka pasur ka qenë
Shumës I	kemi jemi	kishim ishim	patëm qemë	kemi pasur kemi qenë
Shumës II	keni jeni	kishit ishit	patët qetë	kemi pasur kemi qenë
Shumës III	kanë janë	kishin ishin	patën qenë	kanë pasur kanë qenë
Koha	më se e kryer	e kr. e tejshk	e ardhme	e ardh. e përp.
Njëjës I	kisha pasur kisha qenë	pata pasur pata qenë	do të kem do të jem	do të kem pasur do të kem qenë
Njëjës II	kishe pasur kishe qenë	pate pasur pate qenë	do të kesh do të jesh	do të kesh pasur do të kesh qenë
Njëjës III	kishte pasur kishte qenë	pati pasur pati qenë	do të ketë do të jetë	do të ketë pasur do të ketë qenë
Shumës I	kishim pasur kishim qenë	patëm pasur patëm qenë	do të kemi do të jemi	do të kemi pasur do të kemi qenë
Shumës II	kishit pasur kishit qenë	patët pasur patët qenë	do të keni do të jeni	do të keni pasur do të keni qenë
Shumës III	kishin pasur kishin qenë	patën pasur patën qenë	do të kenë do të jenë	do të kenë pasur do të kenë qenë

Zgjedhimi i foljes në mënyrën dëftore laj, kap, zë

Le t'i zgjedhjmë foljet e të tria zgjedhimeve: laj, kap, zë, në formën veprorë dhe joveprorë, në të gjitha kohët e mënyrës dëftore:

Njëjës	I	II	III
E tashme	laj lahem lap kapem zë zihem	lan lahesh kap kapesh zë zihesh	lan lahet lap lapet lë zihet
E pakryer	laja lahesha kapja kapesha zija zihesha	laje laheshe kapje kapeshe zije ziheshe	lante lahej kapte kapej zinte zihej
E kryer e thjeshtë	lava u lava kapa u kapa zura u zura	lave u lave kape u kape zure u zure	lau u la kapi u kap zuri u zu
E kryer	kam larë jam larë kam kapur jam kapur kam zënë jam zënë	ke larë je larë ke kapur je kapur ke zënë je zënë	ke larë je larë ke kapur je kapur ke zënë je zënë



Punoni në grupe prej katër deri gjashtë nxënës dhe krijoni fjali me foljet: *mësoj, këndoj, organizoj*, duke i përdorur në të gjitha mënyrat.

Fiton grupi që e kryen detyrën brenda kohës së caktuar nga mësuesi dhe me saktësi.

- Shkruaj format joveprorë të foljeve në formën veprorë: *mësoj, organizoj, kam hapur; mbyll, zura, kam hipur; mbështes, zbrita, kam zbritur.*
- Formo format e tjera të pashtjelluara duke u nisur nga pjesoret e foljeve: *punuar, kënduar, kërcyer.*

Më se e kryer	I kisha larë isha larë kisha kapur isha kapur kisha zënë isha zënë	II kishe larë ishe larë kishe kapur ishe kapur kishe zënë ishe zënë	III kishte larë ishte larë kishte kapur ishte kapur kishte zënë ishte zënë
E kryer e tejshkuar	pata larë qeshë larë pata kapur qeshë kapur pata zënë qeshë zënë	pate lare qe larë pate kapur qe kapur pate zënë qe zënë	pati larë qe larë pati kapur qe kapur pati zënë qe zënë
E ardhme	do të laj do të lahem do të kap do të kapem do të zë do të zihem	do të lash do të lahesh do të kapësh do të kapesh do të zësh do të zihesh	do të lajë do të lahet do të kapë do të kapet do të zërë do të zihet
E ardhme e përparme	do të kem larë do të jem larë do të kem kapur do të jem kapur do të kem zënë do të jem zënë	do të kesh larë do të jesh larë do të kesh kapur do të jesh kapur do të kesh zënë do të jesh zënë	do të ketë larë do të jetë larë do të ketë kapur do të jetë kapur do të ketë zënë do të jetë zënë
Shumës	I	II	III
E tashme	lajmë lahemi lapim lapemi zënë ziheni	lani laheni kapni kapeni zini ziheni	lajnë lahen kapin kapen zënë zihen
E pakryer	lanim laheshim kapnim kapeshim zinim ziheshim	lanit laheshit kapnit kapeshit zinit ziheshit	lanin laheshin kapnin kapeshin zinin ziheshin

E kryer e thjeshtë	lamë u lamë kapëm u kapëm zumë u zumë	latë u latë kapët u kapët zutë u zutë	lanë u lanë kapën u kapën zunë u zunë
E kryer	kemi larë jemi larë kemi kapur jemi kapur kemi zënë jemi zënë	keni larë jeni larë keni kapur jeni kapur keni zënë jeni zënë	kanë larë janë larë kanë kapur janë kapur kanë zënë janë zënë
Më se e kryer	kishim larë ishim larë kishim kapur ishim kapur kishim zënë ishim zënë	kishit larë ishit larë kishit kapur ishit kapur kishit zënë ishit zënë	kishin larë ishin larë kishin kapur ishin kapur kishin zënë ishin zënë
E kryer e tejshkuar	patëm larë qemë larë patëm kapur qemë kapur patëm zënë qemë zënë	patët larë qetë larë patët kapur qetë kapur patët zënë qetë zënë	patën larë qenë larë patën kapur qenë kapur patën zënë qenë zënë
E ardhme	do të lajmë do të lahem do të kapim do të kapemi do të zëmë do të zihemi	do të laniu do të lani do të kapni do të kapeni do të zini do të zihen	do të lajnë do të lahen do të kapin do të kapen do të zënë do të zihen
E ardhme e përparme	do të kemi larë do të jemi larë do të kemi kapur do të jemi kapur do të kemi zënë do të jemi zënë	do të kemi larë do të jemi larë do të kemi kapur do të jemi kapur do të kemi zënë do të jemi zënë	do të kenë larë do të jenë larë do të kenë kapur do të jenë kapur do të kenë zënë do të jenë zënë

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Duke ndjekur modelin e zgjedhimit të foljes *laj*, zgjedho me gojë foljen *thaj* në të dyja format (veprore - joveprore), në të gjitha kohët e mënyrës dëftore.
2. Duke ndjekur modelin e zgjedhimit të foljes *kap*, zgjedho me gojë foljen *rrit* (veprore - joveprore) në të gjitha kohët e mënyrës dëftore.
3. Sipas modelit të zgjedhimit të tretë të foljes *zë*, zgjedho me gojë në të dyja format (veprore - joveprore) foljen *lë*.

A MUND TË MËSONI VETË NGA LIBRI?



- Ndërto në fletore tabelën e zgjedhimit të foljeve **fut** (veprore - joveprore), mësoj. (veprore - joveprore), **vë** (veprore - joveprore) në kohën e pakryer të mënyrës dëftore.
- Për foljet e mësipërme, ndërto tabelën e zgjedhimit në kohën më se të kryer, të mënyrës dëftore.

Mënyra lidhore

Njëjës	I	II	III
E tashme	të laj të lahem të kap të kapem të zë të zihem	të lash të lahesh të kapësh të kapesh të zësh të zihesh	të lajë të lahet të kapë të kapet të zërë të zihet
E pakryer	të laja të lahesha të kapja të kapesha të zija të zihesha	të laje të laheshe të kapje të kapeshe të zije të ziheshe	të lante të lahej të kapte të kapej të zinte të zihej
E kryer	të kem larë të jem larë të kem kapur të jem kapur të kem zënë të jem zënë	të kesh larë të jesh larë të kesh kapur të jesh kapur të kesh zënë të jesh zënë	të ketë larë të jetë larë të ketë kapur të jetë kapur të ketë zënë të jetë zënë

Më se e kryer	të kisha larë të isha larë të kisha kapur të isha kapur të kisha zënë të isha zënë	të kishe larë të ishe larë të kishe kapur të ishe kapur të kishe zënë të ishe zënë	të kishte larë të ishte larë të kishte kapur të ishte kapur të kishte zënë të ishte zënë
Shumës	I	II	III
E tashme	të lajmë të lahemi të kapim të kapemi të zëmë të zihemi	të lani të laheni të kapni të kapeni të zini të ziheni	të lajnë të lahen të kapin të kapen të zënë të zihen
E pakryer	të lanim të laheshim të kapnim të kapeshim të zinim të ziheshim	të lanit të laheshit të kapnit të kapeshit të zinit të ziheshit	të lanin të laheshin të kapnin të kapeshin të zinin të ziheshin
E kryer	të kemi larë të jemi larë të kemi kapur të jemi kapur të kemi zënë të jemi zënë	të keni larë të jeni larë të keni kapur të jeni kapur të keni zënë të jeni zënë	të kenë larë të jenë larë të kenë kapur të jenë kapur të kenë zënë të jenë zënë
Më se e kryer	Të kishim larë Të ishim larë Të kishim kapur Të ishim kapur Të kishim zënë Të ishim zënë	të kishit larë të ishit larë të kishit kapur të ishit kapur të kishit zënë të ishit zënë	të kishin larë të ishin larë të kishin kapur të ishin kapur të kishin zënë të ishin zënë

Format e pashtjelluara

pjesorja	paskajorja	përcjellorja	forma e pashtjelluar mohore
larë	për të larë për t'u larë	duke larë duke u larë	pa larë pa u larë
kapur	për të kapur për t'u kapur	duke kapur duke u kapur	pa kapur pa u kapur
zënë	për të zënë për t'u zënë	duke zënë duke u zënë	pa zënë pa u zënë

A MUND TË MËSONI VETË NGA LIBRI?



- Ç'fjalëz kanë gjithnjë përpara foljet në mënyrën lidhore?
- Cilat nga kohët e mënyrës lidhore dalin krejt njëjloj si në mënyrën dëftore, po t'u heqim fjalëzën që kanë përpara?

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Sipas modelit të zgjedhimit të foljes *laj*, zgjedho me gojë dhe me shkrim në fletore foljen mësoj në të dyja format (veprore - joveprore) në mënyrën dëftore.

2. Sipas modelit të zgjedhimit të foljes *kap*, zgjedho me gojë dhe me shkrim në fletore foljen hap në mënyrën lidhore.

Më poshtë në tabelë, plotëso me laps!

Njëjës	I	II	III
E tashme	laj lan lan		
E pakryer			
E kryer			

**TEST
(VETË) VLERËSIM**

Kontrollo njohuritë për foljen.

Zgjidh një nga kutitë (të blertë ose të hirtë) të ndryshme nga shoku i bankës.

1. Gjej kohët e foljeve:

1 pikë

punuakam, krihem, vënça, të mbyllja, të nderoheshim, do të flija, u gëzofsh, ngrënkeni, pata menduar

mësofshin, lahesh, rritu, të kem ngrënë, të qetësohem, do të ecnit, u shërofshin, u hapkan, kishe parë

2. Kopjo tekstin dhe nënvizo foljet. Për çdo folje të nënvizuar trego me shkrim: mënyrën, kohën, vetën, numrin, dhe funksionin që kryen në fjali.

3 pikë

Fëmijët e kishin parë ariun.
- Ja, duket atje pas gëmushës, - tha Besmiri.
- Të largohemi shpejt, se është i rrezikshëm

- Alo! ...A është në shtëpi Beni?
- Beni ka shkuar te mjeku, se do të vizitohet. Mbrëmë pati temperaturë.
- U shëroftë së shpejti!

3. Lexo fjalitë: Atëherë e kuptova se pata fjetur shumë. Tani po e shoh se kisha gabuar rëndë.

2 pikë

a) Shndërroji këto fjali duke i vënë foljet:

në vetën e tretë, numri njëjës.

në vetën e tretë, numri shumës.

b) Shkruaji fjalitë e shndërruara.

4. Shkruaj foljen e mëposhtme në mënyrën dëftore (në kohët: e tashme, e kryer e thjeshtë, e ardhme, në vetat I, II, III, njëjës dhe shumës).

3 pikë

për të parë

për të shkruar

5. Shkruaj fjalitë. Në vend të foljes me shkronja të pjerrëta vër pjesoren dhe në vend të foljeve me shkronja të zeza vër formën e pashtjelluar mohore.

1 pikë

Në qiell, re të zymta rrinin (var), (lëviz) fare.

Ja qyteti, (mbështjell) nën rrobat gri të dimrit. Kishte kohë (bie) shi.

Provoni njohuritë që keni

1. Lexo fjalitë më poshtë.

- Dëbora binte ngadalë e rrugët mbuloheshin pak nga pak me çarçafin e saj të bardhë.
- Që të tre ata kishin qenë dikur shokë në shkollën e mesme, dhe ngjiteshin në mal.
- I quanin alpinistë, por ishin lodhur shumë nga ecja në dëborë.
- Pse jeni kaq të emocionuar nga dëbora?

2. Gjej te fjalitë e mësipërme fjalët që tregojnë një rrethanë të kryerjes së veprimit të shprehur nga folja. Çfarë tregojnë ato: vend, kohë, mënyrë, sasi apo shkak?



Ndajfolja

Është fjalë e pandryshueshme që tregon rrethanën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja. Sipas kuptimit që shprehin, ndajfoljet janë disa llojesh:

- **ndajfolje mënyre**, që tregojnë mënyrën se si kryhet një veprim: **mirë, bukur, keq, shpejt, fuqishëm, burrisht, rrjedhshëm, barkazi, ngadalë, lehtë, pastër, qartë, përzemërsisht, më të mirë, copë - copë etj.**

Diskutimin e Gëzimit e duartrokitën, nxehtësisht të gjithë pjesëmarrësit.

- **ndajfolje kohe**, që tregojnë kohën kur kryhet një veprim: **gjithnjë, dje, sot, mbrëmë, nesër, pastaj, kurrë, përditë, pasdreke, tani, vjet, dikur, kurdo, nganjëherë, herë pas here etj.**

Nesër do të shkojmë me klasën në panairin e librit.

- **ndajfolje vendi**, që tregojnë vendin ku kruhet një veprim: **atje, andej, kënde, këtu, afër, larg, lart, poshtë, pranë, brenda, jashtë, kudo, djathtas, majtas, diku, askund, kurrkund.**

Dielli gjigant po kridhej atje tej, në horizontin e largët.

- **ndajfolje sasi**, që tregojnë sasi, në ç'masë realizohet veprimi i shprehur nga folja: **shumë, pak, tepër, aq, kaq, për së tepërmi, një herë, dy herë etj.**

Folën shumë, sa u lodhëm, por pak u morën vesh.

- **ndajfolje shkak**, shërben për të pyetur për shkakun e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja: **pse?**

Pse shkove te shtëpia e Petritit?

- **ndajfolja e qëllimit**: **përse**, përdoret për të pyetur për qëllimin e kryerjes së një veprimi:

Përse (për çfarë qëllimi) më kërkon?

Drejtshkrimi i ndajfoljeve

! KUJDES

- Ndajfoljet: **lart, kot, plot, thjesht, shpejt, drejt, fort, mjaft, mbrapsht**, shkruhen pa ë në fund.
- Ndajfoljet: **copë - copë, fije - fije, herë - herë, dita - ditës, këmba - këmbës, valë - valë** etj., të formuara nga përsëritja e një fjale, shkruhen me vizë në mes.
- Shprehjet ndajfoljore: **ditë për ditë, krah për krah, sot për sot, rreth e rrotull, për së afërmi, për së mbari** etj., shkruhen ndaras.

Ndajfoljet, ashtu si mbiemrat përdoren në shkallë të ndryshme:

Pohore – Për të bërë portretin e Gazmendit, duhet ta njohësh **mirë** atë.

Krahasore – Për të bërë portretin e Gazmendit, duhet ta njohësh **më mirë** atë.

Sipërore – Për të bërë portretin e Gazmendit, duhet ta njohësh **shumë (fare, jashtëzakonisht) mirë** atë.

Përdoren në të tria shkallët zakonisht ndajfoljet e mënyrës, si edhe disa ndajfolje vendi e kohe.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Nënvizoni ndajfoljet dhe thuaj ç’lloj janë:

1. Blerina flet rrjedhshëm dhe reciton bukur.
2. Kaloni djathtas tek ai shteg, atje sepse andej rruga ju bie më shkurt.
3. Pse mungove dje në stërvitje?
4. Sikur ta njihje më mirë Albin, do të flisje ndryshe.
5. Hurmat e kopshtit tonë ishin ngarkuar plot e përplot.
6. Tani unë ndodhesha përsëri në fshatin tim të dashur, me të cilin më lidhnin fort tërë ato kujtime.
7. Sa qenke rritur, more bir!
8. Era e malit i shpërndante tingujt e këngës gjithandej.
9. Kallinjtë e rënduar nga kokrrat lëkundeshin ngadalë.
10. Salla e madhe e koncerteve ishte mbushur plot.
11. Rri shtrembër, fol drejt.
12. Sa mban fshati juaj që këtu?
13. Majtas gjarpëronte një vijë e paktë uji.
14. Tana i ngjan shumë gjyshes së saj.
15. Nganjëherë makina e shtonte shumë shpejtësinë.

2. Krijoni dhe shkruajni fjali si shembuj për pesë llojet e ndajfoljeve. Nënvizoni ndajfoljet dhe shëno llojin e tyre.

3. Plotësoni sipas shembullit dhe shkruajni fjalë ku të përdoren këto fjalë.

Cilës klasë fjalësh i përkasin?

Ç’duhet të mbash mend për drejtshkrimin e tyre?


lart	–	i lartë
shpejt	–	_____
drejt	–	_____
plot	–	_____
fort	–	_____
kot	–	_____

4. Shkruajni fjalinë e mëposhtme, nënvizoni ndajfoljet dhe tregoni llojin e tyre.

Shkruajni edhe dy fjali ku këto ndajfolje t’i përdorësh një herë në shkallën krahasore dhe një herë në shkallën sipërore.

U ngrita herët dhe pashë në parvazin e dritares bashka bore që dukeshin bukur.

Provoni njohuritë që keni



1. Shkruaj nga një fjali për secilën skemë dhe nënvizo fjalët që vure në vend të "L", fjala që do të shërbejë për lidhje.
2. Cila është fjali thjeshtë dhe cila fjali e përbërë? Pse?
3. Përse shërbejnë në fjali fjalët që vure në vend të "L"? A mund të ndryshojnë formë ato? Provo. Si i quajmë?

2. Eksursionistët do të vizitojnë Krujën

L

do të... (tregoni qëllimin e vizitës)

Lidhëzat

Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme që bashkojnë dy gjymtyrë fjalie ose dy pjesë të një fjalie të përbërë.

Meqenëse nuk kanë kuptim të pavarur, lidhëzat, ashtu si dhe parafjalët, nuk mund të jenë gjymtyrë fjalie.

Për nga mënyra si janë krijuar, lidhëzat janë:

- **të thjeshta:** e, dhe, po, që, se, kur, si, sa etj.
- **të përngjitura:** janë formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve, gjatë përdorimit për një kohë të gjatë pranë njëra-tjetrës: edhe, kurse, sesa, posi, meqenëse, ndonëse etj.
- shprehje lidhëzore (që nuk janë bashkuar ende në një fjalë të vetme) në qoftë se, edhe pse, që kur, me qëllim që etj.

Lidhëzat ndahen në dy grupe të mëdha: Lidhëza bashkërenditëse dhe lidhëza nënrenditëse.

1. **Lidhëzat bashkërenditëse** - bashkojnë gjymtyrë ose pjesë që kanë të njëjtën vlerë.
 - gjymtyrë - Vera ose Artani do të shkruajnë një reportazh për këtë ngjarje.
 - pjesë - Shqiponja fluturon në qiell, por shtëpinë e bën në tokë.

Sipas kuptimit lidhëzat bashkërenditëse ndahen në tri grupe.
2. **Lidhëzat shtuese**, që janë: e; edhe; dhe; si edhe; as..., as; si..., ashtu edhe; jo vetëm..., por (edhe); jo vetëm që..., por as etj.
Folklori ynë muzikor është i lashtë dhe i bukur.
 - Lexoje fjalinë duke përdorur lidhëzat e tjera bashkërenditëse shtuese: e; dhe; si edhe; si..., ashtu edhe; jo vetëm..., por edhe.
3. **Lidhëzat veçuese**, që janë: ose; apo; a; ja..., ja; o..., o etj.
Ninullat quhen ndryshe këngë djepi ose nina-nana.
 - Lexoje fjalinë duke përdorur lidhëzat e tjera bashkërenditëse veçuese: a; ja..., ja; o..., o.
4. **Lidhëzat kundërshtore**, që janë: po, por, kurse, mirëpo, veçse etj.
Muri luan, por besa s'luan.
 - Lexoje fjalinë e përbërë duke përdorur midis pjesëve lidhëzat e tjera bashkërenditëse



KUJDES

Para një lidhëze të përsëritur, para pjesës së dytë të një lidhëze dypjesëshe dhe para lidhëzave kundërshtore vihet gjithnjë presje.

Lidhëzat nënrenditëse - Bashkojnë pjesë të një fjalie të përbërë që nuk kanë të njëjtën vlerë: njëra është kryesore, tjetra e nënrenditur.

Kënga e popullit ka lindur pas çdo rrebeshi

ashtu siç shfaqet

ylberi pas furtunës.

Sipas kuptimit, lidhëzat nënrenditëse ndahen në:

- ftilluese:** se, që, në, nëse.
Vura re se Gjergji i mbante librat me shumë kujdes.
- vendore:** ku, tek, nga, etj.
Tek mbaronte pylli, binte si thikë një shkëmb i zhveshur.
 - Cila është pjesa kryesore në këtë fjali të përbërë ?
- kohore:** kur, qëkur, derisa, porsa, sapo, para se, pasi, as herë që etj.
Mësuesi na buzëqeshte sa herë që e takonim.
 - Lexoje fjalinë duke përdorur lidhëza të tjera nënrenditëse në vend të sa herë që.
- shkakore:** se, sepse, për shkak se, meqë, meqënëse, ngaë etj.
Mëngjezi ishte i lagësht, se gjatë natës kishte rënë shumë shi.
 - Lexoje fjalinë duke përdorur lidhëza të tjera nënrenditëse shkakore.
- qëllimore:** që, me qëllim që.
Njeriu duhet të përpiqet shumë, që të bëhet mjeshtër i zoti.
 - Provo të përdorësh lidhëzën tjetër qëllimore.
- mënyrore:** si, sikur, siç, ashtu si, ashtu siç.
Puna e kishte gjallëruar siç gjallërohen bisqet e plepit në pranverë.
 - Lexoje fjalinë duke përdorur lidhëzat nënrenditëse mënyrore si, ashtu si, ashtu siç.
- krahasore:** sa, aq sa, se, sesa, nga sa etj.
S'të vret plumbi, sa të vret fjala.
Më mirë të jetosh një ditë në liri, sesa të lëngosh njëqind vjet në robëri.
- sasiore:** sa, aq sa etj.
E mbusha valixhen, sa nuk merrte më.
- rrjedhimore:** kështu që etj.
Futbollistët tanë janë stërvitur mirë, kështu që do ta fitojnë ndeshjen.
- kushtore:** po, po qe se, në qoftë se, nëse, në rast se etj.
 - Provo me lidhëza të tjera.
- lejore:** megjithëse, ndonëse, sado që, megjithëqë, edhe pse etj.
Shqipëri, o mëma ime, ndonëse jam i mërguar, dashurinë tënde kurrë zemra se ka harruar.
 - Provo me lidhëzat e tjera.

- 1. Dallo lidhëzat. Thuaj nëse bashkojnë dy gjymtyrë fjalie apo dy pjesë të një fjalie të përbërë.**
 1. Të gjithë ndiejnë mall e dashuri, kur kujtojnë mësuesin e parë.
 2. Gjahtarin s'e mundonte as lodhja, as etja, as uria.
 3. Ku dhemb dhëmbi, vete gjuha.
 4. E ndiente veten edhe të kënaqur, edhe të lumtur në mes të të rinjve.

- 2. Lidhëzat e mëposhtme shkruaji në tri shtylla: të thjeshta, të përngjitura, shprehje lidhëzore.**
ose, kurse, si edhe, apo, ndërsa, mirëpo, sa, saqë, aq sa, për, dhe, nëse, se, sepse, që, tek, kur, derisa, që kur, para se, meqenëse, për shkak se, si, ashtu si, sikur, sesa, nga sa, kështu që, në qoftë se, nëse, megjithëse, sado që.

- 3. Shkruaji fjalitë. Nënvizo me një vizë lidhëzat bashkërenditëse dhe me dy vija lidhëzat nënrenditëse. Shëno poshtë vijës llojin.**
 1. Jo vetëm Veriun e Shqipërisë së Mesme, por edhe Jugun e shëtiti Kristoforidhi për të mbledhur visarin gjuhësor të popullit.
 2. Kur vdiq Skënderbeu, Sulltani tha: Tani Europa dhe Azia janë të miat! Mjerë Europa, se i humbi shpata dhe mburoja.
 3. Sa rron, mëson.
 4. As Verës, as Dritës nuk i shkoi në mendje një zgjidhje e tillë.

- 4. Shkruaj pjesën duke vënë në vend të pikave një nga lidhëzat: edhe, dhe, sido që, e, sikur, kur. Nënvizo me një vizë lidhëzat bashkërenditëse dhe me dy vija nënrenditëset.**
Barka kishte lënë pas ishullin... po voziste drejt Viroit. Hëna s'kishte përcaktuar ende, ... së shpejti do të zbardhëllente. Ishte një nga ato netët e ftohta të vjeshtës së dytë, ... hëna, ... të mërdhinte ... ajo, priste të lindte dielli, të ngrohej paksa nga rrezet e tij të nxehta ... pastaj të merrte përsëri rrugën prapa botës për të ndriçuar ... faqen tjetër të globit.

- 5. Dallo lidhëzat dhe thuaj llojin e tyre.**
 1. Pasi u korrën misërishtet e verdha, u duk trualli i tokës i veshur me bar të gjelbër.
 2. Moshë mund të na ikë, por zemra s'na plakët kurrë.
 3. As fyell s'dëgjohej, as këngë s'dëgjohej.
 4. O mbaje fjalën, o mos e jep fare.
 5. Ajo ishte një guvë e gjerë, sa mund të hynte një tufë e tërë me dhen.
 6. Blegtorët rrinë tërë kohën jashtë, kështu që pyesin çdo ditë për kohën.
 7. Shtëpizat e lyera me gëlqere e ruanin bardhësinë e tyre, ndonëse ishin lagur vende-vende nga shiu.
 8. Bashkimi përgatitej që të jepte provimet.

- 6. Shkruaj këto vargje të Naim Frashërit duke vënë në vend të pikave një nga lidhëzat: e, po, kur, qysh, a, edhe, tek, edhe në. Shëno anash llojin e lidhëzave.**
...dëgjon zëthin e s'ëmës, ... e lë qengji kopenë, blegërin dy ... tri herë ... ikën e merr dhenë, ... i përfshin udhën njëzet ... tridhjetë vetë ... ta trembin, ai s'kthehet, ... shkon në mes si shigjetë, ashtu edhe zemra ime më le këtu, ... jam, mua, vjen me vrap ... me dëshirë aty ndër viset e tua.

Provoni njohuritë që keni

Plotëso fjalitë e mëposhtme me fjalët e duhura.

1. Po të kishte frikë bujku ... krimbat ... arë, nuk do të mbillte kurrë farë.
2. Brazda e ujit të shpie ... burimi.
3. Ruaju ... lavdia personale.
4. Çdo njeri duhet të mësojë si nxirret buka ... djersën e ballit.
5. Njeriu ... shokë është si muri. ... tokë.
6. Mos u mat ... hijen e mëngjesit.
7. Rrëketë ishin fryrë ... ujërave pranverore.

Fjalët që shtove (nga, në, te, me, pa, mbi, prej, janë parafjalë. Shiko para cilave fjalë janë përdorur dhe cilës klasë i përkasin këto të fundit.

Parafjala

Është fjalë e pandryshueshme që shërben për t'i lidhur fjalët në fjali e për të shprehur një marrëdhënie varësie ndërmjet tyre. Më shpesh lidh një emër me një folje.

Sipas rasave në të cilat përdoren, parafjalët ndahen në:

Parafjalë të rasës emërore: nga, te (tek)

Skënderbeu i bëri të dridheshin nga marazi sulltanët më të tmerrshëm të atyre kohëve.

Mbasdite shkuam te Kliti për të luajtur shah. Tek oborri i shtëpisë së tij nuk ndihet vapa.

Drejtshkrimi i parafjalëve



KUJDES

Mbaj mend përdorimin e dy varianteve të parafjalës: **te – tek**. Parafjala tek përdoret kur fjala që vjen pas, fillon me zanore (**tek oborri**) ose me bashkëtingëlloren **t (tek, ti)**. Në rastet e tjera përdoret parafjala **te: te Kliti**.

1. **Parafjalë të rasës gjinore: me anë, në sajë, për shkak etj.** *Këto suksese ne i arritëm në sajë të përdorimit të sistemit kompjuterik.*
2. **Parafjalë të rasës kallëzore: në, me, pa, për, mbi, nën, nëpër, bashkë me, në lidhje me etj.** *Dy pëllumba të bardhë fluturuan mbi çati.*
3. **Parafjalë të rasës rrjedhore: prej, përmes, afër, krahas, buzë, ndanë, sipas, prapa etj.** *I kishin thënë se shpella prapa korijes kishte shumë pëllumba të egër.*

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Nënvizo parafjalët dhe trego të cilës rasë janë. Cilat fjalë lidhen në fjali për të treguar marrëdhënie varësie ndërmjet tyre?

1. Nga pylli me pisha doli një dhelpër me bisht të gjatë e të kuq. 2. Ekskursionistët u mblodhën që herët te sheshi i shkollës. 3. Era përdridhte në vorbullën e saj gjethet e fundit. 4. Rëra përvëlonte nga dielli i nxehtë i orës dymbëdhjetë. 5. Blerta u gëzua për vendosmërinë e shoqes. 6. Pleqtë e fshatit qenë mbledhur përreth trungut të ullirit. 7. Dielli pranveror shkëlqente me dritën e tij verbuese. 8. Në grykën midis kodrave ka burime nëntokësore. 9. Atë ditë lliri kishte një mbledhje me rëndësi. 10. Dhoma e madhe ishte ushtruar me qilima. 11. Vendi zinte nga cicërimat e zogjve. 12. Turistët kaluan përmes tregut të bakërpunuesve.

2. Krijë dhe shkruaj dy fjali ku të përdorësh parafjalën te, dhe dy të tjera ku të përdorësh parafjalën tek. Thuaj rregullën.

3. Fjalët prapa, poshtë, pranë përdori në fjali një herë si ndajfolje vendi dhe një herë si parafjalë të rasës rrjedhore. Shkruaj fjalitë dhe nënvizoj me një vijë parafjalët e me dy vija ndajfoljet.

Provoni njohuritë që keni

Era e lehtë, flad aromatik vjeshte, lëvrinte mbi zallishte si një puhizë jetëdhënëse.

- Cilat janë fjalët që formojnë këtë fjali? Shqiptoji një e nga një.
- Lako në numrin njëjës emrin *era*.
- Zgjedho në kohën e pakryer të mënyrës dëftore foljen *lëvrij*. Ç'ndodh me pjesën e fundit të këtyre fjalëve gjatë lakimit dhe zgjedhimit?
- Cilat fjalë nuk mund të zbërthehen në pjesë përbërëse dhe cilat mund të zbërthehen dhe si?

Fjala dhe përbërësit e saj

Tema dhe mbaresa

Fjalët e ndryshueshme (emri, folja, mbiemri, përemri) gjatë përdorimit në fjali marrin forma të ndryshme. *era-erës-erën; fladi-lladit-lladin; lëvrinte-lëvrinin; jetëdhënëse-jetëdhënëse; ai-atë* etj.

Pjesa e fjalës që ndryshon gjatë përdorimit në fjali, quhet **mbaresë**.

Mbaresa nuk ia ndryshon kuptimin fjalës, por i jep formën e duhur gjatë lakimit (për emrin p.sh.) ose gjatë zgjedhimit (për foljen), për t'u lidhur me fjalë të tjera të fjalisë:

flad-i, flad-it, flad-in

lëvrij - lëvrij-a,- lëvrij-e

Me ndihmën e mbaresës shpesh krijohet edhe forma e shumësit: *lis - lis-a ma l- mal-e*.

Pjesa e fjalës që mbetet pasi hiqet mbaresa, quhet **temë**. Tema shpreh kuptimin e fjalës.



KUJDES

Për të dalluar **temën** e një fjale veprojmë kështu:

për **emrin**: e vëmë në rasën emërore, të pashquar, njëjës. P.sh.: lisave - (një) lis (**tema**) (a dhe ve janë dy **mbaresa**: e para e shumësit (një lis-ca lisa), kurse e dyta mbaresë e rasës (lisa-lisave etj.)
folja: kapja- kap (tema) (ja-mbaresë për vetën e parë të kohës së pakryer të mënyrës dëftore).

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Gjej temën dhe mbaresën (në qoftë se ka).

- detit, lisiin, maleve, nxënësit, mur, gurë, miqësinë
- mësojmë, përhapim, vështroi, mbyll, mbyllnim, kapi, shfletova, shkonit.

2. Shpjego me gojë ç'ndryshime kanë pësuar në temë emrat e mëposhtëm:

zogj, pleq, miq, (ca) desh, peshq, ujq, fiq

Përse shërben ky ndryshim?

3. Lexo strofat. Gjej temat e fjalëve me shkronja të zeza.

I dëgjoi djaloshi këngët,

fjalët e dheut të ndritur,

tok me qumështin e nënës,

gjuhën shqipe pati thithur.

Në çdo këng'ish'baltë e vendit,

ishte mali me lajthi,

trimat dhe lulet e verës,

shpirti yt, moj Shqipëri!

Fjalë të parme dhe jo të parme

1. Fjalët që nuk mund të zërthehen në pjesë përbërëse, janë fjalë të parme:

erë, fllad, vjeshtë, lëvrin.

2. Fjalët që mund të zërthehen në pjesë përbërëse, janë fjalë jo të parme: **zallishte, puhizë, jetëdhënës (zall + ishtë, puhi + zë, jetë + dhënës).**

Fjalët jo të parme mund të jenë:

të prejardhura ose të përbëra.

Fjalët e prejardhura janë ato që formohen duke i shtuar një teme (para ose prapa) një element fjalëformues: punë + *tor* = punëtor, për + *krah* = përkrah.

Fjalët e prejardhura mund të formohen nga fjalë të parme (det+*ar*=detar) ose nga fjalë të tjera të prejardhura (punëtor (*fj. e prejardhur*) + *i* = punëtori; mendim (*fj. e prejardhur*) + *tar* = mendimtar.

Fjalët e përbëra formohen zakonisht nga dy tema: mëmë + dhe = mëmëdhe.

Rrënja e fjalës

Një varg fjalësh të prejardhura që lidhen njëra me tjetrën për nga kuptimi, kanë një pjesë të përbashkët. P.sh.: *not, notar, notues, notoj, notim*, kanë të përbashkët pjesën *not*, që përmban kuptimin e tyre bazë.

Pjesa e përbashkët e fjalëve të prejardhura që lidhen për nga kuptimi, quhet rrënjë.


Fjalët e prejardhura që kanë një rrënjë të përbashkët, formojnë një familje fjalësh.

Parashtesa dhe prapashtesa

- Te "fjalët e parme", tema përbëhet vetëm nga rrënja. Fjalët e parme det dhe krah janë edhe rrënjë, edhe temë.
- Te fjalët e prejardhura tema përbëhet nga rrënja dhe nga shtesa që i bëhen kësaj përpara ose prapa, p.sh.: *për* + hap - përhap; hap + *je* - hapje, ose nga një fjalë tjetër e prejardhur dhe nga shtesa, p.sh.: përhap + *je* - përhapje.

Pjesa që vendoset para temës (e parme ose jo) dhe që shërben për të formuar një fjalë të re, quhet parashtesë: *përdor, mbiçmoj*.

Pjesa që vendoset pas temës (e parme ose jo) dhe që shërben për të formuar një fjalë të re, quhet prapashtesë: *dorezë, hapëse*.



KUJDES

Për të dalluar prapashtesat nga mbaresat duhet të kemi parasysh se, gjatë lakimit dhe zgjedhimit, mbaresat ndryshojnë, kurse prapashtesat nuk ndryshojnë.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Thuaj ç'ndryshim ka ndërmjet fjalëve të grupit të parë dhe fjalëve të grupit të dytë.

- kopsht, qep, vesh, gur, qumësht, akull, mend 2. kopshtar, shqep, zhvesh, gurore, qumështor, akullore, përmend.
- Shpjego nëse fjalët e prejardhura të mëposhtme janë formuar nga fjalë të parme apo nga fjalë të tjera të prejardhura: stërgjyshor, arsimtar, besnik, përkrahje, copëtoj, fshatarësi, shkrimtar, çregjistroj, përpunoj, durrësak, zhvesh, përdredh,



2. Formoni grupe prej katër nxënësish dhe bëni një përshkrim të një dite pranverore duke përdorur fjalë të parme dhe të prejardhura. Fjalët e parme i nënvizoni me një vijë, kurse të prejardhurat, me dy vija.

(Fiton grupi që brenda kohës së caktuar e përfundon përshkrimin pa gabime dhe me më shumë fjalë të prejardhura.)

3. Lexo fjalët e çdo rreshti dhe shpjego pse ato formojnë një familje fjalësh.

- zemër, i zemëruar, i përzemërt, zemëroj, zemërim
- i drejtë, i padrejtë, i zhdrejtë, drejtoj, drejtësi, drejtim

4. Lexo me kujdes fjalët dhe thuaj si janë formuar.

përpikëri, rrënjos, ngjyros, përflas, parafjalë, rosak, notar, ndërpres, patok, bindës, rishkruaj, naftëtar, nëpunës, nëndetëse.

5. Gjej parashtesat dhe prapashtesat e këtyre fjalëve:

paralajmëronte, vullnetarëve, kryetarit, pasqyroheshin, padrejtësi, i lëvizshëm, joshkencor, mosbesim, përkrahjes, kuvendimeve.

6. Formo fjalë me kuptim të kundërt duke u shtuar parashtesa.

dëmtoj, palos, i fryrë, i sjellshëm, besim, bëj, i përkulshëm, aftësi, pranim, aktivizoj.

Fjalët e thjeshta dhe të përbëra

Fjalët janë të thjeshta ose të përbëra.

Fjalë të thjeshta quhen ato që kanë vetëm një temë.

Të tilla janë fjalët e parme dhe të prejardhura, p.sh.: kufi (fjalë e parme) dhe kufi-tar (fjalë e prejardhur).

Fjalë të përbëra quhen ato që kanë dy tema, p.sh.: hekurudhë (hekur+udhë),

flokëverdhe (flokë+verdhe), syshqiponjë (sy+shqiponjë).

Fjalët e përbëra janë kryesisht:

- emra - atdhe, mirëdashje, mirëkuptim;
- mbiemra - flokëkuq, zemërmirë, dorështrënguar.
- folje - buzëqesh, bashkëpunoj.

Disa fjalë të përbëra mund të kenë më shumë se dy rrënjë.

Në këto raste ato formohen nga bashkimi i dy temave: njëra e përbërë dhe tjetra e thjeshtë, madje ka raste kur të dyja temat janë të përbëra:

atdhe + dashuri = atdhedashuri

zëvendës + kryeministër = zëvendëskryeministër

Fjalët e përngjitura

Gjatë përdorimit pranë njëra – tjetrës për një kohë të gjatë, dy a më shumë fjalë mund të ngjiten në një fjalë të vetme. Fjalë të tilla quhen të përngjitura.

Fjalët e përngjitura janë kryesisht:

- përemra: kushdo (*kush + do*), askush (*as + kush*),
- numërorë: trembëdhjetë, (*tre + mbë + dhjetë*), tridhjetë (*tri + dhjetë*),
- ndajfolje: atëherë (*atë + herë*), përnjëherë (*për + një + herë*)
- parafjalë: përmbi (*për+mbi*), përmes (*për + mes*)
- lidhëza: kurse (*kur + se*), meqenëse (*me + qenë + se*).

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Shpjego kuptimin e këtyre fjalëve. Thuaj si janë formuar dhe si quhen.

udhëheq, bashkëveprim, vajguri, ditëlindje, letërkëmbim, duartrokas, zemërgur, faqebardhë, sykaltër, flokëzi, lulëkuqe, mendjemadh, bashkëbisedoj.

Cilës klasë i përkasin fjalët e mësipërme (emër etj.)?

2. Krijë fjalë të përbëra duke bashkuar një temë të grupit të parë me një temë të grupit të dytë.

a. *zemër, jetë, rroba, udhë, buzë, vend, krye, flokë, jug, shtat, lule, veri, sy, vend*

b. *shkrim, (e) mirë, qepës, trim, heqës, qesh, banim, lakër, (i) lartë, (i) verdhë, (i) patrembur, punoj, perëndim, lindje.*

3. Bëj skemën e formimit të fjalëve të përbëra të mëposhtme duke dalluar temat që bashkohen, dhe numrin e rrënjëve.

zëvendësdrejtoreshë, vajgursjellës, bashkatdhetar

Shembull: *zëvendësdrejtor*

zë vendës + drejtor



temë e përbërë nga dy rrënjë

zë vendës drejtor



temë e përbërë nga tri rrënjë

4. Cilës klase i përkasin këto fjalë? Shpjego si janë formuar dhe si quhen.

secili, aspak, sapo, nëse, ngado, asnjëherë, cilido, asnjë, megjithëqë, askush, gjithmonë, asnjëherë, pesëdhjetë, dalëngadalë.

5. Shkruaj në dy shtylla: fjalë të përbëra, fjalë të përngjitura.

vërej, gojëmbël, zemërdhembshur, kurdoherë, kudo, asnjë, flokëkaçurrel, shtathedhur, gjithandej, syshkruar, nëntëmbëdhjetë, hundëshkabë, gjithandej.

6. Shkruaj me fjalë numrat: 16, 20, 300, 70, 18, 900.

FJALIA DHE PËRBËRËSIT E SAJ

Lexoni tekstin

Rapsodi ishte një plak me mjekër të bardhë gjer në brez. Ai qe aq i moçëm, sa edhe më të moshuarit ashtu plak e mbanin mend.

Njëherë rapsodi shkoi në Krujë. Ai ndenji në krah të djathtë të Skënderbeut. Plaku i moçëm këndoi shumë bukur, prandaj Skënderbeu, pasi e përqafoi fort, i fali një lahutë. Rapsodi e mbante si bijë të vetme atë lahutë. Aty ishin trimëria, bukuria dhe jeta.

- Dikush i tha plakut:
- Do të ta vëmë edhe në varr.
- Kjo lahutë nuk duhet të kalbet në dhe. Asaj do t'i bien djemtë dhe nipat. Te ne do të ketë gjithmonë gëzime. S'shuhet këngët dhe jeta, - iu përgjigj rapsodi i moçëm.



Provoni njohuritë që keni

1. Sa fjali janë? Lexoji një nga një.

2. Shkruaje në fletore fjalinë:

Rapsodi e mbante si bijë të vetme atë lahutë.

3. Ndërroju vendin fjalëve (dy herë) dhe shkruaji fjalitë e formuara.

4. Thjeshtoi sa të mundesh, këto fjali dhe shkruaji fjalitë më të vogla.

- *Rapsodi i moshuar është një plak me mjekër të bardhë.*
- *Rapsodi i moçëm këndoi shumë bukur.*

5. Në tekstin e mësipërm tregoni:

- *një fjali pohore dhe një fjali mohore.*
- *një fjali të thjeshtë dhe një fjali të përbërë.*

Përbërësit e fjalisë së thjeshtë

Kujto nga klasa e pestë!

Në dallim nga fjalia e përbërë (që ka dy ose më shumë folje), fjalia e thjeshtë ka vetëm një folje në një nga format e zgjedhimit të saj, p.sh.: Plaku i moçëm këndoi shumë bukur.

Shpesh fjalia e thjeshtë përbëhet nga dy grupe fjalësh: grupi emëror i kryefjalës, (GE) dhe grupi foljor i kallëzuesit (GF).

Plaku i moçëm:
(Grupi emëror i kryefjalës)

Këndoi shumë bukur:
(Grupi foljor i kallëzuesit)

Si e dallojmë grupin emëror të kryefjalës?

- Grupi emëror i kryefjalës zakonisht ka si fjalë bazë një emër në rasën emërore: plaku i moçëm. Ai mund të zëvendësohet nga një përemër: Plaku i moçëm këndoi shumë bukur. Ai këndoi shumë bukur.
- Në grupin emëror të kryefjalës, plotësues të emrit janë përcaktorët (plaku i moçëm).

Si e dallojmë grupin foljor të kallëzuesit?

- Grupi foljor i kallëzuesit ka si fjalë bazë një folje në një nga format e zgjedhimit të saj: këndoi shumë bukur. (folja këndoi e ka të shprehur mënyrën (dëftore), kohën (e kryer e thjeshtë), vetën (e tretë), numrin (njëjës).
- Në grupin foljor të kallëzuesit, plotësues të foljes janë kundrinorët dhe rrethatorët: Këndoi shumë bukur (rrethator) një këngë kreshnikësh (kundrinor).

MBANI MEND



Fjala e thjeshtë formohet zakonisht nga:

- grupi emëror i kryefjalës, që ka si fjalë bazë një emër dhe që mund të zëvendësohet nga një përemër; plotësues të emrit janë përcaktorët;
- grupi foljor i kallëzuesit, që ka si fjalë bazë foljen e si plotësues të saj kundrinorë e rrethatorë. Secili nga të dyja grupet mund të zgjerohet ose të zvogëlohet.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Dalloni grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit.

- Kënga e popullit nuk vdes kurrë.
- Imagjinata popullore ka endur legjenda të çuditshme rreth lindjes së Skënderbeut.
- Në folklor pasqyrohen me bukuri të veçantë cilësitë më të mira të popullit tonë.

2. Zgjidhni për çdo grup emëror të kryefjalës një nga grupet foljore të kallëzuesit, që të krijosh fjali. Shkruaji fjalitë.

Bajlozi zemërak *u ngul dymbëdhjetë pashë në lëndinë.*
Kali i Gjergjit *mori në shenjë Gjergj Elez Alinë.*
Topuzi i Bajlozit *ka nxjerrë gjithmonë burra të dëgjuar.*
Vendi ynë *përkuli sakaq të dy gjunjët.*

3. Në fjalinë: "Majat e larta të maleve zbardhnin nga dëbora", ndrysho dy herë grupin emëror të kryefjalës dhe shkruaji në fletore dy fjalitë që formove.

Shembull: Rrugët e fshatit zbardhnin nga dëbora.

4. Në fjalinë: Dy harabela qëndruan te një degë e hollë rrapi, ndrysho dy herë grupin foljor të kallëzuesit dhe shkruaji fjalitë e formuara.

5. Zgjero të dyja grupet përbërëse të këtyre fjalive duke përdorur fjalët që jepen në kllapa. Shkruaji fjalitë e formuara.

Korijet shkëlqenin. (me argjend – plot me kumbulla të egra – si të spërkatura)
Qyteti dremiste. (bregdetar – nën rrezet – të diellit – e ngrohta – i vogël)

6. Ndërto dhe shkruaj dy fjali që të kenë grupe emërore të kryefjalës të formuar rreth emrave motër, shok, dhe dy fjali që të kenë grupe foljore të kallëzuesit të formuar rreth foljeve ecnin, diskutonin.

Llojet e fjalive sipas kumtimit dhe intonacionit të thënies

Kur flasim ose kur shkruajmë, u komunikojmë të tjerëve një *njoftim a informacion, një dëshirë, një pyetje* ose *nxitje* për diçka. Këtë e bëjmë nëpërmjet fjalive. Pra, themi se fjalia përmban një *kumtim*.

Fjalia është një grup fjalësh ose edhe një fjalë e vetme që shpreh një kumtim dhe që përfundon me një pushim të gjatë, i cili në të shkruar shënohet me pikë, pikëpyetje ose pikëçuditje.

Ilustroji këto që thamë, me shembuj.

Sipas kumtimit dhe intonacionit, dallojmë:

fjali dëftore, fjali dëshirore, fjali pyetëse dhe fjali nxitëse.

1. Fjalia dëftore jep një informacion, tregon për diçka:

Arta ka në bibliotekën e saj shumë libra të bukur.

Në fund të fjalisë dëftore vihet pikë.

2. Fjalia dëshirore kumton një dëshirë

(edhe një urim a mallkim):

- Ah, sikur të ishte verë!
- Rroftë e qoftë Shqipëria edhe kombi e gjuha jonë!
- Lulëzoftë dituria!

Në fund të fjalisë dëshirore, vihet pikëçuditje.

3. Fjalia pyetëse shërben për të kërkuar informacion,

për të formuluar një pyetje :

- Edhe sa duhet të ecim për të arritur në fshat?
- A të pëlqen kjo këngë?

Në fund të fjalisë pyetëse vihet pikëpyetje.

4. Fjalia nxitëse kumton një urdhër, një këshillë,

një lutje a një kërkesë.

Në fund të saj vihet pikëçuditje (urdhër) ose pikë (këshillë, lutje ,kërkesë).

- Ta ruani si sytë e ballit Arbërinë.
- Zgjdh shokë të mirë.
- - Ma hap pak derën, të lutem.
- - Ule zërin e televizorit! - thirri i nxehur babai.



Provoni njohuritë që keni

Formo një fjali dëshirore, ku të shprehësh se çfarë do të kesh në shtëpinë tënde.

- Ah, sikur të kisha një qen!..





KUJDES

Në rast se fjalitë *dëftore*, *pyetëse* e *nxitëse* shoqërohen me një ndjenjë të fortë kënaqësie, habie, frike, zemërimi etj., ato quhen **thirrmore** dhe në fund të tyre vihet pikëçuditje (te fjalja *pyetëse thirrmore* vihet edhe pikëpyetje, edhe pikëçuditje).

dëftore-thirrmore:

Ç'netë të bukura ka mali ynë në verë! (kënaqësi)

pyetëse-thirrmore: *A i flitet shokut kështu?!*

(me habi dhe zemërim)

nxitëse-thirrmore:

Të lutem, doktor, ma shpëto vajzën! (me shqetësim të madh)

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Lexo me zë fjalitë dhe thuaj ç'lloj janë.

1. Këngët më të bukura janë thurur nga nënat.
2. Armikut ia vër kufirin larg.
3. Eh, sa hijeshi ka thjeshtësia!
4. Artani doli kampion në shah?
5. Gjuhës sonë poetët i kanë thurur vargje shumë të bukura.
6. Hapni krahët, o bjeshkë piktoreske!
7. Kaq shumë të pëlqen ky film?!
8. – Ec më shpejt, Agim, më shpejt!
9. – Ndihamoi më shumë shokët.
10. – Kush e ka shkruar poemën “Bagëti e bujqësi”?
11. – Gjithmonë me këngë në gojë ju pafsha!
12. – Sa vajzë e papërtuar qenka!
13. – Kaq i thellë qenka ky lumë?!
14. Buka e mëmëdheut zëntë tradhtarët e pabesë!

2. Fjalitë dëftore të mëposhtme ktheji në dëftore thirrmore. Shkruaji dhe lexoji me intonacionin e duhur. Në ç'mënyrë do t'i vendosësh foljet?

1. - Maleve ka rënë borë e madhe.
2. - Kjo grykë e Drinit këtu është shumë e bukur.
3. - Ky rrush është mjaltë i ëmbël.

3. Shkruaj dy urime duke përdorur fjali dëshirore.

4. Fjalitë pyetëse të mëposhtme ktheji në pyetëse thirrmore.

Shkruaji dhe lexoji me intonacionin e duhur (me habi).

1. - Të gjithë këta libra i ke lexuar?
2. - Ky është babai i Blerimit?

5. Fjalitë nxitëse thirrmore të mëposhtme ktheji në nxitëse të zakonshme duke hequr fjalët me shkronja të zeza.

Shkruaji të dyja variantet.

1. - Eja, **pra**, shpejt!
2. - Shkoni te Altini **menjëherë**, tani!
3. - Mos pengoni kalimin mbi urë, **ju thashë!**
4. - Ec më shpejt, Besnik, **më shpejt!**

FJALIA E THJESHTË DHE FJALIA E PËRBËRË

Fjalja e thjeshtë

**Fjalja e thjeshtë ka vetëm një folje - kallëzues.
Fjalja e përbërë ka më shumë se një folje - kallëzues.**

Fjalja e thjeshtë e ka foljen (kallëzuesin) në një nga format e zgjedhimit të saj.

Për shembull: Vajza e vogël recitoi shumë bukur.

Fjalja e thjeshtë mund të jetë e pazgjeruar ose e zgjeruar.

- **E pazgjeruar:**

Degët ishin përkulur. (kur ka vetëm emrin - kryefjalë dhe foljen - kallëzues).

- Ujërat gurgullonin.

- Hëna u fsheh.

- Iku dimri.

- **E zgjeruar:**

- Degët e *holla të ftoit* ishin përkulur nga pesha e kokrrave. (kur emri-kryefjalë dhe folja-kallëzues plotësohen nga fjalë të tjera).

- Një fjali e thjeshtë është e zgjeruar edhe kur plotësohet nga fjalë të tjera, qoftë vetëm emri-kryefjalë ose vetëm folja-kallëzues, për shembull:

Degët e *holla të ftoit* ishin përkulur.

Degët ishin përkulur nga *pesha e kokrrave*.

Jo gjithmonë fjalja e thjeshtë i ka të shprehura të dyja grupet kryesore të fjalisë:

atë të kryefjalës dhe atë të foljes-kallëzues.

Ndonjëherë njëri prej grupeve kryesore të fjalisë nënkuptohet nga përmbajtja e vetë tekstit, për shembull:

- Zogjtë përplaseshin.

- Filmi do të bëhet.

Fjalja e përbërë

Le të shohim këto dy fjali të përbëra:

Lumi i kaltër zvarritej ngadalë dhe shushurima e tij e butë përhapej deri lart në brigje.

Djaloshi herë pas here ulte kokën, që të mos e fshiknin lastarët e pemëve në fytyrë.

Që të dyja fjalitë e përbëra kanë nga dy pjesë, sepse kanë nga dy folje-kallëzues.

Ku ndryshojnë këto dy fjali nga njëra-tjetra?

Në fjalinë e parë, që të dyja pjesët mund të përdoren më vete si fjali të thjeshta:

Lumi i kaltër zvarritej ngadalë. Shushurima e tij e butë përhapej deri lart në brigje.

(të përdorura si pjesë të fjalisë së përbërë, ato lidhen me lidhëzën bashkërenditëse dhe në raste të tjera me lidhëzat ose, por etj.).

**Fjalja e përbërë me
bashkërenditje përbëhet nga dy
pjesë të pavarura.**

Në fjalinë e dytë, pjesët nuk janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk mund të përdoren secila si fjali e thjeshtë, për shembull: pjesa e dytë, e përdorur më vete, nuk do të kishte kuptim: *që të mos e fshiknin lastarët e pemëve në fytyrë. (?)*.

Kjo ndodh sepse ajo është e varur nga pjesa e parë, e cila mund të qëndrojë më vete: *Djaloshi herë pas here ulte kokën.*

Fjalja e përbërë me nënrenditje përbëhet nga një pjesë kryesore (Djaloshi herë pas here ulte kokën) dhe nga një pjesë e nënrenditur (që të mos e fshiknin lastarët e pemëve në fytyrë).

Pjesët e fjalisë së përbërë me nënrenditje lidhen me njëra-tjetrën *me lidhëz nën - renditëse*. (që, me qëllim që), kur, ku, sepse, ndonëse, se etj.) ose *me përemër lidhor* (që, i cili, e cila etj.).

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Thuaj ç'loj janë këto fjali për nga ndërtimi:

e thjeshtë (e pazgjeruar - e zgjeruar); e përbërë (me bashkërenditje - me nënrenditje).

- Dielli humbi tej pas kodrave dhe malet u bënë të errëta.
- Vallet tona popullore janë shumë të bukura.
- Paskan çelur kumbullat!
- Fishekzjarrët shumëngjyrësh derdheshin si një shi yjesh.
- Gjithë natyra buzëqeshte nën rrezet e diellit, që po fundosej tutje në detin e zjarrtë.
- E vërteta s'humbet.
- Mos i shiko gunën, por shikoj punën.
- Koha është e vetmja pasuri për të cilën mund të tregohesh koprrac pa u turpëruar.

2. Në fjalitë e përbëra të ushtrimit 1, trego se me çfarë janë lidhur pjesët ndërmjet tyre. Për fjalitë e përbëra me nënrenditje, thuaj cila është pjesa kryesore dhe cila pjesa e nënrenditur.

3. Shndërroji këto fjali të thjeshta të pazgjeruara në fjali të thjeshta të zgjeruara te grupi emëror-kryefjalë. Shkruaji fjalitë e zgjeruara.

- Fjalët rimonin.
- Erdhi pranvera.

4. Shndërroji këto fjali në fjali të thjeshta të zgjeruara te grupi foljor - kallëzues. Shkruaji fjalitë e zgjeruara.

- Valët shkumonin.
- Konkursi do të zhvillohet.

5. Të gjitha fjalitë e ushtrimeve 3 dhe 4 zgjeroji te të dyja grupet dhe shkruaji fjalitë e zgjeruara.

6. Nga dy fjalitë e thjeshta krijo një fjali të përbërë me bashkërenditje duke përdorur një nga këto lidhëza bashkërenditëse: dhe, por.

Shkruaji fjalitë e përbëra.

(Kujdes: para lidhëzës por, vihet presje!)

- Era e luleve dhe e barit përzihen me njëra-tjetrën. Në pyll ndihet një aromë e mrekullueshme.
- Mbrëmja u var shpejt mbi rrugën e gjerë. Shoferi ndezi dritat.
- S'gjykon mosha. Gjykon mendja.
- Në vilën e bardhë kalohet shumë mirë, e thotë babai.

7. Duke përdorur një nga lidhëzat nënrenditëse: se, në qoftë se, kur, ashtu siç, kështu që, porsa, bashko fjalitë e dhëna në fjali të përbëra me nënrenditje dhe thuaji ato.

- Besniku iu afrua pyllit. Dielli ishte ngritur dy pashë mbi mal.
- Rëra e hollë kërciste nën shojet e këpucëve. Kërcet dëbora e ngrirë.
- Era qe shumë e lehtë. Gjethet e pemëve mezi lëviznin.
- Kalimtarët shpejtuan hapat. U dëgjuan bubullimat e para.
- Mbaj vesh të lehurat e qenit. Ato të nxjerrin në fshat.
- Nuk shter lumi. Nuk mund të fillojnë punimet për urën.
- Deti kishte dallgë. Varkat përplaseshin me njëra - tjetrën.

8. Shkruaj dy nga fjalitë e përbëra që formove duke kryer ushtrimin 7, dhe nënvizo me dy vija pjesën kryesore e me një vijë pjesën e nënrenditur.

Fut në rreth mjetin lidhës ndërmjet tyre.

9. Për çdo çift të dhënë zgjidh një nga mjetet lidhëse në kllapa, dhe shkruaji fjalët e urta që krijohen. (por - që - ku - sa - tek).



- Të rrosh. Do të mësosh.
- Nuk sheh syri. Sheh mendja.
- Hyri dredhia. U zhduk miqësia.
- Është bashkimi. Është fuqia.
- Dhemb dhembi. Vete gjuha.
- Hekuri rrihet. Është i nxehtë.

GJYMTYRËT KRYESORE TË FJALISË

Provoni njohuritë që keni

1. Shiko me vëmendje figurën dhe lexo fjalët që thonë personazhet.
2. Cilat janë fjalët që s'dëgjohen dhe që me mungesën e tyre i bëjnë të pakuptueshme fjalitë? Lexo, njëren pas tjetrës, thëniet në figurat 1 dhe 3, pastaj 4 dhe 6.
3. Në fjalitë e mëposhtme, provo të heqësh fjalë nga ato me shkronja të pjerrëta:
 - Tani këtu **dëbora ka shtruar mirë**.
 - Atëherë **unë po vishem trashë**. A mund të themi se gjymtyrët që mbeten, nuk formojnë fjali?
4. Po fjalët në figurat 1 dhe 4 a formojnë fjali?
5. Ç'kupton me gjymtyrë kryesore dhe gjymtyrë të dyta?

Kryefjala

- Lexo tekstin:

Bletët u vendosën në zgavrën e trungut të një molle të egër. **Ato e mbushën** zgavrën me mjaltin e tyre të mrekullueshëm. Që atë ditë **Molla filloi të mburrej**:

- Tani **unë jam** e bekuar!
- Atëherë **një trëndafil** i tha:
- Nëse **ti dëshiron** të jesh e bekuar prej njerëzve, **mundohu** ti vetë që frutat e tua të bëhen të ëmbla si mjalti i bletëve.
- Në fjalitë dhe pjesët e mësipërme fjalët me shkronja të zeza janë gjymtyrë kryesore të tyre, përkatësisht **kryefjala** dhe **folja kallëzues**. Pa ato thëniet nuk kanë kuptim.

PROVO

Tani provojmë t'i bëjmë pyetje foljes-kallëzues dhe të përgjigjemi me kryefjalën:

Cilat u vendosën? - **Bletët**.

Cilat e mbushën? - **Ato**.

Cila filloi të mburrej? - **Molla**

Cili tha? - **Një trëndafil** etj.

- Thuaj kryefjalën për grupin foljor **jam e bekuar**.

Pra, kryefjala tregon **kush** e kryen veprimin ose **kush** e ka cilësinë a karakteristikën që shprehet nga folja ose grupi foljor: **Bletët u vendosën**. **Unë jam e bekuar**.

Kryefjala është gjymtyra kryesore e fjalisë që u përgjigjet pyetjeve: kush? cili? cila? cilët? etj., që i bëhen foljes - kallëzues. Ajo tregon kush e kryen veprimin ose kush e ka cilësinë a karakteristikën e shprehur nga folja a grupi foljor.



Kryefjala mund të shprehet:

Me emër ose grup emëror: Bletët u vendosën në zemrën e trungut të një molle të egër. Atëherë një trëndafil i tha: Kjo përrallë është e bukur.

Me përemër: Ato e mbushën zgavrën me mjaltin e tyre të mrekullueshëm. Unë jam e bekuar.

Me numëror: (Fëmijët u futën në dhomë.) Dy u ulën në divan. I treti zuri vend në një karrige pranë gjyshit.

Fjalja mund të ketë një kryefjalë të vetme, por edhe disa kryefjalë, p.sh.:

Luani dhe Drita qeshën me gjithë shpirt.

Luani, Drita dhe Petriti qeshën me gjithë shpirt.



KUJDES

Kryefjalët që formojnë kryefjalë të shumëfishtë, kur nuk lidhen në mes tyre me lidhëzat dhe, ose, as, ndahen me presje.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Gjej kryefjalën e fjalive dhe thuaj me se është shprehur.

1. Ne ecnim përmes pllajës së shpyllëzuar. 2. Në dhomën tjetër u dëgjuan hapa. Dikush kishte ardhur. 3. Ky lumë qenka shumë i thellë! 4. Në kopshtet e rrugicës së Majlindës bajamet kishin çelur lule. Këto lule dukeshin si të vëna me dorë mbi degët pa gjethe. Ato dukeshin si yje të kuqe me zemër të bardhë. 5. Çdo zog kërkon folenë e vet. 6. Pjetër Bogdani fliste me zjarr për forcën dhe bukurinë e gjuhës shqipe. 7. Dituria është si arma në luftë. 8. Kruja bujare e ka marrë emrin nga krojet e shumta.

2. Në fjalitë e mësipërme, bëji pyetje foljes-kallëzues dhe përgjigju me kryefjalët që gjete.

3. Vër në vend të emrit- kryefjalë një përemër dhe shkruaji fjalitë që formohen.

1. Turistët mahniten me bukuritë natyrore të vendit tonë. 2. Shtëpitë zbardhnin aty-këtu mes gjelbërimit. 3. Sa qenka rritur vajza! 4. Qenka zbukuruar fshati!

4. Në fjalitë e ushtrimit 3 i shto kryefjalës fjalë plotësuese dhe shkruaji fjalitë e zgjeruara.

Shembull: Turistët e huaj mahniten me bukuritë natyrore të vendit tonë.

5. Detyrë. Punë në grup.

Formoni grupe prej katër nxënësish. Shkruani secili nga katër fjali ku kryefjala të jetë shprehur me: emër të shquar, grup emëror (ku s'mund të hiqet ndonjë fjalë), përemër, numëror. Fiton grupi që shkruan pa gabime të 16 fjalitë brenda kohës së përcaktuar më parë.

6. Me fjalët e dhëna ndërto dhe shkruaj fjali që të kenë kryefjalë të shumëfishtë. Kujdes në përdorimin e presjes!

(gjithmonë-dhe-këngët-janë vlerësuar-vallet-tona-nga të huajt)

(ideali-njeriun-në këmbë-qëllimi-mbajnë-e)

(kulmin-gëzimi-kishin arritur-hareja-kënga-dhe)

Në fjalitë që shkrove, nënvizo kryefjalët (kryefjalën e shumëfishtë) dhe thuaj në ç'numër është folja - kallëzues. A mund të krijosh një rregull lidhur me këtë?

Trego ku ke përdorur presjen, dhe shpjego pse.



Provoni njohuritë që keni

1. Lahuta **ngrinte** perdet e shekujve.

2. Lahuta **është** vegël muzikore popullore.

- Komento kuptimin e figurshëm të fjalisë së parë.
- Gjej kryefjalën në secilën fjali dhe thuaj cilës pyetje i përgjigjet. Me se është shprehur?
- Në fjalinë e dytë, zëvendëso emrin-kryefjalë me një përemër.
- Pse themi që emri *lahuta* në këto fjali është *gjymtyrë kryesore*?
- Tani provo të heqësh nga fjalitë fjalët me shkronja të zeza.
- A mundesh? Pse? Ç'mund të thuash edhe për këto nga rëndësia që kanë në fjali?

Fjalët me shkronja të zeza janë **kallëzues**.

Kallëzuesi është një tjetër gjymtyrë kryesore e fjalisë.



Lahuta


Kallëzuesi

Kallëzuesi është gjymtyra kryesore e fjalisë që tregon ç'bën ose ç'është a si është personi a sendi i shprehur nga kryefjala.

Pra, ai tregon ç'veprim kryen ose ç'veti a karakteristikë ka personi a sendi i shprehur nga kryefjala.

Kallëzuesi që tregon veprim, quhet **kallëzues foljor**.

Kallëzuesi që tregon një veti a karakteristikë, quhet **kallëzues emëror**.



Kallëzuesi foljor mund të jetë: *i thjeshtë* ose *i përbërë*.

Kallëzuesi i thjeshtë foljor

Kallëzuesi i thjeshtë foljor shprehet me një folje të vetme në një nga mënyrat vetore (dëftore, lidhore, habitore, kushtore, urdhërore, dëshirore), pra me një folje të shjelluar. P.sh.:

- Për gjuhën tonë letrare **kanë punuar** breza të tërë patriotësh, (folja është në mënyrën dëftore, koha e kryer, veta e tretë shumës).
- Vëllai yt **i njeh** artistët e cirkut. (folja është në mënyrë dëftore, koha e tashme, veta e tretë, njëjës).

Kallëzuesi i përbërë foljor

Kallëzuesi i përbërë foljor formohet nga dy pjesë.

Pjesa e parë është një folje që **tregon**:

- fillimin e veprimit: **filloj, zë, nis**;
- vazhdimin e veprimit: **vazhdoj**;
- mbarimin e veprimit: **mbaroj, pushoj**;
- domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit: **duhet, do**;
- mundësinë e kryerjes së veprimit: **mund**.

Pjesa e dytë shpreh veprimin dhe është zakonisht një folje në mënyrën lidhore, më rrallë një pjesore, por edhe një emër foljor asnjëanës.

A MUND TË MËSONI VETË NGA LIBRI?



Dallo dy pjesët e kallëzuesit të përbërë foljor. Thuaj ç'tregon pjesa e parë dhe me se është shprehur pjesa e dytë. Cila pjesë tregon veprimin?

- *Dëbora filloi të binte më dendur... •Rrotat e makinave zunë të ngarkoheshin me baltë.*
- *Qyteti nisi të gjallërohej.*
- *Era vazhdonte të frynte e lehtë.*
- *Bubullimat pushuan së gjëmuari.*
- *Bori mbaroi së ngrëni.*
- *Kjo punë do bërë me shumë kujdes.*
- *Njerëzit duhen vlerësuar nga veprat.*
- *Me punë dhe përpjekje mund të arrihet gjithçka e bukur dhe e mirë.*

Kallëzuesi emëror

Kallëzuesi emëror formohet nga **këpuja** dhe **pjesa emërtuese**: E tërë jeta e Nolit **ishte maratonë**. (ishte është këpuja; maratonë është pjesa emërtuese).

- Si këpujë e kallëzuesit emëror përdoret folja **jam**, e cila mund të jetë në të gjitha format e zgjedhimit të saj.
P.sh.: E tërë jeta e Nolit (është, qe, ka qenë, do të ishte etj.) *maratonë*.
- Si pjesë emërtuese e kallëzuesit emëror mund të jetë:
një emër: E tërë jeta e Nolit *ishte maratonë*.
një mbiemër: Bujaria e vatrës shqiptare *është e pashembullt*.
një përemër: Ky libër *është imi*.



KUJDES

Edhe kallëzuesi emëror mund të jetë i përbërë. Në këtë rast, këpuja e tij prihet nga foljet **mund** e **duhet**, për të treguar mundësi, domosdoshmëri, p.sh.:

- Çdo njeri **duhet të jetë i vendosur** në qëllimet e tij.
- Ai **djali i gjatë mund** të jetë basketbollist.

1. Dallo gjymtyrët kryesore të fjalisë dhe thuaj ç'lloj është kallëzuesi: foljor, emëror; i thjeshtë, i përbërë.

1. Heronjtë janë të pavdekshëm.
2. Isoja (e këngës) rridhte ngadalë, si shiu në dimër.
3. Që larg ndihej aroma (e luleve të kopshtit).
4. (I gjithë) fshati kishte mbaruar së lëruari.
5. Uji ka nisur të pushtojë grykën përjetë.
6. Gjuha (jonë amtare) është shpirti (i kombit tonë).
7. Altini duhet të jetë i kujdesshëm.
8. Retë vazhdonin të mblidheshin në qiell.
9. Muri (i oborrit) do lyer me gëlqere.
10. Besa (e shqiptarit) është shqiptaria.
11. - Juaji është topi?

2. Për kallëzuesit e përbërë foljorë të ushtrimit të mësipërm thuaj çfarë tregon pjesa e parë dhe me se është shprehur pjesa e dytë.

3. Për kallëzuesit emërorë të ushtrimit 1 trego këpujën dhe pjesën emërtuese; thuaj me se është shprehur kjo e fundit.

4. Me ç'folje tjetër mund ta zëvendësosh foljen jam? Ç'lloj kallëzuesi është?

1. Shokët e vërtetë janë bashkë në gëzime e në hidhërimi.
2. Lugina ishte larg.
3. Aty në kodër është shtëpia ime.
4. - Në orën shtatë e gjysmë unë duhet të jem në shkollë.

5. Ç'mund të thuash për përdorimin e foljes jam në këto raste? (Vetëm në një rast është këpujë)

- Në oborr ishte një dushk.
- Te dushku ishte kacavjerrë një pjergull.
- Pjergulla ishte e ngarkuar plot me bistakë.

6. Duke u nisur nga fjalitë e mëposhtme, shkruaj fjali ku pjesa emërtuese e kallëzuesit emëror të jetë shprehur me mbiemër.

1. Djaloshi ishte me kryet në qiell.
2. Fjalët e xha Batos ishin sheqer e mjaltë.
3. Ceni është dy pëllëmbë njeri.
4. Njëri nga kuajt ishte kockë e lëkurë.





1. Kallëzuesi i thjeshtë foljor përshtatet me kryefjalën në numër:

Në rrugë **dëgjohej** britma gazmore e fëmijëve.

Në rrugë **dëgjoheshin** britmat gazmore të fëmijëve.

- Kur kryefjala është përemër vetor, kallëzuesi përshtatet edhe në vetë:
Unë arrita në Prishtinë mbasdite vonë. **Ne arritëm** në Prishtinë mbasdite vonë.

2. Përshtatja e kallëzuesit të përbërë me kryefjalën bëhet kështu:

- kur ka si pjesë të parë foljet: **filloj, zë, nis, vazhdoj**, të dyja pjesët përshtaten me kryefjalën njëjloj si kallëzuesi i thjeshtë:

Kodrina nisi të vishet me gjelbërim. (Ajo nisi të vishet.)

Kodrinat nisën të vishen me gjelbërim. (Ti nise të vishesh.)

- Kur ka si pjesë të parë foljet mund dhe duhet dhe si pjesë të dytë një folje në mënyrë lidhore, përshtatet me kryefjalën vetëm pjesa e dytë:

Ti duhet të vazhdosh shkollën e lartë.

Ata duhet të vazhdojnë shkollën e lartë.

Unë mund të vazhdoj shkollën e lartë.

Ju mund të vazhdoni shkollën e lartë.

- Kur pjesa e dytë nuk është një folje në mënyrë lidhore, përshtatet me kryefjalën vetëm pjesa e parë:
Ky libër duhet lexuar patjetër. **Këta libra** duhen lexuar patjetër.

3. Përshtatja e kallëzuesit emëror me kryefjalën

- Këpuja e kallëzuesit emëror përshtatet me kryefjalën njëjloj si kallëzuesi foljor:

Mësuesi është edukator i brezit të ri. **Mësuesit janë** edukatorë të brezit të ri.

Ju jeni edukatorë të brezit të ri. **Unë jam** edukator i brezit të ri.

Ju vazhdoni të jeni edukatorë të brezit të ri.

- Pjesa emërtuese e kallëzuesit emëror e shprehur me mbiemër përshtatet me kryefjalën në numër, gjini dhe në rasë:

Ky djalë qenka i talentuar! **Kjo vajzë** qenka e talentuar!

Këta djem qenkan të talentuar! **Këto vajza** qenkan të talentuara!

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Shkruaji fjalitë duke vënë në numrin shumë kryefjalën. Trego për çdo rast si përshtatet kallëzuesi i thjeshtë me kryefjalën.

1. Ky fshat njihet brez pas brezi për këngët e vallet. 2. Unë arrita i pari në majën e bregut. 3. Nata u mbush me drithërima yjesh. 4. Njeriu me karakter provohet në vështirësi. 5. Një flutur e madhe vërtitej mbi tërfil. Ajo tundte krahët e bardhë.

2. Shkruaji siç duhet fjalitë. Trego për çdo rast si përshtatet kallëzuesi i përbërë me kryefjalën.

1. Daullet (zë, gjëmoj) si bubullimat në maj. 2. Nxënësit (filloj, shkruaj) adresat e njëri-tjetrit. 3. Gjatë gjithë javës (vazhdoj, bie) shira të rrëmbyera. 4. Njerëzit (duhet, kujtohen) për të mirë. Për këtë ngjarje (mund, shkruaj) tregime të mrekullueshme.

3. Shkruaj siç duhet fjalitë dhe shpjego si përshtatet kallëzuesi emëror me kryefjalën.

1. Kënga (qenka më i fuqishëm) se njeriu! 2. Këngët (jam më i fuqishëm) se njeriu. 3. Këto viset tona (jam i njohur) për trimëri.

4. Agroni (jam nxënës) në shkollën tonë. Albana (jam nxënës) në klasën e gjashtë. Agroni dhe Bashkimi (jam nxënës) në shkollën tonë. Albana dhe Besa (jam nxënës) në shkollën tonë.

TEST
(VETË) VLERËSIM

Kontrollo njohuritë për gjymtyrët kryesore të fjalisë.
Zgjidh tekstet me ngjyrë të ndryshme nga shoku i bankës.

1. Kopjo fjalitë:

1. Fatmira këndon në korin e shkollës.
2. Revista është mbi tryezë.
3. Ajo nuk është në oborr.
4. Ata duhet të arrijnë në orën tetë.
5. Gjyshi im është piktor.
6. Retë vazhdonin të lëviznin në qiell.
7. Netët vazhdojnë të jenë të ftohta.
8. Kjo revistë është me ilustrime.

9. Saimiri reciton shumë bukur.
10. Libri është në bibliotekë.
11. Ata nuk janë në shtëpi.
12. Unë mund të vij në orën tetë.
13. Motra ime është e kujdesshme.
14. Era filloi të frynte furishëm.
15. Koha vazhdon të jetë e ngrohtë.
16. Ky nxënës është me talent.

a) Nënvizo kryefjalën me dy vija dhe kallëzuesin me një vijë.

1 pikë

b) Trego me se janë shprehur gjymtyrët kryesore dhe thuaj llojin e kallëzuesve

4 pikë

2. Shkruaj një fjali me kryefjalë të shumëfishtë.

1 pikë

3. Ndërto dhe shkruaj dy fjali ku folja jam, në mënyrën dëftore,

1 pikë

në kohën e pakryer, veta III njëjës

në kohën e tashme, veta III njëjës

Të jetë një herë kallëzues foljor dhe një herë këpujë e kallëzuesit emëror.

4. Shkruaj fjalitë duke bërë përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën:

1 pikë

- a. Ju (jam në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, nxënës, shembullor).
- b. Altini dhe Besa (nisem në kohën e ardhme të mënyrës dëftore) nesër.
- c. Ju (filloj në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, bëj) detyrat.

- a. Ata (jam në kohën e tashme të mënyrës dëftore, basketbollist, i mirë).
- b. Besniku dhe Drita (shkoj në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore) në Durrës.
- c. Ne (vazhdoj në kohën e pakryer të mënyrës dëftore, luaj) me top.

5. Krijë dhe shkruaj një tekst të shkurtër me titull:

2 pikë

Në cirk

Në stadium

kur midis fjalive të ketë:

- një fjali me kallëzues emëror,
- një fjali me kallëzues të përbërë,
- një fjali me kryefjalë të shumëfishtë.

Nënvizë gjymtyrët kryesore në këto fjali.


Llogarit vetë pikët që ke marrë!

PËRCAKTORI

1. Gjej gjymtyrët kryesore në fjalitë e mësipërme.

2. Te gjymtyrët e dyta të fjalisë shiko me vëmendje fjalët me ngjyrë blu.

- Cilën fjalë përcakton emri *e matematikës*? Po *e problemave*? Po përemri *disa* dhe mbiemri *të vështira*? Po përemrat *im*, *të këttilla* dhe mbiemri *i lumtur*?
- Ç'pjesë e ligjëratës është fjala e përcaktuar në të gjitha rastet?



a) Zakonisht, përcaktori shprehet me:

- Mbiemër: *problemave të vështira, baba i lumtur*
- Emër: *orën e matematikës, zgjidhjen e problemave*
- Përemër: *disa problemave, biri im, lajme të këtilla*
- Numëror: *njëqind lekë, dy trokitje.*

b) Përcaktori i shprehur me mbiemër dhe përcaktori i shprehur me përemër përshtaten me emrin e përcaktuar në numër, gjini e rasë:

- Unë ndihem vërtet *baba i lumtur.*
- Unë ndihem vërtet *nënë e lumtur.*
Ne ndihemi vërtet *prindër të lumtur.*
- Ti po më gëzon, *biri im.* Ti po më gëzon, *bija ime.* Ju po më gëzoni, *bijtë e mi.*



c) Përcaktori i shprehur me emër mund të jetë:

- Emër në rasën gjinore : *Astriti kishte fituar besimin e shokëve.*
- Emër me parafralë: *Shtëpia kishte një dhomë me oxhak.*

d) Përcaktori u përgjigjet pyetjeve : ç'?-i kujt?-sa?, që i bëhen emrit të përcaktuar:

Në *klasën e Artës* kanë ardhur dy *nxënës të rinj.*

Në *klasën e kujt?* → e *Artës*

Sa *nxënës?* → dy

Ç'nxënës? → të rinj.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Gjej përcaktorët. Thuaj cilin emër përcaktojnë dhe me se janë shprehur.

1. *Saranda është perlë e rrallë e bregdetit tonë jugor.*
2. *Arkitektura e qytetit të Beratit është vepër e mjeshtërve popullorë shqiptarë.*
3. *Mos u mat me hijen tënde.*
4. *E ku ka më të bukur se atdheu ynë!*
5. *-Ua, paskan çelur dy gonxhe trëndafili!*
6. *Zëri i fortë burrëror i Skënderbeut kumbonte si jehonë malesh.*
7. *Kënga e re për kurbetin e mallëngjeu shumë nënën.*
8. *Duhet bërë tri pengesa në shtratin e lumit.*

2. Sipas shembullit të dhënë, për fjalitë e ushtrimit 1, paraqit me skemë lidhjen e përcaktorëve me emrin që përcaktojnë.

Fjalja 1:



(Kujdes!) Një emër që është përcaktor për një emër tjetër, mund të përcaktohet nga përcaktorë të tjerë. Shiko skemën e mësipërme.)



3. Ndahuni në grupe nga katër nxënës. Në ushtrimin 1 gjeni fjalinë ku një emër ka tre përcaktorë. Shkruajeni fjalinë. Futni në kornizë emrin e përcaktuar dhe nënvizoni me një vijë përcaktorin e shprehur me mbiemër të nyjshëm, me dy vija përcaktorin e shprehur me mbiemër të panyjshëm dhe me tri vija përcaktorin shprehur me emër.

Tani formuloni me shkrim rregullën që përcakton rendin e përcaktorëve të të njëjtit emër, kur këta janë shprehur me: mbiemër të nyjshëm, me emër të panyjshëm, mbiemër, emër. Fiton grupi që e shkruan rregullën të saktë brenda kohës së përcaktuar.

4. Shkruaj fjalitë, duke vënë në rendin e duhur përcaktorët në kllapa.

1. Këngët (popullor, i bukur) janë përherë një burim (frymëzim, i madh) për artistët.
2. Hëna (i ri, pesëmbëdhjetëshe) nxori kokën nga gjiri i fletëve (i gjelbër, ulli).
3. Qetësinë e natës e çau fishkëllima (tren, i largët).
4. Shtëpia (dykatësh, gjysh, i ri) humbiste në detin e gjelbërimit.
5. Ajo ditë (pranverë, i kthjellët) përhapte kudo gëzimin e vet.
6. Malet janë një vend (sportiv, i mrekullueshëm).

5. Shkruaj fjalitë duke zëvendësuar përcaktorët e shprehur me emër me parafjalë me përcaktorë të shprehur me mbiemër të nyjshëm.

1. Ai kishte fjalë të ëmbla dhe një karakter prej burri.
2. Të tre djemtë e tij ishin bërë njerëz me shkollë.
3. Djaloshi vrapoi tatëpjetë shkallëve prej guri.
4. Artani është djalë me talent.
5. Gjyshit i sollën fidanë nga mollët me famë të Zvirinës.
6. Mësuesja kujdestare na ngarkoi një detyrë me rëndësi.

6. Krahaso këto dy pjesë dhe shpjego pse përshkrimi në pjesën e dytë është më i plotë e më i gjallë. Në pjesën e dytë, trego përcaktorët dhe thuaj me se janë shprehur.

Dhe, papritur, një dorë e grisi pelerinën e shiut. Pastaj në majë të malit u ndez një zjarr që përflaku horizontin. Ishte dielli. Një re u tulat pas malit e deshi të fshihej, por qielli e treti dhe e piu me gotën e tij.

... Dhe, papritur, një dorë e padukshme e grisi pelerinën e përhime të shiut. Pastaj në majë të malit të lartë u ndez një zjarr madhështor që përflaku gjithë horizontin. Ishte dielli. Një re e braktisur u tulat pas malit e deshi të fshihej, por qielli i thellë e treti dhe e piu me gotën e tij blu.

KUNDRINORI

Provoni njohuritë që keni

1. Gjej përcaktorët dhe trego cilin emër përcaktojnë.
2. Tani shkruaji fjalitë në fletore duke i hequr përcaktorët.
3. Kopjoji edhe një herë fjalitë që shkrove, duke vënë përpara çdo gjymtyrë pyetjen që i përshtatet.

P.sh.: (kur?) **dje** (ç'bëra?) **isha** (ku?)... etj.

Kundrinori

Herën e dytë ju duhet të keni shkruar në fletore:

(Kur?) *Dje* (ç'bëra?) *isha* (ku?) *në bibliotekë dhe* (ç'bëra?) *i mora* (kujt?) *vëllait* (çfarë?) *librin.*

(Ku?) *Atje* (ç'bëra?) *takova* (kë?) *Altinin dhe* (ç'bëmë?) *biseduam* (për çfarë?) *për librat.*

Siç shihet, të gjitha fjalët që kanë pyetjen përpara, janë folja-kallëzues dhe gjymtyrët e dyta që plotësojnë foljen-kallëzues;

këto gjymtyrë të dyta ose u përgjigjen pyetjeve me ndajfolje (kur?- ku?) ose u përgjigjen pyetjeve me përemra

(kujt?- çfarë? - kë? -për çfarë?)

Tani le të heqim nga grupet foljore gjymtyrët që tregojnë kohën dhe vendin ku kryhet veprimi, pra që u përgjigjen pyetjeve kur? dhe ku?.

... (ç'bëra?) *isha* ... dhe (ç'bëra?) *i mora* (kujt?) *vëllait* (çfarë?) *librin.*


... (ç'bëra?) *takova* (kë?) *Altinin dhe biseduam* (për çfarë?) *për librat.*

Ç'mund të themi për gjymtyrët e dyta që kanë mbetur?

- Ato që të gjitha plotësojnë foljen.
- U përgjigjen pyetjeve me përemra.
- Tregojnë personin a sendin mbi të cilin bie ose me të cilin ka lidhje veprimi i shprehur nga folja. Gjymtyrë të dyta të tilla i quajmë **KUNDRINORË**.



Kundrinorët mund të jenë:



Kundrinori i drejtë

Kundrinori i drejtë është ajo gjymtyrë e dytë e fjalisë që tregon mbi kë bie veprimi i shprehur nga folja. Ai u përgjigjet pyetjeve: *kë? - cilin? - çfarë?*, që i bëhen foljes: *mora* (çfarë mora?) librin; *takova* (kë takova? cilin takova?) Altinin.

Kundrinori i zhdrejtë

Kundrinori i zhdrejtë është ajo gjymtyrë e dytë e fjalisë që tregon me kë ka lidhje veprimi i shprehur nga folja. Ai është dy llojesh: kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinor i zhdrejtë me parafjalë.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë u përgjigjet pyetjeve: *kujt? - cilit? - cilës? etj.*, që i bëhen foljes. ... i *mora* (kujt i mora?) vëllait; ... i *mora* (cilin i mora?) vëllait; i *mora* (cilës i mora?) motrës, i hodha një sy (cilin i hodha një sy?) peizazhit.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë u përgjigjet pyetjeve: *për çfarë? - për kë? - me se? - me kë? - me çfarë etj.*, që i bëhen foljes. ... *biseduam* (për çfarë biseduam) për librin; *bisedova* (me kë bisedova?) me Shpresën; i *folja* Shpresës (për kë i folja?) për Altinin.

Kundrinorët shprehen me emra, por edhe me përemra:

Kundrinori i drejtë: ... *takova* Altinin → *takova* atë.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë: ... i *mora* vëllait → i *mora* atij.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë: ... *bisedova* me Shpresën → *bisedova* me atë.



KUJDES

Kundrinori i drejtë, përveç emrit ose përemrit me të cilin shprehet, mund të shoqërohet edhe nga një trajtë e shkurtër e përemrit vetor, p.sh.: Unë *mora* librin. Unë **e** mora **librin**. Ai mund të shprehet edhe vetëm me trajtë të shkurtër, p.sh.:

Kritika është ilaç i hidhur, por të shëron.

Kurse kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë shoqërohet gjithnjë nga një trajtë e shkurtër e përemrit vetor:

Unë **i** mora **vëllait** librin. (S'mund të thuhet: Unë *mora* vëllait librin?!)

Edhe ky mund të shprehet vetëm me trajtë të shkurtër: **Më** erdhën në shtëpi shokët e klasës.

1. Dallo kundrinorët, thuaj cilës pyetje i përgjigjen dhe ç'lloj janë.

1. Lëmashku bren gurin, përtimi fik burrin.
2. Shkolla e bën të ditur njeriun.
3. Bardha kujdesej shumë për kanarinat.
4. Asaj i pëlqejnë shumë këngët popullore.
5. Gjuha bashkon kombin.
6. Guna e huaj s'të mban ngrohtë.
7. Për Taulantin më kishte folur një shok.
8. Migjeni i dha vargut shpirtin e tij.
9. Basketbolli më ka pëlqyer gjithmonë.
10. Nga kali i huaj të zbresin.
11. Mos e shuaj zjarrin me vaj.

2. Në fjalitë e mësipërme trego me se janë shprehur kundrinorët.

Në cilat raste kundrinori shoqërohet nga:

trajta e shkurtër dhe në cilat raste kundrinori është shprehur vetëm me trajtë të shkurtër?

3. Shkruaj fjalitë duke vënë në vend të pikave trajtat e shkurtra që duhen.

1. Armikut mos... kthe krahët.
2. Gënjeshtarit vetëm një herë... shkon fjala.
3. ... bën bujku arën, s'... bën ara bujkun.
4. Unë po... drejtohem juve.
5. Mos... var maces zile.
6. Pranvera... veshi drurët e pyjeve me petk të ri.

4. Në fjalitë që shkrove, nënvizo kundrinorët dhe bashko me shigjetë trajtën e shkurtër me kundrinorin që

shoqëron. Shëno ç'lloj kundrinori është secili.

Shembull:

Armikut mos i kthe krahët.

(k. i zhdr.pa parafjalë) (kundrinor i drejtë)

5. Krijë dhe shkruaj fjali ku emri shok të përdoret si:

- kundrinori i drejtë i pashoqëruar nga trajta e shkurtër.
- kundrinor i drejtë i shoqëruar nga trajta e shkurtër
- kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë.
- kundrinor i zhdrejtë me parafjalë.

Nënvizo kundrinorët.

6. Çdo çift fjalësh vendose në fjali në mënyrë që fjala e parë të jetë kundrinori i drejtë, kurse e dyta, kundrinor i zhdrejtë. Shkruaj fjalitë.

1. gazetë, gjysh;
 2. libër, motër;
 3. lule, nënë;
 4. vjershë, mësuese.
- Nënvizo kundrinorët.

Provoni njohuritë që keni

1. Analizo fjalinë poshtë figurës duke bërë pyetjen për çdo gjymtyrë.
2. A mund të heqësh ndonjë prej tri gjymtyrëve? Provo.
3. A do të ishte e rregullt fjalia, sikur t’u ndërroje vendin gjymtyrëve? Provo.
4. Provo të shtosh në fjalinë e dhënë gjymtyrë të tjera që t’u përgjigjen pyetjeve kur?-ku?-si?.



Takim shokësh

Shkruaji fjalitë e zgjeruara.

Rrethanori

Tani të provojmë së bashku të zgjerojmë fjalinë e dhënë sipas pyetjeve:

Kur e takoi Besniku Albin? – Besniku e takoi Albin të dielën.

Ku e takoi Besniku Albin? – Besniku e takoi Albin në park.

Si e takoi Besniku Albin? – Besniku e takoi Albin rastësisht.

Madje mund t’u përgjigjemi të tria pyetjeve me një fjali të vetme:

Besniku e takoi Albin rastësisht të dielën, në park.

Gjymtyrët që shtuam, plotësojnë foljen:

E takoi rastësisht, e takoi të dielën, e takoi në park.

Ato janë gjymtyrë të dyta që u përgjigjen pyetjeve me ndajfolje: kur?-ku?-si? etj., dhe tregojnë një rrethanë të kryerjes së veprimit: kohën-vendin-mënyrën etj.

Gjymtyrë të dyta të tilla i quajmë rrethanorë.

Rrethanori është një gjymtyrë e dytë e fjalisë që plotëson foljen duke treguar një rrethanë të kryerjes së veprimit të shprehur prej saj. Ai u përgjigjet pyetjeve me ndajfolje që i bëhen foljes.

Në dallim nga kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë, rrethanori mund të hiqet dhe fjalia të jetë përsëri e pranueshme:

Besniku e takoi Albin të dielën – Besniku e takoi Albin.

Një veçori tjetër e rrethanorit është se ai mund të ndërrojë vend lirisht në fjali:

- *Besniku e takoi Albin të dielën.*

- *Besniku e takoi të dielën Albin.*

- *Të dielën Besniku e takoi Albin.*

- *Besniku të dielën e takoi Albin*

Llojet e rrethanorëve

Sipas rrethanës që tregojnë, rrethanorët marrin edhe emrin:

1. Rrethanori i vendit

- Tregon vend. - *Besniku e takoi Albin në park.*
- I përgjigjet pyetjes ku?, që i bëhet foljes.- (ku e *takoi?*) në park.
- Zakonisht shprehet me:
- *Emër me ose pa parafjalë* - ... e *takoi* në park; e *takoi* rrugës.
Ndajfolje vendi, si : këtu, atje, përpara, larg, brenda, sipër, poshtë etj. - *Besniku e takoi Albin atje.*

2. Rrethanori i kohës

- Tregon kohë. - *Besniku e takoi Albin të dielën.*
- I përgjigjet pyetjes kur?, që i bëhet foljes. - (kur e *takoi?*) të dielën.
- Zakonisht shprehet me:
- *Emër me ose pa parafjalë* - e *takoi* të dielën; e *takoi* në mbrëmje
- *Ndajfolje kohe*, si : dje, sot, nesër, dikur, vonë, pastaj etj. - e *takoi* dje.

3. Rrethanori i mënyrës

- Tregon mënyrë. - *Besniku e takoi Albin rastësisht.*
- I përgjigjet pyetjes si?, që i bëhet foljes. - (si e *takoi?*) rastësisht.
- Zakonisht shprehet me:
- *Emër me parafjalë* - *Besniku e përqafoi shokun me mall.*
- *Ndajfolje mënyre*, si : bukur, mirë, keq, ngadalë, shpejt, miqësisht etj, → *Ai i foli miqësisht.*

4. Rrethanori i sasisë

- Tregon sasi. - *Besniku u gëzua shumë.*
- I përgjigjet pyetjes sa?, që i bëhet foljes. - (sa u *gëzua?*) shumë .
- Zakonisht shprehet me:
- *Emër me parafjalë* - u *gëzua* pa masë.
- *Ndajfolje sasië*, shumë, pak, tepër etj.- u *gëzua* tepër.

5. Rrethanori i shkakut

- Tregon shkak.- *Gjyshja u përlot nga mallëngjimi.*
- I përgjigjet pyetjes pse?, që i bëhet foljes. - (pse u *përlot?*) nga mallëngjimi.
- Zakonisht shprehet me emër me parafjalë. - u *përlot* nga mallëngjimi.

6. Rrethanori i qëllimit

- Tregon qëllim. - *Kreshniku ka shkuar në Itali për studime.*
- I përgjigjet pyetjes përse?, që i bëhet foljes. - (përse ka *shkuar?*) për studime.
- Zakonisht shprehet me emër me parafjalë. - ka *shkuar* për studime.

KUJDES

Rrethanorët mund të shprehen edhe me një grup fjalësh, kur këto nuk mund të qëndrojnë si gjymtyrë më vete në fjali, p.sh.: Ky libër kushton 200 lekë. Ata mund të shprehen edhe me forma të pashtjelluara të foljes, p.sh.: Shokët u ulën në një stol për të pushuar.

Ç'lloj rrethanori dalloni në këta dy shembuj?

1. Dallo rrethanorët dhe thuaj cilës pyetje i përgjigjen e ç'lloj janë.

1. Linda me të motrën shkojnë shpesh në bibliotekë.
2. Në stacion autobusi qytetas u mbush plot.
3. Ata e pleqëruan çështjen fshatçe.
4. Salla gjëmonte nga duartrokitjet.
5. Atdheu pret shumë prej nesh.
6. Ushtarët prenë shkurre e degë për t'u maskuar.
7. Nesër të shkojmë tek Altini.
8. Grupi folklorik vazhdonte me këmbëngulje provat.
9. Artanit i pëlqeu tepër gjuetia e peshkut.
10. Ne vajtëm atje për punë.
11. Turtujt uleshin arave për të kullotur.
12. Gryka e Drinit ushtoi sërish nga era.

2. Për secilin rrethanor që dallove, trego me se është shprehur dhe cilën gjymtyrë plotëson në fjali.

3. Në vend të pikave vendos njërin nga rrethanorët e dhënë në kllapa dhe thuaj ç'lloj është. Shkruaj fjalitë.

1. Sirena e lokomotivës fërshëlleu ...
2. ... gjëmonte deti.
3. ... ata arritën buzë Vjosës.
4. Njerëzit e dëgjonin ...
5. Që nga maja e kodrës qyteti dukej ...
6. ... nëna u zgjua që pa gdhirë.
7. ... dukeshin shtëpizat rrethuar me kangjella.
8. U shërofsh...!
9. Ajri i asaj nate pranvere dridhej... të fyellit.
10. Fëmijët u shtrinë...

(nga ata tinguj, atë mëngjes, si në pëllëmbë të dorës, për të marrë një sy gjumë, pas një ore, në fund të rrugës, nga koha e keqe, një orë e më parë, disa herë, me gojë hapur)

4. Shpjego për çdo rast pse rrethanorët që shtove në fjali, janë shprehur me një togfjalësh.

5. Plotëso fjalitë sipas kërkesave dhe shkruaj të plotësuarat. Nënvizu rrethanorët.

1. Besës i ishin skuqur duart (rrethanor shkaku).
2. Nëna u vesh (rrethanor mënyre), hodhi shallin (rrethanor vendi) dhe doli (rrethanor vendi).
3. Ne shkojmë në shkollë (rrethanor qëllimi).
4. Majlinda (rrethanor kohe) vishet (rrethanor mënyre).
5. Mua më ka pëlqyer (rrethanor sasi) ai film.

TEST
(VETË) VLERËSIM

Kontrollo njohuritë për gjymtyrët e dyta të fjalisë.
Zgjidh tekstet me ngjyrë të ndryshme nga shoku i bankës.

1. Kopjo fjalitë:

Në mëngjes, shoku im i bankës i bleu gjyshit në librari gazetën e sotme. Tani gjyshi po bisedon gjithë kënaqësi me nipin.

Dje, motra ime e madhe i çoi Blerinës në shtëpi librin e gjuhës. Këtë javë motra takohet ditë për ditë me Blerinën.

a) Nënvizu kryefjalën, kallëzuesin, përcaktorët, kundrinorët dhe rrethanorët.

1 pikë

b) Trego llojin e kundrinorëve dhe të rrethanorëve
(me shkurtime poshtë nënvizimeve, p.sh: k.d.- k.zh.p.- k.zh.m.- rr.v.- rr.k.-rr.m. etj.)

2 pikë

2. Ndërto dhe shkruaj fjalinë e mëposhtme duke e plotësuar me përcaktorët, kundrinorët dhe rrethanorët e shënuar në kllapa. Shkruaj dy fjali ku folja jam, të jetë në mënyrën dëftore.

2 pikë

[Rreth.vendi] një vajzë [përcaktor mb. i nyjshëm] po këndon [kundr. i drejtë] [përcaktor emër me parafjalë]. [në skenë, për nënën, një këngë, e vogël]

[Rreth. kohe] një nxënës [përcaktor mb. i nyjshëm] do të recitojë [kundrinor i drejtë] [përcaktor emër me parafjalë] [për pranverën, më vonë, i talentuar, një poezi]

3. Emrin:

3 pikë

Vëlla

Motër

kur midis fjalive të ketë:

- një fjali me kallëzues emëror,
- një fjali me kallëzues të përbërë,
- një fjali me kryefjalë të shumëfishtë.

Nënvizu gjymtyrët kryesore në këto fjali.

4. Zgjero fjalinë:

2 pikë

Skuadra luajti.

Portieri u dëmtua.

Duke shtuar:

dy përcaktorë të kryefjalës dhe dy rrethanorë (kohe dhe mënyre)

dy përcaktorë të kryefjalës dhe dy rrethanorë (sasi dhe vendi)

Llogarit vetë pikët që ke marrë!

PËRDORIMI DREJT I SHKRONJËS SË MADHE NË FJALI

Romani "Aktori", i Ismail Kadaresë, u shkrua në vitet 2001-2002 në Paris.

U botua në shqip dhe në frëngjisht, me titullin "**Jeta** dhe vdekja e **Lul Mazrekut**", titull me të cilin njihet në shumicën e përkthimeve. **Titulli** i ri "**Aktori**", përdoret për herë të parë në botimin e plotë të veprave të shkrimtarit.

Provoni njohuritë që keni

1. Çfarë janë fjalë me shkronjat e theksuara të zeza (**bold**)? _____
2. Me çfarë shkronjë fillojnë ato? _____
3. Kanë ndonjë veçori të përbashkët që janë shkruar me shkronja të mëdha? _____

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.

Romani "Aktori", i Ismail Kadaresë, u shkrua në vitet 2001-2002 në Paris.

U botua në shqip dhe në frëngjisht, me titullin "**Jeta** dhe vdekja e **Lul Mazrekut**".

Me shkronjë të madhe shkruhen:

1. emrat dhe mbiemrat e njerëzve, epitetet dhe pseudonimet e tyre, gradat, postet e tyre: Skënderbeu, Ismail Qemali, Ismail Kadare, Aleksandri i Madh i Maqedonisë, etj.
2. emrat e përveçëm të kafshëve: Baku, Balua, Hachiko, Bambi etj.
3. emrat e planetëve, të yjeve, të konstelacioneve: Jupiter, Neptun, Saturn, Ylli Polar, Orion etj.
4. emërtimet gjeografike të një vendi, të një kontinenti, të botës: Gadishulli i Karaburunit, Ishulli i Sazanit, Ishulli i Sardenjës, Vargmalet e Sharrit, Deti i Veriut, Deti Kaspik, Uellsit, Groenlanda etj.
5. emërtimet e institucioneve dhe të partive politike: Parlamenti i Shqipërisë, Kryeministria, Ministria e Kulturës, Partia e Mbrojtjes së Mjedisit, Avokati i Popullit etj.
6. emërtimet e periudhave ose të ngjarjeve të mëdha historike: Koha e Neolitit, Paleoliti, Mesjeta e Vonë, Iluminizmi, Rilindja, Zbulimi i Amerikës, Lufta e Dytë Botërore, Futurizmi etj.
7. emërtimi i monumenteve të kulturës: Mozaiku i Durrësit, Amfiteatri i Apolonisë etj.

Me shkronjë të madhe shkruhen:



OKB, organizatë e rëndësishme botërore, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe paqes në botë.

1. Titujt e librave, emrat e rrugëve: "Mos", "Luigj Gurakuqi" etj.
2. Nyjat dhe pjesëzat e mbiemrave të huaj, shkruhen me të vogël, p.sh.: Edmond de Amicis, Antuan de Sent Eskzyperi etj.
3. Emrat e përgjithshëm, kur përdoren si personifikime të një qenie, p.sh.: Ja, po vjen me sajën ngarkuar Plaku i Vitit të Ri!
4. Emrat e shteteve, organizatave, shoqatave etj., kur shkurtohen shkruhen me shkronja të mëdha, pa vënë pikë as ndërmjet as në fund të tyre, p.sh.: **BE** (Bashkimi Europian), **RSH** (Republika e Shqipërisë), **SHBA** (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), **OKB** (Organizata e Kombeve të Bashkuara).
5. Pas dy pikave, kur fillon ligjëratë e drejtë, që vihet midis thonjzave. Populli ynë thotë: "Duaje atdhenë si shqiponja folenë" etj.

Shënim. Emrat dielli, hëna, toka, kur nuk përdoren si terma të astronomisë nuk shkruhen me shkronjë të madhe. Për shembull: vajza kishte hirin si të hënës, në lulishte kishte pjesë toke të zhveshur nga gjelbërimi etj.

DREJTSHKRIMI I ZANOREVE E DHE Ë, TË THEKSUARA DHE TË PATHEKSUARA, NË POZICIONE TË NDRYSHME

Provoni njohuritë që keni

1. Zanorja e e theksuar

- a) Fjalët që kanë **e** të theksuar para bashkëtingëlloreve m, n, nj, shkruhen me e dhe jo me ë:
emër, qendër, shenjë.
- b) Me **e** shkruhen edhe fjalët: *dre, fle, ngre, pe.*

2. Zanorja ë e patheksuar

- Te fjalët që në trajtën e pashquar të njëjësit kanë **e** të patheksuar në fund të fjalës, si p.sh.:
lule, në emëroren e shquar **e**-ja bie:
lule - lulja, nxënëse - nxënësja.
- Kurse në rasat e tjera ajo shkruhet: *luleje, nxënëseje.*

3. Zanorja ë e theksuar

- Shkruhen me **ë** të gjitha fjalët tek të cilat zanorja **ë** e theksuar i përgjigjet në dialektin e Veriut një **a**-je të ndjekur nga bashkëtingëlloret: m, n, nj,
si: *ëndje* (krahaso-*ândje*) e *ëma* (krahaso-*e âma*).

4. Zanorja ë e patheksuar,

a) Kur ndodhet para theksit të fjalës:

- shkruhet tek të gjitha fjalët: *dëbórë, lëkúnd;*
- shkruhet te fjalët e prejardhura që janë formuar nga një temë me **ë** me anë prapashtesash që fillojnë me bashkëtingëllore: *anëtár, botëror;*
- shkruhet te fjalët e përbëra e të përngjitura që kanë si pjesë të parë një temë me **ë** të ndjekur nga një temë që nis me bashkëtingëllore: *buzëqesh, frymëmarrje, çfarëdo.*
- shkruhet te fjalët e prejardhura të formuara prej temash me **-ër, -ërr, -ël, -ës, -ëz** me anë prapashtesash që fillojnë me zanore: *arbëror, numëror, zemëroj.*

KUJDES

1. Nuk shkruhet ë-ja paratheksore te përemrat, ndajfoljet e lidhëzat që kanë si pjesë të parë gjithë ose kurrë, p.sh.: gjithçkáká, gjithkúnd, kurrkúsh, kurrkúnd etj.

a) Nuk shkruhet ë-ja paratheksore te fjalët:

- amtár, besnik, furrtar, lojtár, rojtár, zyrtár, atdhé, fillestar, për shkak të ngulitjes prej kohësh (ka zënë vend).*

b) kur ndodhet pas theksit të fjalës,

- shkruhet tek emrat femërorë me **-ëz** dhe tek emrat dhe mbiemrat mashkullorë me **-ës**, si: *drejtëz, çelës, tetërrokësh, pallat dykatësh.*
- shkruhet te mbiemrat me **-ët**: *i dóbët, i cekët, i ngáthët.*

KUJDES

Nuk shkruhet ë-ja pastheksore tek emrat dhe mbiemrat me -ël, -ër, -ërr, kur shquhen dhe gjatë lakimit:

púpła, végła, dhélpra, kókrra, ëndrra, (i,e) një púple, (prej) ca kókrash etj.

c) kur ndodhet në fund të fjalës, shkruhet te fjalët që në krye të herës me theks në rrokjen e parafundit:

enë, bukë, burrë, i ftohtë, i artë, i drejtë.

KUJDES

Te çiftet e fjalëve më poshtë, mbiemrat shkruhen me ë, ndajfoljet pa ë:

i drejtë-drejt, i fortë-fort, i kotë-kot

i lartë-lart, i plotë-plot, i shpejtë-shpejt

i thjeshtë-thjeshtë, i vërtetë-vërtet, i mbrapshtë-mbrapshtë;

- shkruhet te trajtat e shumësit të emrave dhe të mbiemrave mashkullorë:
shqiptarë, lejlekë, punëtorë, ushqimorë
- shkruhet tek emrat femërorë me "më":
basëmë, dasëmë, gjysëmë
- shkruhet tek numërorët themelorë:
pesë, dhjetë, tetëdhjetë (por njëzet, dyzet, njëqind).

KUJDES

Nuk shkruhen me ë fundore emrat dhe mbiemrat me -ël, -ërr, -ër, -ëz, -ull, -ur, që në emëroren e pashquar të njëjësit nuk e kanë theksin në rrokjen e fundit:

pupël, motër, puçërr, gishtëz, vetull, flutur;

Si edhe emrat e mbiemrat që në shumësin e pashquar dalin me -gj, -q, -j, -nj, të prira nga një zanore:

zogj, fiq, bij, ftonj.

Nuk shkruhet gjithashtu te mbiemrat e formuar nga emra, numërorë e ndajfolje me theksin në rrokjen e parafundit:

(i) akullt, (i) kaltër, (i) tepërt.

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Lexoju si duhet fjalët dhe shkruaji të plotësuara.

p_pla, v_gla, dh_lpra, k_krra, _ndrra, (i,e) një p_ple, (prej) ca k_krrash

2. Zgjidh formën e drejtë dhe shkruaje.


shëmbull-shëmbull; qendër-qëndër; zëvendës-zëvendës;

i shtrenjtë-i shtrenjtë; flë-flë; lulishtja-lulishteja; i një lulishte-i një lulishteje

FUSHA LEKSIKORE E FJALËS

Provoni njohuritë që keni

1. Ndërto në fletore familjen e fjalëve të emrit dorë.
2. Krahasoje punën tënde me skemën e mëposhtme.
3. Cila është pjesa e përbashkët për të gjitha fjalët?



Fusha leksikore e fjalës

Në skemën e mësipërme, fjalët: *dorazi, dorac, doracak, dorëz, dorezë, përdor, përdorues, përdorim, dorëzoj, dorëzim, dorëzues, shpërdor, shpërdorues, shpërdorim*, janë fjalë të prejardhura të formuara me ndihmën e parashtesave a të prapashtesave. Të gjitha këto fjalë kanë një pjesë të përbashkët, fjalën bazë ose fjalën rrënjë *dorë*. Ndaj themi se formojnë një *familje fjalësh*.

Por, kur përmendim fjalën *dorë*, si gjymtyrë e trupit të njeriut, vetiu na shkon mendja te fjala këmbë, që është një tjetër gjymtyrë. Në këtë kuptim themi se fjala *dorë* bën pjesë në fushën leksikore të fjalës gjymtyrë, ku bën pjesë gjithashtu edhe fjala këmbë.

Pra, fjalët *dorë* dhe këmbë formojnë fushën leksikore të fjalës gjymtyrë, e cila, si të thuash, i përmbledh ato.

Gjymtyrë → dorë, këmbë

Fjalët e veçanta që i përgjigjen nga ana kuptimore një fjale më të përgjithshme, që i përmbledh ato, formojnë fushën leksikore të kësaj fjale.

Për shembull, fusha leksikore e fjalës *prind* është: nënë, baba. Fusha leksikore e fjalës *ngjyrë* formohet nga shumë fjalë: *ngjyrë e kuqe, e verdhë, e gjelbër, e zezë, e bardhë etj.*

USHTROHUNI DHE TREGONI SA KENI MËSUAR

1. Shkruaj fjalët e veçanta që formojnë fushën leksikore të fjalës së përgjithshme: *lule, perime*. Bëj paraqitjen grafike.
2. Cila do të ishte fjala e përgjithshme ose fjala etiketë për këto fusha leksikore?
 - (*fruth, verdhëz, shytat, tuberkuloz, sida etj.*)
 - (*hallë, nip, mbesë, dajë, teze, xhaxha, kushëri etj.*)
 - (*pantallona, triko, pallto, kapelë, xhaketë, jelek, fund, fustan...*)
 - (*kumri, harabel, qukapik, dallëndyshe, lejlek...*)



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Doksani, Jorgji

Gjuha shqipe 6 / Jorgji Doksani, Loredan Bubani ; red.
Hajrije Hoxha. - Tiranë : SHBLSH e Re, 2026.

... f. ; ... cm.

ISBN 9789994325139

I.Bubani, Loredan

1.Gjuha shqipe 2.Tekste për shkollat 9-vjeçare

811.18 (075.2)